



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 370 Akti

Nr. 604 Vendimi
Tiranë, më 21.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 9.12.2022, ora 10:00; në datën 12.12.2022, ora 13:00 dhe 16:00; në datën 13.12.2022, ora 15:00; në datën 14.12.2022, ora 10:00 dhe në datën 19.12.2022, ora 16:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Andri Ymeri**, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancat dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri, aktualisht me funksionin gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Roland Ilia.

3.1. Në mbledhjen e datës 20.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues, znj. Pamela Qirko, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga asnjë anëtarët e këtij trupi, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Andri Ymeri.

3.2. Pas njohjes me rezultatet hetimit të dërguara në datën 19.4.2022, bazuar vetëm mbi kriterin e pasurisë dhe paraqitjes së shpjegimeve shoqëruar me prova, subjekti është ftuar në seancë dëgjimore¹.

3.3. Subjekti, gjatë seancës dëgjimore të datës 13.6.2022, ka kërkuar përjashtimin nga trupi gjykues të dy komisionerëve, anëtarë të trupit gjykues, përkatësisht të relatorit Roland Ilia dhe anëtares Etleda Çiftja.

3.4. Me vendimin e datës 15.6.2022, trupi gjykues i zgjedhur me short² ka vendosur pranimin e kërkesës për përjashtim të komisionerit Roland Ilia.

3.5. Me vendimin e datës 17.6.2022, trupi gjykues i zgjedhur me short³ ka vendosur pranimin e kërkesës për përjashtimin e komisioneres Etleda Çiftja.

3.6. Me vendimin nr. 22, datë 17.6.2022, të Komisionit, është caktuar me short relatorja e re e subjektit Andri Ymeri, komisionerja Genta Tafa (Bungo).

3.7. Me vendim nr. 23, datë 17.6.2022, është caktuar me short anëtarja e re e trupit gjykues, komisionerja Firdes Shuli.

4. Dy anëtarët e rinj të trupit gjykues kanë deklaruar menjëherë mospasjen e konfliktit të interesit. Për këtë ndryshim të trupit gjykues subjekti është njohur nëpërmjet postës elektronike, duke iu kërkuar të shprehet në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit në raport me anëtarët e rinj.

4.1. Në *email*-in e datës 21.6.2022 subjekti nuk është shprehur në lidhje me ndonjë konflikt interesi me anëtarët e rinj të trupit gjykues.

¹ Për më shumë shihni në vijim në pjesën II “Seanca dëgjimore”.

² Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. 21, datë 14.6.2022, të Komisionit.

³ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. 20, datë 14.6.2022, të Komisionit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 5, datë 21.6.2022, ka vendosur riçeljen e hetimit administrativ për subjektin Andri Ymeri dhe vijimin e hetimit për të tria kriteret e vlerësimit.

6. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Andri Ymeri nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

7. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

10. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

11. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar raportin⁴ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Andri Ymeri. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

12. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. ***prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 12.7.2022, të KDZH-së. Në datën 26.9.2022 DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., të përditësuar, të kontrollit të figurës, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 10.10.2022.

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.11.2018.

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport⁵ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

14. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

15. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 28.10.2022 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit Andri Ymeri, si dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

16. Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike të datës 31.10.2022 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, duke iu përcaktuar si afat data 14.11.2022, ora 12:00.

17. Në datën 1.11.2022 subjekti ka kërkuar nga Komisioni kohë shtesë deri më 27.11.2022, me qëllim përgatitjen e mbrojtjes së tij në përgjigje të barrës së provës.

17.1. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën, vendosi ta pranojë atë, duke e njoftuar subjektin po në datën 1.11.2022 se mund të paraqiste provat dhe shpjegimet e tij brenda datës 27.11.2022.

17.2. Në datën 25.11.2022 subjekti i është drejtuar përsëri Komisionit me kërkesë për shtyrje afati deri më 30.11.2022, për arsye shëndetësore të nënës së tij. Bashkëlidhur kësaj kërkesë subjekti ka dërguar një dokument në funksion të mbrojtjes së tij, që sipas subjektit është 264 faqe, i papërpunuar, redaktuar dhe i pakonsultuar me mbrojtësit e tij.

17.3. Komisioni, pasi vlerësoi kërkesën e subjektit, shoqëruar me dokumentacion mjekësor për kushtet shëndetësore të nënës së tij, e pranoi atë duke caktuar si afat të ri datën e kërkuar nga subjekti, 30.11.2022. Në të njëjtin njoftim subjektit iu soll në vëmendje detyrimi ligjor për të përmbyllur këtë proces brenda një afati të arsyeshëm.

17.4. Në datën 29.11.2022 subjekti ka dërguar nëpërmjet postës elektronike shpjegimet e tij. Në tekstin e *email*-it shoqërues subjekti ka kërkuar me mirësjellje që materiali të lexohet me kujdes, pasi nuk ka vetëm shpjegime, por edhe kërkesa procedurale në brendësi të tij. Ai ka bërë një grupim të kërkesave⁶, por pa i specifikuar ato. Subjekti ka kërkuar që të gjitha kërkesat e tij të shqyrtoheshin nga Komisioni përpara datës së seancës. Subjekti ka vlerësuar të nevojshme dhe gjithashtu edhe si të drejtë të tij procedurale që të njihet me vendimmarrjet e Komisionit përpara seancës, të paktën 2 ditë, në mënyrë që të modelojë përfundimisht sjelljen e tij procedurale në seancën dëgjimore.

17.5. Në datën 30.11.2022 Komisioni i është drejtuar subjektit me anë të postës elektronike, duke i kërkuar të adresonte kërkesat e tij procedurale në një/disa dokumente të ndara nga dokumenti i mbrojtjes së tij, në mënyrë që Komisioni të jetë korrekt dhe i plotë në vlerësimin

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.5.2020.

⁶ Kërkesa për thirrje dëshmitarësh; kërkesa për thirrjen si palë të interesuara në procesin administrativ; kërkesa për pezullimin e procesit deri sa të zgjidhen çështje të tjera civile/administrative/penale.

e tyre. Në lidhje me këtë kërkesë të Komisionit, subjekti ka kërkuar kohë për të dërguar kërkesat e tij procedurale.

17.6. Në datën 30.11.2022, subjekti, së bashku me provat, ka depozituar dorazi⁷ dhe ridërguar me anë të postës elektronike në datën 1.12.2022 një kërkesë të përfaqësuesit të tij A.Ll për shtyrje afati prej 10 ditësh, me qëllim njohjen me dosjen e rivlerësimit të subjektit që ai përfaqëson. Këtë kërkesë ai e arsyeton me faktin se i përfaqësuari prej tij i ka vënë në dispozicion dokumentacionin e procesit të rivlerësimit, pikërisht atë ditë, në datën 30.11.2022.

17.7. Me anë të postës elektronike, në datën 1.12.2022, Komisioni i është përgjigjur subjektit, duke vendosur *cc* përfaqësuesin e tij, se mbetet në pritje të evidentimit të kërkesave të tij procedurale brenda datës 5.12.2022, ndërkohë që nuk ka pranuar plotësisht kërkesën për shtyrje afati të bërë nga avokati i tij, duke arsyetuar se: (i) z. A.Ll është avokati i subjektit që nga data 26.5.2022, pra subjekti ka pasur kohën e mjaftueshme për të qenë në kontakt me të dhe për ta njohur me dokumentacionin; (ii) subjektit i është dhënë afat për të paraqitur mbrojtjen nga data 31.10.2022, kur i janë dërguar rezultatet e hetimit, deri në datën 14.11.2022; (iii) ka kërkuar kohë shtesë dhe Komisioni e ka pranuar kërkesën duke e shtyrë afatin deri në datën 27.11.2022; (iv) subjekti kërkoi përsëri kohë shtesë, duke arsyetuar, përveç të tjerave, edhe rishikimin e materialit nga avokatët. Komisioni ka pranuar përsëri kërkesën në datën 25.11.2022, duke caktuar një afat të ri në datën 30.11.2022; (v) në datën 1.12.2022 avokati i subjektit A.Ll kërkoi përsëri kohë shtesë prej 10 ditësh, duke arsyetuar se i janë vënë në dispozicion materialet vetëm në datën 30.11.2022. Komisioni vlerësoi se kërkesat për shtyrje të afatit tejkalojnë kufijtë e të arsyeshmes, megjithatë, meqenëse subjektit iu caktua si afat për paraqitjen e kërkesave procedurale data 5.12.2022, i njëjti afat iu mundësua edhe avokatit A. Ll, duke pranuar pjesërisht kërkesën e tij. Komisioni ka vlerësuar të sjellë në vëmendje të subjektit se mungesa e komunikimit të tij me avokatin nuk mund të jetë shkak i arsyeshëm për shtyrje dhe zvarritje të procesit.

17.8. Në datën 5.12.2022, nëpërmjet postës elektronike, subjekti i ka dërguar Komisionit dokumentin “Sqarim për kërkesat procedurale”⁸. Në këtë dokument subjekti ka pretenduar se: (i) vlerëson se është e drejta e tij e mbrojtjes të zgjedhë nëse kërkesat procedurale do t’i paraqesë të integruara në një dokument të vetëm që përmban edhe shpjegimet e tij apo veçmas në një apo disa dokumente të ndara; (ii) vlerëson se Komisioni ka detyrimin korrespondues të individualizojë ato që ai i quan kërkesa procedurale në fazën e hetimit administrativ; (iii) marrja e përgjigjes paraprake lidhur me kërkesat procedurale të parashtruara në përmbyllje të fazës së hetimit administrativ shërben për të modeluar sjelljen e tij procedurale në gjykimin administrativ, pra në seancën dëgjimore.

17.9. Subjekti ka vijuar sqarimin se paraqitja e kërkesave procedurale në një dokument të vetëm dhe të integruar me shpjegimet e mbrojtjes së tij, ndër të tjera, ka për qëllim që të sigurohet dhe garantohet se materiali i tij i mbrojtjes të lexohet, studiohet dhe vlerësohet pikërisht nga anëtarët e trupit gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar, të cilët me këtë rast duhet të marrin vendime të ndërmjetme, që duhet të njoftohen me shkrim. Madje për të ndihmuar Komisionin për të qenë korrekt dhe i plotë në trajtimin e kërkesave procedurale të hetimit administrativ, subjekti ka përcaktuar radhën e shqyrtimit të këtyre kërkesave. Në përfundim, subjekti ka qartësuar se i përket Komisionit detyrimi të jetë korrekt dhe i plotë në individualizimin e kërkesave dhe se pikërisht mënyra se si Komisioni do të përmbushë këtë detyrim do t’i japë shembullin modelues të sjelljes së tij në seancën dëgjimore.

⁷ Kërkesa mban nr. *** prot., datë 30.11.2022.

⁸ Për më shumë shihni *email*-in e subjektit, dërguar në datën 5.12.2022, ora 10:33.

17.10. Po në datën 5.12.2022, Komisioni, pasi mori në shqyrtim kërkesat e subjektit, të cilat i kishte evidentuar qartësisht që më parë, me administrimin e materialit mbrojtës në datat 25.11.2022 dhe 29.11.2022, e njoftoi subjektin se: (i) përveç faktit se ka konstatuar se ka refuzuar të depozitohë kërkesat procedurale në formën e kërkuar nga ligji, ai ka abuzuar me afatin e kërkuar për të dërguar kërkesat procedurale, ka përdorur një gjuhë fyese, duke aluduar moskryerjen e detyrës nga Komisioni për leximin e kujdesshëm të materialit mbrojtës dhe kërcënues, duke theksuar se përgjigjja e Komisionit do të modelojë sjelljen e tij në seancë; (ii) ka vendosur: (a) të rrëzojë kërkesat për thirrjen e dëshmitarëve dhe personave të tretë në përputhje me germën “a” të nenit 49/6 të ligjit nr. 84/2016; (b) të rrëzojë kërkesën për pezullim të këtij procesi, pasi çështjet e pretenduara nga subjekti nuk lidhen me këtë proces rivlerësimi; (c) të rrëzojë kërkesën për hetime të mëtejshme, pasi dokumentacioni i pretenduar është i administruar nga Komisioni, si dhe në disa raste vlerësohet i panevojshëm për procesin; (ç) në lidhje me kërkesat për rillogaritje dhe vlerësim/rivlerësim të provave, Komisioni vlerëson se nuk mund të kryhen në këtë moment procedural, derisa të përfundojë dëgjesa e subjektit në seancë dëgjimore; (d) në lidhje me kërkesën e subjektit për konvalidimin apo jo të dokumentacionit të administruar deri në datën 19.4.2022, trupi gjykues konstaton se i gjithë dokumentacioni i administruar nga Komisioni që nga momenti i fillimit të procedurave të rivlerësimit janë pjesë e dosjes që i është vënë në dispozicion subjektit; (dh) në lidhje me dokumentacionin e subjektit A.P, dokumentacioni i depozituar nga subjekti Andri Ymeri dhe çdo dokumentacion i depozituar është pjesë e dosjes së rivlerësimit, që do t’i nënshtrohet shqyrtimit gjatë vendimmarrjes, pasi të zhvillohet seanca dëgjimore.

Kërkesat e mësipërme, të evidentuara përfundimisht nga dokumenti i dërguar nga subjekti me emërtimin “Memo-KPK-Shkodër” me *email*-in e datës 29.11.2022, janë të argumentuara në këtë vendim sipas vlerësimit të Komisionit.

18. Subjekti ka depozituar provat dhe shpjegimet e tij në datën 29.11.2022, nëpërmjet postës elektronike, si dhe në datën 30.11.2022 i ka depozituar⁹ ato pranë zyrës së protokollit të institucionit.

19. Pas administrimit të parashtrimeve të subjektit, provave dhe dokumentacionit, si dhe kthimit të përgjigjet të subjektit në lidhje me kërkesat e tij procedurale, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore¹⁰.

II. SEANCA DËGJIMORE

20. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 5.12.2022.

21. Seancat dëgjimore me subjektin e rivlerësimit janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

21.1. Këto seanca janë zhvilluar në datat:

- 27.5.2022 ora 11:00 - 11:48
- 13.6.2022 ora 10:00 - 12:58
- 9.12.2022 ora 10:00 - 11:29
- 12.12.2022 ora 13:00 - 13:26
- 12.12.2022 ora 16:00 - 18:56

⁹ Shihni dokumentin “Dorëzim dokumentesh”, përgatitur nga subjekti me shkrim dore, me nr. *** prot., datë 30.11.2022.

¹⁰ Vendimi i ndërmjetëm nr. 8, datë 5.12.2022.

- 13.12.2022 ora 15:00 - 21:07
- 14.12.2022 ora 10:00 - 19:55
- 19.12.2022 ora 16:00 - 16:14

22. Subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri, si dhe përfaqësuesit e tij ligjorë, morën të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

23. Në vlerësimin e përgjithshëm, Komisioni konstaton se z. Andri Ymeri nuk ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion Komisioni arrin nisur nga faktet e renditura në vijim.

23.1. Në afatin e përcaktuar nga Komisioni për të përmbysur barrën e provës të kaluar me rezultatet e hetimit, subjekti ka kërkuar dy herë shtyrje të afatit. Megjithatë Komisioni i ka pranuar këto kërkesa, ai, nëpërmjet avokatit, ka kërkuar përsëri shtyrje të afatit me pretendimin se dokumentacioni i dosjes së rivlerësimit i ishte komunikuar avokatit vetëm datën e përfundimit të afatit të caktuar për mbrojtjen. Komisioni konstaton se avokati është caktuar si përfaqësues ligjor i subjektit që në datën 26.5.2022 dhe vlerëson se ka pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për të bashkëpunuar me të përfaqësuarin e tij, për pasojë e çmon këtë qëndrim të subjektit dhe përfaqësuesit të tij si një tentativë për të shtyrë procesin e rivlerësimit pa shkaqe të arsyeshme.

23.2. Gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, subjekti ka bërë gjithsej 11 kërkesa për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues.

i) Në seancën e datës 13.6.2022, subjekti ka bërë dy kërkesa për përjashtim, përkatësisht të relatorit të çështjes Roland Ilia dhe anëtares së trupit gjykues Etleda Çiftja. Me vendimin e datës 15.6.2022, trupi gjykues i zgjedhur me short¹¹ ka vendosur pranimin e kërkesës për përjashtim të komisionerit Roland Ilia. Me vendimin e datës 17.6.2022, trupi gjykues i zgjedhur me short¹² ka vendosur pranimin e kërkesës për përjashtimin e komisioneres Etleda Çiftja.

ii) Në seancën e datës 9.12.2022 subjekti ka bërë kërkesë për përjashtimin¹³ e një prej anëtarëve të trupit gjykues, komisioneres Firdes Shuli. Trupi gjykues i zgjedhur me short¹⁴ vendosi në datën 9.12.2022 mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 12.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 16.12.2022.

iii) Në të njëjtën seancë, subjekti ka bërë kërkesë për përjashtim të komisioneres Pamela Qirko. Trupi gjykues i ngritur me short¹⁵ vendosi në datën 9.12.2022 të rrëzojë kërkesën e subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 12.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 14.12.2022.

iv) Në seancën e datës 12.12.2022, subjekti, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, paraqiti kërkesën për përjashtim të komisioneres Firdes Shuli. Trupi gjykues i ngritur me short¹⁶ vendosi në datën 12.12.2022 mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim

¹¹ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. 21, datë 14.6.2022, të Komisionit.

¹² Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. 20, datë 14.6.2022, të Komisionit.

¹³ Dërguar edhe me anë të postës elektronike në datën 8.12.2022, ora 05:01. Kjo kërkesë nuk identifikon se për cilën nga anëtarët e trupit gjykues është.

¹⁴ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. 45, datë 9.12.2022, të Komisionit.

¹⁵ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. 46, datë 9.12.2022, të Komisionit.

¹⁶ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. 47, datë 12.12.2022, të Komisionit.

iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 12.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 15.12.2022.

v) Po në seancën e datës 12.12.2022, subjekti ka paraqitur kërkesë për përjashtim të komisioneres Genta Tafa (Bungo). Trupi gjykues i ngritur me short¹⁷ vendosi në datën 12.12.2022 mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 12.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 15.12.2022.

vi) Po në seancën e datës 12.12.2022, subjekti ka paraqitur kërkesë për përjashtim të komisioneres Pamela Qirko. Trupi gjykues i ngritur me short¹⁸ vendosi në datën 15.12.2022 mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 15.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 16.12.2022.

vii) Po në seancën e datës 12.12.2022, subjekti ka paraqitur kërkesë të dytë për përjashtim të komisioneres Genta Tafa (Bungo). Trupi gjykues i ngritur me short¹⁹ vendosi në datën 12.12.2022 mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 15.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 16.12.2022.

viii) Në seancën e datës 13.12.2022, subjekti ka paraqitur kërkesën për përjashtimin e të tre anëtarëve të trupit gjykues, komisionereve Pamela Qirko, Firdes Shuli dhe Genta Tafa (Bungo). Trupi gjykues i ngritur me short²⁰ vendosi në datën 16.12.2022 mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 16.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 19.12.2022.

ix) Në datën 12.12.2022, subjekti, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, me anë të postës ka paraqitur pranë Komisionit kërkesën për përjashtim të komisioneres Firdes Shuli. Trupi gjykues i ngritur me short²¹ vendosi në datën 15.12.2022 mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 16.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 20.12.2022.

x) Me anë të postës elektronike të datës 15.12.2022, subjekti ka paraqitur kërkesën për përjashtimin e të tre anëtarëve të trupit gjykues, komisionereve Pamela Qirko, Firdes Shuli dhe Genta Tafa (Bungo). Trupi gjykues i ngritur me short²² vendosi në datën 16.12.2022 mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 16.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 19.12.2022.

24. Komisioni konstaton se të gjitha kërkesat e subjektit apo përfaqësuesve të tij nuk janë pranuar nga trupat e ngritura me short për këtë qëllim. Ky fakt krijon bindjen tek Komisioni se këto kërkesa kanë pasur për qëllim vetëm zvarritjen e procesit të rivlerësimit. Kjo bindje theksohet edhe nga fakti tjetër se, pavarësisht kërkesës së kryesueses së seancës për të paraqitur të gjitha kërkesat paraprake së bashku, që në fillim të seancës, me qëllim shqyrtimin e tyre menjëherë, pa penguar procesin, subjekti nuk ka pranuar, duke i depozituar këto kërkesa herë pas here, duke detyruar ndërprerjen e seancës për shqyrtimin e kërkesave nga trupa të tjera gjykuese.

¹⁷ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. 48, datë 12.12.2022, të Komisionit.

¹⁸ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. 49, datë 12.12.2022, të Komisionit.

¹⁹ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. 50, datë 12.12.2022, të Komisionit.

²⁰ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. 51, datë 15.12.2022, të Komisionit.

²¹ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. 52, datë 15.12.2022, të Komisionit.

²² Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin të Komisionit nr.53, datë 15.12.2022

25. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 14.12.2022, pasi subjekti kishte ushtruar të drejtën e tij të mbrojtjes për afro 10 orë²³, iu kërkua nga trupi gjykues të shprehë qëndrimin e tij përfundimtar në lidhje me procesin e rivlerësimit, në përputhje me pikën 2 të nenit 88 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti kërkoi kohë për të përgatitur konkluzionet e tij përfundimtare. Pavarësisht se nga ana e kryesueses iu qartësua se qëndrimi i tij përfundimtar nuk nënkupton të gjitha shpjegimet nga e para, trupi gjykues e pranoi kërkesën e subjektit, duke njoftuar zhvillimin e seancës tjetër në datën 19.12.2022.

26. Në seancën e datës 19.12.2022, sapo subjektit iu dha fjala për të shprehur qëndrimin e tij përfundimtar, përfaqësuesi i tij kërkoi të paraqiste dy kërkesa të tjera për përjashtim, përkatësisht për komisioneren Genta Tafa (Bungo) dhe një kërkesë për përjashtimin e të gjithë anëtarëve të trupit gjykues. Trupi gjykues, pasi u konsultua aty për aty në sallë, vendosi të mos i administrojë këto kërkesa, duke i konsideruar si abuzive. Duke pasur në konsideratë se subjekti ka bërë në total 11 kërkesa për përjashtim, prej të cilave vetëm dy janë pranuar, duke qenë se subjekti ka pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për të paraqitur kërkesat më parë dhe se subjekti kishte paraqitur me shkrim mbrojtjen e tij dhe e kishte lexuar edhe në seancë materialin e përgatitur prej afro 260 faqesh për një kohë rreth 15 orë, Komisioni çmon se këto kërkesa janë kryer vetëm me qëllim zvarritjen dhe pengimin e procesit. Komisioni e vlerëson këtë sjellje të subjektit si një abuzim me të drejtën që i njeh ligji. Ky qëndrim përforcohet edhe nga fakti që subjektit iu bë e ditur në seancë se faza e hetimit dhe administrimit kishte përfunduar dhe i takonte e drejta të shprehej vetëm për qëndrimin përfundimtar ndaj procesit.

Subjekti ka kërkuar edhe pezullimin e vijimit të shqyrtimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të procesit të tij të rivlerësimit deri në zgjidhjen e konfliktit gjyqësor të ndodhur pranë Gjykatës Kushtetuese dhe/apo KPA derisa të merret vendim përfundimtar i formës së prerë. Në lidhje me këtë kërkesë Komisioni vlerëson se ajo nuk është e bazuar në ligj dhe në prova, për rrjedhojë është abuzive dhe është bërë me qëllim zvarritjen e procesit të rivlerësimit të subjektit. Për më tepër që pretendimet e subjektit në kërkesën drejtuar KPA janë pretendime të cilat shqyrtohet së bashku me vendimin përfundimtar.

27. Në seancën e datës 12.12.2022 subjekti ka bërë dy kërkesa për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues. Pasi u administruan këto kërkesa, seanca u shty për në datën 13.12.2022. Menjëherë me çeljen e seancës subjektit iu bë e ditur se bazuar në nenin 75 të Kodit të Procedurës Civile, seanca do të vijonte zhvillimin, por trupi gjykues nuk do të merrte asnjë vendim derisa të shpreheshin trupat gjykuese të ngritura me short për shqyrtimin e kërkesave për përjashtim. Pikërisht në këtë seancë një nga përfaqësuesit e subjektit, znj. O.S, ka kërkuar përjashtimin e të gjithë trupit gjykues, me arsyetimin se ndaj të tre anëtarëve ka depozituar një kallëzim në SPAK. Në zbatim të nenit 75/6 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues e administroi këtë kërkesë dhe e përcolli pranë Komisionit për ngritjen e trupit gjykues që do ta shqyrtojë, ndërkohë që seanca vijoi.

27.1. Në seancën e datës 14.12.2022 subjekti i drejtoi trupit gjykues një kërkesë për pezullim të procesit të rivlerësimit derisa të zgjidhet nga prokuroria çështja e kallëzimit penal të paraqitur prej tij dhe avokatëve ndaj anëtarëve të trupit gjykues. Qëllimi i kësaj kërkesë sipas subjektit është për ta përdorur vendimin e trupit gjykues si provë për të përmbysur barrën e provës, pra mbrojtje nëpërmjet shembullit. Trupi gjykues qartësoi pozitën e tij nën dritën e nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile, duke sqaruar subjektin se ky trup gjykues nuk merr asnjë vendim

²³ Subjekti ka parashtruar mbrojtjen e tij në tre seanca dëgjimore. Gjatë këtyre seancave trupi gjykues ka pranuar kërkesat e subjektit për pushim sa herë që ai ka kërkuar. Për më shumë shihni procesverbalin e seancave të datave 12, 13 dhe 14.

derisa të shprehen trupat e tjera të ngritura për shqyrtimin e kërkesave për përjashtim të bëra nga subjekti.

28. Menjëherë me çeljen e seancës së datës 19.12.2022, subjekti u njoftua se, pasi të gjitha trupat e ngritura për shqyrtimin e kërkesave të tij për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues kanë vendosur mospranimin e kërkesave, ky trup gjykues, po në datën 19.12.2022 mori në shqyrtim kërkesën e bërë në seancën e datës 14.12.2022, për pezullim të procesit të rivlerësimit për shkak të kallëzimit të tre anëtarëve në SPAK. Pasi shqyrtoi këtë kërkesë, trupi gjykues vendosi të mos e pranojë, si një kërkesë të pabazuar në ligj. Procesi i rivlerësimit është një proces administrativ, që zhvillohet në mënyrë të pavarur nga çdo proces tjetër. Kallëzimi penal i bërë nga subjekti për anëtarët e trupi gjykues nuk mund të jetë shkak i arsyeshem e ligjor për pezullim të procesit të rivlerësimit, që bazuar në pikën 3 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 duhet të përmbillet brenda një afati sa më shpejt të mundshëm. Nga ana tjetër, trupi gjykues e konsideron këtë kërkesë të bërë me qëllim zvarritjen e procesit të rivlerësimit, duke e mbajtur në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të subjektit.

29. Në përfundim të vlerësimit të qëndrimit të subjektit gjatë seancave dëgjimore, por edhe gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, Komisioni çmon se subjekti: ka qenë pengues në të gjitha procedurat e rivlerësimit; ka abuzuar me të drejtat e tij për kërkesat për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues; ka refuzuar të evidentojë kërkesat për marrje prove gjatë paraqitjes së mbrojtjes së tij; si dhe ka tentuar disa herë të shtyjë datat e zhvillimit të seancave, me arsye më të shumtën e herës të pabazuara. Mungesa e bashkëpunimit të subjektit për zhvillimin e procesit të rivlerësimit do të mbahet në konsideratë nga Komisioni në marrjen e vendimit përfundimtar, në përputhje me kërkesat e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

30. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

31. Referuar vendimit nr. 2/2017²⁴ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

32. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI;

²⁴ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

(ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; si dhe (g) shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura gjatë seancës dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

33. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

34. Apartament²⁵ në përdorim me sipërfaqe 111 m², lagjja “V.Sh”, rruga “A.Gj.F”, Shkodër, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. **, f. ***. Çmimi i blerjes: 3,936,000 lekë. Pjesa takuese: e papërcaktuar.

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: kjo pasuri e paluajtshme është regjistruar në regjistrat publikë në pronësi të shtetasit F.F.Y, babai i subjektit, dhe aktualisht është në përdorim të subjektit dhe të familjes së tij (të krijuar pas martesës).

Mbi këtë pasuri që është në përdorimin të subjektit, pavarësisht se nga ana formale është regjistruar me pronar të vetëm babain e tij, shtetasin F.Y, subjekti ka të drejta bashkëpronësie, por aktualisht të papërcaktuara në pjesë ideale. Pasuria në fjalë është krijuar edhe me kontributet e subjektit gjatë kohës që ka qenë beqar (përpara lidhjes së martesës), nga bashkimi i kontributeve të përbashkëta të anëtarëve të familjes së origjinës.

Subjekti shprehet se: *“Mesa mbaj mend, kontributet për krijimin e kësaj pasurie, renditen si më poshtë:*

- *kontributet e mia nga kursimet e pagës që kam marrë gjatë kohës që kam ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës (gjatë viteve 2001 - 2002);*
- *kontributet e mia nga kursimet e pagës që kam marrë si gjyqtar nga data kur kam filluar punë 21.10.2003 deri në datën kur është fituar pasuria 10.4.2006;*
- *kontributet e motrës time A.F.Y nga kursimet e pagës që ajo ka marrë gjatë kohës që ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës (gjatë viteve 2001 - 2002);*
- *kontributet e motrës time A.F.Y nga kursimet e pagës që ajo ka marrë si prokurore nga data kur ka filluar punë 1.10.2003 deri në datën kur është martuar (rreth vitit 2004);*
- *kontributet e nënës time E.F.Y nga kursimet e pagës si mësuese përgjatë viteve deri në kohën e fitimit të pasurisë;*
- *kontributet e babait tim F.F.Y nga kursimet e pensionit si ish-ushtarak, përgjatë viteve, deri në kohën e fitimit të pasurisë;*
- *kontributet e babait tim F.F.Y nga fitimet e nxjerra nga ushtrimi gjatë vitit 2005 të aktivitetit privat tregtar si shitës fruta-perimesh;*

²⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. ***, datë 23.5.2007, të ZVRPP-së Shkodër; (ii) kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.4.2006; (iii) kontratë shitblerjeje nr. ***rep., nr. *** kol., datë 30.4.2007.

- kontributet e babait tim F.F.Y nga fitimet e nxjerra nga ushtrimi gjatë vitit 2006 të aktivitetit privat si person fizik, me objekt “legalizimin e dokumenteve zyrtare dhe ofrimin e shërbimeve parakonsullore në Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë, ambasadat e huaja dhe institucionet të tjera shtetërore”;
- kontributet e vëllait tim G.F.Y nga kursimet e bursës së fituar si shpërblim për rezultate të shkëlqyera gjatë kohës që në vitin akademik 2004 - 2005 ka ndjekur studimet në Fakultetin e Drejtësisë, universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër;
- kë ardhura nga produktet e tokës bujqësore në bashkëpronësi të F, E, A, A dhe F.Y, të realizuara gjatë viteve 2005 - 2006”.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- Deklarim i rremë i burimit të krijimit të shumës 3,936,000 lekë për blerjen e apartamentit me sipërfaqe banimi 111 m², në lagjen “V.Sh”, Shkodër, në emër të babait të subjektit, në datën 10.4.2006, pasi: nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për pagesën e shumës sipas kontratës; mungon dokumentacioni justifikues ligjor; babai i subjektit ka blerë një apartament në vitin 2004; gjithashtu, QKB-ja dhe organet tatimore nuk konfirmojnë të ardhura të realizuara nga aktiviteti privat i babait.
- Fshehje në deklarin Vetting të huas në shumën 1,500,000 lekë, që ka shërbyer si burim financiar për pagesën e apartamentit me sipërfaqe banimi 111 m², në lagjen “V.Sh”, Shkodër, në datën 10.4.2006, gjithashtu, mungon dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të kësaj shume.
- Deklarim i rremë i vlerës së apartamentit me sipërfaqe banimi 111 m², në lagjen “V. Sh”, Shkodër, pasi sipas kontratës së sipërmarrjes është 3,936,000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes është 3,552,000 lekë, ndërsa sipas EKB-së vetëm kosto e shfrytëzimit është 29,835 lekë/m². Gjithashtu, apartamenti ndodhet në një zonë të lakmueshme në Shkodër, vlera e tregut të të cilit shkon afro 500 euro/m² ose rreth 55,000 euro.
- Ndërtimi nga babai i subjektit në vitin 2009, i shtesës së katit në vlerën 2,070,900 lekë, është i dyshimtë, me qëllim fshehjen e ndërtimit dhe burimet reale të financimit nga ana e vetë subjektit.

Hetimi²⁶ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

35. Me kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 10.4.2006, babai i subjektit F.Y ka porositur nga shoqëria “*** C” sh.p.k.²⁷ apartament banimi me sipërfaqe tërësore 123 m², nga e cila 111 m² sipërfaqe funksionale, ndërsa pjesa tjetër ambiente të përbashkëta (sipërfaqe oborri, shkallësh, ashensori, etj.) në vlerën 3,936,000 lekë, e cila është likuiduar tërësisht në kohën e lidhjes së kontratës. Në datën 30.4.2007 është lidhur kontrata e shitblerjes me nr. *** për këtë apartament. Vlera e apartamentit në kontratë është përcaktuar 3,552,000 lekë dhe deklarohet e likuiduar që në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes.

I pyetur në lidhje me pasqyrimin e ndryshëm të çmimit të shitblerjes së kësaj pasurie në kontratën e sipërmarrjes dhe atë të shitjes, subjekti ka deklaruar: “*Deklaroj se çmimi që është paguar për blerjen e apartamentit është ai i shprehur në kontratën e sipërmarrjes dhe jo ai i shprehur në kontratën e shitjes. Mospërputhja në çmim rezulton nga fakti se pala sipërmarrëse, për arsyt e saj, nuk ka përfshirë në çmim vleftën e sipërfaqes së përbashkët, ashtu sikurse ka*

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 21.5.2020, drejtuar FSHU-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.5.2020, e FSHU-së; shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2022, drejtuar FSHU-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.2.2022, e FSHU-së; shkresë nr. *** prot., datë 21.5.2020, drejtuar UKT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. K-*** prot., datë 3.6.2020, e UKT-së.

²⁷ Shoqëria përfaqësohet në nënshkrimin e kontratës nga administrator L.L.

vepruar edhe me vetë sipërfaqen e apartamentit, ku ndonëse në kontratën e sipërmarrjes rezulton se pjesë e apartamentit dhe e vleftës së paguar është edhe sipërfaqja e përbashkët, e shkallëve, ashensorit...”.

35.1. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstatoi se ato nuk përputhen me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, duke i kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me këtë mospërputhje.

35.2. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti, në mënyrë të përmbledhur²⁸, sqaroi se çmimi prej 4,224,000 lekësh ka rezultuar si rrjedhojë e llogaritjes së çmimit bazuar në kontratën e sipërmarrjes datë 10.4.2006. Sipas subjektit, në nenin 1 të kësaj kontrate gabimisht noterja ka shënuar si sipërfaqe të apartamentit sipërfaqen 132 m², ndërkohë që sipërfaqja e banimit e apartamentit në fjalë është 123 m², llogaritur me sipërfaqe të përbashkëta, dhe 111 m² sipërfaqe funksionale. Sipërfaqja për të cilën është bërë pagesa e blerjes së apartamentit nga babai i tij është ajo që përfshin edhe ambientet e përbashkëta, pra 123 m².

Subjekti deklaroi se çmimi që është paguar për blerjen e apartamentit është ai i shprehur në kontratën e sipërmarrjes dhe jo ai i shprehur në kontratën e shitjes. Ai ka vijuar të shpjegojë në lidhje me arsyet se pse nuk kemi të bëjmë me një çmim më të lartë sa ai i përcaktuar në kontratë, por në lidhje me këtë pretendim të subjektit Komisioni vlerëson të mos ndalet, për sa kohë nuk i ka kaluar barrë prove.

35.3. Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se përgjigjet e tij në lidhje me gabimin e kryer nga noterja në përcaktimin e sipërfaqes së apartamentit në kontratë mbeten në nivel deklarativ. Subjekti nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm arsyet e çmimeve të ndryshme në lidhje me këtë apartament. Komisioni çmon se subjekti nuk ka pasqyruar saktësisht çmimin e blerjes së kësaj pasurie, duke e vlerësuar këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij.

35.4. Në lidhje me këtë apartament, Komisioni evidenton deklaratimet e mëposhtme të kryera nga subjekti i rivlerësimit:

- i. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka shpjeguar: *“...pavarësisht se nga ana formale është regjistruar me pronar të vetëm babain, shtetasin F.Y, unë kam të drejta bashkëpronësie, por aktualisht të papërcaktuara në pjesë ideale. Kjo, pasi pasuria në fjalë është krijuar edhe me kontributet e mia gjatë kohës që kam qenë beqar (përpara lidhjes së martesës), nga bashkimi i kontributeve të përbashkëta të anëtarëve të familjes së origjinës”.*
- ii. Në DPV/2006 subjekti ka deklaruar se *apartamenti në fjalë do të jetë në pronësi të gjithë familjes pavarësisht se kontrata është lidhur nga kryefamiljari.*
- iii. Në rubrikën “të dhëna konfidenciale” të DPV/2007, subjekti ka deklaruar: *“Apartament banimi i blerë me kontratën nr. ***, me sip. 112 m², me vlerë përafërsisht 4,000,000 lekë”.*
- iv. Në DPV/2008 subjekti ka deklaruar: *“...gjatë vitit 2008 jam martuar dhe pas martesë banoj me bashkëshorten time dhe djalin në apartamentin e banimit që ndodhet në lagjen ‘V. Sh’. Ky apartament banimi është në bashkëpronësinë time me prindërit dhe vëllain tim...”.*
- v. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar si adresë banimi këtë pasuri në deklaratimet periodike nga viti 2008 e në vijim.

²⁸ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

vi. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se ka banuar në këtë adresë nga muaji janar i vitit 2008 e në vijim.

35.5. Nga hetimi, Komisioni ka konstatuar se: (i) prindërit e subjektit kanë pasur një apartament tjetër dhe kanë kryer një shtesë kati mbi këtë apartament në vitin 2008; (ii) ky apartament është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës që subjekti ka kryer detyrën e gjyqtarit; (iii) subjekti ka dhënë kontributin e tij financiar për krijimin e kësaj pasurie; (iv) subjekti dhe bashkëshortja kanë banuar në këtë apartament nga momenti i martesës e në vijim, ndërsa familjarët e tij nuk kanë banuar asnjëherë në të; (v) pamundësi financiare të subjektit për të mbuluar me të ardhurat e tij blerjen e këtij apartamenti.

35.6. Në vlerësimin e këtyre fakteve Komisioni është ndriçuar edhe nga jurisprudenca e konsoliduar e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit²⁹, në mënyrë specifike në paragrafin 14.15 të vendimit nr. 10/2022.

➤ Për pasojë, Komisioni ka ngritur dyshimet për fshehjen e pasurisë apartament nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke i kaluar barrën e provës.

35.7. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur³⁰ ka shpjeguar se apartamenti në fjalë nuk është në pronësinë e tij, edhe pse ai pretendon të drejta bashkëpronësie mbi të. Të drejtat e tij të bashkëpronësisë mbi këtë apartament burojnë nga kontributi i tij financiar i dhënë për sigurimin e shumës monetare me të cilën është blerë ky apartament.

Nga ana tjetër, në lidhje me këtë pasuri, subjekti pretendon se nuk ka ushtruar asnjë pushtet juridik disponimi, fakt që rezulton qartësisht bazuar në: (i) nuk ka bërë asnjë rivlerësim të pasurisë për efekt të përfitimit nga legjislacioni fiskal të kësaj pasurie; (ii) nuk rezulton që kjo pasuri përgjatë rrjedhës së kohës të jetë ngarkuar me barrë hipotekore, të ketë qenë objekt servituti, uzufukt, nuk është ngarkuar me të drejta reale, nga të cilat mund të përfitonte ndonjë përfitim ekonomik, qoftë edhe indirekt. Mungesa e këtyre veprimeve juridike pasqyron më së miri se ai nuk ka ushtruar pushtet juridik disponimi mbi këtë pasuri.

Fakti se prindërit e tij, ka vijuar subjekti, kanë pasur një apartament tjetër dhe kanë kryer një shtesë kati mbi këtë apartament në vitin 2008, nuk është një argument i mjaftueshëm për të konkluduar se apartamenti, objekt vlerësimi, është në pronësinë e tij. Subjekti ka pretenduar se nuk pajtohet me të vërtetën konstatimi se në këtë apartament nuk kanë banuar familjarë të tjerë të tij, pasi në këtë apartament, në periudha të ndryshme kohe, kanë jetuar dhe vijnë të jetojnë prindërit e tij. Kjo ka ndodhur për ilustrim në periudhën e përmbytjeve të qytetit të Shkodrës në vitin 2012, ku e gjithë familja e tij (nëna, babai, vëllai dhe bashkëshortja e tij) janë shpërngulur dhe kanë jetuar disa muaj në këtë banesë, për shkak se ndodhet në një zonë të qytetit, e cila nuk pati përmbytje. Po kështu, prindërit e tij, për shkak të nevojave të tyre si të shkuar në moshë dhe të sëmurë kronikë, qëndrojnë shpesh në këtë banesë (në kushtet që apartamenti është më afër institucioneve shëndetësore dhe ka ashensor, element ky që i ndihmon prindërit e tij të ngjiten më lehtë). Subjekti ka shpjeguar se *në periudha të ndryshme kohe që lidhen me rritjen e fëmijëve të tij dhe nevojës për ndihmë, nëna dhe babai i subjektit kanë jetuar në këtë apartament, siç ka ndodhur pas lindjes së vajzave të tij binjake, rritja e të cilave ishte shumë e vështirë për ta, ndaj dhe janë ndihmuar për një kohë të gjatë nga nëna dhe babai, të cilët kishin eksperiencë të mëparshme të rritjes së fëmijëve binjakë.*

²⁹ Shihni vendimin nr. 7, datë 24.6.2020, paragrafi 94; vendimin nr. 20, datë 8.9.2020, paragrafi 21.4; vendimin nr. 21, datë 10.9.2020, paragrafi 74; vendimin nr. 4, datë 9.2.2021, paragrafi 147; dhe vendimin nr. 10, datë 14.4.2022, paragrafi 14.15.

³⁰ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

35.8. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjektit, bazuar në rrethanat faktike dhe nën dritën e përcaktimeve kushtetuese e ligjore, të cilat normojnë deklarimin e pasurive, duke marrë në konsideratë (i) analizën e mëposhtme financiare, sipas së cilës subjekti dhe prindërit e tij rezultojnë me pamundësi financiare për blerjen e apartamentit; (ii) gjithë sjelljen e subjektit në raport me procesin e rivlerësimit dhe fakteve që kanë rezultuar nga hetimi (të trajtuar në mënyrë të detajuar në vijim në lidhje me këtë apartament); (iii) sjelljen si pronar i vetëm i këtij apartamenti, për sa kohë e ka përdorur në mënyrë ekskluzive, ka deklaruar të drejta bashkëpronësie dhe kontribut në blerjen e tij, si dhe mbështetur në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit³¹ – konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimet e tij, sipas nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, duke kryer fshehje të pasurisë.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

36. Komisioni, mbështetur në deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting*, ku ka pranuar që ka kontribuar për blerjen e kësaj pasurie, si dhe duke u bazuar në pikën 30 të vendimit nr. 22/2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ka kryer një hetim të plotë në lidhje me burimet e kësaj pasurie.

36.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim kontributet e tij të pagës, si dhe kontributet e familjarëve të tij. Kontrolli i deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme i shërben Komisionit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij. Në këto kushte, Komisioni ka analizuar deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike, në ILDKPKI, si dhe ato gjatë procesit të tij të rivlerësimit, nga ku ka rezultuar se:

i. Në DPV/2006 subjekti ka deklaruar se gjatë vitit 2006 janë shtuar të ardhurat në para duke arritur shumën e përgjithshme 3,300,000 lekë (në anë është shënimi “kjo është e përbashkët”). Subjekti ka shpjeguar se këtyre parave i është shtuar një shumë prej 700,000 lekësh, e cilat është përdorur për të lidhur një kontratë sipërmarrjeje për ndërtimin dhe fitimin e pronësisë mbi një apartament banimi të papërfunduar. Vlera e objektit të kontratës është përafërsisht 4,000,000 lekë dhe kontrata në fjalë është lidhur me shoqërinë “** C” me administrator shtetasin L.L. Sipërfaqja e objektit është 112 m² funksionale. Apartamenti në fjalë do të jetë në pronësi të të gjithë familjes, pavarësisht se është lidhur nga kryefamiljari.

Në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar: “*Marrë borxh Xh.Th 1,500,000 lekë nga kryefamiljari. Detyrimi është marrë me qëllim blerjen e apartamentit. Afati i shlyerjes është 5 vjet. Shlyerja e detyrimit deri më 31.12.2006 është në shumën 800,000 lekë dhe detyrimi i mbetur prej 700,000 lekësh*”.

ii. Subjekti, në lidhje me burimin e apartamentit, në procesverbalin e datës 16.10.2009³², ka deklaruar të njëjtin burim, duke specifikuar se gjendja prej 1,500,000 lekësh, e deklaruar në vitin 2007, është gjendja përfundimtare, pasi gjendja *cash* e deklaruar më parë në shumën 3,300,000 lekë është përdorur për blerjen e apartamentit të banimit në shumën e deklaruar 4,000,000 lekë.

Në lidhje me huan e marrë z. Xh.Th, deklaroi se ajo ka qenë në shumën 1,500,000 lekë dhe është shlyer totalisht sipas deklaratimeve të dhëna.

³¹ Shihni vendimet nr. 32/2022 dhe nr. 9/2020.

³² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2022, të ILDKPKI-së.

- iii. Subjekti, në memon e datës 13.2.2015³³, në kushtet kur nga ana e inspektorëve të ILDKPKI-së i është njoftuar fakti që rezulton me rezultat negativ për vitin 2006 në vlerën 1,537,040 lekë³⁴, ka deklaruar se babai i tij gjatë vitit 2006 ka blerë një apartament banimi me sip. 112 m². Për të blerë këtë apartament, me sa mban mend, babai ka marrë hua shumën 1,500,000 lekë dhe nuk është i sigurt, por i duket se për blerjen e apartamentit babai i ka marrë një hua edhe vëllait F.Y, por nuk e di nëse është shlyer brenda vitit apo jo. Nëse po, kjo hua nuk është deklaruar.
- iv. Në përgjigje të pyetësorit standard lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: *“...burimet për financimin e këtij shpenzimi janë po ato të përmendura në deklaratën Vetting, por dua të saktësoj se kur unë jam shprehur në deklaratën Vetting se burimet e krijimit të pasurisë janë të ardhurat dhe kursimet që ka pasur familja ime, këtë deklaram e kam bërë duke pasur parasysh kohën kur është përpiluar deklarata Vetting (në janar të vitit 2017) dhe jo duke pasur parasysh kohën kur është kryer shpenzimi. Konkretisht, në atë kohë burim financimi për kryerjen e këtij shpenzimi kanë qenë dy hua (që në kohën kur është përpiluar deklarata Vetting, kanë qenë të shlyera me kursimet familjare), që babai im F.Y ka marrë nga vëllai i tij, i quajtur F.Y, në shumën prej 2,000,000 lekësh, si dhe kunati i tij, i quajtur Xh.C.Th, në shumën 1,500,000 lekë. Këto dy hua vërtetohen përmes akteve noteriale të vitit 2006”*.
- v. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka sqaruar se gjendja e tij cash në vitin 2006 ka qenë në total 3,300,000 lekë, e përbërë nga kursimet e mëparshme të deklaruara në deklaratat periodike dhe nga shtesat e vitit 2006 në vlerën 1,762,960 lekë. Subjekti vijon në deklarin e tij shprehimisht: *“Nga përshkrimi i shënuar me shkrim korsiv si më sipër, që ndodhet në f. 3 të DPV/2006, duket qartë se jo vetëm që akumulimi prej 3,300,000 lekësh është përdorur pothuajse i gjithi për blerjen e apartamentit (pra është zvogëluar pothuajse në zero), por nuk ka mjaftuar, pasi është dashur t’i shtohen këtij akumulimi edhe përafërsisht 700,000 lekë (saktësisht 636,000 lekë), për të bërë shumën 3,936,000 lekë, që ka kushtuar apartamenti që ka përbërë objektin e kontratës së sipërmarrjes të përshkruar në f. 3 të DVP/2006”*.

36.2. Nga analizimi i deklarimeve të subjektit në lidhje me burimin e këtij apartamenti konstatohet se:

- i. Subjekti nuk ka deklaruar si burim për blerjen e këtij apartamenti në deklaratën Vetting huat e marra nga z. Xh.Th dhe z. F.Y.
- ii. Subjekti ka kryer deklarime kontradiktore në lidhje me burimin e këtij apartamenti, duke e bërë të pamundur evidentimin e burimeve për blerjen e tij.
- iii. Subjekti nuk rezulton që huan në shumën 2,000,000 lekë ta ketë deklaruar si burim në momentin e blerjes së apartamentit në DPV/2006, por edhe kur është pyetur nga ILDKPKI-ja në vitin 2009. Kjo hua është deklaruar si burim vetëm në vitin 2015, kur i është vënë në dukje nga ana e ILDKPKI-së se rezulton me një bilanc negativ në shumën 1,537,040 lekë. Për rrjedhojë, huaja në shumën 2,000,000 lekë nuk do të konsiderohet si burim për blerjen e këtij apartamenti.

Në lidhje me këto konstatime subjektit iu kalua barra e provës.

³³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2022, të ILDKPKI-së.

³⁴ Procesverbal datë 27.1.2015.

36.3. Pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur³⁵, subjekti ka shpjeguar se: *“Në përgjigjet e pyetësorit standard, unë e kam sqaruar me iniciativën time, pa më pyetur Komisioni, që kam bërë deklaram të paplotë në deklaratën Vetting lidhur me burimet e krijimit të pasurisë - apartament banimi me sip. 111 m², që është regjistruar në regjistrat publikë të ZVRPP-së Shkodër. Vetë fakti juridik që unë kam vepruar me iniciativën time, në përgjigjet e pyetësorit standard, për të riparuar gabimin e kryer, provon që kemi të bëjmë me deklaram të paplotë, por që është kryer nga unë si rrjedhojë e mangësisë që kam pasur për të kuptuar drejt, plotësisht, saktësisht, mënyrën se si duhet të plotësohet deklaratat Vetting. Dy huat e marra të përmendura në pyetësorin standard vërtetohen me akte noteriale të datës 24.4.2006. Këto janë akte zyrtare me fuqi të plotë provuese, sipas nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile”.*

Subjekti ka kërkuar që të merren në konsideratë raste të ngjashme në Komision³⁶, si dhe në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit³⁷, duke deklaruar se çdo qëndrim ndryshe bie në kundërshtim me vendimet e vetë Komisionit.

36.4. Komisioni shqyrtoi pretendimet e mësipërme të subjektit dhe duke marrë në konsideratë jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, të shprehur së fundmi edhe në vendimin nr. 33/2022³⁸, vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në raste të tjera Komisioni, ndryshe nga çka vlerësuar në çështjen objekt gjykimi, i ka marrë në konsideratë në analizë huat e padeklaruar në deklaratën Vetting, nuk qëndron, pasi çdo vendimmarrje e Komisionit merret në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e situatës faktike dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit. Për rrjedhojë të sa më sipër, vendimet e Komisionit, të cilat përmenden nga subjekti i rivlerësimit, nuk përbëjnë provë të fakteve relevante që lidhen me deklaramin e huas nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe, si të tilla, çmohen pa efekt në zgjidhjen e kësaj çështjeje.

36.5. Kolegji ka një qëndrim tashmë të konsoliduar³⁹ se pasaktësitë në deklaramet periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Në rastin e subjektit të rivlerësimit nuk jemi në këto kushte, pasi ai, jo vetëm që nuk ka provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit (shihni pikën 42 të këtij vendimi), por ka qenë kontradiktor në deklaramet e tij periodike, të cilat përbëjnë provë bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni konstaton se subjekti e ka deklaruar huan në shumën 2,000,000 lekë vetëm në vitin 2015, vit kur i është njoftuar nga ILDKPKI-ja se gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për apartamentin në shumën 1,537,040 lekë. Nga ana tjetër, në lidhje me pretendimin e subjektit se kontrata e huas vërtetohet me aktin noterial të datës 24.4.2006, Komisioni vlerëson se lidhja e kësaj kontrate jo detyrimisht provon që shumat e marra hua nga babai i tij janë përdorur për blerjen e këtij apartamenti, për më tepër ato janë marrë në një kohë më të vonë se pagesa e kryer për këtë apartament.

36.6. Mosdeklarami i huas në deklaratën Vetting, si dhe shpjegimet kontradiktore të subjektit, bëjnë që deklarami i këtij të fundit të jetë jo i plotë dhe i saktë, për pasojë, të bjerë ndesh me përcaktimet e pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Shkalla e njohjes që subjekti dëshmon për procesin e rivlerësimit në tërësi, normat, rregullat dhe metodologjinë për kryerjen e tij nga organet e rivlerësimit të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, përmes parashtrimeve në prapësime për rezultatet e hetimit administrativ,

³⁵ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

³⁶ Subjekti ka cituar vendimet nr. 46/2018, nr. 444/2021, nr. 445/2021, nr. 49/2018, nr. 327/20202 dhe nr. 536/2022.

³⁷ Subjekti ka cituar vendimet nr. 37/2021 dhe nr. 9/2020.

³⁸ Vendimet nr. 35/2022 dhe nr. 38/2022.

³⁹ Vendimet nr. 28/2020, nr. 24/2021, nr. 25/2021, nr. 37/2021, nr. 20/2022 dhe nr. 29/2022.

si dhe çdo komunikim përgjatë hetimit administrativ, përjashton mundësinë e paqartësive në lidhje me rëndësinë e deklarimeve të kryera prej tij në procesin e rivlerësimit. Në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Komisioni, duke theksuar se për qartësimin e situatës faktike për këtë hua, saktësia dhe konsistenca e deklarimeve mbetet e rëndësishme dhe është përgjegjësi e subjektit përkundrejt ndryshimit të deklarimeve që krijojnë dyshim të arsyeshëm se kanë ndodhur në funksion të përmirësimit të situatës financiare, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar këtë pretendim të subjektit. Ky qëndrimi i Komisionit mbështetet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁴⁰.

36.7. Në përfundim për sa më sipërparashtruar, Komisioni vlerëson të mos e marrë në konsideratë huan në shumën 2,000,000 lekë në analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti.

37. Referuar shpjegimeve të subjektit, Komisioni ka analizuar në cilësinë e burimeve: (i) kursimet nga të ardhurat e realizuara nga familja e origjinës së subjektit; si dhe (ii) huamarrjen nga shtetasi Xh.Th në vlerën 1,500,000 lekë.

Në lidhje me kursimet e familjes së origjinës së subjektit

37.1. Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me të ardhurat e familjes së origjinës së subjektit, nga ku ka rezultuar se:

- i. Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2022, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, rezulton se:
 - nëna e subjektit është trajtuar me pension invaliditeti për periudhën janar 2009 e në vijim;
 - për vëllain e subjektit G.Y të dhënat janë për vitin 2012 e në vijim;
 - babai i subjektit është trajtuar me pension suplementar të parakohshëm për periudhën korrik 2009 – gusht 2016.

37.2. Subjektit, pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit⁴¹, ka depozituar vërtetimin nr. ***prot., datë 26.4.2022, të DRSSH-së Shkodër, i cili nuk përputhet me të dhënat e mësipërme, pasi deklarohet se babai i subjektit është trajtuar me pension suplementar para kohe për periudhën 1999 – 2016. Për sa më sipër, të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit nga pensioni suplementar janë marrë me rezervë, duke i kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar me dokumentacion provues mospërputhjen midis shkresës së ISSH-së dhe DRSSH-së Shkodër.

37.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur ka shpjeguar se: *“Për sa kohë Komisioni ka administruar akte shkresore të lëshuara nga institucione shtetërore, fakti se këto akte nuk prodhohen nga ana ime, tregon qartë se pikërisht për këtë arsye barra e provës nuk më përket mua, por vetë institucionit që i ka lëshuar ato. Komisioni mundet që informacionin thjesht dhe lehtësisht mund ta administrojë direkt përmes një shkrese drejtuar këtyre institucioneve dhe administrimit të përgjigjes së tyre zyrtare”.*

37.4. Duke qenë se subjekti nuk depozitoi ndonjë dokument apo shpjegim në lidhje me këtë mospërputhje, duke treguar mungesë bashkëpunimi, Komisioni duhet që në analizë financiare të përfshinte vetëm të ardhurat për pensionin suplementar të babait të tij, të konfirmuar në shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2022, të ISSH-së, e cila është administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ. Nëse mbahen në konsideratë të dhënat e pasqyruara në këtë shkresë, rezultojnë të ardhura nga pensioni suplementar i babait vetëm për periudhën 2009 – 2016, ndërsa për periudhën paraardhëse nuk konfirmohen të dhëna. Pakësimi i të ardhurave të babait

⁴⁰ Shihni vendimet nr. 25/2022, nr. 16/2022 dhe nr. 22/2022.

⁴¹ Rezultatet e hetimit të datës 19.4.2022, të cilave në vijim Komisioni do t'i referohet si rezultatet e para të hetimit.

reflektohet me thellim të rezultatit negativ në analizën financiare. Komisioni, me qëllim mosthëllimin e rezultatit negativ të analizës financiare të subjektit, vendosi që të përfshijë të ardhurat e babait nga pensioni suplementar, duke e ngarkuar subjektin vetëm me përgjegjësi për mungesë bashkëpunimi, e cila do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

- ii. QKB-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2022, informon se: G.Y figuron si person fizik me NIPT K***V, me datë regjistrimi 30.1.2008; babai i subjektit F.Y figuron të jetë i regjistruar si person fizik:
 - a. Me vendimin nr. ***, datë 16.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të cilin nuk gjendet NIPT – bazuar në vendimin e gjykatës rezulton se babai i subjektit është regjistruar për të ushtruar aktivitetin privat të Agjencisë së Legalizimeve Parakonsullore, me objekt “legalizimin e dokumenteve”, për të cilat ligji parashikon kryerjen e tij në institucionet shtetërore, përfshirë dokumentet përkatëse në zyrën konsullore në Ministrinë e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe nxjerrjen e dëshmive të gjendjes gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë.
 - b. Me vendim nr. ***, datë 19.8.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të cilin nuk gjendet NIPT – bazuar në vendimin e gjykatës rezulton se babai i subjektit është regjistruar për të ushtruar aktivitetin privat të porosisë dhe agjencisë. Adresa e deklaruar është: lagjja “N.Gj”, rruga “E.G”, e cila është e njëjta adresë e deklaruar nga subjekti në DPV/2003. Subjekti ka depozituar, pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, kërkesë datë 15.8.2002, të babait të tij për ushtrimin e veprimtarisë së mësipërme.
- iii. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2022, informon se z. F.Y nuk rezulton të ketë ose të ketë pasur aktivitet tregtar të regjistruar në emër të tij dhe nuk rezulton i punësuar, ndërsa në lidhje me z. G.Y të dhënat janë pas vitit 2010.
- iv. Subjekti, së bashku me pyetësorin nr. 2, për të provuar të ardhurat e babait të tij, ka depozituar: vendimin nr. ***, datë 13.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për regjistrimin si person fizik të babait të tij F.Y në ushtrimin e aktivitetit të Agjencisë së Legalizimeve Parakonsullore; dhe pasaportën e babait të tij.
- v. Subjekti, në memon e datës 13.2.2015⁴², në lidhje me:
 - Të ardhurat nga aktivitetit privat tregtar si shitës fruta-perimesh, ka sqaruar se babai i tij këtë veprimtari e ka ushtruar si shitës ambulant me pakicë, kryesisht në kohën e festave, me ndihmën e vëllait të tij F.Y, i cili në atë kohë ka ushtruar veprimtari tregtare si tregtar fruta-perimesh me shumicë. Duke pasur karakter jo të vazhdueshëm veprimtaria tregtare e babait të tij, ndonëse ka prodhuar të ardhura, nuk ka qenë e regjistruar në organet tatimore. Për rrjedhojë, ai nuk ka pasur mundësi për ta vërtetuar me ndonjë dokument zyrtar të lëshuar nga organet kompetente tatimore.
 - Kontributet e babait nga fitimet e nxjerra nga ushtrimi gjatë vitit 2006 të aktivitetit privat si person fizik, me objekt “legalizimin e dokumenteve zyrtare dhe ofrimin e shërbimeve parakonsullore në Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë, ambasadat e huaja dhe institucionet të tjera shtetërore, ka sqaruar se kjo veprimtari tregtare do të ketë filluar rreth 6-mujorit të parë të vitit 2006 dhe është zhvilluar në bazë të një vendimi gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nuk ka dijeni

⁴² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2022, të ILDKPKI-së.

nëse kjo veprimtari është ushtruar, pasi është licencuar nga organet tatimore përkatëse.

- vi. Subjekti, në pyetësin nr. 3, për të provuar të ardhurat e nënës së tij, ka depozituar dokumentacionin e mëposhtëm:
- librezë pune, nga ku provohet se nëna e tij ka qenë e punësuar si mësuese për periudhën 1975 – 2007 (në datën 22.6.2007 është liruar nga detyra);
 - vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare të të ardhurave të përfituara nga nëna e tij;
 - urdhër nr. ***, datë 22.6.2007, për lirim nga detyra të znj. E.Y;
 - vendim nr. ***, datë 19.7.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas të cilit rezulton e provuar se nëna e subjektit ka punuar si mësuese e ciklit të ulët për 32 vjet.
- vii. Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, ka depozituar:
- kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.4.2000, sipas së cilës prindërit e subjektit kanë shitur një banesë me sip. 76 m² në vlerën 430,000 lekë;
 - urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale për harkun kohor janar – dhjetor 2011 të z. F.Y, i cili në datën 17.5.2022 ka paguar shumën 109,150 lekë për të ardhura në vlerën 319,750 lekë;
 - urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale për harkun kohor janar – dhjetor 2011 të z. F.Y, i cili në datën 19.5.2022 ka paguar shumën 105,400 lekë për të ardhura në vlerën 319,800 lekë;
 - urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale për harkun kohor janar – dhjetor 2011 të z. F.Y, i cili në datën 20.5.2022 ka paguar shumën 104,793 lekë për të ardhura në vlerën 210,193 lekë.

37.5. Në lidhje me pagesat e kryera nga babai i subjektit për tatimin mbi të ardhurat personale, ato nuk rezultojnë të jenë bërë për të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar, për rrjedhojë, të ardhurat e pretenduara nga subjekti të përfituara nga babai i tij për ushtrimin e aktivitetit tregtar nuk mund të përfshihen në analizë financiare, pasi nuk provohet shumat e përfituar nga babai dhe pagimi i detyrimeve tatimore si subjekt tregtar, si dhe nuk përcaktohet se për çfarë xhiroje apo aktiviteti janë paguar.

37.6. Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e mësipërm, ka përfshirë në analizë financiare:

- a. të ardhurat e përfituara nga nëna e subjektit nga puna si mësuese;
- b. të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit nga pensioni suplementar i parakohshëm.

37.7. Në përfundim:

- i. Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së paluajtshme në vitin 2000 janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2000, por nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2006, pasi subjekti ka deklaruar rregullisht shtesat dhe pakësimet e gjendjes *cash* në deklaratat periodike dhe këto të ardhura janë përfshirë në mundësinë e subjektit për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën 200,000 lekë në vitin 2003.
- ii. Të ardhurat e pretenduara nga subjekti si të përfituara nga babai i tij nga aktiviteti tregtar nuk janë përfshirë në analizë financiare, pasi nga organet tatimore nuk rezulton e provuar që babai i subjektit të ketë përfituar të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit tregtar si shitës fruta-perimesh dhe si person fizik, me objekt “legalizimin e dokumenteve zyrtare dhe ofrimin e shërbimeve parakonsullore në Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë, ambasadat e huaja dhe institucionet të tjera shtetërore”. Gjithashtu, nuk rezulton e provuar që babai i subjektit në periudhën e pretenduar të krijimit të këtyre të ardhurave të ketë paguar detyrimet tatimore.

Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në lidhje me këto të ardhura.

37.8. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti, në mënyrë të përmbledhur⁴³, shpjegoi se: *“Vlerësimi i Komisionit se këto të ardhura nuk duhet të përfshihen në analizën financiare për shkak se nuk provohet realizimi i të ardhurave nga këto veprimtari/aktivitete të ushtruara nga babai im, mendoj se bie në kundërshtim me provat e dërguara nga ana ime, që Komisioni ka pasur për shqyrtim, dhe konkretisht:*

- *Deklarimet e mia periodike për pasurinë dhe shpjegimet që kam dhënë përpara ILDKPKI-së*
Të ardhurat nga këto veprimtari unë i kam deklaruar në kohë reale, pra në DPV-të e kohës, duke dhënë edhe shpjegime shtesë dërguar ILDKPKI-së, kohë kur unë as e kam ditur dhe as kam pasur ndonjëherë mundësi ta dija se do t'i nënshtrohesha ndonjëherë procesit të Vetting-ut.
- *Provave rrethanore të paraqitura nga ana ime, për të provuar ushtrimin e aktivitetit të tilla si fotografi të kohës (babai im duke ushtruar këtë veprimtari), vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (nr. ***, datë 16.3.2006) që provojnë regjistrimin e babait tim si person fizik, me objekt veprimtarie “legalizimin e dokumenteve zyrtare dhe ofrimin e shërbimeve parakonsullore në Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë, ambasadat e huaja dhe institucionet të tjera shtetërore”.*

Subjekti ka pretenduar se qëndrimi i Komisionit nuk i përgjigjet parimit të barazisë, duke kërkuar trajtimin në pozita të njëjta me vendimmarrje të ngjashme të Komisionit⁴⁴.

37.9. Komisioni, pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion provues të ardhurat e përfituara nga babai i tij nga aktiviteti tregtar. Gjithashtu nuk arriti të provojë as pagimin e detyrimeve tatimore. Për sa i përket pagesave të kryera nga babai i subjektit në vitin 2022, për tatimin mbi të ardhurat individuale, ato nuk do të merren në konsideratë nga Komisioni, bazuar në vendimin nr. 15/2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Në pikën 23 të këtij vendimi, Kolegji shprehet: *“Për sa i përket një qëndrimi orientues, në referim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të ardhurave të krijuara, Kolegji çmon se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë të organeve të rivlerësimit duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie apo një qëllim për t'u arritur. Në çdo rast, këto të ardhura nuk mund të legjitimohen nëse subjektet, personat e lidhur apo personat e tjerë të lidhur kanë qenë në kushte keqbesimi, në kufijtë e kryerjes së një vepr penale”.*

Për më tepër, në parashtrimet e tij (f. 29), subjekti deklaroi tekstualisht: *“Edhe nëse aktualisht unë apo të afërmit e mi do të tentonin t'i paguanin këto detyrime tatimore, ekzistojnë kushtet e pamundësisë objektive për ta bërë këtë gjë. Kjo pasi për shkak të rregullimeve ligjore të kohës, ku këto detyrime janë shuar, pasi janë falur me ligj”.*

⁴³ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

⁴⁴ Subjekti ka cituar vendimet: nr. 56/2018; nr. 187/2019; nr. 96/2019; dhe nr. 31/2018.

37.10. Për sa më sipër, subjekti nuk rezulton të ketë përmbushur asnjë nga rrethanat e përcaktuara nga Kolegji në vendimin nr.15/2021 në lidhje me të ardhurat e babait të tij, pasi ai nuk ka provuar bindshëm ekzistencën e këtyre të ardhurave, si dhe nuk ka provuar që babai i tij ka qenë i regjistruar në organet tatimore për ushtrimin e aktivitetit tregtar.

Në lidhje me vendimet e cituara nga subjekti, Komisioni, për të mos rënë në përsëritje, paraqet të njëjta argumente si në pikën 36.4 e këtij vendimi.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se të ardhurat e babait të subjektit nga aktiviteti tregtar nuk do të përfshihen në analizë financiare, për sa kohë ato nuk provohen me dokumentacion provues, si dhe babai i subjektit nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore dhe, rrjedhimisht, nuk ka paguar as detyrimet tatimore.

38. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore kursime *cash*, të cilat, sipas deklaramit të tij gjatë hetimit, kanë qenë në vlerën totale 3,300,000 lekë, si vijon:

- Në DPV/2003 subjekti ka deklaruar 200,000 lekë kursime *cash*. Nga analiza financiare rezulton se ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume.
- Në DPV/2004 subjekti ka deklaruar 200,000 lekë gjendje *cash*, e cila nuk ka ndryshuar nga viti 2003.
- Në DPV/2005 subjekti ka deklaruar në seksionin “Deklarim i interesave private pasuri të paluajtshme/të luajtshme”, si vijon:
 - kursimi i rrogës 750,000 lekë;
 - fitimi nga prodhime bujqësore 350,000 lekë;
 - fitim nga puna e babait nga tregtia me pakicë 400,000 lekë.

Sipas deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ, shuma 1,500,000 lekë ka përbërë kursimet *cash* të tij të vitit 2005.

38.1. Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* në shumën 1,500,000 lekë, duke mos përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore, trajtuar në pikën 48 të vendimit dhe nga puna e babait nga tregtia, trajtuar në pikën 37.1- 37.10 të vendimit.

Tabela nr. 1 – analiza e mundësisë së krijimit të gjendjes *cash* në shumën 1,500,000 lekë

	Viti 2005
Pasuria	1,514,490.07
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>1,514,490.07</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	1,514,490.07
Të ardhura	1,330,754.00
Të ardhurat e subjektit	964,184.00
Të ardhurat e babait F.Y	146,409.00
Të ardhurat e babait F.Y si PF	0.00
Të ardhurat e nënës E.Y	220,161.00
Të ardhurat e vëllait G.Y	0.00
Shpenzime	438,228.00
Shpenzime jetike	438,228.00
Mundësia për kursime	-621,964.07

Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 621,964.07 lekë, duke i kaluar barra e provës.

38.2. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti, në mënyrë të përmbledhur⁴⁵, shpjegoi se: *“Shuma prej 3,300,000 lekësh, e përmendur, nuk është e ardhur e fituar nga kontributet e anëtarëve të familjes së origjinës vetëm për vitin 2006, por është shumë e të ardhurave neto (pasi zbriten shpenzimet e konsumit familjar) për vitet 2004, 2005 dhe 2006. Fakti që shuma në fjalë është akumulim i kursimeve familjare për tri vite (2004, 2005 dhe 2006) del jo vetëm nga përshkrimi në DPV/2006, por edhe nga shpjegimet me shkrim që kam dhënë në vitet 2009, 2011 dhe 2015 në ILDKPKI, sipas nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003 (i ndryshuar). Pra, duket qartë se në DPV/2006 unë nuk e kam deklaruar shprehimisht shtesën e pasurisë vetëm për këtë vit (që është në vlerën 1,762,960 lekë, por e kam treguar këtë vlerë sipas metodës së deklarimit progresiv, pra shtesa e pasurisë për vitin 2006 është diferenca ndërmjet pasurisë së akumuluar për tri vitet 2004, 2005 dhe 2006, me pasurinë e deklaruar në vitet 2005 dhe 2004”.*

Subjekti pretendon se në analizë nuk janë përfshirë të ardhurat e babait të tij nga toka bujqësore, aktiviteti tregtar si shitës ambulant fruta-perime, si dhe të ardhurat e vëllait të tij si asistent avokat.

Subjekti ka pretenduar se ndodhet në kushtet e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, pasi është në pamundësi për të paraqitur dokumentacion provues për regjistrimin e babait të tij si shitës ambulant, duke i kërkuar Komisionit të kërkojë informacion.

38.3. Në lidhje me këtë kërkesë të subjektit, Komisioni vlerëson se nuk jemi në kushtet e pamundësisë objektive të parashikuar nga neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016, pasi organet tatimore kanë informuar se babai i subjektit nuk rezulton i regjistruar si subjekt për ushtrimin e aktivitetit tregtar. Për sa i përket kërkesës për informacion, pavarësisht se nga ana e subjektit nuk është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, Komisioni e ka analizuar dhe vlerëson kjo kërkesë nuk duhet të pranohet, pasi gjatë hetimit është administruar shkresa nr. *** prot., datë 23.2.2022, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas së cilës babai i subjektit nuk rezulton të ketë apo të ketë pasur aktivitet tregtar të regjistruar në emër të tij.

38.4. Në lidhje me pretendimet e subjektit për përfshirjen në analizë financiare të të ardhurave:

- i. Nga aktiviteti tregtar privat i babait të tij, e cila është trajtuar gjerësisht në pikën 37.1-37.10 të këtij vendimi.

Përveç sa është parashtruar më lart, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i legalizimeve, ato nuk mund të përfshihen në analizë financiare dhe për arsye se në DPV/2005 subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar të ardhura të krijuara nga ky aktivitet.

- ii. Nga toka bujqësore, e cila është trajtuar gjerësisht në pikën 48 të këtij vendimi.
- iii. Për sa i përket të ardhurave të vëllait të subjektit, Komisioni do të përfshijë vetëm të ardhurat nga bursa në vitin 2005 në vlerën 19,500.00 lekë dhe në vitin 2006 në vlerën 39,000.00 lekë⁴⁶. Ndërkohë, në lidhje me të ardhurat e pretenduara si shitës ambulant apo si asistent avokat, për sa kohë subjekti nuk i ka deklaruar si burim në deklaratën *Vetting*, si dhe nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues për: (a) ekzistencën e punësimit të vëllait të tij; (b) përfitimin e këtyre të ardhurave; (c) për pagimin e detyrimeve tatimore – ato nuk do të përfshihen në analizën financiare.

⁴⁵ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 4.5.2022, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Nga verifikimi i DPV/2005 nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar të ardhura nga aktiviteti për vëllain e tij. Gjithashtu, në DPV/2006, si burim të ardhurash për vëllain e tij ka deklaruar vetëm nga puna si asistent avokat për harkun kohor korrik – dhjetor 2006.

38.5. Komisioni vlerëson të ndalet edhe në lidhje me deklaratimet kontradiktore të subjektit për sa i përket të ardhurave të babait të tij nga aktiviteti tregtar, si dhe të vëllait të tij në vitin 2006.

Subjekti, në lidhje me këto të ardhura, ka deklaruar si më poshtë vijon:

i) Në DPV/2003 dhe DPV/2004 subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti tregtar i babait të tij si shitës ambulant apo nga legalizimet. Subjekti deklaroi për herë të parë të ardhura në shumën 350,000 lekë nga shitja me pakicë e babait të tij gjatë vitit 2005. Në këtë vit subjekti ka deklaruar edhe kursime *cash* në një shumë të konsiderueshme prej 1,500,000 lekësh. Në vitin 2006 subjekti deklaroi shumën 200,000 lekë nga aktivitet privat tregtar me pakicë ambulant dhe si person fizik në shumën 300,000 lekë.

Ndërkohë, në lidhje me të ardhurat e vëllait, ato janë deklaruar vetëm në vitin 2006.

ii) Në deklaratën *Vetting*, subjekti, si burim për blerjen e këtij apartamenti, ndër të tjera, ka deklaruar:

- kontributet e babait të tij nga fitimet e nxjerra nga ushtrimi i aktivitetit privat si shitës frutaperimesh në vitin 2005;
- kontributet e babait të tij nga fitimet e nxjerra nga ushtrimi i aktivitetit privat si person fizik në vitin 2006, me objekt “legalizimin e dokumenteve zyrtare...”;
- kontributet e vëllait të tij G.Y nga kursimet e bursës së fituar në vitin akademik 2004 - 2005.

Për sa më sipër, subjekti, jo vetëm që nuk ka provuar të ardhurat e vëllait dhe të babait të tij nga aktiviteti tregtar privat, por ka kryer edhe deklarime kontradiktore në lidhje me këto të ardhura.

38.6. Në përfundim, në lidhje me këto të ardhura, Komisioni vlerëson të mos i përfshijë në analizë financiare. Për rrjedhojë, subjekti rezulton me një pamundësi financiare në shumën 602,464.07 lekë për krijimin e kursimeve *cash* në vitin 2005. Në këto kushte, këto kursime *cash* nuk do të përfshihen në analizën financiare për blerjen e apartamentit në vitin 2006.

Në lidhje me krijimin e gjendjes *cash* prej 1,700,000 lekësh në DPV/2006, ajo është trajtuar bashkërisht me mundësinë për kthimin e huave në vitin 2006.

Në lidhje me huamarrjen nga shtetasi Xh.Th, në vlerën 1,500,000 lekë

39. Në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit Xh.Th, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar: “*Lidhur burimet e ligjshme të huadhënësit Xh.Th, që është bashkëshorti i hallës time, ju sqaroj se nga komunikimi me huadhënësin kam marrë dijeni se burimi i ligjshëm i të ardhurave që ai më ka dhënë hua burojnë nga: (a) ushtrimi i aktivitetit tregtar prej tij për periudhën 1992 – 2014; (b) shitja e tokës së fituar në bazë të ligjit nr. 7501 dhe shfrytëzimi bujqësor i tokës*”.

39.1. Për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme të huadhënësit Xh.Th, gjatë hetimit, si dhe pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, sipas së cilit z. Xh.Th ka përfituar 9.000 m² sipërfaqe tokë bujqësore, nga të cilat 8.700 m² arë dhe 300 m² truall;
- certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë nr. ***, z. k. ***, me sip. 1500 m², në emër të z. Xh.Th;
- kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 20.10.2014;

- certifikatë regjistrimi në organin tatimor;
- ekstrakt i personit fizik “L.Th”, regjistruar në vitin 2014;
- kontratë huaje me nr. ***, datë 24.4.2006, nëpërmjet së cilës babai i subjektit i ka marrë hua z. Xh.Th shumën 1,500,000 lekë për një afat 3-vjeçar;
- deklaratë datë 28.1.2022, e shtetasve Xh dhe L.Th;
- kontratë shitblerjeje datë 11.12.2000, përmes së cilës z. Xh.Th dhe z. F.Th i kanë shitur pasurinë tokë arë prej 4.000 m² në D, Shkodër, në vlerën 1,800,000 lekë.

Nga fashikulli gjyqësor nr. ***/2010, i depozituar nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, referuar procesverbalit të seancës së datës 17.2.2010, blerësi ka deklaruar se z. Xh.Th i ka blerë 1 dynym, ndërsa pjesa tjetër rezultoi e regjistruar në emër të z. Th. Nga certifikata për vërtetim pronësie e datës 11.12.2000 rezultoi se z. Xh.Th ka 2/3 e pasurisë, ndërsa z. F.Th 1/3 e pasurisë.

Për sa më sipër, në analizë financiare do të përfshihet 2/3 e çmimit të shitjes, sikundër është në certifikatën e pronësisë, pavarësisht deklarimeve të blerësit përpara gjykatës.

- Kartelë pasurie e llojit “arë”, me sip. 1.500 m², të pasurisë nr. ***, z. k. ***, e cila figuron në pronësi të shtetasve Xh, F dhe F.Th.
- Kontratë shitblerjeje datë 23.7.1999, përmes së cilës z. Xh.Th dhe dy bashkëpronarë të tjerë kanë shitur pasurinë e mësipërme në vlerën 500,000 lekë.

Në analizë financiare do të përfshihet vetëm 1/3 e çmimit të shitjes.

- Kartelë pasurie (1 faqe) për pasurinë nr. ***, sipas së cilës kjo pasuri ka ndryshuar pronësi nga z. Xh.Th në favor të z. A.P, me vlerë transaksioni 1,751,400 lekë, me regjistrim të kryer në datën 27.12.2001.

39.2. Komisioni ka kryer një hetim⁴⁷ të plotë në lidhje me aftësinë financiare të z. Xh.Th për dhënien e huas. Nga hetimi i kryer ka rezultuar:

- a) Bankat e nivelit të dytë konfirmojnë llogari bankare në emër të huadhënësit, të cilat janë përfshirë në analizën e mundësisë për kursim për dhënien e huas në shumën 1,500,000 lekë, sipas gjendjes së tyre në datën e dhënies së huas.
- b) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon se:
 - Xh.Th rezultoi administratori i subjektit tatimpagues “Xh.Th” person fizik, me NUIS K***O, me objekt veprimtarie “transport rrugor i mallrave” me status “pasiv” nga data 21.5.2014. Ky institucion informon se në regjistrin e dosjeve të tatimpaguesve nuk disponohen të dhëna të tjera për subjektin veç deklaratës së tatimit të thjeshtuar për vitin 2006;
 - personi fizik “L.Th”, me NIPT L***J, regjistruar në datën 17.2.2014.
- c) Qendra Kombëtare e Biznesit konfirmon regjistrimin e personit fizik “Xh.Th”, regjistruar mbi bazën e vendimit nr. ***, datë 2.3.2000.
- d) DPSHTRR-ja informon se z. Xh.Th ka pasur të regjistruar në emër të tij:

⁴⁷ Shkresë nr.*** prot., datë 24.6.2022, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresat kthim përgjigjeje të bankave të nivelit të dytë; shkresë nr. *** prot., datë 24.6.2022, drejtuar QKB-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.7.2022, e QKB-së; shkresë nr. *** prot., datë 24.6.2022, drejtuar DPT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.7.2022, e DPT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.7.2022, e DRT-së Shkodër; shkresë nr. *** prot., datë 24.6.2022, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.7.2022, e DPSHTRR-së

- automjetin me targa SH *** C, me status “çregjistruar”, blerë nga shtetasi Xh.Th në datën 21.2.2000, për çmimin 1,500,000 lekë;
 - automjetin me targa SH *** C, me status “çregjistruar”, për të cilin DPSHTRR-ja nuk ka vënë në dispozicion dosjen e automjetit.
- e) ASHK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 8.8.2022, informon se shtetasit L.Th, S.Y, E.Yetj. janë pajisur me leje legalizimi nr. *** datë 29.5.2012.

39.3. Analiza financiare

Komisioni ka kryer një analizë financiare për dhënien e huas nga shtetasi Xh.Th, duke përfshirë vetëm ato të ardhura të cilat provohen me dokumentacion provues.

Tabela nr. 2 – analiza e mundësisë së dhënies së huas në shumën 1,500,000 lekësh, në datën 10.4.2006

	Periudha 1999 – 10.4.2006
Pasuri	3,505,098.36
Automjet furgon “Mercedes-Benz”	1,500,000.00
<i>Likuiditete shtesa/pakësime</i>	2,005,098.36
Detyrime	0.00
Pasuri neto	3,505,098.36
Të ardhura	3,230,695.51
Të ardhura nga puna e z. Xh.Th	0.00
Të ardhura nga puna e znj. L.Th	0.00
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme (tokë)	3,128,066.67
Të ardhura Xh.Th si PF	0.00
Të ardhura nga interesat e depozitës	102,628.84
Shpenzime	1,433,872.00
Shpenzime jetike për 2 persona	1,433,872.00
TIMS	0.00
Mundësi për kursime	-1,708,274.85

Nga analiza financiare duket se z. Xh.Th nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas në shumën 1,708,274.85 lekë.

39.4. Në lidhje me këtë hua, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit, si vijon:

- i. Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të ardhurave të z. Xh.Th për dhënien e huas.
- ii. Nga hetimit dhe analiza financiare, z. Xh.Th nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas.
- iii. Bazuar në kontratën e huas rezulton se huaja është marrë në datën 24.4.2006.

Për rrjedhojë, shuma 1,500,000 lekë nuk do të përfshihet në analizë financiare për blerjen e apartamentit.

39.5. Pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁴⁸, subjekti ka shpjeguar se burimi i ligjshëm i të ardhurave të z. Xh.Th është: (i) ushtrimi i aktivitetit tregtar; (ii) shitja e tokës së fituar në bazë të ligjit nr. 7501; dhe (iii) shfrytëzimi bujqësor i tokës.

39.6. Subjekti ka kërkuar aplikimin e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me të ardhurat e siguruar nga huadhënësi nëpërmjet veprimtarisë tregtare për periudhën 1992 – 1997, duke qenë se kërkimet e tij i janë përgjigjur me faktin se në trazirat e vitit 1997 ky dokumentacion

⁴⁸ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

është djegur. Kjo bën që ai të gjendet në kushtet e pamundësisë si pasojë e një ngjarjeje që është fakt i njohur botërisht. Subjekti ka pretenduar se halla dhe bashkëshorti i saj, pra shtetasit Th, i kanë vënë në dispozicion akte shkresore që provojnë faktin që familja e saj ka fituar tokë në pronësi, në bazë të ligjit nr. 7501, ku një sipërfaqe e së cilës ajo e ka tjetërsuar, duke realizuar të ardhura monetare, që e tejkalojnë shumën e dhënë hua tek babai i subjektit në vlerën 1,500,000 lekë. Subjekti deklaroi se nga halla dhe bashkëshorti i saj, por edhe për shkak të lidhjes së afërt në gjini, është në dijeni të faktit se nga ana e tyre ka pasur të ardhura edhe nga shfrytëzimi bujqësor i tokave të fituara në bazë të ligjit nr. 7501.

39.7. Për të provuar aftësitë huadhënëse të z. Xh.Th, subjekti ka deklaruar se ky i fundit i ka shitur shtetasit F.B një sipërfaqe toke në shumën 4,000,000 lekë. Kjo shitje fillimisht është bërë me kontratën noteriale⁴⁹ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.12.2000, midis shitësve Xh dhe F Th (vëllezër) dhe blerësve S dhe F.B (nënë e bir), për vlerën 1,800,000 lekë. Çmimi nuk është paguar tërësisht nga blerësi në kohën e lidhjes së kësaj kontrate, por është paguar vetëm vlera 1,800,000 lekë. Një pjesë tjetër prej 1,000,000 lekësh ia ka dhënë, gjithmonë sipas deklarimeve të bashkëshortit të hallës së subjektit, rreth viteve 2003 - 2004, por ai nuk e mban mend me saktësi. Pjesën tjetër nuk ia ka dhënë asnjëherë. Ndërkohë shtetasi (blerësi) F.B e ka marrë në posedim sipërfaqen e tokës nga shitësi Xh.Th dhe mbi të ka ngritur një ndërtim pa leje që aktualisht e përdor si shtëpi banimi. Meqenëse blerësi ka vonuar pagesën tjetër të çmimit, atëherë shtetasi Xh.Th, në vitin 2010, ka hapur një proces gjyqësor, ku i ka kërkuar ose kthimin e sendit, sipas nenit 296 të Kodit Civil, ose pagimin e shumës së mbetur. Ky konflikt gjyqësor, ku avokat përfaqësues i shtetasit Xh.Th ka qenë av. G.Y, që është vëllai i subjektit, është zgjidhur me pajtim, duke u pushuar gjykimi, me vendimin nr. ***, datë 19.4.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kjo pasi palët jashtëgjyqësisht janë dakordësuar që shtetasi Xh.Th të merrte një pjesë të vlerës në konflikt që ai pretendonte se nuk i ishte paguar, ndërsa merrte përsipër detyrimin për të hequr dorë si nga e drejta e gjyqimit të padisë, ashtu edhe nga e drejta e tij për të kërkuar një pjesë të vlerës së papaguar.

39.8. Në përmbledhje të sa më sipër, subjekti ka konkluduar se huamarrësi Xh.Th, vetëm nga shitja e tokave ka arkëtuar në periudhën 1999 – 2003 shumën prej rreth 4,000,000 lekësh, që konsiderohet e ardhur e ligjshme, sipas ligjit nr. 84/2016, pasi në lidhje me këto veprim shitblerjeje janë paguar detyrimet tatimore dhe rezultojnë të regjistruara në regjistra publikë si veprime të ligjshme.

39.9. Më tej, subjekti ka pretenduar se: *“Nga analiza financiare që Komisioni i bën ‘personit tjetër të lidhur’, Xh.Th, rezulton qartazi se ai e barazon atë në cilësi me vetë subjektin e rivlerësimit, qëndrim i cili del jashtë qëllimit të ligjit nr. 84/2016. Detyra ime si subjekt i rivlerësimit në lidhje me huan e dhënë babait tim nga personi tjetër i lidhur Xh.Th është të provoj ligjshmërinë e krijimit të shumës së dhënë hua dhe jo të provoj mundësinë e krijimit të çdo pasurie nga ky shtetas gjatë jetesës së tij”*. Subjekti ka kërkuar që vlerësimi i burimeve të të ardhurave të bashkëshortit të hallës së tij të bëhet duke iu referuar praktikave të mëparshme të Komisionit në vendimet nr. 96/2019, nr. 31/2018, nr. 283/2020 dhe nr. 445/2021, si dhe të Kolegjit në vendimin nr. 15/2019.

39.10. Subjekti, gjithashtu, ka pretenduar: *“...pra, të dyja këto hua janë marrë nga babai im jo në datën 24.4.2006, në të cilën janë hartuar deklaratat noteriale, por në një kohë të mëparshme, që duke pasur parasysh diatezat foljore, ‘i ka dhënë’, të përdorura në këto akte noteriale, si dhe duke pasur parasysh qëllimin se pse janë marrë këto dy hua (për blerje*

⁴⁹ Kjo kontratë është marrë nga dosja gjyqësore civile me nr. regj. them ***, datë 15.2.2010, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të cilën e ka dërguar bashkëlidhur.

apartamenti), që rezulton nga vetë përmbajtja e këtyre akteve noteriale, duket qartë këto hua janë marrë përpara datës së lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, që është data 10.4.2006”.

39.11. Subjekti i ka kërkuar Komisionit:

- i. *Që të hetojë kryesisht faktin – nëse në emër të z. Xh.Th ka apo jo të dhëna në sistemin bankar të Republikës së Shqipërisë (Bankën e Shqipërisë dhe/apo bankat e nivelit të dytë), si dhe në organe shtetërore që ushtrojnë veprimtari administruese apo kontrolluese/mbikëqyrëse në fushën ekonomiko-financiare (Ministria e Financave, etj.), që tregojnë depozitimin/mbajtjen apo qarkullimin prej këtij shtetasi të vlerave monetare në periudhën ndërmjet datave 1.3.2000 – 21.5.2014 (që është periudha për të cilën nga provat e paraqitura nga subjekti vërtetohet se bashkëshorti i hallës ka ushtruar aktivitet tregtar të shitjes së fruta-perimeve me shumicë e pakicë, sipas vendimit të gjykatës me nr. ***, datë 1.3.2000, mbi bazën e të cilit është regjistruar në Degën e Tatim-Taksave të rrethit Shkodër (emërtim i asaj kohe) si ‘biznes i vogël’, me Kod Fiskal ***, me adresë D, Komuna Rr, Shkodër dhe në vijim është reregjistruar si “biznes i vogël”, në emër të Xh.Th, me NIPT K***O, me adresë “D.Shkodër”, duke kaluar në status “pasiv” në datën 21.5.2014.*
- ii. *Që duke iu referuar të dhënave të mundshme të INSTAT-it dhe/apo anketave korresponduese të Bankës së Shqipërisë, si dhe veçanërisht të dhënave mbi depozitat e shtetasit Xh.Th, të marra në sistemin bankar, të bëjë një vlerësim të përafërt të fitimit të mundshëm që mund të ketë realizuar për periudhën 1991 – 2005, nga aktiviteti i tij si biznes i vogël i shitjes së fruta-perimeve. Gjithashtu, i kërkon Komisionit që në vlerësimin e rëndësishëm që ka në procesin e rivlerësimit kalimtar, nga ky burim të ardhurash të shtetasit Xh.Th, të marrë në konsideratë edhe faktin që subjekti e ka vërtetuar tashmë burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij në një vlerë që e kapërcen pothuajse me 50% shumën prej 1,500,000 lekësh që ai i ka dhënë hua në vitin 2006 babait F.Y (vetëm përmes shitjes së dy sipërfaqeve të tokës së lartpërmendura).*

39.12. Subjekti ka kërkuar që të mos përfshihet në analizën financiare blerja e automjetit në shumën 1,500,000 lekë nga ana e z. Xh.Th në vitin 2000, pasi pasuritë e paluajtshme janë shitur pas blerjes së këtij automjeti dhe, për rrjedhojë, nuk mund të rëndojnë analizën financiare.

40. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

40.1. Në lidhje me kërkesën për sa i përket rasteve të ngjashme të vendimmarrjeve nga Komisioni, kjo është trajtuar në pikën 36.4 të këtij vendimi.

40.2. Në lidhje me kërkesën e parë, që ka lidhje për kryerjen e veprimeve hetimore, siç mund të konstatohet, Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me këtë shtetas, ku përfshihen edhe të dhënat bankare të pretenduara nga subjekti, të cilat për më tepër janë përfshirë edhe në analizë financiare. Në lidhje me kërkesën e dytë, Komisioni ka kryer një analizë financiare për shtetasin Xh.Th, duke marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Komisioni nuk mund të kryejë një përlllogaritje të fitimit të mundshëm të shtetasit Xh.Th, për sa kohë nga ana e organeve tatimore nuk është vënë në dispozicion informacion mbi qarkullimin e këtij shtetasi dhe për pagimin e detyrimeve tatimore, informacion që më pas do të përdorej për llogaritjen e fitimit të mundshëm. Subjekti, gjatë hetimit, por edhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit, nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues për sa i përket qarkullimit të shtetasit Xh.Th. Subjekti ka ngritur pretendimin se për vitet 1992 – 1997 është në pamundësi objektive për shkak të trazirave të vitit 1997. Ky pretendim i subjektit nuk përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit

administrativ, nga ku rezulton se shtetasi Xh.Th është regjistruar në vitin 2000 për ushtrimin e aktivitetit tregtar.

40.3. Në lidhje me pretendimin e subjektit se shtetasi Xh.Th e ka shitur tokën e tij në shumën 4,000,000 lekë, ky pretendim nuk është i shoqëruar me dokumentacion provues. Nga analizimi i dosjes gjyqësore me nr. *** vendimi, datë 19.4.2010, konstatohet se blerësi i kësaj pasurie ka deklaruar se shuma e paguar për blerjen e saj ka qenë 1,800,000 lekë. Gjithashtu përfaqësuesi i palës paditëse, z. G.Y, nuk e ka kundërshtuar këtë deklaram, por në seancën e fundit gjyqësore ka deklaruar se do të realizojnë një akt shitblerjeje për pjesën e zaptuar nga pala e paditur. Pra çështja gjyqësore nuk ka pasur lidhje me pasurinë e shitur për të cilën është paguar shuma 1,800,000 lekë. Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklarime që nuk përputhen me dokumentacionin e administruar, duke u përpjekur që të ndryshojë rrethanat e shitjes së pasurisë nga shtetasi Xh.Th me qëllim përmirësimin e situatës financiare të tij, veprim i cili do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

40.4. Në lidhje me analizën financiare, Komisioni e ka kryer këtë analizë bazuar në të dhëna të cunguara dhe jo të plota për sa i përket shpenzime të familjes Th, pa u marrë në konsideratë: (i) përbërja e plotë familjare (familja Th ka pasur tre fëmijë në përbërjen e saj familjare në momentin e dhënies së huas); (ii) shpenzimet e mundshme në investime të kryera; dhe (iii) huadhënie të tjera të mundshme apo shpenzimet nga sistemi TIMS. Në këtë analizë, referuar edhe kërkesave të subjektit, janë përfshirë vetëm shpenzimet jetike për dy persona dhe likuiditetet në bankë. Pra Komisioni nuk e ka barazuar familjen Th me subjektet e rivlerësimit, si dhe nuk i ka kaluar barrë prove subjektit për llogaritë bankare të familjes Th apo për blerjen e automjetit. Kjo analizë financiare është bazuar në vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 20/2019(JR) dhe nr. 15/2019(JR). Ky qëndrim është konfirmuar së fundmi nga Kolegji edhe në vendimin nr. 36/2022.

40.5. Në lidhje me pretendimin e subjektit që shuma 1,500,000 lekë për blerjen e automjetit të mos përfshihet në analizë financiare, Komisioni, pavarësisht se kjo kërkesë e subjektit nuk është e bazuar, edhe sikur të mos e përfshijë në analizë financiare, sërish rezultati nuk do të ndryshonte, pasi nga ana e familjes Th në vitin 2005 është rritur gjendja e tyre në banka në vlerën 2,000,000 lekë, duke mos qenë i bazuar pretendimi i subjektit se ato kanë pasur gjendje në bankë shumën 10,000,000 lekë, për rrjedhojë, ato nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas në shumën 1,500,000 lekë. Gjithashtu, edhe sikur në këtë analizë të hiqen shpenzimet jetike, sërish familja Th rezulton me pamundësi financiare për dhënien e kësaj huaje.

40.6. Subjekti nuk arriti të provojë që huaja në shumën 1,500,000 lekë është marrë përpara datës 24.4.2006, pasi pretendimet e tij mbeten në nivel deklarativ. Për më tepër, në deklaratën noteriale nuk përcaktohet qëllimi i përdorimit të huas. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk provoi dhe nuk justifikoi ligjshmërinë e burimit të shumës 1,500,000 lekë, si dhe faktin që kjo shumë është marrë përpara datës 24.4.2006.

40.7. Për sa më sipër, mosdeklarimi i huas në deklaratën *Vetting*, i shoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme, referuar jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit⁵⁰, passjellin që deklarimi i subjektit të jetë jo i plotë dhe i saktë, për pasojë, të bjerë ndesh me përcaktimet e pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, huaja në shumën 1,500,000 lekë nuk do të përfshihet në analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti.

41. Në lidhje me mundësinë e subjektit për shlyerjen e huas, marrë z. Xh.Th

⁵⁰ Shihni vendimet nr. 28/2020, nr. 24/2021, nr. 25/2021, nr. 37/2021, nr. 20/2022 dhe nr. 29/2022, të Kolegjit.

- Në DPV/2006 subjekti, në lidhje me këtë hua, ka deklaruar: “*Marrë borxh Xh.Th 1,500,000 lekë, shlyer nga kryefamiljari në emër të familjes 800,000 lekë*”.

Detyrimi familjar është marrë me qëllim për blerjen e apartamentit. Afati për shlyerjen e apartamentit është 5 vjet. Kontratë noteriale nr. ***, datë 24.4.2006.

- Në DPV/2007 subjekti deklaroi shlyerjen e pjesës tjetër të huas në shumën 700,000 lekë.

Në këtë deklaratë subjekti deklaroi kursime *cash* në shumën 1,500,000 lekë.

Komisioni, bazuar në deklaratimet e subjektit për shlyerjen e huas, ka kryer një analizë financiare mbi mundësitë e subjektit për kthimin e kësaj huaje.

Tabela nr. 3 – analiza e mundësisë së kthimit të huas në shumën 1,500,000 lekësh, në datën 10.4.2006

	Periudha 10.4.2006 – 31.12.2006	Viti 2007
Pasuria	5,729.81	1,505,845.17
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>5,729.81</i>	<i>1,505,845.17</i>
Detyrime	-800,000.00	-700,000.00
Shlyerje detyrimi ndaj Xh.Th	-800,000.00	-700,000.00
Pasuria neto	805,729.81	2,205,845.17
Të ardhura	874,825.33	1,301,714.00
Të ardhurat e subjektit	599,888.67	878,167.00
Të ardhurat e babait F.Y	103,804.00	159,606.00
Të ardhurat e babait F.Y si PF		
Të ardhurat e nënës E.Y	171,132.67	263,941.00
Shpenzime	292,152.00	558,571.00
Shpenzime jetike	292,152.00	546,480.00
TIMS		12,091.00
Mundësia për kursime	-223,056.48	-1,462,702.17

41.1. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kthimin e huas në vlerën 1,685,758.65 lekë, pa u përfshirë në analizë kthimi i huas së z. F.Y në shumën 2,000,000 lekë në vitin 2006.

41.2. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka shpjeguar se në analizën financiare të vitit 2006 të bërë nga ai, ka evidentuar të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së origjinës për këtë vit. Nga kjo analizë evidentohet qartë fakti se pas blerjes së apartamentit, babai i tij ka pasur mundësi t’i kthejë bashkëshortit të hallës një pjesë të huas të marrë atij dhe xhaxhait prej 2,000,000 lekësh.

41.3. Për vitin 2006 subjekti rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme financiare për kthimin e kësaj huaje në shumën 170,285.15 lekë. Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga bursa e vëllait të subjektit dhe të ardhurat e nënës të përfshira në analizë janë korrigjuar sipas nxjerrjes së llogarisë bankare⁵¹, ndërkohë nuk janë përfshirë të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit nga vëllai dhe babai i tij, të trajtuara gjerësisht më lartë.

41.4. Në lidhje me kthimin e huas në vitin 2007, subjekti, në faqen 69 të parashtimeve të tij të dërguara nëpërmjet postës elektronike në datën 29.11.2022, ka pranuar se rezultoi me një mungesë financiare për vitin 2007 në shumën 506,092 lekë. Për ta kthyer në pozitiv këtë rezultat në këtë vit, subjekti ka mbledhur të gjitha tepricat e viteve 2001 – 2006, duke dalë në vitin 2007 me një shumë totale për efekt kuadrimi në vlerën 1,325,141 lekë, shumë kjo që nuk mund të merret në konsideratë nga Komisioni, për sa kohë subjekti ka deklaruar saktësisht për

⁵¹ Ishte 171,132.67 lekë, bëhet 184,904 lekë.

çdo vit në deklaratat periodike shitesat dhe pakësimet. Gjithashtu, bazuar në analizën financiare, duke u përfshirë të ardhurat e vëllait nga bursa, subjekti rezulton me një rezultat negativ për vitin 2005 në vlerën 602,464.07 lekë dhe për vitin 2006 në vlerën 1,323,308.84 lekë.

41.5. Në përfundim, rezulton se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për kthimin e huas z. Xh.Th për vitin 2006 në vlerë 170,285.15 lekë dhe për vitin 2007 në vlerë 1,462,702.17 lekë, në kuptim të nenit 33/5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

41.6. Me qëllim mosrëndimin dy herë të situatës financiare të subjektit, Komisioni nuk e ka përfshirë në analizë financiare kthimin e kësaj huaje, për sa kohë në këtë analizë nuk është përfshirë as marrja e huas nga z. Xh.Th në shumën 1,500,000 lekë. Subjektit iu kalua barra e provës për kthimin e kësaj huaje, pasi Komisioni nuk mund të paragjykonte rezultatin final të analizës financiare, për sa kohë subjektit iu dha mundësia që të provonte burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. Xh.Th. Duke qenë se subjekti pas kalimit të barrës së provës nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit, Komisioni nuk do të përfshijë përfundimisht në analizë financiare as marrjen dhe as kthimin e huas z. Xh.Th.

42. Komisioni, pavarësisht se nuk ka përfshirë si burim për blerjen e apartamentit shumën 2,000,000 lekë, marrë hua nga z. F.Y, me qëllim kryerjen e një procesi tërësor rivlerësimi për subjektin, duke i dhënë të drejtën e plotë të mbrojtjes dhe pa paragjykuar përfundimin e këtij procesi, ka analizuar edhe mundësinë e këtij shtetasi për dhënien e huas në shumën 2,000,000 lekë, si dhe mundësinë e subjektit për kthimin e kësaj huaje.

42.1. Në lidhje me këtë huamarrje, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar: *“Borxhi i marrë nga F.Y nuk është deklaruar në DPV/2006, sepse ky borxh është marrë dhe është shlyer brenda vitit. Duke qenë detyrim i lindur dhe i shuar brenda të njëjtit vit ushtrimor të mbuluar nga kjo DPV, në atë kohë kam vlerësuar se nuk duhej deklaruar. Huat janë marrë nga babai im disa ditë më parë, por në datën 24.4.2006 janë hartuar deklaratat noteriale, me qëllimin blerje apartamenti. Lidhur me burimet e ligjshme të huadhënësit F.Y, ju sqaroj se burimet e ligjshme që kanë i shërbyer xhaxhait tim për t'i dhënë babait tim huan e lartpërmendur, janë: xhaxhai im F. Y dhe gjyshi im i ndjerë F.Y kanë jetuar në dy banesa të ndodhura në qendër të qytetit të Shkodrës, fqinje në vendin e quajtur ‘ish-Kinema Verorja’. Këto dy banesa kanë qenë pjesë përbërëse të një pasurie të paluajtshme truall + ndërtesë, që për shkak të marrëdhënieve familjare ka qenë e regjistruar në pronësi vetëm në emër të gjyshit tim, të ndjerit F.Y. Këtë pasuri truall + ndërtesë, përmes kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.3.1996, gjyshi im ia ka shitur blerësit ‘Sh.E.J’, duke përfituar si vlerë shumën prej 47,000 USD. Shuma e përfituar është ndarë ndërmjet gjyshit F.Y, që ka marrë prej saj 1,500,000 lekë, me të cilat ka blerë një banesë -apartament banimi, në qytetin e Shkodrës, në vlerën 1,310,000 lekë, përmes kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.7.1996, ndërsa pjesën tjetër të kësaj shume e ka ruajtur si kursim familjar xhaxhai im F.Y. Mbi këtë të ardhur të xhaxhait tim F.Y janë paguar edhe detyrimet fiskale dhe kështu ajo përbën të ardhur të ligjshme... Xhaxhai im ka pasur edhe burime të tjera të ardhurash, të cilat i kanë shërbyer për të përballuar shpenzimet e konsumit familjar, si dhe për të realizuar kursime të tjera. Xhaxhai im F.Y ka shitur përmes kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.11.2001, në shumën 1,000,000 lekë, një apartament banimi në pronësi të tij, tek shtetasi Nj.Gj.I. Edhe mbi këtë të ardhur të xhaxhait tim F.Y janë paguar detyrimet fiskale. Për vitet 1998 – 2006 xhaxhai im ka ushtruar aktivitetin e shitjes së fruta-perimeve me shumicë dhe pakicë, por ka pasur edhe markete ushqimore...”*

42.2. Për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme të huadhënësit F.Y, subjekti, gjatë procesit të rivlerësimit, ka paraqitur:

- deklaratë datë 28.1.2022, të shtetasve F, E, F, S, S.Y dhe Xh e L.Th;

- deklaratë noteriale nr. ***, datë 16.2.2015, e shtetasve G, F dhe E.Y;
- deklaratë datë 28.1.2022, e shtetasve F dhe E.Y;
- deklaratë datë 28.1.2022, e shtetasve Xh dhe L.Th;
- shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.1.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- akt shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 6.11.2001, me palë shitëse F.Y dhe palë blerëse Nj.I, me objekt “shitjen e pasurisë apartament në vlerën 1,000,000 lekë”;
- vërtetim pronësie datë 29.5.1996, në emër të z. F.Y;
- akt shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 15.3.1996, me palë shitëse F.Y dhe palë blerëse Sh e E.J, me objekt “shitja e pronës shtëpi banimi në vlerën 47,000 dollarë amerikanë”;
- akt shitblerjeje pasurie të paluajtshme datë 9.7.1996, sipas së cilës z. F.Y ka blerë një apartament në shumën 1,310,000 lekë;
- vendim nr. ***, datë 3.4.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me palë paditëse F.Y dhe të paditur OSHEE Shkodër, me objekt “pavlefshmëri titulli ekzekutiv...”, lidhur me të dhënat mbi aktivitetin e ushtruar në lagjen “P”, Shkodër, si biznes (jo familjar);
- të dhëna nga sistemi i OSHEE-së Shkodër lidhur me kontratën për energji elektrike mbi aktivitetin e ushtruar në lagjen “P”, Shkodër, si biznes (jo familjar);
- kontratë huaje nr. ***, datë 24.4.2006, nëpërmjet së cilës babai i subjektit ka marrë nga z. F.Y hua shumën 2,000,000 lekë për një periudhë 5-vjeçare;
- shkresë nr. *** prot., datë 26.1.2022, e DRT-së Shkodër në lidhje me aktivitetin e z. F.Y;
- deklaratë datë 28.1.2022, e shtetasve F dhe S.Y, të cilët deklarojnë se i kanë dhënë hua shtetasve F dhe E.Y shumën 2,000,000 lekë për blerjen e një apartamenti, e cila i është kthyer brenda vitit 2006. Si burim kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës së z. F.Y nga shitja e banesës që kanë pasur në pronësi dhe nga aktiviteti tregtar që kanë ushtruar.

42.3. Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, ka depozituar kartelë klienti e OSHEE-së në emër të z. F.Y, kabina P.

42.4. Komisioni ka kryer një hetim⁵² të plotë në lidhje me aftësinë financiare të z. F.Y për dhënien e huas. Nga hetimi i kryer dhe i kufizuar deri në periudhën e huadhënies në prill të vitit 2006, ka rezultuar se:

- a) Bankat e nivelit të dytë konfirmojnë llogari bankare në emër të huadhënësit, të cilat janë përfshirë në analizën e mundësisë për kursim për dhënien e huas në shumën 2,000,000 lekë, sipas gjendjes së tyre në datën e dhënies së huas.
- b) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon se:
 - shtetasi F.Y rezulton administratori i subjektit tatimpagues “I.Y” me NUIS J***H, me objekt veprimtarie “tregti me shumicë jo e specializuar e artikujve ushqimorë...”, i regjistruar në datën 1.7.1994 dhe aktualisht me status “pasiv” nga data 2.3.2001;
 - shtetësja S.Y nuk ka leje ushtrimi profesioni privat dhe nuk rezulton e punësuar ose në marrëdhënie pune në sektorin privat ose publik.

⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 24.6.2022, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresat kthim përgjigjeje të bankave të nivelit të dytë; shkresë nr. *** prot., datë 24.6.2022, drejtuar QKB-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.7.2022, e QKB-së; shkresë nr. *** prot., datë 24.6.2022, drejtuar DPT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.7.2022, e DPT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.7.2022, e DRT-së Shkodër; shkresë nr. *** prot., datë 24.6.2022, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.7.2022, e DPSHTRR-së.

- c) Qendra Kombëtare e Biznesit konfirmon regjistrimin e subjektit “I.Y” sh.p.k., me NUIS J***H dhe informon se ky subjekt nuk ka kryer plotësimin e të dhënave në regjistër.
- d) DPSHTRR-ja informon se nuk identifikohen automjete të regjistruara në emër të shtetasve F e S.Y.
- e) ASHK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 8.8.2022, informon se z. F.Y është aplikues për legalizimin e banesës me nr. aplikimi **, viti 2006. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur shkresës konstatohet se ky shtetas është pajisur me leje legalizimi për objektin godinë banimi 1 kat, me sip. 98.8 m². Në vetëdeklarimin për legalizimin e objektit viti i ndërtimit është deklaruar 7.11.1999. Ky ndërtim është llogaritur në vlerën 2,382,747.6 lekë, bazuar në koston e ndërtimit për m² të EKB-së.

42.5. Analiza financiare

Komisioni ka kryer një analizë financiare për dhënien e huas nga ana e shtetasit F.Y, duke përfshirë vetëm ato të ardhura të cilat provohen me dokumentacion provues. Në lidhje me shumën e shitjes së banesës prej 47,000 USD të z. F.Y, e cila sipas deklarimeve të subjektit përveç vlerës 1,500,000 lekë i ka kaluar z. F.Y, për sa kohë nga ana e tij nuk është provuar me dokumentacion provues të kohës që kjo shumë është përfituar nga z. F.Y, ajo nuk është përfshirë në analizë financiare derisa subjekti të argumentojë bindshëm arsyet e përfitimit të kësaj shume nga ana e z. F.Y, si dhe të depozitujë dokumentacionin provues.

Tabela nr. 4 – analiza e mundësisë së dhënies së huas në shumën 2,000,000 lekë, në datën 10.4.2006

	Periudha 1996 – 10.4.2006
Pasuri	3,693,747.60
Ndërtim 98.8 m ² në vitin 1999, kostoja sipas EKB-së 24,127 lekë/m ² sipërfaqe ndërtimi	2,383,747.60
Apartament, 9.7.1996	1,310,000.00
<i>Likuiditete shtesa/pakësime</i>	0.00
Detyrime	0.00
Pasuri neto	3,693,747.60
Të ardhura	1,000,000.00
Të ardhura nga puna e F. Y	0.00
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme, datë 6.11.2001	1,000,000.00
Shpenzime	1,287,796.00
Shpenzime jetike	1,287,796.00
Mundësi për kursime	-3,981,543.60

Nga analiza financiare duket se z. F.Y nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas në shumën 3,981,543.60 lekë. Në këtë analizë, edhe sikur të përfshihet shuma e mbetur nga çmimi shitjes së banesës të z. F.Y, sërish rezultati do të ishte negativ në vlerën 570,043.60 lekë.

42.6. Në përfundim, në lidhje me këtë hua, konstatohet se:

- i. Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. F.Y për dhënien e huas.
- ii. Nga hetimit dhe analiza financiare, z. F.Y nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas në shumën 3,981,543.6 lekë.

iii. Bazuar në kontratën e huas rezulton se huaja është marrë në datën 24.4.2006.

➤ Për rrjedhojë, shuma 2,000,000 lekë nuk do të përfshihet në analizë financiare.

42.7. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁵³, i ka qëndruar shpjegimeve fillestare të dhëna për këtë çështje. Ai ka theksuar se: *“Në kohën e ndodhjes së këtij veprimi xhaxhai dhe gjyshi im nuk kanë mbajtur akt të shkruar, për shkak të marrëdhënieve familjare, por për të vërtetuar faktin e dhënies së kësaj shume xhaxhait tim unë ju kam paraqitur disa prova, të cilat duhen riparë dhe marrë në konsideratë nga ana e Komisionit. Për të vërtetuar burimet e ligjshme të të ardhurave të xhaxhait tim F.Y, krahas akteve të shitblerjes së pasurive të paluajtshme, unë kam sjellë akte dokumentare të tjera që vërtetojnë faktin se ai ka pasur të ardhura edhe nga burime të tjera të ligjshme. Këto akte lidhen më faktin e vërtetuar nga ana ime se xhaxhai im F.Y ka ushtruar veprimtari tregtare, pretendime këto të vërtetuara edhe nga ana juaj”*.

Subjekti, në lidhje me analizën financiare, ngre të njëjtat pretendime sikundër në rastin e huadhënësit Xh.Th. Gjithashtu ai pretendon se një ndërtim që është kryer nga z. F.Y, për të cilin ky shtetas ka kryer edhe vetëdeklarimin përkatës pranë ALUZINI-t, është bërë pas dhënies së huas.

42.8. Subjekti pretendon se:

- i. Situata e aktivitetit tregtar të z. F.Y është identike me vendimin nr. 31/2018 të Komisionit.
- ii. Është në kushtet e pamundësisë objektive, në kuptim të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, për shkak se dokumentacioni që provon ushtrimin e aktivitetit të xhaxhait të tij është asgjësuar apo ka humbur për faj të institucioneve shtetërore.
- iii. Shtetasit Xh.Th dhe F.Y nuk janë persona të tjerë të lidhur me të, pasi huan e ka marrë babai i tij, i cili ka blerë dhe shtëpinë. Subjekti pretendon se përveç të drejtës së banimit/përdorimit nuk ka ndonjë të drejtë tjetër ligjore mbi apartamentin e banimit të blerë. Subjekti, duke iu referuar vendimit nr. 536/2022 të Komisionit, deklaroi se ai nuk mund të ngarkohet me “barrë prove” për të provuar ligjshmërinë e krijimit të një pasurie që nuk është në pronësinë të tij, por është në pronësinë e prindërve të tij.
- iv. Komisioni ka përfshirë në analizë financiare kthimin e huave nga subjekti, ndërkohë që nuk ka përfshirë në këtë analizë dhënien e këtyre huave.

42.9. Subjekti i ka kërkuar Komisionit:

- i. Të thirren për t’u pyetur në cilësinë e dëshmitarëve shtetasit F.Y, S.Y, L.Th, E.Y, S.Y dhe Xh.Th.
- ii. Të pyeten fqinjët e kohës, shtetasit F.T, F.T, D.T, K.V etj.
- iii. Të administrojë të dhëna nga: Drejtoria e Doganave në lidhje me faktin se shtetasi F.Y apo F.Dh ka importuar mall nga Republika e Greqisë dhe e Maqedonisë së Veriut; Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit në Policinë e Shtetit lidhur me hyrje-daljet në kufi të xhaxhait të tij F.Y.
- iv. Të bëjë një vlerësim të përafërt të fitimit të mundshëm që mund të ketë realizuar xhaxhai i tij për periudhën 1998 – 2006, bazuar në të dhënat e INSTAT-it apo Bankës së Shqipërisë.

⁵³ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

42.10. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

- i. Në lidhje me pretendimet e subjektit, të përshkruara në pikën 42.8 më lart:
 - a. Për sa i përket pretendimit nr. 1, në lidhje me rastet e ngjashme qëndrimi i Komisionit është i njëjtë si në pikën 36.4 të këtij vendimi .
 - b. Për sa i përket pretendimit nr. 2, ai nuk qëndron, pasi organet tatimore kanë konfirmuar faktin se xhaxhai i tij ka qenë i regjistruar dhe se ai është me status “pasiv” që në vitin 2001. Pra nga ana e këtyre organeve nuk është deklaruar se dokumentacioni është asgjësuar apo ka humbur. Dokumentacioni në lidhje me të dhënat tatimore të lëshuara nga institucionet shtetërore, bazuar në legjislacionin për arkivat, nuk asgjësohet, por arkivohet.
 - c. Në lidhje me pretendimin e subjektit se shtetasit Xh.Th dhe F.Y nuk janë persona të lidhur, ky pretendim i tij nuk qëndron, pasi mbështetur në deklaratimet e vetë subjektit në deklaratën *Vetting*, ai ka pranuar që ka kontribuar për blerjen e kësaj pasurie. Bazuar në pikën 30 të vendimit nr. 22/2020 të Kolegjit: “*Subjekti ka pasur detyrimin ligjor të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie dhe të pasurive të tjera të krijuara nga shitja e saj, si pasuri të krijuara edhe me kontributin e tij*”. Subjekti ka pasur detyrimin ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë apartament dhe, për rrjedhojë, në zbatim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016 edhe të burimit të ligjshëm të huave të marra nga babai i tij. Për më tepër, Komisioni ka ngritur dyshime për fshehje pasurie për këtë apartament, për rrjedhojë, subjekti duhet të provonte me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave, jo vetëm të huadhënësve, por edhe të familjes së tij të pretenduar si burim për blerjen e këtij apartamenti.
 - d. Për sa i përket pretendimit nr. 4, ai nuk qëndron, pasi Komisioni qartësisht është shprehur në rezultatet e hetimit dërguar subjektit, si vijon:
 - në faqen 15: “*Pa u përfshirë në analizë kthimi i huas së z. F.Y në shumën 2,000,000 lekë në vitin 2006*”;
 - në faqen 19: “*Në këtë analizë nuk është përfshirë kthimi i huas së z. Xh.Th në shumën 800,000 lekë*”;
 - në faqen 41: “*Nuk janë përfshirë: (1) hua marrë nga Xh.Th, viti 2006, deklaratë noteriale 24.4.2006; (2) shlyerje detyrimi ndaj Xh.Th; (3) hua marrë nga F.Y, viti 2006, deklaratë noteriale 24.4.2006; (4) shlyerje detyrimi ndaj F.Y*”.
- ii. Në lidhje me kërkesat e subjektit, të përshkruara në pikën 42.9 më lart:
 - a. Për sa i përket kërkesës nr. 1, të gjithë këta shtetas janë shprehur nëpërmjet deklaratës të datës 28.1.2022, të depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, për rrjedhojë, vlerësohet se dëgjimi i tyre nuk do të paraqesë asnjë të dhënë të re për procesin e rivlerësimit. Kjo kërkesë e subjektit, sikundër edhe kërkesat e tjera të tij në lidhje me kryerjen e hetimit, vlerësohen se janë bërë me qëllim zvarritjen e procesit të rivlerësimit të subjektit. Për këtë arsye, bazuar në nenin 49, pika 6, germat “a” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vendosi të mos e pranojë këtë kërkesë të subjektit.
 - b. Për sa i përket kërkesës nr. 2, Komisioni, mbështetur në nenin 49, pika 6, germat “a” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, vendosi të mos e pranojë, pasi bazuar në nenin 232 të Kodit të Procedurës Civile nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë. Në këtë rast, kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme-banesë është nënshkruar nga gjyshi i subjektit, i cili ka qenë edhe përfituesi i shumës 47,000 USD. Gjithashtu Komisioni vlerëson se kjo kërkesë është bërë me qëllim zvarritjen e procesit të rivlerësimit, pasi subjekti nuk ka përcaktuar

në mënyrë shteruese rrethin e personave që do të duhet të thirren si dëshmitarë, duke e përfunduar fjalinë me fjalën “etj.”, si dhe nuk ka vendosur gjeneralitetet dhe kontaktet për secilin nga dëshmitarët e kërkuar.

- c. Për sa i përket kërkesës nr. 3, Komisioni vendosi të mos e pranojë, bazuar në germën “a” të nenit 49/6 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga ana e Komisionit janë administruar të dhënat nga organet tatimore, duke mos u provuar qarkullimi, fitimi dhe pagimi i detyrimeve tatimore. Për më tepër, aktiviteti tregtar i z. Y rezulton me status “pasiv” që në vitin 2001. Nga ana tjetër, subjekti, duke qenë se pretendon se të dhënat e mësipërme nuk mund të merreshin prej tij, Komisioni vlerëson se ai i ka pasur të gjitha mundësitë për t’ia kërkuar xhaxhait të tij t’i administronte këto të dhëna dhe më pas t’i depozitonte si prova në Komision.
- d. Për sa i përket kërkesës nr. 4, Komisioni vendosi të mos e pranojë, pasi nga hetimi nuk rezulton asnjë e dhënë në lidhje me aktivitetin e xhaxhait të subjektit, në mënyrë të tillë që Komisioni të realizonte një vlerësim për fitimin e mundshëm. Për më tepër, i përket subjektit që të provojë me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të xhaxhait të tij, duke qenë se nga hetimi i Komisionit dhe analiza financiare z. F.Y ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar dhënien e huas.

42.11. Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion provues përfitimin e shumës së mbetur nga shitja e banesës së gjyshit të tij nga z. F.Y. Komisioni, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁵⁴ në lidhje me deklaratat e depozituara nga subjekti, vlerëson se ato nuk kanë fuqi provuese në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe, e parë në raport me të dhënat e tjera, nuk mbështeten nga rrethanat dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes, në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, çka të krijon bindjen se janë konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit dhe se nuk mbështeten nga provat e tjera të administruara në këtë proces. Gjithashtu, subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion provues të ardhurat e pretenduara të përfituar nga aktiviteti tregtar i z. F.Y, ku për më tepër nga hetimi ka rezultuar se ai është me status “pasiv” që në vitin 2001.

42.12. Në lidhje me analizën financiare të huadhënësit, Komisioni e ka kryer këtë analizë bazuar në të dhëna të cunguara dhe jo të plota për sa i përket shpenzime të familjes Y, pa u marrë në konsideratë: (i) përbërja e plotë familjare (familja Y ka pasur dy fëmijë në përbërjen familjare në momentin e dhënies së huas); (ii) shpenzimet e mundshme në investime të kryera; si dhe (iii) huadhënie të tjera të mundshme apo shpenzimet nga sistemi TIMS.

42.13. Në këtë analizë, referuar edhe kërkesave të subjektit, janë përfshirë vetëm shpenzimet jetike për dy persona dhe likuiditetet në bankë, si dhe blerja e një pasurie të paluajtshme dhe ndërtimi i një objekti informal. Pra Komisioni nuk e ka barazuar situatën e familjes Y me subjektet e rivlerësimit, si dhe nuk i ka kaluar barrë prove subjektit për llogaritë bankare apo për pamjaftueshmërinë e kësaj familjeje për pasuritë e paluajtshme. Kjo analizë financiare është bazuar në vendimet e Kolegjit nr. 20/2019 dhe nr. 15/2019, qëndrim i cili është konfirmuar së fundmi edhe në vendimin nr. 36/2022.

42.14. Komisioni vlerësoi të kryejë edhe një analizë hipotetike, duke përjashtuar të gjitha shpenzimet jetike të cilat do të konsiderohen të mbuluara nga aktiviteti tregtar i xhaxhait të subjektit, si dhe shpenzimet për blerjen/ndërtimin e pasurive të paluajtshme. Edhe në këtë rast huadhënësi është në mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1,000,000 lekë.

⁵⁴ Vendim nr. 6/2018(JR), datë 12.9.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendim nr. 11/2019(JR), datë 22.5.2019, paragrafi 27.12.1; vendim nr. 34/2019(JR), datë 2.12.2019, paragrafi 85.2; vendim nr. 23/2020(JR), datë 25.9.2020, paragrafi 26.2; dhe vendim nr. 11/2021(JR), datë 31.3.2021.

42.15. Subjekti nuk arriti të provojë që huaja në shumën 2,000,000 lekë është marrë përpara datës 24.4.2006, pasi pretendimet e tij mbeten në nivel deklarativ. Për më tepër, në deklaratën noteriale nuk përcaktohet qëllimi i përdorimit të huas.

42.16. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk provoi dhe nuk justifikoi ligjshmërinë e burimit të shumës 2,000,000 lekë, si dhe faktin që kjo shumë është marrë përpara datës 24.4.2006. Për më tepër kjo hua nuk rezulton e deklaruar si burim as në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratën e vitit 2006.

42.17. Për sa më sipër, mosdeklarimi i huas në deklaratën *Vetting*, i shoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme, referuar jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit⁵⁵, bëjnë që deklarimi i subjektit të jetë jo i plotë dhe i saktë, për pasojë të bjerë ndesh me përcaktimet e pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, huaja në shumën 2,000,000 lekë nuk do të përfshihet në analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti.

43. Në lidhje me mundësinë e subjektit për shlyerjen e huas marrë z. F.Y

Subjekti gjatë hetimit ka deklaruar se kjo hua është kthyer brenda vitit me kursimet *cash* të krijuara gjatë vitit 2006. Komisioni, bazuar në deklaratimet e subjektit për shlyerjen e huas, ka kryer një analizë financiare mbi mundësitë e subjektit për kthimin e saj në vitin 2006.

Tabela nr. 5 – analiza e mundësisë së kthimit të huas në shumën 2,000,000 lekësh, në datën 10.4.2006

	Periudha 10.4.2006 – 31.12.2006
Pasuria	5,729.81
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>5,729.81</i>
Detyrime	-2,000,000.00
Shlyerje detyrimi ndaj z. F.Y	-2,000,000.00
Pasuria neto	2,005,729.81
Të ardhura	874,825.33
Të ardhurat e subjektit	599,888.67
Të ardhurat e bashkëshortes	0.00
Të ardhurat e babait F.Y	103,804.00
Të ardhurat e babait F.Y si PF	
Të ardhurat e nënës E.Y	171,132.67
Shpenzime	292,152.00
Shpenzime jetike	292,152.00
Mundësia për kursime	-1,423,056.48

43.1. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kthimin e huas në vlerën 1,423,056.48 lekë. Në këtë analizë nuk është përfshirë kthimi i huas së z. XhTh në shumën 800,000 lekë.

43.2. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk ka dhënë shpjegime të detajuara, por është shprehur se babai i tij ka pasur mundësi të kthejë huan e marrë nga z. F. Y.

43.3. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe tabelën e paraqitur prej tij në lidhje me analizën financiare të vitit 2006, vlerëson se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kthimin e kësaj huaje, pasi në analizën e pretenduar prej tij janë përfshirë kursimet *cash* të vitit 2005, si dhe të ardhurat nga toka bujqësore, aktiviteti tregtar i babait dhe vëllait të tij. Në lidhje me këto të ardhura, Komisioni është shprehur në mënyrë të detajuar në

⁵⁵ Shihni vendimet nr. 28/2020, nr. 24/2021, nr. 25/202, nr. 37/2021, nr. 20/2022 dhe nr. 29/2022 të Kolegjit.

këtë vendim, duke mos i konsideruar ato në analizën financiare. Komisioni ka përfshirë në analizë vetëm të ardhurat nga bursa e vëllait të subjektit, si dhe ka korrigjuar të ardhurat e nënës sipas nxjerrjes së llogarisë bankare, duke u ndryshuar rezultati në vlerën 1,370,285.14 lekë.

43.4. Në përfundim rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për kthimin e huas marrë shtetasit F.Y në shumën 1,370,285.14 lekë, në kuptim të nenit 33/5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

43.5. Subjektit iu kalua barra e provës për marrjen dhe kthimin e huas tek z. F.Y, pasi Komisioni nuk mund të paragjykonte rezultatin final të subjektit, për sa kohë iu dha mundësia që të provonte se: kjo hua kishte shërbyer si burim për blerjen e apartamentit; z. F.Y kishte të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas; kjo hua ishte marrë përpara blerjes së këtij apartamenti.

43.6. Duke qenë se subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit, Komisioni nuk do të përfshijë përfundimisht në analizën financiare as marrjen dhe as kthimin e huas z. F.Y, për të mos rënduar pozitën financiare të subjektit.

44. Komisioni, në përfundim të analizës së burimeve financiare, ka përllogaritur mundësitë e subjektit dhe familjes së tij të origjinës për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi.

Tabela nr. 6 – analiza e mundësisë së blerjes së apartamentit me sip. 111 m², lagjja “V. Sh”, në datën 10.4.2006

	Datë 10.4.2006
Pasuria	4,141,411.00
Apartament 111 m ² , rr. “A. “Gj. F”, Shkodër – F.Y - 2006	3,936,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>205,411</i>
Detyrime	0.00
Hua marrë nga z. Xh.Th, viti 2006, në vlerën 1,500,000 lekë	0
Pasuri neto	4,141,411.00
Të ardhura	437,412.67
Të ardhurat e subjektit	299,944.33
Të ardhurat e babait F.Y	51,902.00
Të ardhurat e babait F.Y si PF	0.00
Të ardhurat e nënës E.Y	85,566.33
Shpenzime	109,557.00
Shpenzime jetike	109,557.00
Mundësia për kursime	-3,813,555.33

44.1. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 3,813,555.33 lekë. Edhe sikur në këtë analizë të përfshihet gjendja *cash* në shumën 1,500,000 lekë, e pretenduar nga subjekti, sërish subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme. Edhe sikur në këtë analizë të përfshihen huat, subjekti sërish nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kthimin e huave dhe, për rrjedhojë, edhe blerjen e apartamentit.

Subjektit iu kalua barra e provës për këtë rezultat të hetimit.

44.2. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti, në mënyrë të përmbledhur⁵⁶, pretendoi se Komisioni nuk i ka njohur si burime të ligjshme të ardhurash:

- të ardhura nga aktiviteti tregtar si shitës ambulant i babait;

⁵⁶ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

- të ardhura nga aktiviteti i babait për legalizimin e dokumenteve;
- të ardhura nga aktiviteti i vëllait si asistent avokat dhe shitjen e fruta-perimeve;
- të ardhura nga dhënia me qira e tokës bujqësore;
- huan marrë shtetasit Xh.Th;
- huan marrë shtetasit F.Y.

Sipas subjektit, përfshirja e këtyre burimeve të ardhurash në analizën financiare për vitet 2004 - 2006 pasqyron qartë faktin se babai i tij në datën 10.4.2006 ka pasur mundësi monetare të blejë apartamentin në lagjen “V.Sh” në qytetin e Shkodrës.

Subjekti pretendon se në lidhje me këto të ardhura ai ndodhet në të njëjtën situatë si në vendimin nr. 479/2021 të Komisionit.

44.3. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

- i) Në lidhje me rastet e ngjashme, Komisioni është shprehur në pikën 36.4 të këtij vendimi.
- ii) Në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga subjekti, ato janë trajtuar gjerësisht në këtë vendim. Komisioni ka përfshirë në analizë vetëm të ardhurat nga bursa e vëllait të subjektit, si dhe ka korrigjuar të ardhurat e nënës sipas nxjerrjes së llogarisë bankare, duke u ndryshuar rezultati në vlerën 3,788,326.67 lekë.
- iii) Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti në shumën -3,788,326.67 lekë, në kuptim të nenit 33/5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

44.4. Në përfundim, Komisioni konkludon se: (i) subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me këtë pasuri; (ii) subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në shumën -3,813,555.33 lekë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

45. Automjet⁵⁷ tip “M-B” në bashkëpronësi me bashkëshorten, i blerë në shumën 930,000 lekë

Subjekti ka deklaruar: *“Meqenëse automjeti është blerë i përdorur, përveç çmimit të blerjes, kam shpenzuar ekstra rreth 80,000 lekë për pajisjen me dokumentacionin tekniko-ligjor të mjetit dhe riparime të ndryshme të tij, duke shkuar shpenzimet në tërësi, në shumën 1,010,000 lekë. Mendoj që vlera e automjetit është 1,000,000 lekë që përbëhet nga çmimi i blerjes dhe shpenzimet ekstra që kam kryer unë. Në zotërim me bashkëshorten”.*

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: kursimet nga të ardhurat familjare të subjektit dhe bashkëshortes.

Hetimi⁵⁸ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

45.1. Me aktshitjen e pasurisë së luajtshme nr. ***, datë 19.9.2016, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “D.C *** e *** CDI”, vit prodhimi 2009, me vlerë 930,000 lekë.

⁵⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) aktshitje pasuri e luajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.9.2016; (ii) faturë doganore e datës 13.3.2016; (iii) leje qarkullimi e datës 27.9.2016, (iv) si dhe policë e sigurimit të detyrueshëm datë 29.6.2016.

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 21.5.2020, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.6.2020, e DPSHTRR-së, shkresë nr. *** prot., datë 21.5.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje BKT nr. *** prot., datë 4.6.2020.

45.2. Në dosjen e automjetit evidentohet vërtetimi nr. *** prot., datë 27.12.2019, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku citohet se mbi bazën e të dhënave të ardhura nga Komisariati i Policisë Shkodër për djegien e automjetit tip “M-B, me targa AA *** NZ, në pronësi të shtetasit Andri Ymeri, është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 10.12.2019.

45.3. Në përgjigje të pyetësorit standard, në lidhje me këtë automjet, subjekti ka deklaruar: “... ky automjet, aktualisht është jashtë përdorimit, pasi përmes një ngjarjeje kriminale më është djegur, në datën 24.11.2019, në orët e vona të natës, ndërsa ka qenë i parkuar në parkimin publik të pallatit ku unë dhe familja ime banojmë”.

45.4. BKT-ja konfirmon se pagesa për këtë automjet është kryer në datën 16.9.2016 nga ana e subjektit të rivlerësimit me anë të depozitimit *cash* në llogarinë e bashkëshortes së shitësit të automjetit.

Tabela nr. 7 – analiza e mundësisë së blerjes së automjetit në datën 19.9.2016

	Datë 19.9.2016
Pasuria	1,009,742.34
Automjet “M-B”, me targa AA *** NZ - 50% - 2016	1,010,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	-257.66
Detyrime	0.00
Pasuria neto	1,009,742.34
Të ardhura	1,631,172.49
Të ardhurat e subjektit	1,023,693.75
Të ardhurat e bashkëshortes	371,607.00
Të ardhura nga dhurimi i babait të subjektit F.Y, viti 2008	120,000.00
Të ardhurat nga depozitat	115,871.74
Shpenzime	745,582.75
Shpenzime jetike	690,582.75
Shpenzime shkollimi 2015 - 2016, djali E.Y	55,000.00
Mundësia për kursime	-124,152.60

Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në shumën 124,152.60 lekë, duke iu kaluar barra e provës.

45.5. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁵⁹, ka shpjeguar se për vitin 2016 të ardhurat në total janë në shumën 1,765,198 lekë dhe shpenzimet në total (lëvizje paraje) janë në shumën 907,213 lekë. Subjekti ka pretenduar se analiza e mësipërme gabimisht tregon se shpenzimi prej 80,000 lekësh për dokumentacionin dhe riparimin e automjetit nuk është bërë brenda datës së blerjes së automjetit 19.9.2016, por është bërë deri në përfundim të vitit 2016. Subjekti ka pretenduar se *është absurde të mendohet se ka bërë shpenzime për riparimin e automjetit përpara se ta blinte*. Po ashtu subjekti ka vijuar më tej sqarimin se *është absurde të besohet që në datën e blerjes së automjetit ka bërë shpenzime për riparimin e tij, pasi riparimi kërkon shpenzimin e një kohe fizike dhe sipas ligjit për mbrojtjen e konsumatorit pagesa për riparimit bëhet pas kryerjes së riparimit dhe pasi të paraqitet fatura*.

45.6. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson të marrë në konsideratë pretendimet e subjektit në lidhje me lindjen e vajzave, për rrjedhojë ka rillogaritur këto shpenzime që janë në vlerën 675,889.5 lekë, ndërkohë në lidhje me shumën 80,000 lekë për sa kohë është shpenzuar së bashku me blerjen e automjetit dhe subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues për të provuar kohën kur janë kryer këto shpenzime, ato do të konsiderohen në momentin e blerjes së këtij automjeti.

⁵⁹ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

Në përfundim subjekti rezulton me pamundësi financiare për blerjen e këtij automjeti në shumën -51,244.44 lekë. Kjo shumë do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

46. Automjet⁶⁰ tip “F.F”, me targa AA * M, viti i prodhimit 2001, në përdorim nga bashkëshortja A.Y dhe vëllai G.Y,** i blerë i përdorur nga vëllai i subjektit prej shtetasit Z. Ç, në shumën 350,000 lekë, mbi bazën e kontratës së shitblerjes nr. ***. Subjekti ka deklaruar se nuk kanë të drejta pronësie për këtë automjet.

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: kursimet nga të ardhurat familjare të vëllait të subjektit G.Y.

Hetimi⁶¹ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

46.1. Automjeti është blerë nga vëllai i subjektit në datën 2.4.2014, me akt shitje pasurie të luajtshme nr. ***, në vlerën 350,000 lekë. Sipas këtij akti shitjeje shuma është likuiduar ndërmjet palëve jashtë zyrës noteriale. Leja e qarkullimit e këtij automjeti është lëshuar në emër të z. G.Y, në datën 14.4.2014. Nga hetimi ka rezultuar se në datën 19.6.2009 vëllai i subjektit ka blerë automjetin tip “M-B E ***”, me targa SH *** E, me çmim 500,000 lekë, viti 2001.

46.2. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, në lidhje me automjetin tip “F.F”, se është përdorur fillimisht nga vëllai i tij G.Y, por ndonjëherë përveç vëllait të tij përdoret edhe nga bashkëshortja e tij A.Y, në rast nevoje, me miratimin e vëllait.

46.3. Nga të dhënat e administruar nga AMF-ja konstatohet se bashkëshortja e subjektit rezulton policëmbajtëse për këtë automjet në periudhat 5.4.2017 – 4.4.2018 dhe 30.3.2016 – 29.3.2017.

46.4. Komisioni ka kryer analizën financiare për blerjen e automjetit nga vëllai i subjektit.

Tabela nr. 8

	Periudha 2011 – 31.3.2014
Pasuria	350,000.00
Automjet “M-B”	350,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>0.00</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	350,000.00
Të ardhurat	3,418,003.00
Të ardhurat e babait F.Y	530,728.00
Të ardhurat e babait F.Y si PF	0.00
Të ardhurat e nënës E.Y	1,211,980.00
Të ardhurat e vëllait G.Y	307,529.00
Të ardhurat e vëllait G.Y si PF	207,348.00

⁶⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) aktshitje pasuri e luajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.4.2014, për blerje automjeti tip “F.F”, vit prodhimi 2001, me palë shitëse Z.Ç dhe blerës G.Y, me vlerë 350,000 lekë, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale; (ii) faturë doganore e datës 25.10.2013, policë për sigurim të detyrueshëm datë 30.3.2016; (iii) leje qarkullimi e automjetit tip “F.F” me targa AA *** IM, në emër të z. G.Y, datë 14.4.2014; (iv) certifikatë e pronësisë së automjetit në emër të z. G.Y.

⁶¹ Shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2022, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.2.2022, e DPSHTRR-së; shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2022, drejtuar AMF-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.2.2022, e AMF-së.

Të ardhurat e bashkëshortes së vëllait	1,160,418.00
Shpenzime	3,823,140.00
Shpenzime jetike për 4 persona	3,823,140.00
TIMS	0.00
Mundësia për kursime	-755,137.00

Nga analiza financiare duket se vëllai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

46.5. Në përfundim, duke marrë në konsideratë faktin se: (i) vëllai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie; (ii) ky automjet është përdorur nga bashkëshortja e subjektit; (iii) për këtë automjet polica për vitin 2016 ka qenë në emër të bashkëshortes së subjektit; (iv) subjekti nuk ka pasur automjet tjetër në pronësi – Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për fshehje pasurie në emër të vëllait.

46.6. Pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁶², subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri nuk është në pronësinë e tij apo të familjes, por të vëllait të tij G.Y, dhe është përdorur nga bashkëshortja e tij. Bazuar në këtë fakt, pra për shkak të përdorimit nga bashkëshortja të një pasurie që rezultojnë në emër të vëllait të tij, cilësia që ky i fundit duhet të kishte për efekt të procesit të rivlerësimit nuk duhet të ishte ai i “subjektit të rivlerësimit”, siç e ka trajtuar Komisioni në bërjen e analizës financiare të tij, por ai i “personit tjetër të lidhur”, sipas parashikimit të nenit 3/14 të ligjit nr. 84/2016, ka deklaruar subjekti.

Subjekti ka pretenduar gjithashtu se kryerja e analizës financiare të vëllait të tij deri në datën e blerjes së automjetit, nga ana e Komisionit, është bërë në mënyrë të pasaktë, duke mos llogaritur të gjitha të ardhurat e tij nga pagat, aktiviteti si avokat, huat e familjes së tij në atë kohë apo edhe shuma monetare që vetë subjekti i ka dhënë babait të tij në vitin 2013 prej 400,000 lekësh, shumë kjo që për sa kohë i është llogaritur si shpenzim për subjektin, rrjedhimisht për familjen e babait të tij, ku bën pjesë edhe vëllai, është e ardhur.

46.7. Subjekti ka pretenduar se ka shpjeguar edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 se arsyeja e blerjes së këtij automjeti nga vëllai i tij ka qenë fakti se bashkëshortja e vëllait punonte në një fshat të Shkodrës, nevojitej një automjet në dispozicion të saj për të realizuar transportin për në punë (automjeti u ble nga vëllai me qëllim që bashkëshortja e tij, pasi ta mësonte ta ngiste, të shkonte dhe të vinte vetë nga puna). Meqenëse pas pak kohësh bashkëshortja e vëllait e rregulloi këtë problematikë transporti në mënyrë tjetër (duke u grupuar me disa kolegë të saj), si dhe duke qenë se ajo nuk kishte mësuar ende ta ngiste makinën, familja e vëllait e kishte të panevojshëm këtë automjet, pasi ndërkohë ata kishin në dispozicion edhe një automjet tjetër.

46.8. Në lidhje me sigurimin e detyrueshëm të këtij automjeti, sipas subjektit, Komisioni nuk evidenton informacionin e marrë nga Agjencia e Mbikëqyrjes Financiare, dhe konkretisht shkresën nr.***prot., datë 25.2.2022, ku pasqyrohet qartë fakti se në lidhje me këtë automjet polica e sigurimit për vitet 2017, 2018 dhe 2019 është prerë nga pronari i këtij automjeti, vëllai G.Y. Sipas subjektit, Komisioni evidenton të shkëputur informacionin e marrë nga ky institucion, duke pasqyruar vetëm ato pjesë të tij që i shërbejnë qëllimit të tij për t’i atribuar fakte që nuk ekzistojnë.

46.9. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

⁶² Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

i) Për sa i përket analizës financiare, Komisioni ka konstatuar një gabim material në llogaritjen e shpenzimeve jetike të familjes së vëllait të subjektit, i cili është korrigjuar. Pas korrigjimit të këtij gabimi familja e vëllait rezulton me të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

ii) Në lidhje me pretendimin e subjektit se policat janë prerë nga vëllai i tij, ky pretendim nuk qëndron, për sa i përket viteve 2017 dhe 2018, sepse rezulton që polica për këtë periudhë me afat vlefshmërie deri në datën 4.4.2018 janë në emër të bashkëshortes së subjektit.

iii) Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka pretenduar se si burim për blerjen e këtij automjeti ka shërbyer edhe huaja që ai i ka dhënë babait të tij. Sipas këtij pretendimi babai i subjektit ka marrë hua nga subjekti për të blerë një automjet, i cili do të përdorej nga bashkëshortja e subjektit.

iv) Subjekti pretendon se ai kishte të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij automjeti. Ky pretendim nuk qëndron, pasi referuar analizës financiare, po të përfshihej shuma e blerjes së automjetit, subjekti do të rezultonte me pamjaftueshmëri të ardhurash të ligjshme për blerjen e automjetit.

46.10. Në përfundim, në lidhje me këtë automjet, Komisioni, duke marrë në konsideratë: (i) deklaratimet kontradiktore të subjektit në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e këtij automjeti nga vëllai i tij; (ii) pretendimet e subjektit se si burim ka shërbyer edhe një hua në shumën 400,000 lekë dhënë babait nga ana e tij; (iii) deklaratimet e subjektit se vëllai i tij kishte një automjet tjetër; (iv) mungesën e burimeve të ligjshme të subjektit për të blerë këtë automjet në vitin 2014; (v) dhënien në vitin 2014 të shumës 1,400,000 lekë hua vëllait të tij; (vi) të dhënat e administruara nga AMF-ja, nga ku rezulton se bashkëshortja e subjektit është policëmbajtëse për këtë automjet për një periudhë të pandërprerë 30.3.2016 – 4.4.2018; si dhe (vii) subjekti nuk ka pasur automjet tjetër në pronësi – vlerëson se automjeti tip “F.F” mund të ketë qenë në pronësi të fshehur të subjektit.

Komisioni do t’i trajtojë konstatimet e mësipërme në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

47. Orendi shtëpiake në bashkëpronësi me bashkëshorten, të cilat kanë shërbyer për mobilimin e banesës. Vlera e përbashkët e tyre varion në minimum-maksimum ndërmjet 1,200,000 lekë - 1,500,000 lekë. Pjesa takuese: 100% me bashkëshorten.

Konstatimi i ILDKPKI-së: *Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për shpenzimet e kryera të mobilimit dhe burimin e krijimit të tyre.*

Hetimi dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

47.1. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ka në bashkëpronësi pasuri të luajtshme-orendi shtëpiake, që kanë shërbyer për mobilimin e banesës, vlera e përbashkët e të cilave varion në minimum-maksimum ndërmjet 1,200,000 lekë - 1,500,000 lekë.

47.2. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: *“Shpenzimet e mobilimit të shtëpisë time janë maksimumi 1,200,000 lekë të bërë ndërmjet viteve 2008 – 2020, duke përfshirë çdo pajisje apo send që ndodhet në banesë”.*

47.3. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se ka përfituar në formën e dhurimit shumën 300,000 lekë nga prindërit e tij me rastin e martesës. Këto të ardhura, sipas deklaratimeve të subjektit, kanë shërbyer për mobilimin e banesës. Për të provuar këtë dhurim subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 23.1.2017, të shtetasve F dhe E.Y, të cilët deklarojnë se në vitin 2008 i kanë dhuruar shumën 300,000 lekë subjektit me rastin e martesës.

47.4. Në procesverbalin e datës 27.1.2015⁶³ subjekti ka deklaruar se nga viti 2008, kur është futur në shtëpi, deri në vitin 2013, vlera e mobilimit mund të ketë qenë 1,000,000 lekë.

47.5. Pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, subjekti, në lidhje me mobilimin, ka deklaruar se ai ka shpenzuar vetëm shumën 623,000 lekë, ndërsa vlera tjetër ka qenë dhuratë. Sipas subjektit përbën fakt të njohur botërisht se shpenzimet e mobilimit bëhen në pjesën dërrmuese në fillim të jetesës.

47.6. Në kushtet kur nga ana e subjektit janë kryer deklarime kontradiktore, Komisioni do të përfshijë në analizë vlerën e mobilimit të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Në përfundim, shpenzimet e mobilimit do të përfshihen në analizën financiare të viteve 2008 - 2009, duke i kaluar barrën e provës subjektit.

47.7. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka pretenduar se vlera e mobilimit e deklaruar prej tij ka përfshirë edhe dhuratat që ka përfituar nga familjarë të tij. Subjekti deklaron se: “... nëse Komisioni e vlerëson këtë deklaram të paplotë, atëherë unë po e saktësoj përmes këtij shpjegimi, por duke pasur parasysh që edhe Komisionit i ka lindur detyrimi që në kohën kur unë kam bërë këtë deklaram, që të bëjë pyetje plotësuese dhe jo të veprojë duke e konsideruar mungesën e detajimit si mosveprim, apo ca më keq, si premisë që çon në mungesa likuiditeti ose mundësie financiare”.

Subjekti ka listuar një pjesë të mobilimit të tij rreth vlerës 727,000 lekë, të cilën e pretendon si të dhuruar.

47.8. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti ka pasur të gjitha mundësitë që në deklaratën *Vetting* të saktësonte vlerën e mobilimit, si dhe pjesën që i ishte dhuruar. Pavarësisht se ligji nr. 84/2016 nuk kërkonte deklarimin e vlerës së mobilimit, subjekti e ka kryer një deklaram të tillë duke pranuar që vlera e mobilimit është 1,200,000 lekë - 1,500,000 lekë. Gjithashtu subjekti, gjatë hetimit, por edhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka dhënë shpjegime kontradiktore në lidhje me orenditë e dhuruara. Tabela e paraqitur në faqet 64-65 të shpjegimeve të tij (me emërtim “Memo-KPK-Shkodra”)⁶⁴ nuk përputhet me deklaramet e subjektit në pyetësonin standard. Kështu, subjekti deklaron në pyetësonin standard se dhoma e gjumit është sjellë pajë nga bashkëshortja dhe ka një vlerë 120,000 lekë, së bashku me aksesore, ndërkohë, pas kalimit të barrës së provës, deklaron vlerën 200,000 lekë, në mobilim përfshin dhe vlerën 150,000 lekë mobilim tualeti sikur i është dhuruar nga firma ndërtuese, ndërkohë që në pyetësonin standard nuk ka deklaruar një dhurim të tillë. Në pyetësonin standard deklaron se dy piktura i janë dhuruar nga vëllai i tij (të cilit ia kishte dhuruar një mik OPGJ, J.B), ndërkohë që në tabelën e shpjegimeve deklaron se i janë dhuruar katër piktura nga miku i tij J.B. Në pyetësonin standard deklaron se dhomën e djalit e ka mbuluar me shpenzimet e tij në shumën 60,000 lekë, ndërkohë në tabelën e shpjegimeve deklaron se i është dhuruar krevat në vlerën 60,000 lekë.

47.9. Për shkak të deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, është e pamundur të verifikohet pasqyrimi i situatës së vërtetë lidhur me vlerën e mobilimit, për rrjedhojë, konstatohet pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të mobilimit. Në këto rrethana, deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Në analizë financiare Komisioni do të përfshijë vlerën e mobilimit, sikundër e ka pasqyruar në rezultatet e hetimit, për sa kohë subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës.

⁶³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2022, të ILDKPKI-së.

⁶⁴ I njëjti deklaram është bërë nga subjekti edhe në faqen 52 të dokumentit “Memo për raportin e vlerësimit nëntor 2022”.

Për të qenë sa më shterues Komisioni ka kryer edhe një analizë financiare sipas deklarimeve të subjektit pas kalimit të barrës së provës, por sërish subjekti do të kishte një pamjaftueshmëri financiare për të mbuluar shpenzimet e mobilimit në vitin 2008.

48. Tokë bujqësore⁶⁵, me sipërfaqe 10.950 m², me nr. pasurie *, z. k. ***, vol. **, f. ***, në bashkëpronësi të shtetasve F, E, A, A dhe F.Y, që është regjistruar në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme në ZVRPP-në Shkodër në emër të kryefamiljarit F.Y, me adresë: fshati T, Njësia Administrative B, Bashkia Shkodër.**

Hetimi dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

48.1. Babai i subjektit, në cilësinë e kryefamiljarit të familjes bujqësore, ka përfituar me AMTP-në nr. **, datë 16.7.1994, sipërfaqen prej 11.250 m² tokë bujqësore në fshatin B, Shkodër. Kjo pasuri rezulton e regjistruar në ZVRPP-në Shkodër me vendndodhje në Rr, e llojit “arë”, me sip. 10.950 m², me nr. ***, z. k. ***.

48.2. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se mbi këtë pasuri të paluajtshme ka vetëm formalisht të drejta bashkëpronësie, pasi nuk e posedon, nuk e gëzon dhe nuk e ka në përdorim që nga viti 2008 e në vazhdim (pas martesë). Kjo pasuri *de facto* është në pronësi të vetme të prindërve të tij, pasi së bashku me motrën dhe vëllain, pas martesave përkatëse, faktikisht (ndonëse jo formalisht) kanë hequr dorë nga çdo lloj pretendimi bashkëpronësor mbi këtë pasuri.

48.3. Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.2.2015, me deklarues Sh.G, i cili deklaroi se: “*Gjatë periudhës 2005 – 2008 ka marrë në përdorim nga F.Y tokë arë me sip. 10.800 m² dhe i ka dhënë pronarit F.Y shumën 600,000 lekë*”. Nga kontrolli në regjistrin elektronik të QKB-së nuk rezulton që shtetasi Sh.G të jetë regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti tregtar.

48.4. Nga verifikimi i deklarimeve periodike të subjektit konstatohet se ai, në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore, ka deklaruar si më poshtë vijon:

- i. Në DVP/2005 subjekti ka deklaruar: “*Fituar nga prodhimi i tokës së babait tim, fitime të bëra gjatë vitit 2005 nga prodhimet bujqësore në shumën 400,000 lekë*”.
- ii. Në DVP/2006 subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura në shumën 100,000 lekë nga dhënia me qira e tokës bujqësore*”.
- iii. Në DVP/2007 subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura në shumën 70,000 lekë nga dhënia me qira e tokës bujqësore*”.

Bazuar në deklaratimet e subjektit në DPV, rezulton se babai i tij ka përfituar 400,000 lekë të ardhura nga prodhimet bujqësore dhe 170,000 lekë të ardhura nga dhënia me qira e tokës bujqësore.

48.5. Siç rezulton nga vetë deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore, ato nuk përputhen me deklaratën noteriale të depozituar nga subjekti, pasi në vitin 2005 ka deklaruar se ka përfituar të ardhura nga toka bujqësore për shkak të prodhimit dhe vetëm nga viti 2006 e në vijim ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira.

Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti ka depozituar një dokument që nuk përputhet me deklaratimet e tij në deklaratat periodike, duke i kaluar barrën e provës.

⁶⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë pronësie datë 28.6.2002, të ZVRPP-së Shkodër; (ii) hartë treguese e regjistrimit, aplikimi për regjistrim; dhe (iii) Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. **, datë 18.7.1994.

48.6. Pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 4.5.2022, nga Bashkia V i D, sipas së cilit z. F.Y ka shlyer të gjitha detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore deri në vitin 2022. Bashkëlidhur gjendet fatura e arkëtimit e datës 4.5.2022, sipas së cilit z. F.Y ka paguar taksë toke, ndërtesë etj. për vitet 2017 – 2022 në shumën 17,893 lekë.

48.7. Në lidhje me këto të ardhura rezulton se:

- i. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues të kohës për përfitimin e këtyre të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore.
- ii. Subjekti nuk ka provuar pagesën e detyrimeve tatimore ndaj tokës bujqësore për periudhën e krijimit të këtyre të ardhurave.
- iii. Nga hetimi nuk provohet që shtetasi Sh.G të ketë ushtruar aktivitet tregtar apo të ketë përdorur tokën bujqësore.
- iv. Subjekti ka depozituar një dokument noterial që përmban të dhëna që nuk përputhen me deklaratimet e subjektit në deklaratimet periodike.

➤ Për rrjedhojë, të ardhurat nga toka bujqësore nuk do të përfshihen në analizën financiare.

48.8. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁶⁶, ka shpjeguar se: *“I bëj me dije Komisionit se shprehja ‘përdorim i tokës bujqësore’ e përdorur nga shtetasi Sh.G nuk lidhet vetëm me marrjen me qira të tokës bujqësore, por përfshin në vetvete edhe marrjen e prodhimeve bujqësore të realizuara nga kjo tokë. Kjo shprehje nuk është përjashtuese, por përfshirëse dhe në vetvete përfshin të gjitha veprimet që lidhen me shfrytëzimin në të gjitha format e mundshme të tokës bujqësore. Fakti është se:*

- *familja ime ka realizuar të ardhura nga toka bujqësore në formën e shitjes së produkteve dhe dhënies me qira të saj;*
- *ky fakt rezulton i provuar jo vetëm me deklaratimet e mia në DVP-të e kohës, por edhe në deklaratën noteriale të përdoruesit të kësaj toke;*
- *në lidhje me këtë tokë nga babai im janë paguar detyrimet tatimore.*

Unë kam depozituar dokumentacion provues për të vërtetuar të ardhurat e fituara nga toka bujqësore. Deklarimi i këtyre të ardhurave është pasqyruar nga ana ime fillimisht në DPV-të e viteve respektive. Në vijimësi, në vitin 2015 nga ana ime është dorëzuar pranë ILDKPKI-së një deklaratë noteriale e lëshuar nga shtetasi Sh.G, nga e cila rezulton i qartë fakti i përdorimit të tokës bujqësore në pronësi të babait tim nga ky shtetas, përdorim i cili është kryer në formën e marrjes së prodhimeve bujqësore dhe marrjes me qira të tokës nga ana e tij”.

48.9. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Rezulton e provuar se të dhënat e deklaruara nga subjekti në DPV nuk përputhen me të dhënat e deklaratës noteriale të shtetasit Sh.G. Komisioni vlerëson se kjo deklaratë mund të jetë hartuar me qëllimin që subjekti të mund të provonte përpara ILDKPKI-së në vitin 2015 të ardhurat e pretenduara nga toka bujqësore. Nga hetimit i Komisionit, por dhe nga vetë subjekti, nuk u provua pagimi i detyrimeve tatimore, jo vetëm për taksën e tokës bujqësore për vitet 2005 - 2007, por dhe për pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara nga dhënia me qira e tokës bujqësore.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se për sa kohë nuk është provuar ekzistenca e këtyre të ardhurave, si dhe pagimi i detyrimeve tatimore, ato nuk do të përfshihen në analizën financiare.

⁶⁶ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

49. Bono thesari⁶⁷ në vlerën 3,150,000 lekë, e depozituar në emër të bashkëshortes së subjektit A.Y në Bankën e Shqipërisë, me nr. *, me datë emetimi 7.4.2016 dhe datë maturimi 6.4.2017**

50. Bono thesari në vlerën 4,200,000 lekë, e depozituar në emër të bashkëshortes së subjektit A.Y në Bankën e Shqipërisë, me nr. *, me datë emetimi 22.12.2016 dhe datë maturimi 21.12.2017.**

Burimi i krijimit sipas deklaratës Vetting: këto pasuri janë krijuar nga kursimet e të ardhurave familjare përgjatë viteve të martesës (vitet 2008 e në vazhdim). Pjesa takuese: e pandarë.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Mungesë e burimeve të ligjshme financiare për krijimin e bonove të thesarit në shumën 1,750,000 lekë në datën 5.4.2010.*
- *Deklarim i pasaktë i burimit të shtesave në vitin 2012 në bono thesari me kredinë e marrë në BKT në dhjetor 2011.*
- *Transaksione të dyshimta, të kryera ndërmjet subjektit dhe babait të tij në vitin 2012 dhe 2013, lidhur me kreditë e marra dhe shlyerjet e tyre, shuma të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e shtesave në bono thesari.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor dhe burimi të ligjshëm financiar për krijimin e dhuratave në shumën totale 2,100,000 lekë në vitin 2008 (nga prindërit, miqtë e të afërmit e subjektit 600,000 lekë dhe nga nëna e bashkëshortes 1,500,000 lekë), shumë e cila pjesërisht ka shërbyer si burim për depozitë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2008 dhe më pas, bono thesari në vitin 2009.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor dhe burimi të ligjshëm financiar për krijimin e depozitës në shumën 1,000,000 lekë në “Raiffeisen Bank” në vitin 2008, shumë e cila ka shërbyer si burim për bono thesari në vitin 2009.*
- *Mungesë e burimeve të ligjshme financiare për krijimin e shumës 750,000 lekë në datën 18.7.2011 dhe 930,000 lekë në datën 23.7.2012, shuma të cilat kanë shërbyer si shtesë në bono thesari.*
- *Mosdeklarim i kredisë në shumën 1,500,000 lekë, në “Tirana Bank”, e cila ka shërbyer si burim për bono thesari në vitin 2009, në deklaratën e pasurisë Vetting.*
- *Veprime të dyshimta lidhur me marrjen e kredisë në “Tirana Bank”, datë 10.7.2009, në shumën 1,500,000 lekë, për të cilën babai i subjektit vë garanci një depozitë në vlerën 1,850,000 lekë, shumë e depozituar cash në datën 9.7.2009. Burimi i krijimit të kësaj shume nga babai i subjektit mbetet i panjohur dhe i dyshimtë.*

Hetimi⁶⁸ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

⁶⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) vërtetimin mbi shpalljen fitues nga Banka e Shqipërisë, në emër të znj. A.Y, për bono thesari 12-mujore, me datë emetimi 7.4.2016 dhe datë maturimi 6.4.2017, të shumës 3,150,000 lekë nga llogaria e “Societe Generale Bank”; (ii) vërtetimin mbi shpalljen fitues nga Banka e Shqipërisë në emër të znj. A.Y, për bono thesari 1-vjeçare, me datë emetimi 22.12.2016 dhe datë maturimi 21.12.2017, të shumës 4,200,000 lekë nga llogaria e “Societe Generale Bank”.

⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 21.5.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. ***/tbo-**, datë 29.5.2020, e OTP Bank; shkresë kthim përgjigjeje nr. ON-A***prot., datë 28.5.2020, e Bankës së Parë të Investimeve; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.5.2020, e “Tirana Bank”; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.6.2020, e BKT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 26.5.2020, e Bankës së Shqipërisë.

50.1. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në OTP Bank rezulton se:

- në datën 28.7.2016 është transferuar shuma 3,981,321.15 lekë, e cila është tërhequr *cash* në datën 1.8.2016;
- në datën 14.12.2016 bashkëshortja e subjekti ka depozituar *cash* shumën 4,200,000 lekë, e cila është investuar sërish në bono thesari dhe në datën 23.12.2016 është tërhequr shuma 122,600 lekë, që përbën interesin e bonove të thesarit;
- në datën 22.12.2017 janë maturuar bonot e thesarit, duke u kthyer fondi në vlerën 4,181,598.62 lekë, i cili sërish është bllokuar në bono thesari.

50.2. Banka e Parë e Investimeve konfirmon llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, çelur në datën 28.7.2009, llogari e cila rezulton e mbyllur në datën 4.1.2017. Bashkëlidhur *statementi* i llogarisë, ku figuron se znj. A.Y ka kryer derdhje në llogari dhe kalim në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, si vijon:

- në datën 28.7.2009 ka derdhur *cash* 2,250,000 lekë të kaluara për blerje bonoje;
- në datën 5.4.2010 ka derdhur *cash* 1,750,000 lekë të kaluara për blerje bonoje;
- në datën 23.7.2010 ka derdhur *cash* 75,000 lekë të kaluara për blerje bonoje;
- në datën 31.3.2011 ka derdhur *cash* 150,000 lekë të kaluara për blerje bonoje;
- në datën 18.7.2011 ka derdhur *cash* 750,000 lekë të kaluara për blerje bonoje;
- në datën 5.4.2012 ka derdhur *cash* 900,000 lekë të kaluara për blerje bonoje;
- në datën 23.7.2012 ka derdhur *cash* 930,000 lekë të kaluara për blerje bonoje;
- në datën 29.3.2013 ka derdhur *cash* 350,000 lekë të kaluara për blerje bonoje.

Për sa më sipër, rezulton se nga data 28.7.2009 deri më 29.3.2013 janë depozituar *cash* për blerje bono thesari 7,155,000 lekë.

50.3. Banka e Shqipërisë konfirmon blerjen e bonove të thesarit, si më poshtë vijon:

- në datën 9.4.2015 është debituar shuma 3,133,794 lekë, e cila është përdorur sërish për blerje bono thesari në të njëjtën datë në vlerën 3,043,173.76 lekë;
- në datën 30.7.2015 është debituar shuma 3,981,347.56 lekë, e cila është përdorur sërish për blerjen e bonove të thesarit në të njëjtën datë në vlerën 3,875,474.32 lekë;
- në datën 28.7.2016 është debituar shuma 3,981,321.15 lekë;
- në datën 7.4.2016 është kredituar shuma 3,133,976 lekë, e cila është përdorur sërish për blerjen e bonove të thesarit në të njëjtën datë në vlerën 3,102,080 lekë;
- në datën 22.12.2016 është kredituar shuma 4,077,324.15 lekë për blerjen e bonove të thesarit.

50.4. Subjekti, përpara se të analizojë barrën e provës të kaluar nga Komisioni për blerjen e bonove të thesarit që fillojnë nga viti 2009, ka dhënë shpjegime⁶⁹ dhe ka paraqitur në mënyrë analitike gjendjen financiare të familjes së tij për vitet 2007 - 2008, nga e cila rrjedh mundësia për blerjen e këtyre bonove në vitin 2009. Ai ka paraqitur në tabelë në faqen 68 të shpjegimeve të tij me emërtim “Memo-KPK-Shkodra” një analizë financiare të vitit 2007, nga rezulton me një bilanc negativ në shumën 506,092 lekë⁷⁰.

Për të rregulluar këtë bilanc të vitit 2007 subjekti ka bërë një analizë kumulative të viteve 2001 - 2007, duke nxjerrë një rezultat total me emërtim “për efekt kuadrimit” në shumën 1,325,141 lekë. Siç është trajtuar edhe më lart, kjo vlerë nuk është e bazuar në deklaratimet e tij periodike, për rrjedhojë, nuk mund të përfshihet në vitin 2008 apo të konsiderohet që viti 2007 është me rezultat pozitiv.

⁶⁹ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

⁷⁰ E njëjta shumë është edhe në faqen 56 në dokumentin “Memo për raportin e rivlerësimit nëntor 2022”.

50.5. Në lidhje me vitin 2008 subjekti ka pretenduar se Komisioni ka njohur si burim të ardhurash dhuratat e martesës dhe lindjes së djalit jo në vlerën e deklaruar nga ana e tij 600,000 lekë, por në vlerën 450,000 lekë. Gjithashtu evidenton se Komisioni nuk ka njohur në të ardhurat e tij vlerën 300,000 lekë, që i është dhënë dhuratë nga prindërit e tij me rastin e martesës dhe vlerën 150,000 lekë që i është dhuruar nga nëna e bashkëshortes së tij. Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka pasqyruar si shpenzim për vitin 2008 vlerën e huas dhënë babait të tij në shumën 400,000 lekë.

50.6. Në lidhje me këto të ardhura të pretenduara rezulton se Komisioni ka përfshirë në analizë shumën 450,000 lekë, duke marrë të mirëqenë deklaratimet e subjektit për këtë shumë si të dhuruar nga familjarë dhe të afërm, pavarësisht faktit që ai nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues dhe ka qenë në nivel deklarativ. Ky qëndrim i Komisionit nuk është në përputhje me vendimin nr. 18/2022 të Kolegjit⁷¹, por pavarësisht këtij fakti Komisioni, për të mos rënduar pozitën e subjektit, do të përfshijë këtë shumë në analizë financiare. Për sa i përket shumës së dhuruar nga prindërit, Komisioni ka konstatuar se ata nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kryer këtë dhurim. Mungesa e të ardhurave provohet edhe nga vetë deklaratimet e subjektit se në vitin 2008 i ka dhënë hua prindërve të tij shumën 400,000 lekë. Nëse prindërit e subjektit do të kishin të ardhura të mjaftueshme për dhurimet e bëra subjektit, atëherë nuk do të kishte asnjë arsye që ai t'i jepte hua atyre shumën 400,000 lekë.

Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të subjektit për krijimin e këtyre bonove.

51. Në lidhje me bonot e krijuara në vitin 2009

51.1. Subjekti, në pyetësin nr. 3, për burimin e këtyre bonove, ka deklaruar: *“Për bonon e thesarit, për të cilën në datën 28.7.2009 janë derdhur cash 2,250,000 lekë, sqaroj se për financimin e saj kanë shërbyer si burim akumulimi i tërheqjes së shumës së depozituar nga bashkëshortja ime në ‘Raiffeisen Bank’ dhe i interesave mbi depozitën, kursimet nga rroga ime dhe ajo e bashkëshortes nga data 1.1.2009, si dhe një pjesë e vogël e një kredie bankare që kam marrë tek ‘Tirana Bank’ (në shumën në totale 1,500,000 lekë). Pjesën tjetër të kësaj kredie e kemi përdorur, sikurse do të shihet në vijim të këtij deklarimi”.*

51.2. Subjekti ka deklaruar në DPV/2009 marrjen e një kredie në vlerën 1,500,000 lekë në “Tirana Bank”.

Nga të dhënat e administruara nga “Tirana Bank” ka rezultuar se:

- a) Subjekti në datën 10.7.2009 ka marrë kredi konsumatore me kontratën nr. *** në shumën 1,500,000 lekë, me afat 40-mujor. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit rezulton se në datën 13.7.2009 është disbursuar kredia në shumën 1,500,000 lekë. Në po të njëjtën datë është tërhequr shuma 1,332,000 lekë.
- b) Kredia është siguruar nga shuma 1,850,000 lekë⁷² në formën e depozitës me afat dyvjeçar nga data 9.7.2009 deri më 11.7.2011, në emër të babait të subjektit F.Y. Nga nxjerrja e llogarisë së babait të subjekti në “Tirana Bank” rezulton një depozitim në datën 8.7.2009, në shumën 1,850,000 lekë, me përshkrimin “me vendim gjykate dhe kursime”.
- c) Në lidhje me këtë kredi subjekti ka deklaruar në procesverbalin e datës 16.11.2011⁷³ se në datën 13.7.2009 ka marrë kredi konsumatore në “Tirana Bank”, një pjesë e së cilës është

⁷¹ Shihni paragrafët 42-45 të këtij vendimi.

⁷² Kontratë pengu nr. ***, datë 10.7.2009.

⁷³ Shihni shkresë nr. *** prot., datë 14.7.2022, të ILDKPKI-së.

përdorur në bono të krijuara më 28.7.2009, ndërsa pjesa tjetër është përdorur për nevoja familjare.

51.3. Ndërkohë, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, për të njëjtën kredi, subjekti deklaron se vetëm një pjesë e vogël e saj është përdorur për blerjen e bonove në vitin 2009, pasi kjo kredi ka shërbyer për blerjen e bonove në datën 5.4.2010. Sipas subjektit, ai gabimisht nuk e ka deklaruar saktësisht në DPV/2009. Subjekti deklaron: *“Kjo ka qenë kredi konsumatore e përdorur shumë pak në vitin 2009, duke financuar një udhëtim në Turqi në shumën 1,000 euro, ndërsa pjesën tjetër e kemi përdorur për të plotësuar bonot e krijuara në datën 28.7.2009, pra është përdorur një pjesë e vogël e kësaj kredie, ndërsa pjesën e mbetur të kësaj kredie e kemi përdorur për të financuar bonot e datës 5.4.2010. Lidhur me gabimin e bërë në deklarimin e kësaj kredie kjo justifikohet me faktin se ka qenë hera e parë që unë kam shkruar me dorën time deklaratën individuale vjetore, pasi herët e tjera janë shkruar nga babai dhe jam ngatërruar”*.

51.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë kredi, konstaton se:

- i. Deklarimi i subjektit i kryer gjatë hetimit administrativ nuk përputhet me deklarimin e tij përpara ILDKPKI-së në vitin 2011 dhe në DPV/2009.
 - ii. Subjekti ka deklaruar në DVP/2009 gjendje *cash* shumën 400,000 lekë, si dhe nuk rezulton të ketë deklaruar si kursim *cash* të ardhurat nga kredia.
 - iii. Subjekti nuk rezulton të ketë saktësuar shumat e përdorura nga kredia për blerjen e bonove në vitet 2009 dhe 2010, duke u bërë e pamundur të përcaktohet vlera e saktë e përdorur nga kjo kredi për blerjen e këtyre bonove në këto vite.
- Për rrjedhojë, kredia në shumën 1,500,000 lekë nuk do të përfshihet si burim për blerjen e bonove në vitet 2009 dhe 2010.

51.5. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁷⁴, ka shpjeguar se rezulton e qartë se nga momenti i marrjes së kredisë (datë 13.7.2009) deri në datën e blerjes së bonove të thesarit (31.7.2009) ka një distancë kohore prej 18 ditësh. Gjatë kësaj periudhe të shkurtër kohore ai pretendon se nuk ka kryer asnjë blerje të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, si dhe nuk ka shpenzuar në udhëtime, për pasojë, sipas tij, evidentohet qartë se një pjesë e të ardhurave monetare të marra me këtë kredi janë përdorur për blerjen e bonove të thesarit. Subjekti pretendon se kemi të bëjmë me një pasaktësi, e cila nuk shoqërohet me fshehje të pasurisë apo burimeve të saj, duke iu referuar edhe vendimit nr. 46/2018 të Komisionit.

51.6. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se edhe pas kalimit të barrës së provës nuk është saktësuar sërish shuma përkatëse e përdorura prej tij për vitet 2009 - 2010 në lidhje me këtë kredi. Për rrjedhojë, për sa kohë vetë subjekti nuk është përpjekur për të saktësuar këto shuma, edhe pse Komisioni i ka kaluar barrën e provës, vlerësohet se kjo kredi nuk është përdorur për blerjen e këtyre bonove. Komisioni vlerëson se kjo kredi është deklaruar nga subjekti si burim gjatë hetimit, me qëllim rregullimin e pozitës së tij në analizën financiare, duke u fshehur në këtë mënyrë burimi i ligjshëm i të ardhurave për krijimin e bonove.

51.7. Për shkak të deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, është e pamundur të verifikohet pasqyrimi i situatës së vërtetë lidhur me shumën e saktë të kredisë së përdorur për blerjen e bonove, për rrjedhojë, konstatohet pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të bonove. Në këto rrethana, deklarimi i subjektit të

⁷⁴ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit si dhe gjatë seancave dëgjimore.

rivlerësimit është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në analizën financiare për blerjen e bonove, Komisioni nuk do ta përfshijë këtë kredi, ndërkohë ajo do të përfshihet në analizën e plotë të vitit 2009.

51.8. Në lidhje me shumën 1,850,000 lekë të depozituar nga babai i subjektit, nga analiza financiare konstatohet se ai nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite. Në kushtet kur kjo depozitë: (i) është krijuar dy ditë përpara se subjekti të përfitonte kredinë në “Tirana Bank”; (ii) ka shërbyer për sigurimin e kredisë së marrë nga subjekti; si dhe (iii) babai i tij nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite – Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit, duke ngritur dyshime për pasuri të fshehur.

51.9. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁷⁵ ka shpjeguar se: *“Në lidhje me këtë barrë prove me të cilën më ka ngarkuar Komisioni, shpjegoj se për shkak të cilësisë së kësaj shume të depozituar nga babai im, ‘garanci bankare’, unë nuk kam pasur asnjë detyrim ta deklaroj atë ndonjëherë. Mosdeklarimi i kësaj garancie bankare nuk mund të konsiderohet nga Komisioni as si mosdeklarim dhe as si deklarim i rremë nga ana ime. Kjo për shkak se kjo ‘garanci bankare’ nuk sjell asnjë pasojë në analizën financiare të pasurisë sime, pasi kjo shumë nuk rezulton të jetë futur në qarkullim nga ana ime për t’u përdorur as për krijim pasurie, as për mbulim shpenzimesh të tjera të ekonomisë time familjare dhe as rezulton të jetë deklaruar si burim për qëllime të kësaj natyre⁷⁶. ...fillimisht shpjegoj se kjo shumë bankare është rrjedhojë e kursimeve familjare të familjes sime të origjinës. Nëse Komisioni do të vlerësojë analizën financiare të familjes sime të origjinës për vitin 2008, rezulton e qartë se për këtë vit ata rezultojnë me balancë pozitive në një shumë më të madhe se 2,000,000 lekë, shumë e cila tejkalon shumën e vënë garanci bankare nga babai im. Konkretisht, shpjegoj se kjo shumë është rrjedhojë e kursimeve të familjes time të origjinës për vitet 2007, 2008 dhe 2009, ku veçanërisht duhen përmendur të ardhurat rreth 950,000 lekë nga ekzekutimi i dy vendimeve gjyqësore në favor të nënës time në vitin 2008, të ardhurat nga puna si avokat e vëllait tim G.Y, që sikur 50% vitin mbi xhiron të llogariten, janë rreth 2,000,000 lekë, Gjithashtu shpjegoj se në këtë periudhë kohore babai im ka marrë kredi bankare pranë ‘ProCredit Bank’, shumë e cila tejkalon vlerën monetare të vënë nga babai im si garanci për këtë kredi bankare, aktet e se cilës gjithashtu jua kam dërguar, por për të cilat me sa kam konstatuar, edhe ju vetë keni marrë informacion nga bankat e nivelit të dytë”.*

51.10. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se shpjegimet e tij nuk janë bindëse. Nuk ka asnjë logjikë ekonomike që babai i subjektit të merrte një kredi, që ta depozitonte në bankë për të siguruar kredinë që do të merrte vetë subjekti. Së dyti, subjekti ka pretenduar se gjatë vitit 2008 i ka dhënë babait të tij hua shumën 400,000 lekë, e cila po sipas subjektit, i është kthyer sërish në vitin 2009. Nëse babai i subjektit do të kishte të ardhura të mjaftueshme, ai nuk kishte pse të merrte hua shumën 400,000 lekë.

51.11. Në lidhje me të ardhurat e vëllait të subjektit, nga hetimi ka rezultuar se nuk është provuar pagimi i detyrimeve tatimore për vitet 2008 - 2010, si dhe nga të dhënat e deklaruara për vitet 2011 - 2012 të ardhurat e tij nga aktiviteti si avokat janë në shumën rreth 200,000 lekë.

51.12. Në këto kushte, jo vetëm gjatë hetimit, por edhe pas kalimit të barrës së provës, nga ana e subjektit nuk është provuar burimi i ligjshëm i të ardhurave të babait të tij për shumën

⁷⁵ Për më shumë, referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit si dhe gjatë seancave dëgjimore.

⁷⁶ Subjekti, në lidhje me këtë pretendim, i është referuar vendimit nr. 1/2022 të Kolegjit.

1,850,000 lekë, shumë e cila rezulton të jetë krijuar gjatë vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009 (pasi subjekti ka deklaruar rregullisht deri në vitin 2007 të ardhurat e gjithë familjes). Gjatë vitit 2008, babai i subjektit, bazuar në vetëdeklarimet e subjektit, i ka marrë atij hua shumë 400,000 lekë⁷⁷, i ka dhuruar shumë 300,000 lekë për mobilim, si dhe i ka mbuluar shpenzimet e dasmës, ndërkohë që gjatë vitit 2009 nga hetimi rezulton se babai i subjektit ka shpenzuar shumë 2,000,000 lekë për shtesën e katit në shtëpinë e blerë në vitin 2004, të analizuar në vijim. Për sa më sipër, rezulton se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e depozitës, e cila është përdorur si garanci për kredinë e marrë nga subjekti.

51.13. Në përfundim, duke marrë në konsideratë deklarimet e subjektit në lidhje me burimin e shumës 1,850,000 lekë, mungesën e burimeve të ligjshme të babait të subjektit për krijimin e kësaj shume dhe qëllimin e përdorimit të saj për interesa të subjektit, Komisioni ngre dyshime se ka të bëjë me një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit. Komisioni do t'i trajtojë konstatimet e mësipërme në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

51.14. Në lidhje me pretendimin e subjektit se është në të njëjtën situatë si në vendimin nr. 1/2022 të Kolegjit, Komisioni vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk është i mbështetur, pasi Komisioni nuk e ka analizuar shumë 1,850,000 lekë si garanci bankare, por si pasuri të fshehur të subjektit.

51.15. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 28.7.2008 ka depozituar *cash* shumë 1,000,000 lekë, e cila është përdorur për hapje depozite. Kjo shumë së bashku me interesat është tërhequr në datën 28.7.2009 në vlerën 1,066,000 lekë.

Në pyetësin nr. 3, në lidhje me burimin e shumës 1,000,000 lekë, subjekti deklaron: *“Sqaroj se burimi i krijimit të kësaj depozite bankare në emër të bashkëshortes sime fillimisht kanë qenë një pjesë e kursimeve familjare të familjes së saj të origjinës... Fillimisht, vjehrra ime F. H ka pasur synim që këtë shumë parash, për të cilën pyet Komisioni, t’ia japë të bijës së saj, pra bashkëshortes sime A.Y. Kjo pasi vjehrra ka konsideruar se kjo ka qenë një shumë parash që bashkëshortja ime duhet ta përfitonte si trashëgimtare e të atit të saj A.H. Kjo është edhe arsyeja që bashkëshortja ime, pasi i ka marrë këto para, i ka depozituar në emër të saj në ‘Raiffeisen Bank’. Pasi kam filluar bashkëjetesën me bashkëshorten time në janar 2008 dhe, veçanërisht, pas dasmës së kryer në datën 6.4.2008, unë dhe bashkëshortja ime kemi rënë dakord që t’ia kthejmë vjehrrës shumë prej 1,000,000 lekësh që ishte depozituar në emër të bashkëshortes sime në bankë. Mbi bazën e dakordësisë së arritur nga unë dhe bashkëshortja ime, pak muaj pas dasmës, mos gaboj rreth vjeshtës së vitit 2008, ne ia kemi kthyer cash vjehrrës sime (pra nënës së bashkëshortes) shumë prej 1,000,000 lekësh, që figuronin të depozituara në emër të bashkëshortes sime, në ‘Raiffeisen Bank’ sh.a. Deklaroj që kjo shumë parash është përdorur pas tërheqjes së saj, si një nga zërat që i kanë shërbyer bashkëshortes sime për të blerë bonot e thesarit në shumë 2,250,000 lekë, të depozituara po në datën 28.7.2009, për blerje bono”.*

51.16. Komisioni konstaton se shpjegimet e subjektit nuk përputhen me deklarimet e bëra prej tij në vitin 2008, kur ka deklaruar se ai dhe bashkëshortja kanë një pasuri të luajtshme në shumë 1,000,000 lekë, të depozituar në “Raiffeisen Bank”, për rrjedhojë kjo shumë nuk mund të ketë pasur si burim të ardhurat e nënës së bashkëshortes, deklaruar nga subjekti gjatë hetimit.

⁷⁷ Shihni deklarimet e subjektit në faqet 86-87 të prapësimeve të dërguara me *email* në datën 29.11.2019 me emërtimin “Memo-KPK-Shkodra”, përgjigjet e pyetësorit të tretë në lidhje me burimin e të ardhurave për bonot e vitit 2010, si dhe shpjegimet e dërguara nga subjekti me *email* të datës 19.12.2022, faqet 72 dhe 73.

Ky konstatim i Komisionit bazohet edhe në vetëdeklarimet e subjektit përpara ILDKPKI-së, si vijon:

- i) Subjekti deklaron në procesverbalin e datës 16.10.2009⁷⁸ se depozita është në emër të bashkëshortes dhe është tërhequr në qershor - korrik 2009, por nuk rezulton të ketë deklaruar që është përdorur si burim për blerjen e bonove.
- ii) Në procesverbalin e datës 6.3.2015 përpara ILDKPKI-së⁷⁹ subjekti ka deklaruar se asetet *neto* të krijuara në vitin 2008 kanë qenë në vlerën 1,600,000 lekë, 1,000,000 lekë llogaria bankare dhe 600,000 gjendje *cash*, të cilën nuk e ka deklaruar. Subjekti edhe në memon e datës 13.2.2015, të paraqitur në ILDKPKI në lidhje me këtë llogari bankare, nuk deklaron si burim të ardhurat nga prindërit e bashkëshortes, por sqaron se me bashkëshorten ka lidhur martesë faktike shumë muaj më parë.

51.17. Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësinë e krijimit të depozitës në “Raiffeisen Bank” në shumën 1,000,000 lekë, në datën 28.7.2008.

Tabela nr. 9

	Datë 28.7.2008
Pasuria	925,598.20
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	925,598.20
<i>Total likuiditeti</i>	925,598.20
<i>Cash</i>	0.00
Detyrime	-270,000.00
Huadhënie babait	-270,000
Pasuria <i>neto</i>	1,195,598.20
Të ardhura	570,648.40
Të ardhurat e subjektit	570,648.40
Shpenzime	92,013.00
Shpenzime jetike	79,695.00
TIMS	12,318.00
Mundësia për kursime	-716,962.80

Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite në vlerën 716,962.80 lekë.

51.18. Në lidhje me shumën 1,000,000 lekë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, si vijon:

- i. Subjekti ka kryer deklarime kontradiktore në lidhje me burimin e krijimit të shumës 1,000,000 lekë.
- ii. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues për të provuar të ardhurat e nënës së bashkëshortes së tij për krijimin e depozitës në shumën 1,000,000 lekë.
- iii. Subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj shume.
- iv. Subjekti nuk e ka deklaruar si burim për krijimin e bonove këtë shumë në ILDKPKI.

⁷⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2022, të ILDKPKI-së.

⁷⁹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje të ILDKPKI-së.

- Për rrjedhojë, kjo shumë nuk do të përfshihet në analizën financiare si burim për krijimin e bonove në vitin 2009.

51.19. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁸⁰, ka shpjeguar se: *“Fillimisht shpjegoj se këtë depozitë bankare unë e kam deklaruar në DPV/2008 dhe, pikërisht në faqen 3, ku në lidhje me të shprehem: ‘Unë dhe bashkëshortja ime nga viti 2008 e në vazhdim kemi një pasuri të luajtshme prej 1.000.000 lekësh të reja të depozituara në ‘Raiffeisen Bank’’. Në lidhje me burimin fillestar të krijimit të kësaj shume nga vjehrra ime, unë jo vetëm që kam dhënë shpjegime të plota, por edhe ju kam dërguar prova që e provojnë bindshëm ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume (dërguar me përgjigjet e pyetësorit nr. 3). Ndër këto prova evidentoj si shembull analog vendimin me nr. *** (***), datë 21.9.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga përmbajtja e të cilit rezulton se në datën 15.1.2001, shtetasit F dhe A.H i kanë shitur shtetases M. M një apartament banimi me sipërfaqen 55 m², të ndodhur në lagjen ‘D. M’, Shkodër, në vlerën 2,700,000 lekë. Krahas kësaj, siç e kam shpjeguar në përgjigjet e këtij pyetësori, nëna e bashkëshortes sime, pas vdekjes së bashkëshortit të saj, ka jetuar me prindërit e saj. Vjehrra ka qenë e punësuar (edukatore kopshti) dhe po kështu prindërit e saj janë trajtuar me pension pleqërie dhe invaliditeti. Nga të gjitha këto prova rezulton qartë se nëna e bashkëshortes sime ka pasur mundësi të krijojë shumën e të ardhurave, me të cilat u krijua depozita bankare nga bashkëshortja ime A.Y(H) në vitin 2008. Komisioni i ka pasur në dispozicion të gjitha këto prova, por nuk i ka marrë në konsideratë. Ndërkohë, bazuar në analizën financiare të lartpërmendur për vitin 2008 rezulton qartë se kam pasur të ardhura të mjaftueshme për t’i kthyer vjehrrës sime shumën 1,000,000 lekë, me të cilën u krijua kjo depozitë, veprim të cilin e kam kryer me qëllim që kjo depozitë t’i mbetej familjes sime. Fakti që kjo depozitë ka shërbyer për krijimin e bonove në vitin 2009 rezulton qartë nga deklarimet e mia me DPV/2009 dhe koha kur unë e kam tërhequr depozitën në raport me kohën e depozitimit të bonove që është vetëm 3 ditë më parë. Gjithashtu, theksoj se nga analiza financiare që më është dërguar me rezultatin e hetimeve në muajin prill 2022, kjo depozitë është njohur nga Komisioni si burim të ardhurash”.*

51.20. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

i) Subjekti në DPV/2009 nuk rezulton që të ketë deklaruar si burim shumën 1,000,000 lekë, sikundër pretendohet prej tij. Në lidhje me pretendimin e subjektit se kjo shumë është konsideruar si burim në rezultatet e para të hetimit, Komisioni çmon se pas riçeljes së hetimit janë administruar dokumente të reja, ndër to edhe shkresa nr. *** prot., datë 14.7.2022, e ILDKPKI-së, dokumentacioni i së cilës është cituar më lart në cilësinë e provës në lidhje me shumën 1,000,000 lekë. Pas administrimit të të gjitha provave të reja është vendosur mbyllja e hetimit dhe dërgimi i rezultateve të hetimit subjektit, i cili nuk mund dhe nuk duhej të ishte i njëjtë me rezultatet e mëparshme të hetimit, për sa kohë është kryer një hetim më i thelluar, bazuar edhe në vetë kërkesat e subjektit, pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, por edhe gjatë hetimit.

ii) Për sa i përket pretendimeve të subjektit se si burim kanë shërbyer të ardhurat e nënës së bashkëshortes së tij, këto pretendime mbeten në nivel deklarativ dhe të pashoqëruara me dokumentacion provues. Për më tepër, ato nuk përputhen me deklarimet e subjektit në deklaratat periodike, por edhe përpara ILDKPKI-së.

51.21. Në përfundim, në lidhje me shumën 1,000,000 lekë, Komisioni vlerëson se:

⁸⁰ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

- i. Subjekti ka kryer deklarime kontradiktore në lidhje me burimin e krijimit të kësaj shume.
 - ii. Në deklaratën *Vetting* nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar si të ardhura shumën 1,000,000 lekë të dhuruar nga nëna e bashkëshortes, duke deklaruar vetëm shumën 150,000 lekë me numër rendor 13, në seksionin e të ardhurave të deklaratës *Vetting*.
 - iii. Subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për depozitimin e kësaj shume.
 - iv. Subjekti nuk rezulton që këtë shumë ta ketë deklaruar si burim për krijimin e bonove të thesarit në DPV/2009 përpara ILDKPKI-së, por edhe në deklaratën *Vetting* (në këtë deklaratë subjekti ka bërë një deklaram të përgjithshëm për sa i përket burimit, duke deklaruar kursime dhe të ardhura familjare gjatë martesës).
- Për rrjedhojë, kjo shumë nuk do të përfshihet në analizë financiare si burim për krijimin e bonove të thesarit në vitin 2009.

51.22. Analiza e mundësisë së investimit në bono thesari në shumën 2,250,000 lekë, në datën datë 31.7.2009

Tabela nr. 10

	Datë 31.7.2009
Pasuria	2,250,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>2,250,000.00</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	2,250,000.00
Të ardhura	934,053.46
Të ardhurat e subjektit	569,218.55
Të ardhurat e bashkëshortes	297,334.92
Të ardhurat nga depozitat	67,500.00
Shpenzime	610,693.02
Shpenzime jetike	239,085.00
Shpenzime interesi, disbursimi për kredi në “Tirana Bank” - 1,500,000 lekë	35,024.69
Mobilimi sipas DPV-së dhe deklaratës <i>Vetting</i>	336,583.33
Mundësia për kursime	-1,926,639.56

Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e bonove të thesarit në shumën 1,926,639.56 lekë.

51.23. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁸¹, ka paraqitur të njëjtat pretendime si më lart, në lidhje me shumën 1,000,000 lekë, kredinë bankare, si dhe vlerën e mobilimit.

51.24. Duke qenë se subjekti nuk ndryshoi qëndrim në përmbysje të barrës së provës, si dhe nuk solli asnjë dokument plotësues, Komisioni e vlerëson të ezauruar arsyetimin mbi këtë çështje si më lart.

⁸¹ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

51.25. Në përfundim, në lidhje me bonot në vitin 2009, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -1,926,639.56 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

52. Në lidhje me bonot e krijuara në vitin 2010

52.1. Subjekti, në pyetësorin nr. 3, në lidhje me burimin e këtyre bonove, ka deklaruar: *“Për bonot e thesarit të datës 5.4.2010 janë derdhur cash 1,750,000 lekë, sqaroj se kanë shërbyer si burim: 1. akumulimi i kursimeve familjare të rrogës sime deri në këtë datë; 2. rroga e bashkëshortes sime; 3. gjendja cash prej 400,000 lekësh, e deklaruar në DPV/2009 (e cila është deklaruar në mënyrë jo të qartë në f. 3 të DPV/2009, si hua prej 400,000 lekësh, pavarësisht se nuk ka qenë e tillë). Këtë shumë parash unë ia kam dhënë babait tim në vitin 2011; 100,000 lekë që më janë kthyer nga vëllai, pasi ia kisha dhënë borxh në vitin 2009, e deklaruar në DPV/2009, si dhe pjesa e përdorur e kredisë së marrë në vitin 2009, tek ‘Tirana Bank’ sh.a., që unë gabimisht nuk e kam deklaruar saktësisht në DPV/2009 (duke u shprehur vetëm se kam marr një kredi tek ‘Tirana Bank’, në shumën 1,500,000 lekë, të cilën kam marr përsipër ta shlyej për 40 muaj). Kjo ka qenë kredi konsumatore, që familja jonë e ka përdorur shumë pak në vitin 2009, duke financuar vetëm një udhëtim në Turqi që ka kushtuar rreth 1,000 euro, ndërsa pjesën tjetër të saj e kemi përdorur për të plotësuar (krahas burimeve të tjera) bonon e krijuar në datën 28.7.2009 (pra, është përdorur një pjesë e vogël e kësaj kredie), ndërsa pjesën e mbetur të kësaj kredie e kemi përdorur për të financuar bonon e datës 5.4.2010. Fillimisht, kredinë e kemi marrë për ta përdorur për mobilimin e shtëpisë, por nuk e kemi përdorur sipas destinacionit të saj. Për bonot e thesarit të datës 23.7.2010 janë derdhur cash 75,000 lekë sqaroj se për financimin e saj kanë shërbyer si burim kursimet familjare nga të ardhurat e deklaruar në DPV/2010”.*

52.2. Në procesverbalin e datës 16.11.2011⁸² subjekti deklaroi se bonot e krijuara në korrik 2010 e kanë burimin nga pakësimi i gjendjes cash të mbartur nga viti 2009, pra 400,000 lekë kursime + 100,000 lekë kthim huaje dhënë vëllait + 300,000 lekë interesa nga bono e vitit 2009 + kursime nga pagat deri në korrik 2010, si dhe 400,000 lekë të marrë në formën e huas nga babai i tij F.Y.

52.3. Për sa më sipër, duket se ka një mospërputhje midis deklaramëve të subjektit sa i përket:

- i) burimit të bonove të thesarit;
- ii) shumës 400,000 lekë, për të cilën gjatë hetimit subjekti deklaroi se e ka deklaruar gabimisht si gjendje cash, ndërkohë përpara ILDKPKI-së e ka konsideruar si gjendje cash, duke shtuar si burim edhe huan e marrë nga babai në shumën 400,000 lekë.

52.4. Komisioni ka bërë analizën financiare në lidhje me këto bono.

Në këtë analizë financiare nuk është përfshirë: (i) shuma 400,000 lekë e pretenduar si gjendje cash, pasi subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore në lidhje me burimin e kësaj shume; (ii) kredia e marrë në “Tirana Bank” në vitin 2009, trajtuar në pikën 51.2-51.7 të këtij vendimi.

Tabela nr. 11 – analiza e mundësisë së investimit në bono thesari në shumën 1,750,000 lekë, në datën 5.4.2010

	Datë 5.4.2010
Pasuria	1,399,195.39
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>1,399,195.39</i>

⁸² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2022, të ILDKPKI-së.

Detyrime	-139,345.07
Shlyerje e kredisë në “Tirana Bank” - 1,500,000 lekë - 2009 - Andri Ymeri	-139,345.07
Pasuria neto	1,538,540.46
Të ardhura	599,883.67
Të ardhurat e subjektit	335,624.67
Të ardhurat e bashkëshortes	169,938.33
Të ardhurat nga depozitat	94,320.67
Shpenzime	219,102.62
Shpenzime jetike	136,620.00
TIMS	47,432.77
Shpenzime interesi për kredi në “Tirana Bank” - 1,500,000 lekë	35,049.85
Mundësia për kursime	-1,157,759.41

Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e bonove të thesarit në shumën 1,157,759.41 lekë.

52.5. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁸³, ka shpjeguar: *“Evidentoj faktin se nga ana e Komisionit nuk më është njohur si burim të ardhurash pjesa e pa konsumuar e kredisë së marrë në vitin 2009, me arsyetimin se ‘nuk kam deklaruar kursime’. Kursime nga të ardhurat e marra nga kjo kredi unë i kam deklaruar edhe gjatë pyetjes sime në datën 16.11.2011, përpara inspektorese së ILDKPKI-së. Kështu, në këtë procesverbal unë deklaroj: ‘Bonot e krijuara në korrik 2010 kanë burimin nga pakësimi i gjendjes cash të mbartur nga viti 2009, pra 400,000 lekë kursime + 100,000 lekë kthim huaje nga vëllai + 300,000 lekë interesat nga bonot e vitit 2009 + kursimet nga pagat deri në korrik 2010 + 400,000 lekë, marrë në formë borxhi nga babai pa kontratë, pa interes, pa afat’. Nga sa rezulton nga ky procesverbal duket qartë se unë kam deklaruar kursime të mbartura nga viti 2009. Ky procesverbal bashkëlidhur me shpjegimet e dhëna me DPV duhet të konsideroheshin nga Komisioni si një shpjegim i vetëm në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9040, datë 10.4.2003, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë’”, i ndryshuar, qëndrim të cilin Komisioni e ka mbajtur në çdo rast tjetër të mëparshëm, ku gabimet e subjekteve të rivlerësimit në deklarimin e pasurisë të ‘shëruara’ me shpjegime apo deklarime të mëvonshme përpara ILDKPKI-së, i ka konsideruar tërësisht të sakta për procesin e rivlerësimit. Një rast i tillë është ai i gjyqtarit A.Ç i konfirmuar në detyrë, me vendimin e formës së prerë, me nr. 444, datë 16.9.2021, ku shpjegimet e dhëna nga ai gjatë procesit të hetimit administrativ përpara ILDKPKI-së u konsideruan si plotësuese të shpjegimeve të dhëna me DPV dhe i shërbyen vërtetimit të shpjegimeve të dhëna nga ai. Në lidhje me mosdeklarimin e gjendjes cash në deklaratat periodike nga subjektet e rivlerësimit ka një praktikë të konsoliduar edhe me vendime të Kolegjit të Apelit. Kështu, Kolegji, me vendimin nr. 1, datë 27.1.2022, të subjektit të rivlerësimit A.K nuk ka konsideruar si penalizues faktin e mosdeklarimit nga ana e subjektit të gjendjes cash, pas shitjes së banesës së tij, vlerë të cilën ai e ka përdorur në vijim për krijimin e pasurisë. Evidentoj faktin që ndoshta gabimisht në burimet e të ardhurave të mia për vitin 2010 nuk janë njohur borxhet e kthyer nga babai im në vlerën 400,000 lekë dhe vëllai im në vlerën 100,000 lekë, me arsyetimin se ‘ato nuk i kam deklaruar në DPV/2009’. Përfundimisht, konkludoj se unë kam pasur të ardhura financiare për të realizuar shumën prej 1,750,000 lekësh të depozituara nga ana ime për blerjen e bonove të thesarit në datën 5.4.2010 dhe kurrsesi nuk rezultoj me bilanc negativ për këtë vit”.*

⁸³ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

52.6. Subjekti ka kryer një analizë financiare të tij, nga ku rezulton me një pamundësi financiare në vlerën 708,906.86 lekë⁸⁴. Ndërkohë, për vitin 2010, sipas analizës së tij rezulton me një pamundësi në shumën 388,064 lekë, për të cilën shprehet se: *“Në lidhje me vitin 2010 shpjegoj se pamundësia financiare prej 383,064 lekësh nuk vjen realisht nga mungesa e mjeteve monetare, por është shkaktuar nga një gabim në raportim (deklarim) në DPV/2009, të dorëzuar në ILDKPKI. Kjo pasi në këtë DPV gabimisht nuk kam deklaruar kursime në fund të vitit, ndonëse sikurse u pa nga analiza financiare e vitit 2009 unë rezultoj me një balancë pozitive prej 991,236 lekësh. Konkretisht, ju bëj me dije se në DPV-në e këtij viti më ka ndodhur një ngatërresë në identifikimin e saktë të periudhës së raportimit që mbulon DPV/2009. Kjo, pasi sipas ligjit, data fundore e periudhës së raportimit në DPV është data 31.12.2009. Duke qenë se DPV/2009 duhej dorëzuar në ILDKPKI, sipas ligjit deri në datën 31.3.2010, unë e kam plotësuar atë me datën 25.3.2010. Në këtë datë të fundit, pra në datën 25.3.2010, që kam plotësuar DPV/2009, unë kam menduar se i kisha të dala nga gjendja cash mjetet monetare (kursimet), që kanë shërbyer për të krijuar bonon e thesarit të datës 5.4.2010. Kjo, pasi depozitimi i fondeve për bonon e thesarit, bëhet përpara datës së ankandit që ka qenë data 5.4.2010. Për rrjedhojë, duke u ngatërruar në diferencimin kohor të periudhës ligjore të raportimit që mbulon DPV/2009, që është data 31.12.2009, unë faktikisht në datën 25.3.2009, kur kam plotësuar këtë DPV, nuk kam deklaruar kursime cash, pasi vërtet kursime cash nuk kam pasur në datën e plotësimit të DPV/2009. Pra, në vend që të deklaroja përmes DPV/2009 gjendjen financiare për periudhën 1.1.2009 - 31.12.2009, faktikisht unë përmes DPV/2009 kam raportuar (me pasaktësi në raportim) gjendjen financiare për periudhën 1.1.2009 - 25.3.2010. Është pikërisht kjo pasaktësi në raportim (deklarim), por që nuk është mungesë likuiditeti apo mundësie financiare, që ka shkaktuar si balancën negative për vitin 2010, në shumën -383,064 lekë, ashtu edhe balancat negative në mundësinë e blerjes së bonove të thesarit të datës 5.4.2010, në shumën -708,906.86 lekë”*.

52.7. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se shpjegimet e subjektit jo vetëm që nuk janë bindëse, por janë edhe kontradiktore me vetë deklaratimet e tij. Subjekti është përpjekur të japë shpjegime të ndryshme në lidhje me burimin e këtyre bonove të thesarit, si dhe të kursimeve *cash* të tij me qëllim përmirësimin e situatës së tij financiare. Subjekti në DPV/2009 ka deklaruar se ka pasur kursime *cash* në shumën 400,000 lekë. Këto kursime janë përfshirë në analizë financiare. Në lidhje me pretendimin e subjektit që ai kishte kursime *cash* në vlerë më të lartë dhe pasaktësia ka ardhur si pasojë e depozitimit të shumës për blerjen e bonove përpara deklaratimit të tij periodik, ky pretendim i tij nuk përputhet me të dhënat e administruara gjatë hetimit nga ku rezulton se Banka e Parë e Investimeve, konfirmon llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, çelur datë 28.7.2009, llogari e cila rezulton e mbyllur në datën 4.1.2017. Bashkëlidhur *statementi* i llogarisë ku figuron se znj. A.Y ka kryer derdhje në llogari dhe kalim në bono thesari në Bankën e Shqipërisë në datën 5.4.2010 derdhje *cash* 1,750,000 lekë të kaluara për blerje bonoje. Për sa rezulton, depozitimi është kryer pas plotësimit të deklaratës periodike vjetore të subjektit dhe se ai nuk kishte si të ngatërrohej në lidhje me deklarinimin e gjendjes *cash* të tij.

52.8. Komisioni nuk ka përfshirë në analizë financiare vetëm huan e pretenduar të marrë nga babai i tij në shumën 400,000 lekë, pasi kjo nuk është deklaruar si burim në deklaratën *Vetting*, si dhe në DPV/2010. Gjithashtu, nuk rezulton që subjekti në DPV/2010 të ketë deklaruar marrjen e kësaj huaje. Nëse kjo hua nuk përfshihet në analizë, rezultati negativ i Komisionit përputhet me rezultatin negativ të vetë subjektit në analizën e tij.

⁸⁴ Shihni f. 90 të shpjegimeve të tij me emërtimin “Memo-KPK-Shkodra” dhe f. 75 të shpjegimeve me emërtimin “Memo” për raportin e vlerësimit nëntor 2022.

52.9. Në përfundim, në lidhje me bonot në vitin 2010, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -1,157,759.41 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

53. Në lidhje me bonot e krijuara në vitin 2011

53.1. Subjekti, në pyetësorin nr. 3, në lidhje me burimin e këtyre bonove, ka deklaruar: *“Për bonot e thesarit, për të cilat në datën 31.3.2011 janë derdhur cash 150,000 lekë, sqaroj se për financimin e saj kanë shërbyer si burim kursimet familjare nga të ardhurat e deklaruara në DPV/2010 dhe DPV/2011. Për bonon e thesarit, për të cilën në datën 18.7.2011, janë derdhur cash 750,000 lekë, sqaroj se për financimin e saj kanë shërbyer si burim: 1. kursimet familjare nga të ardhurat e deklaruara në DPV/2010 dhe DPV/2011, pra gjendja cash prej 120,000 lekësh nga viti paraardhës (shihni f. 4 të DPV/2010, të plotësuar në datën 23.3.2011) dhe 2. kursimet familjare deri në datën 18.7.2011, kur është bërë shtesa e fondeve për rinovimin e bonos”.*

53.2. Analiza e mundësisë së investimit në bono thesari në shumën 750,000 lekë, në datën 18.7.2011

Tabela nr. 12

	Datë 31.3.2011	Datë 18.7.2011
Pasuria	-25,478.06	780,910.49
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>-25,478.06</i>	<i>780,910.49</i>
Detyrime	-214,491.28	-285,988.37
Shlyerje e kredisë në “Tirana Bank” - 1,500,000 lekë - 2009 - Andri Ymeri	-114,491.28	-152,655.03
Kthim për huadhënie babait	-100,000.00	-133,333.33
Pasuria neto	189,013.22	1,066,898.86
Të ardhura	595,036.25	793,381.67
Të ardhurat e subjektit	367,356.50	489,808.67
Të ardhurat e bashkëshortes	147,160.00	196,213.33
Të ardhurat nga depozitat	80,519.75	107,359.67
Shpenzime	140,726.84	187,635.78
Shpenzime jetike	102,465.00	136,620.00
TIMS	22,015.48	29,353.98
Shpenzime interesi për kredi në “Tirana Bank” - 1,500,000 lekë	16,246.36	21,661.81
Mundësia për kursime	265,296.20	-461,152.97
Kumulative deri më 18.7.2011		-195,856.77

Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e bonove në shumën 195,856.77 lekë.

53.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁸⁵ ka shpjeguar se evidenton faktin se nga analiza financiare e kryer nga Komisioni në burimet e të ardhurave deri në datën e depozitimit të bonove të thesarit nuk janë llogaritur kursimet nga viti 2010. Bazuar në të ardhurat e vitit 2010 subjekti pretendon se jo vetëm që nuk rezulton me bilanc negativ,

⁸⁵ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

por përkundrazi rezulton me balancë pozitive në vlerën 120,000 lekë (deklaruar faqen 4 të DPV/2010, të plotësuar në datën 23.3.2011), shumë e cila po t'u shtohet të ardhurave nga paga (kursimet) deri në datën e depozitimit të bonove 18.7.2011, krijon mundësinë financiare për të depozituar këtë shumë të ardhurash.

53.4. Ndërkohë, Komisioni konstaton se subjekti ka paraqitur një analizë financiare në faqen 95 të parashtrimeve të tij, të dërguara në datën 29.11.2022, nga ku rezulton me një rezultat negativ në vlerën 123,139 lekë dhe në faqen 97 të po këtyre parashtrimeve rezulton për vitin 2011 me një rezultat negativ në vlerën 321,335 lekë. I njëjti rezultat është paraqitur nga subjekti edhe në dokumentin me emërtimin “Memo” për raportin e vlerësimit nëntor 2022, në faqet 80-81.

53.5. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë. Edhe sipas llogaritjeve të vetë subjektit, ai rezulton me një rezultat negativ në vitin 2010, në shumën 383,064 lekë, ndërsa sipas analizës financiare të Komisionit pamundësia është në shumën 865,263 lekë. Gjithashtu, subjekti pranon se rezulton me një rezultat negativ në vitin 2011, në shumën 123,139 lekë, në momentin e krijimit të bonove dhe në shumën 321,335 lekë për vitin 2011, ndërkohë nga analiza e Komisionit subjekti rezulton në vitin 2011 me një rezultat negativ në shumën 452,500 lekë.

53.6. Në përfundim, në lidhje me bonot në vitin 2011, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -195,856.77 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka vlerësuar të konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së subjektit në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij, për sa kohë ka të bëjë me një vlerë, e cila nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore.

54. Në lidhje me bonot e krijuara në vitin 2012

54.1. Subjekti, në pyetësoin nr. 3, në lidhje me burimin e këtyre bonove, ka deklaruar: *“Për bonon e thesarit, për të cilën në datë 5.4.2012 janë derdhur cash 900,000 lekë, sqaroj se për financimin e saj kanë shërbyer si burim: 1. akumulimi i gjendjes cash prej 750,000 lekësh (të deklaruar në f. 4 të DPV/2011, të plotësuar në datën 19.3.2012) dhe 2. kursimet deri në datën 5.4.2011, kur është bërë shtesa e fondeve për rinovimin e bonos. Për bonon e thesarit, për të cilën në datën 23.7.2012 janë derdhur cash 930,000 lekë, sqaroj se për financimin e saj kanë shërbyer si burim: 1. akumulimi i kursimeve familjare deri në datën 23.7.2012 dhe 5,000 euro që ia kam marrë borxh djalit të xhaxhait tim O.Y. Në lidhje me këtë borxh, në përgjigjet e pyetësorit standard jam shprehur se: ‘... rreth muajit prill të vitit 2012, unë kam qenë në Itali bashkë me bashkëshorten time. Aty kam takuar djalin e xhaxhait tim të quajtur O.K.Y, që së bashku me familjen e tij jeton që nga viti 1995 në Itali. Atij i kam marrë hua shumën 5,000 euro, sepse kam dashur të ble një automjet të përdorur, në Itali apo Gjermani, pasi sikurse është e njohur botërisht, po të blihet një automjet jashtë shtetit, merret në një gjendje më të mirë teknike, si dhe me çmim më të favorshëm. Burimi i kësaj huaje që më ka dhënë shtetasi O. Y në atë kohë kanë qenë të ardhurat dhe/apo kursimet familjare të familjes së tij, ndër vite. Gjithashtu, ju bëj me dije se huan në fjalë e kam shlyer brenda vitit 2012, disa muaj pasi e kam marrë. Kjo pasi nuk e kam blerë automjetin që kam pasur për qëllim për të blerë në kohën e marrjes së huas. Faktin e marrjes së huas dhe kohën e shlyerjes së saj e kam deklaruar në DPV, që është dorëzuar prej meje në ILDKPKI, në periudhën korresponduese. Në DPV/2012, të plotësuar në datën 15.3.2013, jam shprehur se: ‘..5,000 euro që ia kam marrë borxh djalit të xhaxhait O.K.Y (me banim në Itali), në muajin maj (kur kam qenë në Itali), të cilin nuk e kam blerë dhe ia kam kthyer përsëri në muajin dhjetor...’, si dhe 2. interesat e bonos së thesarit të datës 5.4.2012”.*

54.2. Subjekti ka deklaruar në DPV/2011 kursime *cash* në shumën 750,000 lekë, pakësimin e të cilave e ka deklaruar në vitin 2012 për blerjen e bonove.

Tabela nr. 13 – analizë për shumën 750,000 lekë (kursimet e vitit 2011)

	Viti 2011
Pasuria	1,411,773.02
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>1,411,773.02</i>
Detyrime	-857,965.10
Shlyerje e kredisë në “Tirana Bank” - 1,500,000 lekë - 2009 - Andri Ymeri	-457,965.10
Kthim për huadhënie babait	-400,000
Pasuria <i>neto</i>	2,269,738.12
Të ardhura	2,380,145.00
Të ardhurat e subjektit	1,469,426.00
Të ardhurat e bashkëshortes	588,640.00
Të ardhurat nga depozitat	322,079
Shpenzime	562,907.35
Shpenzime jetike	409,860.00
TIMS	88,061.93
Shpenzime interesi për kredi në “Tirana Bank” - 1,500,000 lekë	64,985.42
Mundësia për kursime	-452,500.47

Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 452,500.47 lekë.

54.3. Subjekti ka deklaruar në DPV/2012 si burim për bonot huan në shumën 5,000 euro, marrë z. O.Y. Subjekti, pas kalimit të rezultateve të para të hetimit, ka depozituar:

- ekstraktin e llogarisë së sigurimeve shoqërore, datë 18.5.2022, për z. O.Y, nga ku rezulton se për periudhën 2001 – 2011 ka përfituar të ardhura në total 209,651.24 euro;
- deklaratë zëvendësuese e aktit provues datë 20.5.2022, sipas së cilës z. O.Y deklaron se në muajin prill/maj të vitit 2012: (i) ka pritur subjektin dhe bashkëshorten e tij pranë banesës së ndodhur në Brescia; (ii) i ka dhënë hua shumën 5,000 euro për blerjen e një automjeti dhe në muajin dhjetor i është kthyer shuma 5,000 euro; dhe (iii) me rastin e lindjes së fëmijës së parë i ka dhënë shumën 500 euro.

54.4. Komisioni konstaton se kjo deklaratë noteriale nuk përputhet me udhëtimin e kryer nga subjekti, pasi nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se ai ka udhëtuar në datën 13.4.2012 në Venezia dhe është kthyer në datën 16.4.2012. Në pyetësorin standard, subjekti, për këtë udhëtim, ka deklaruar se: *“Në datat 13.4.2012 - 16.4.2012 unë dhe bashkëshortja ime kemi udhëtuar në Itali me avion. Me sa mbaj mend, linja e fluturimit të avionit ka qenë Rinas - Venecia. Aty kemi udhëtuar me tren në qytetin e Padovas, ku jemi pritur nga djali i xhaxhait tim O.Y, me banim në Itali, që nga viti 1994 ose 1995. Aty kemi fjetur në një hotel që nuk e kujtojmë. Të nesërmen kemi udhëtuar në Firenze dhe jemi kthyer brenda të njëjtës ditë, ku kemi fjetur në një hotel tjetër po në Padova, për pjesën e mbetur të kohës. Shpenzimet e hotelit janë paguar nga vetë unë, në mos gaboj 50 - 60 euro/person, por paratë më janë dhënë nga djali i xhaxhait tim O.Y, që më dhuroi 200 euro (duke më thënë, çoja djalit nga ana ime). Nuk besoj që kostoja totale të më ketë shkuar më shumë se 500 – 600 euro, së bashku me shpenzimet e udhëtimit, që janë përballuar nga ana jonë”*.

Në këtë pyetësor subjekti ka deklaruar se z. O.Y i ka dhënë shumën 100 euro me rastin e dasmës.

54.5. Në lidhje me këtë hua, për sa kohë dokumentacioni i depozituar nga subjekti nuk përputhet me të dhënat e sistemit TIMS, por edhe me vetë deklaratimet e subjektit gjatë hetimit, ajo nuk do të përfshihet në analizë financiare.

54.6. Analiza e mundësisë së investimit në bono thesari në shumën 930,000 lekë, në datën 23.7.2012

Tabela nr. 14

	Datë 5.4.2012	Datë 23.7.2012
Pasuria	168,453.42	882,256.17
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>168,453.42</i>	<i>882,256.17</i>
Detyrime	-153,652.93	-115,239.70
Shlyerje e kredisë në “Tirana Bank” - 1,500,000 lekë - 2009 - Andri Ymeri	-153,652.93	-115,239.70
Pasuria neto	322,106.35	997,495.87
Të ardhura	831,884.33	623,913.25
Të ardhurat e subjektit	500,837.33	375,628.00
Të ardhurat e bashkëshortes	189,587.00	142,190.25
Të ardhurat nga depozitat	141,460.00	106,095.00
Shpenzime	194,867.88	179,858.36
Shpenzime jetike	139,548.00	104,661.00
TIMS	48,203.40	69,860.00
Shpenzime interesi, disbursimi për kredi në “Tirana Bank” - 1,500,000 lekë	7,116.48	5,337.36
Mundësia për kursime	314,910.10	-553,440.98
Mundësia për kursime kumulative më 23.7.2012	314,910.10	-238,530.87

54.7. Në përfundim, subjektit iu kalua barra e provës për sa vijon:

- i. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 452,500.47 lekë në vitin 2011.
- ii. Duket se subjekti ka depozituar një dokument që nuk përmban të dhëna të vërteta, pasi deklaratimet e z. O.Y nuk përputhen me deklaratimet e subjektit në pyetësorin standard, por edhe me të dhënat e sistemit TIMS.
- iii. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e bonove në shumën 238,530.87 lekë.

54.8. Pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁸⁶, subjekti ka shpjeguar se në lidhje me pretendimin e tij se ka bërë një gabim në deklarin periodik të vitit 2011, pasi nuk ka pasur gjendje *cash*, e cila, sipas tij, është krijuar në vitin 2012, me burim kredinë e marrë në shumën 800,000 lekë dhe në lidhje me barrën e dytë dhe të tretë të provës, subjekti ka deklaruar se nuk është e vërtetë se deklaratimet e tij në pyetësorin standard kanë kundërthënë me deklaratimet e kushëririt të tij me deklaratë noteriale. Në vlerësimin e përputhshmërisë së këtyre deklaratimeve duhet të merret në konsideratë fakti se nga momenti i ndodhjes se faktit kanë

⁸⁶ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

kaluar 10 vjet dhe se kushëriri i tij nuk ka qenë i detyruar të mbajë mend çdo detaj që lidhet me këtë takim. Deklarimet e kushëririt të tij nuk janë në kundërshtim me të dhënat e sistemit TIMS, pasi nëse kushëriri ka deklaruar se subjekti ka shkuar në Itali në harkun kohor prill - maj të vitit 2012, nga sistemi TIMS rezulton se vërtetë ka shkuar në Itali në datën 13.4.2012 dhe është kthyer më 16.4.2012. Fakti që kushëriri i tij e përcakton kohën e shkuarjes në Itali me përafërsi, pasqyron faktin se ai tregon të vërtetën e asaj që ka ndodhur.

Subjekti thekson gjithashtu se shuma 5,000 euro, që i ka marrë hua kushëririt të tij O.Y, ka shërbyer për krijimin e bonos së dytë të vitit 2012 dhe, pikërisht, atë të datës 23.7.2012 dhe jo bonos së parë të datës 5.4.2012. Edhe në këtë drejtim subjekti evidenton faktin se nuk ka asnjë kundërshti mes deklarimit të kushëririt të tij dhe të dhënave në sistemin TIMS.

54.9. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se në lidhje me barrën e parë të provës shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Subjekti, në të gjitha rastet ku rezulton me mungesë burimesh të ligjshme, pretendon se kanë qenë gabime të tij në deklarimet periodike. Nga verifikimi i deklarimeve periodike të subjektit rezulton se ai ka deklaruar saktësisht gjendjen *cash* në vitin 2011, në shumën 750,000 lekë dhe pakësimin e kësaj shume në DPV/2012. Gjithashtu, ai në DPV/2012 kur ka deklaruar kredinë në shumën 800,000 lekë nuk rezulton të ketë deklaruar se kjo kredi ka shërbyer si burim për bonot apo për kursimet *cash* të vitit 2011. Pas dërgimit të barrës së provës, subjekti ka ndryshuar tërësisht deklarim duke pretenduar se nuk ka pasur kursime *cash* në vitin 2011 dhe se kredia ka shërbyer si burim për blerjen e bonove.

Shkalla e njohjes që subjekti dëshmon për procesin e rivlerësimit në tërësi, normat, rregullat dhe metodologjinë për kryerjen e tij nga organet e rivlerësimit të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, përmes parashtrimeve në prapësime për rezultatet e hetimit administrativ, si dhe çdo komunikimi përgjatë hetimit administrativ, përjashton mundësinë e paqartësive në lidhje me rëndësinë e deklarimeve të kryera prej tij në procesin e rivlerësimit, por edhe në deklaratat periodike. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson të mos marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit, i cili nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash*⁸⁷ në shumën 452,500.47 lekë në vitin 2011.

54.10. Në lidhje me barrën e dytës të provës shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Mbetet fakt se në deklaratën e datës 20.5.2022, z. O.Y deklaroi se në muajin prill/maj të vitit 2012 ka pritur subjektin dhe bashkëshorten e tij pranë banesës së ndodhur në Brescia, i ka dhënë hua shumën 5,000 euro për blerjen e një automjeti dhe në muajin dhjetor i është kthyer kjo shumë. Me rastin e lindjes së fëmijës së parë i ka dhënë shumën 500 euro.

Ndërkohë, kjo deklaratë nuk përputhet me të dhënat e sistemit TIMS, nga ky rezulton se subjekti ka udhëtuar në Venezia, si dhe në vetë deklarimet e subjektit të bërë në pyetësorin standard, ku deklaroi se ai ka shkuar në Venezia duke udhëtuar drejt qytetit të Padovas, ku është pritur nga kushëriri i tij, i cili i ka dhënë edhe shumën 100 euro me rastin e dasmës.

54.11. Në përfundim, Komisioni vlerëson se për sa kohë nuk është provuar marrja e kësaj shume, si dhe subjekti ka depozituar një deklaratë që nuk përmban të dhëna të sakta e të provuara, huaja në shumën 5,000 euro nuk do të përfshihet si burim për blerjen e bonove të thesarit.

54.12. Në përfundim, në lidhje me bonot në vitin 2012, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -238,530.87 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka vlerësuar të konsiderojë peshën e këtij

⁸⁷ Në shumën 750,000 lekë.

defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së subjektit, në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij, për sa kohë ka të bëjë me një vlerë, e cila nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore.

55. Në lidhje me bonot e krijuara në vitin 2013

55.1. Subjekti, në pyetësin nr. 3, në lidhje me burimin e këtyre bonove, ka deklaruar: “Për bonon e thesarit, për të cilën në datën 9.3.2013 janë derdhur cash 350,000 lekë, sqarohet se për financimin e saj ka shërbyer si burim: 1. akumulimi i gjendjes cash të vitit paraardhës (120,000 lekë) dhe 2. kursimet familjare”.

55.2. Nga analiza financiare rezulton një vlerë prej 6,500 lekësh pamundësie financiare. Kjo vlerë është konsideruar nga Komisioni e papërfillshme duke mos e ngarkuar subjektin me përgjegjësi.

56. Nga dokumentacioni i administruar nga bankat e nivelit të dytë, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka marrë kredi, si vijon:

56.1. Në datën 20.1.2012, subjekti ka marrë kredi në BKT në shumën 800,000 lekë. Si dorëzanës për këtë kredi rezulton z. F.Y. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në BKT rezulton se kredia është disbursuar në datën 20.1.2012 dhe në po të njëjtën datë subjekti ka tërhequr shumën 760,000 lekë.

Kjo kredi është shlyer në datën 23.7.2012 me një depozitim në vlerën 800,000 lekë, të kryer në emër të subjektit nga babai i tij.

Babai i subjektit në datën 22.7.2022, me kontratë kredie bankare nr. ***, ka marrë kredi nga BKT në shumën 810,000 lekë. Nga nxjerrja e llogarisë së babait të subjektit në BKT rezulton se në datën 23.7.2012 është disbursuar kredia në shumën 810,000 lekë, të cilën ai e ka tërhequr cash në po të njëjtën datë.

56.2. Subjekti, në datën 6.8.2012, ka marrë kredi në “ProCredit Bank”, në shumën 400,000 lekë me afat 24-mujor për konsum dhe si debitor solidar rezulton edhe babai i tij F.Y.

Në aneksin 2 të kontratës, subjekti së bashku me babain e tij kanë nënshkruar një deklaratë, ku deklarohet se janë pronarë të një depozite në emër të z. F.Y, në shumën 1,000,000 lekë, me afat maturimi 6.8.2014.

Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “ProCredit Bank” rezulton se në datën 6.8.2012 ka tërhequr cash shumën 398,000 lekë. Depozitimet për shlyerjen e kësteve të kredisë janë kryer cash nga babai i subjektit F.Y.

56.3. Subjekti, në datën 19.2.2013, ka marrë kredi me afat 12 muaj në shumën 700,000 lekë nga “Tirana Bank” për nevoja konsumatore. Pagesa e kredisë është siguruar me shumën 890,000 lekë të depozituar nga z. F.Y⁸⁸, me maturim në datën 11.7.2013.

Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Tirana Bank” rezulton se:

- a. në datën 19.2.2013 është disbursuar kredia në shumën 700,000 lekë, e cila është tërhequr cash nga subjekti në datën 19.2.2013;
- b. në datën 28.8.2013 ka një transferim nga z. F.Y në shumën 421,600 lekë, shumë e cila ka shërbyer për shlyerjen e plotë të kredisë.

57. Detyrim monetar⁸⁹ në shumën 2,200,000 lekë, të cilën vëllai i subjektit G.Y detyrohet t’ia kthejë subjektit për shkak të faktit se në vitet 2014 dhe 2015 ky i fundit ia ka dhënë

⁸⁸ Marrëveshje siguroese datë 19.2.2013.

⁸⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.4.2015; (ii) deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. ** kol., datë 23.1.2017.

hua pa interes, pjesë-pjesë. Kontratat e huas nuk janë formalizuar përmes ndonjë veprimi juridik.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.4.2015, shuma 2,200,000 lekë merret pa interes dhe për t'u kthyer në datën 11.12.2015, ndërsa sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. ** kol., datë 23.1.2017, kthimi do të bëhet me këste, pa datë të përcaktuar, sipas mundësive, meqenëse janë në marrëdhënie familjare.*
- *Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2009, subjekti ka deklaruar 100,000 lekë dhënë borxh vëllait, G.Y, pa deklaruar në vijim shlyerjen apo gjendjen e detyrimit të tij.*
- *Subjekti nuk ka deklaruar qëllimin e përdorimit të shumës prej 2,200,000 lekësh, dhënë hua vëllait, në deklarimin Vetting dhe deklarimet periodike vjetore 2014 dhe 2015.*

Hetimi dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

57.1. Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.4.2015, me deklaruues G.Y, i cili deklaroi se në vitin 2014 i ka marrë, në formë huaje, vëllait Andri Ymeri shumën 1,400,000 lekë si vijon: 250,000 lekë në datën 25.4.2014; 250,000 lekë në datën 2.6.2014; 170,000 lekë në datën 13.6.2014; 330,000 lekë në datën 15.8.2014; 200,000 lekë në datën 20.10.2014; 100,000 lekë në datën 27.11.2014; dhe 100,000 lekë në datën 11.12.2014, marrë pa interes dhe për t'u kthyer në datën 11.12.2015.

57.2. Me anë të deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. ** kol., datë 23.1.2017, deklaruesit G. Y dhe A.D.Y deklarojnë se i kanë marrë në formën e huas, Andri Ymerit (vëllai i deklaruesit G. Y) shumën 2,200,000 lekë gjatë viteve 2014 - 2015. Kthimi do të bëhet me këste, pa datë të përcaktuar, sipas mundësive, meqenëse janë në marrëdhënie familjare.

57.3. Nga verifikimi i deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit konstatohet se ai ka deklaruar dhënien e disa shumave hua vëllait të tij, si vijon:

- DPV/2009 – shuma 100,000 lekë;
- DPV/2014 – shuma 1,400,000 lekë;
- DPV/2015 – shuma 800,000 lekë.

57.4. Analiza financiare

Nga rezultati financiar pozitiv i viteve 2014 dhe 2015 duket se subjekti ka pasur mundësi financiare për t'i dhënë hua vëllait të tij G.Y shumat e deklaruara, përkatësisht, 1,400,000 lekë në vitin 2014 dhe 800,000 lekë në vitin 2015. Mundësia e huadhënies së këtyre vlerave është vlerësuar me rezultatin financiar të këtyre viteve sepse subjekti dhe vëllai i tij deklarojnë se huat janë dhënë gjatë gjithë vitit në shuma të veçanta.

57.5. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me huat e mësipërme. Subjekti ka kryer deklarim të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me dhënien e këtyre huave.

58. Gjendje cash me vlerë 60,000 lekë

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kursimet *cash*. Subjekti ka kryer deklarim të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

KONSTATIME TË TJERA

59. Pasuria apartament në përdorim, me sipërfaqe 73 m², lagjja “V.Sh”, bulevardi “Z i P”, pallati *, Shkodër, jetuar në periudhën 2004 – 2008.**

59.1. Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se ka pasur në përdorim pasurinë apartament në Shkodër, lagjja “S.H” (Xh), bulevardi “Z i P”, pallati nr. ***, hyrja e **, kati i ***, ku ka banuar nga data 20.7.2004 dhe deri në gjysmën e parë të janarit të vitit 2008.

59.2. Nga verifikimi i deklaratave periodike ka rezultuar se subjekti, gjatë viteve 2004 – 2007, ka deklaruar si adresë banimi: “Lagjja ‘V. Sh’, rruga ‘Z i P’, p. ***, Shkodër”.

59.3. Subjekti gjatë hetimit ka deklaruar se burimi për blerjen e kësaj pasurie ka qenë kontributi i tij dhe i familjarëve të tij, ndërkohë në deklaratën *Vetting* nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar kontributin e tij financiar dhe as burimin e krijimit të kësaj pasurie të përdorur në vitet 2004 – 2008.

59.4. Komisioni, duke u bazuar në pikën 30 të vendimit nr. 22/2020 të Kolegjit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka lidhje interesi me pasurinë e paluajtshme në fjalë për shkak të përdorimit të kësaj pasurie dhe si bashkëfinancues për blerjen e saj dhe, për rrjedhojë, ka kryer një hetim të plotë në lidhje me këtë pasuri.

59.5. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se kjo pasuri me sip. 73 m² është blerë sipas akt shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., në datën 20.7.2004, kundrejt çmimit 1,000,000 lekë. Shuma është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Ajo figuron e regjistruar në regjistrat publikë me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. *, f. **, në bashkëpronësi të prindërve të subjektit. Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, ka depozituar kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 6.2.2009, sipas së cilës babai i subjektit ka porositur ndërtimin e objektit shtesë kati banesë mbi këtë apartament në shumën 2,070,900 lekë.

59.6. Analiza e mundësisë së blerjes së apartamentit me sip. 73 m², në lagjen “S.H”, në datën 20.7.2004

Tabela nr. 15

	Viti 2004
Pasuria	800,000.00
Apartament me sip. 73 m ² , lagjja “S. H”, Shkodër	1,000,000.00
Ndryshim likuiditeti	-200,000.00
Detyrime	0.00
Pasuria neto	800,000.00
Të ardhura	716,788.33
Të ardhurat e subjektit	512,925.00
Të ardhurat e babait F.Y	80,328.50
Të ardhurat e nënës E.Y	123,534.83
Të ardhura nga puna motra A.Y.P	0.00
Shpenzime	299,926.28
Shpenzime jetike	264,926.28
TIMS	

Shpenzime qiraje 2001 – 2004	35,000.00
Mundësia për kursime	-383,137.94

Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me rezultatin negativ të mësipërm.

59.7. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁹⁰, ka shpjeguar se: “Sikurse e kam shpjeguar në pyetësonin standard dhe në DPV/2008, si dhe vetë në deklaratën Vetting, unë i kam shkëputur lidhjet me këtë banesë në vitin 2008, kohë kur kam krijuar familjen time të re dhe kemi shkuar bashkë me bashkëshorten time për të jetuar në një banesë të re, që është apartamenti i banimit, me sip. 111 m², që është regjistruar në regjistrat publikë të pasurive paluajtshme të ZVRPP-së Shkodër, me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë: Njësia Administrative Shkodër, Bashkia Shkodër, lagjja ‘V.Sh’, rruga ‘A.Gj.F’, pallati pranë K së F, kati i ***, apartamenti nr. **. Në deklaratën Vetting unë kam shënuar vetëm këtë apartament të fundit dhe jo atë ku kam banuar kur kam qenë beqar. Kjo, pasi kam vlerësuar se në deklaratën Vetting duhen shënuar vetëm pasuritë mbi të cilat unë kam ushtruar të drejta reale (pronësie/bashkëpronësie/ përdorimi/ banimi), në kohën kur është plotësuar deklarata Vetting dhe jo në një kohë të shkuar.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit se unë nuk kam deklaruar në deklaratën Vetting kontributin tim në krijimin e kësaj pasurie, shpjegoj edhe një herë se blerja e kësaj banese nuk ka ardhur si rrjedhojë vetëm e kontributit tim në familjen time të origjinës, por është rrjedhojë e kontributit të të gjithë pjesëtarëve të familjes sime dhe, konkretisht – babait, nënës, motrës dhe unë.

Edhe sikur Komisionit të mos marrë fare në konsideratë shumën e kursyer nga prindërit e mi nga shitja e banesës në fshatin Bushat, Shkodër, në vlerën 430,000 lekë (kontratën noteriale të së cilës jua kam dërguar), vetëm me të ardhurat e realizuara nga pagat e mia, të motrës sime (në Shkollë të Magjistraturës dhe punë si gjyqtar e prokuror), nënës si mësuese dhe pensioni i babait (ku këto dy të fundit nuk kanë qenë fare pjesë e analizës financiare të Komisionit), rezulton qartë se edhe pas zbritjes së shpenzimeve për jetesë të familjes sonë, jo vetëm që mbulojmë vlerën e blerjes së këtij apartamenti, por pas blerjes kemi edhe kursime. Nga analiza financiare që më është vënë në dispozicion nga ana juaj për mundësinë e blerjes së këtij apartamenti nga familja ime evidentoj se nuk është llogaritur paga e motrës sime A. P(Y). Po kështu, evidentoj faktin se në analizën financiare të këtij viti Komisioni nuk ka njohur dhe përfshirë në analizën financiare të ardhurat e familjes sime nga shitja e banesës në fshatin Bushat, Shkodër, në vlerën 430,000 lekë.

Mosnjohja e këtyre të ardhurave ka ardhur si rrjedhojë e çmuarjes së Komisionit se në fund të vitit 2004 unë kam deklaruar kursime në vlerën 200,000 lekë. Shpjegoj se ky arsyetim i Komisionit është i padrejtë, për sa kohë në DPV/2004 unë kam deklaruar kursimet e mia dhe jo ato të babait tim, i cili nuk kishte detyrim për të bërë deklarim pasurie. Ky qëndrim i Komisionit është mbajtur edhe me vendimin e formës së prerë me nr. 327, datë 23.12.2020”.

59.8. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

i) Në lidhje me pretendimin e subjektit se në deklaratat periodike ka deklaruar vetëm kursimet e tij *cash*, ky pretendim i tij nuk qëndron, pasi nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, ai në vitin 2005 ka deklaruar si kursime *cash* edhe të ardhurat e babait të tij (pranuar nga ana e tij dhe në faqen 19 të dokumentit “Memo-KPK-Shkodra”), ndërkohë që në vitin 2006 për shumën 3,300,000 lekë, të deklaruar si kursim *cash*, shprehet se kjo është e përbashkët. Ky fakt

⁹⁰ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

është pranuar prej tij në faqen 19 të dokumentit “Memo-KPK-Shkodra”, ku shprehet tekstualisht: “Fakti që shuma në fjalë është akumulim i kursimeve familjare për tri vite (2004, 2005 dhe 2006), del jo vetëm nga përshkrimi i sipërpërmendur në DPV/2006, por edhe nga shpjegimet me shkrim që kam dhënë në vitet 2009, 2011 dhe 2015 në ILDKPKI, sipas nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003 (i ndryshuar)”.

Ndërkohë, në dokumentin “Memo për raportin e vlerësimit nëntor 2022” e dërguar me email në datën 19.12.2022, subjekti shprehet tekstualisht: “Nga ana ime është deklaruar se shuma prej 3,300,000 lekësh është rezultat i kursimeve të pagave, pensionit të babait, aktiviteteve të familjarëve të mi dhe qirasë së tokës bujqësore, e krijuar deri në përfundim të vitit 2006. Pra, kjo shumë nuk ka qenë e ardhur monetare e krijuar nga familja ime në kohën e blerjes së apartamentit, por ka qenë shumatorja e të gjitha të ardhurave monetare të familjes sime në përfundim të vitit 2006”.

ii) Për sa i përket pretendimeve në lidhje me kursimet *cash*, nuk rezulton që subjekti në DPV/2004 të ketë deklaruar pakësimin *cash* të shumës 200,000 lekë, ku për më tepër ka pretenduar se ka shtuar shumën 200,000 lekë. Kjo shumë së bashku me kursimet e tjera i është llogaritur subjektit në analizën financiare për blerjen e shtëpisë në vitin 2006. I njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga vetë subjekti në faqen 19 të dokumentit “Memo-KPK-Shkodra” dhe në faqen 15 të dokumentit “Memo për raportin e vlerësimit nëntor 2022”. Për sa i përket shumës 430,000 lekë, Komisioni e ka përfshirë këtë shumë në analizën financiare deri në vitin 2003, pasi pas vitit 2003 subjekti ka deklaruar rregullisht kursime *cash* dhe, për rrjedhojë, kjo shumë nuk mund të konsiderohet në analizën e vitit 2006, për sa kohë nuk rezulton të jetë deklaruar si e tillë. Kjo shumë është përfshirë në analizën për krijimin e kursimeve *cash* të vitit 2003.

59.9. Në përfundim, në lidhje me këtë banesë, Komisioni vlerëson se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -383,137.94 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka vlerësuar të konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së subjektit, në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij, për sa kohë ka të bëjë me një vlerë, e cila nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit. Kjo shumë është përfshirë në vlerësimin e pasurisë së subjektit referuar jurisprudencës së Kolegjit në vendimin nr. 22/2020, për sa kohë nga subjekti është konfirmuar edhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit se ka kontribuar në blerjen e kësaj pasurie.

60. Në lidhje me analizën financiare⁹¹ Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për pamundësi financiare në shumën 2,746,975 lekë nga fillimi i detyrës deri në momentin e martesës dhe në shumën 1,817,804.62 lekë nga momenti i martesës deri në deklaratën *Vetting*. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk dha shpjegime në lidhje me këtë rezultat negativ, por Komisioni mbajti në konsideratë të ardhurat e vëllait të subjektit të përfituara nga bursa. Për sa më sipër, subjekti nga fillimi i detyrës deri në deklaratën *Vetting* ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 4,506,279.70 lekë, në kuptim të nenit nr. 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

Përveç konstatimeve të Komisionit në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme të të ardhurave, edhe vetë subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij ka pranuar një rezultat negativ kumulativ në shumën 1,536,333 lekë⁹².

Konkluzioni përfundimtar i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

61. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se:

⁹¹ Për më shumë detaje referohuni në rezultatet e hetimit.

⁹² Shihni paragrafët 50.4, 52.6 dhe 53.4 të këtij vendimi.

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë *Vetting*, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- iii. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedim ose në përdorim të tij, sipas parashikimeve të pikës 5 të Aneksit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

62. Në këto rrethana, Komisioni krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. KONTROLLI I FIGURËS

63. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 12.7.2022, të KDZH-së. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarin për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri.

64. Në datën 26.9.2022, DSIK-ja ka dërguar raportin e përditësuar të kontrollit të figurës⁹³, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 10.10.2022, sipas të cilit:

- Gjatë periudhës në të cilën subjekti ushtronte detyrën si gjyqtar dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive [REDACTED].
- Gjithashtu, për subjektin Andri Ymeri, në cilësinë e gjyqtarit [REDACTED], ka ushtruar ndikim të paligjshëm në disa procese gjyqësore, duke dhënë vendime favorizuese gjatë gjykimit të çështjeve lidhur me tjetërsimin e pronave publike.
- Institucionet verifikuese kanë informuar instancat kompetente [REDACTED]

65. DSIK-ja ka konstatuar se *situata pasqyron korrupsion sistematik në vetë sistemin e drejtësisë, ku në rastin në fjalë disponohen informacione për përfshirje në veprime korruptive të një gjyqtari. Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale “krim i organizuar, trafikim dhe korrupsion”.*

Në përfundim, Grupi i Punës ka ndryshuar konstatimin fillestar nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.

⁹³ Për më shumë shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

66. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur⁹⁴, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Për shkak të volumit të madh të dokumentacionit të administruar, Komisioni ka analizuar një pjesë të dosjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat do të jenë pjesë edhe e vlerësimit profesional të subjektit.

Në lidhje me çështjet gjyqësore të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit me palë shtetasin I.K, babai i avokatit L.K

Nga informacionet e marra nga organet ligjzbatuese, si dhe nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti ka lidhje shoqërore dhe familjare me avokatin L.K⁹⁵. Ka rezultuar, gjithashtu, se subjekti ka gjykuar disa çështje gjyqësore, ku njëra nga palët ka qenë babai i avokatit, shtetasi I.K. Pas administrimit të dosjeve gjyqësore, gjatë vlerësimit të tyre, Komisioni, përveç elementeve që merren në konsideratë në procedurat e rivlerësimit të figurës, ka konstatuar defekte dhe mangësi që duhet të konsiderohen edhe në rivlerësimin profesional të subjektit. Për këtë arsye, elemente të rivlerësimit janë gërshetuar në të dyja kriteret e mëposhtme të rivlerësimit.

Komisioni ka administruar dhe vlerësuar pesë dosje gjyqësore, ku njëra nga palët gjyqësore është shtetasi I.K.

67. Çështje gjyqësore, regjistruar në datën 14.7.2005, me kërkues I.K dhe objekt “lëshim urdhërkzekutimi të vendimit nr. ***, datë 10.5.2004”. Me vendimin e datës 14.7.2005, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës.

67.1. Nga shqyrtimi i fashikullit gjyqësor Komisioni ka konstatuar se: (i) në dosje nuk gjendet njoftimi dërguar palës kërkuese për caktimin e seancës gjyqësore; (ii) pala kërkuese është babai i avokatit L.K, me të cilin rezulton se subjekti ka lidhje shoqërore.

Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi dukej se ai kishte gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, për rrjedhje ngriheshin dyshime për favorizimin e z. I.K, duke marrë në konsideratë edhe faktin që në dosjen gjyqësore nuk gjendej njoftimi i palës kërkuese për zhvillimin e seancës gjyqësore.

67.2. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur⁹⁶ ka shpjeguar se lidhur me kryerjen e njoftimit nuk është detyrë e gjyqtarit, por e sekretarit gjyqësor dhe nëpunësit gjyqësor (ftuesit), sipas neneve 77/3 dhe 78/2 të Kodit të Procedurës Civile. Gjyqtari ka kompetencë mbikëqyrëse dhe kontrolluese përkundrejt sekretarit dhe ftuesit që e ushtron kur është nevoja dhe rasti i përshtatshëm, por në rastin konkret vetë fakti i paraqitjes së të njoftuarit në gjykim ka bërë që, sipas vlerësimit të subjektit, të bien në dekadencë pretendimet e mundshme lidhur me njoftimin e shtetasit I.K. Subjekti ka pretenduar se nuk ka sekretar gjyqësor në Republikën e Shqipërisë që në veprimtarinë e tij, për arsye praktike (për t’u mos u mbingarkuar), nuk aplikon lidhur me njoftimet nenin 144 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon: *“Njoftimi mund të kryhet në çdo mënyrë tjetër që garanton një njoftim të rregullt për sa kohë që personi i thirrur konfirmon personalisht me shkrim se ka marrë njoftimin”*. Në rastin konkret, paraqitja e shtetasit I.K dhe dokumentimi i faktit të paraqitjes me procesverbal gjyqësor nuk është gjë tjetër veçse konfirmim me shkrim i faktit që njoftimi ka qenë jo vetëm bindës, por edhe se e ka realizuar qëllimin për të cilin është destinuar, ndërsa në lidhje me

⁹⁴ Për më shumë shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

⁹⁵ Për këtë shihni pikën 95 të këtij vendimi.

⁹⁶ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

konfliktin e interesit subjektit ka pretenduar se për sa kohë nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me z. L.K, nuk është as me babain e tij.

67.3. Subjekti: (a) i ka kërkuar Komisionit të qartësojë nëse ka dhënë vlerësim për të gjitha materialet e DSIK-së apo vetëm për një pjesë të tyre; (b) ka pretenduar se nuk i është dhënë informacioni i organeve ligjzbatuese.

67.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

i) Në lidhje me kërkesën (a) të subjektit, Komisioni qartëson se gjatë hetimit në lidhje me figurën e subjektit ka administruar dokumentacionin e plotë duke përfshirë në relacion në mënyrë të përmbledhur informacionin e administruar, për të cilin subjektit i ka kaluar barra e provës.

ii) Në lidhje me pretendimin (b) të subjektit për mosdhënie informacioni, Komisioni i ka kaluar subjektit barrë prove konkrete për çështje konkrete (duke e informuar se do të jenë pjesë edhe e vlerësimit profesional, si dhe duke i kaluar barrë prove për cenimin e besimit të publikut). Komisioni i ka vënë në dispozicion subjektit raportin e deklasifikuar pjesërisht, duke përmbushur në këtë mënyrë standardet për kalimin e barrës së provës, sipas neneve DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

67.5. Për sa i përket shpjegimeve të subjektit në lidhje me barrën e provës, ato nuk janë bindëse. Në kërkesën e z. I.K nuk gjendet asnjë e dhënë për sa i përket adresës së banimit të tij apo numër kontakti për të bërë të mundur njoftimin e tij nga ana e sekretarisë gjyqësore, sikundër pretendohet nga subjekti. Gjithashtu, në dosjen gjyqësore nuk gjendet i administruar njoftimi i këtij shtetasi, detyrim ligjor i parashikuar nga neni 128 i Kodit të Procedurës Civile i kohës së shqyrtimit të çështjes gjyqësore, ku parashikohet se thirrja në gjykatë bëhet me letërthirrje, e cila si rregull njoftohet me anë të nëpunësit gjyqësor. Neni 144 i Kodit të Procedurës Civile, të cilit i referohet subjekti në prapësime në kohën e shqyrtimit të çështjes gjyqësore, parashikonte se gjykata mund të urdhërojë me vendim edhe mënyra të tjera njoftimi nga ato të parashikuara nga ligji, si nëpërmjet telegramit me përgjigje, me faks kur vërtetohet me shkrim marrja e tij, me shkresë dorazi e me mënyra të tjera që garantojnë një njoftim të rregullt, kur e kërkojnë rrethana të veçanta ose nevoja e një njoftimi të shpejtë.

67.6. Lidhur me konfliktin e interesit, Komisioni vlerëson se subjekti, për sa kohë ka gjykuar një çështje, ku si palë është paraqitur babai i një personi, me të cilin ka pasur njohje shoqërore dhe familjare, bazuar në nenin 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, që parashikon heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie, ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga çështja, në zbatim të nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

67.7. Komisioni çmon se mungesa e njoftimit të palës kërkuese, si dhe gjykimi në kushtet e konfliktit të interesit do të jenë pjesë e vlerësimit etik e profesional të subjektit, por në këtë moment do të konsiderohen në funksion të dyshimit për favorizim të palës në proces.

68. Çështje gjyqësore, regjistruar në datën 23.2.2012, me kërkues I.K dhe objekt “lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë olograf” për të ndjerin Xh.K. Me vendimin datë 27.2.2012, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

68.1. Subjekti, në dispozitiv të vendimit, ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare për trashëgimlënësin Xh. K, duke caktuar si trashëgimtar testamentar djalin e tij I.K, mbi pasurinë e paluajtshme godinë, e cila ndodhet në lagjen “Partizani”. Në pjesën argumentuese të vendimit subjekti shprehet se z. Xh.K ka shprehur vullnetin e tij duke lënë si trashëgimtar të tij djalin I.K.

68.2. Nga verifikimi i fashikullit gjyqësor konstatohet se është administruar në cilësinë e provës, ndër të tjera, edhe një deklaratë dore, sipas së cilës z. Xh.K i dhuron djalit të tij I.K një godinë që ndodhet në lagjen (nuk lexohet qartë). Bazuar në nenin 372⁹⁷ të Kodit Civil dhe në nenin 379⁹⁸ të Kodit Civil konstatohet se vendimi i subjektit nuk është i bazuar në prova. Deklarata e depozituar nga ana e z. I.K nuk është testament, pasi në këtë dokument z. Xh.K nuk ka disponuar për pasurinë e tij pas vdekjes, por është shprehur se i dhuron djalit të tij I.K një pasuri të paluajtshme. Gjithashtu, nuk rezulton të jetë administruar dokumentacion, nëse trashëgimlënësi ka pasur trashëgimtarë ligjorë, që përfitojnë nga e drejta e rezervës ligjore, sipas parashikimit të nenit 361 të Kodit Civil, në mënyrë që të vërtetohej moscenimi i rezervës ligjore.

68.3. Subjekti, në datën 24.2.2012, ka caktuar si datë për zhvillimin e seancës gjyqësore të kësaj çështjeje datën 27.2.2012. Nga verifikimi i kalendarit data 24.2.2012 rezulton ditë e premte. Pra, subjekti e ka gjykuar këtë çështje brenda 1 dite pune. Në fashikullin gjyqësor nuk gjendet njoftim i kërkuarit për datën e seancës gjyqësore, një fakt që rezulton edhe nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore. Gjithashtu, është konstatuar dhe mosrespektimi i afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile.

68.4. Në përfundim, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për sa vijon:

- i. Në këtë proces gjyqësor evidentohen gabime thelbësore dhe serioze, pasi është vendosur lëshimi i trashëgimisë testamentare të z. I.K në mungesë të testamentit.
- ii. Subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, pasi ka gjykuar një çështje, ku si palë është paraqitur babai i një personi me të cilin ai ka pasur njohje shoqërore dhe familjare.
- iii. Subjekti nuk ka respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës⁹⁹.
- iv. Nuk provohet njoftimi i kërkuarit sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

➤ Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioni ngriti dyshime për favorizimin e z. I.K.

68.5. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹⁰⁰ ka deklaruar se është dakord me gjetjen e Komisionit se dorëshkrimi shkruan “dhurim”, se mosleximi apo leximi gabim i fjalës “dhurim” është gabim thelbësor. Kjo pasi është e qartë se po të mos lexohej kjo fjalë, përfundimi i gjykimit do të kishte rezultat të ndryshëm, por subjekti nuk bie dakord me vlerësimin e Komisionit se mosleximi apo leximi gabim i fjalës “dhurim” është gabim serioz. Subjekti ka sqaruar se: “Kjo pasi natyra e çështjes për të cilën po jap mendim ka

⁹⁷ Në nenin 372 të Kodit Civil parashikohet se: “Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anë të të cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes. Testamenti nuk mund të bëhet prej dy ose më shumë personave po në një akt, as edhe në dobi të një të treti, as me disponime reciproke”.

⁹⁸ Në nenin 379 të Kodit Civil parashikohet se: “Trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim (neni 361, paragrafi i dytë), si dhe trashëgimtarët e tij të tjerë të paafte për punë në qoftë se thirren në trashëgim dhe as të cenojë me testament në çdo mënyrë qoftë pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar”.

⁹⁹ Në nenin 155 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë duhet të sigurohet një afat jo më pak se dhjetë ditë. Kur vendi i njoftimit është jashtë rrethit ose jashtë shtetit, afati për paraqitjen në gjyq duhet të jetë i tillë sa të sigurohet një komunikim normal i padisë dhe paraqitja në gjykatë e të paditurit ose të personave të tretë. Në çështjet që është e nevojshme të kryhet një njoftim i shpejtë i padisë, me kërkesën e paditësit, gjyqtari kur e sheh atë me vend, mund të lejojë mosrespektimin e afatit të mësipërm të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, por gjithnjë njoftimi duhet të jetë bindës, në përputhje me rregullat e parashikuara prej neneve 132 e 133 të këtij Kodi dhe pa i cenuar të paditurit të drejtën e mbrojtjes”.

¹⁰⁰ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

të bëjë me një çështje që i përket juridiksionit gjyqësor gracioz, pra gjykim pa palë kundërshtare, me objekt lëshim dëshmie trashëgimie. Fakti që ndonëse kanë kaluar mbi 10 vjet dhe nuk është ngritur ndonjë padi e tillë, tregon që gabimi im, ndonëse bie në kundërshtim me ligjin, nuk ka sjellë ndonjë pasojë juridike për askënd. Pra, ky gabim nuk ka pasur asnjë lloj ndikimi në cenimin e besimit publik në dhënien e drejtësisë”.

68.6. Lidhur me vlerësimin e Komisionit se ka shkelur nenin 155 të Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk ka respektuar kohën e parashikuar ligjore për caktimin e seancës, si dhe nuk figuron njoftimi i kërkuarit, subjekti nuk është dakord, pasi, sipas tij, afati ligjor i parashikuar nga neni 155/1 i Kodit të Procedurës Civile zbatohet për paditë me palë kundërshtare (të juridiksionit gjyqësor kontencioz) dhe nuk zbatohet për kërkesat pa palë kundërshtare, që në thelbin e tyre janë vërtetime faktesh gjyqësore (që përfshihen në juridiksionin gjyqësor grocioz), kjo sipas interpretimit literal (gjuhësor) të normës.

Në lidhje me mungesën e njoftimit, si dhe të konfliktit të interesit, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si në pikën 67.2 të këtij vendimi, për rrjedhojë edhe qëndrimi i Komisionit është i njëjtë, sikundër është trajtuar më lart.

68.7. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, i vlerëson ato jobindëse. Vetë subjekti pranon se jemi përpara gabimeve thelbësore, ndërkohë që i konsideron ato joserioze. Komisioni çmon se në kushtet kur nga ana e subjektit është lëshuar një dëshmi trashëgimie testamentare në mungesë të aktit të testamentit jemi përpara gabimeve thelbësore dhe serioze. Megjithatë, duket se lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë testamentare në emër të djalit të tij I.K, për objektin në fjalë nuk vjen në kundërshtim me vullnetin e ish-pronarit. Nisur nga ky fakt, si dhe fakti që nuk ka të dhëna që të jetë ngritur ndonjë pretendim pronësie nga ndonjë person në lidhje këtë pasuri, lëshimi i dëshmisë testamentare nga subjekti, pa pasur një testament (me akt noterial ose olograf), ndonëse është i gabuar ligjërisht, mund të mos ketë sjellë asnjë pasojë, ashtu sikurse subjekti pretendon.

Parë nën këtë këndvështrim, nëse ky rast do të ishte një rast i vetëm i konstatuar gjatë ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, nuk do të përbënte shkak autonom për penalizimin e tij. Por, në kushtet kur është vërtetuar që subjekti ka njohje me trashëgimtarin testamentar I.K, për të cilin ka shqyrtuar disa çështje, ku ai ka qenë palë në proces dhe në kushtet kur subjekti nuk ka dhënë dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes në fjalë, lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë testamentare, pa një testament, qoftë edhe olograf, jo vetëm që e vë subjektin në kushtet e konfliktit të interesit, por krijon dyshime të forta për favorizim të shtetasit I.K.

Këtë fakt Komisioni do ta mbajë në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit, ndërkohë që në këtë pikë do të konsiderohet në funksion të favorizimit të shtetasit I.K.

68.8. Për sa i përket arsytimit të subjektit për mosrespektim të afatit 10-ditor për caktimin e seancës, Komisioni vlerëson se në Kodin e Procedurës Civile nuk ka asnjë parashikim përjashtues për këtë çështje, siç është rasti i lëshimit të urdhërekzekutimit, ku në nenin 511 të tij parashikohej afati 5-ditor. Subjekti ka qenë i detyruar ta respektonte këtë afat edhe për faktin që pala kërkuese të kishte kohë për të përgatitur dokumentet e nevojshme. Në rastin e z. K dokumentacioni i depozituar së bashku me padinë është noterizuar në datën 27.2.2012 nga shtetasi L.K¹⁰¹, pikërisht datën e gjykimit dhe shpalljes së vendimit.

69. Çështje gjyqësore, regjistruar në datën 24.9.2014, me kërkuar I.K, me objekt “sigurim prove”

¹⁰¹ Shihni f. 6 të fashikullit gjyqësor.

69.1. Në përmbajtje të dosjes gjyqësore evidentohet vendimi “Mbi caktimin e çështjes në seancë gjyqësore”, përmes të cilit subjekti i rivlerësimit ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, si dhe caktimin e seancës në datën 25.9.2014, ora 11:30. Në lidhje me këtë kërkesë është zhvilluar vetëm një seancë gjyqësore në datën 25.9.2014. Në përfundim të kësaj seance, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lejimin e sigurimit të provës duke u pranuar kërkesa për këqyrjen e ndërtimit në marrëdhënie fqinjësore me pasurinë e kërkuarit. Referuar procesverbalit që i bashkëlidhet vendimit gjyqësor, rezulton se subjekti së bashku me sekretaren gjyqësore dhe kërkuarin kanë kryer këqyrjen në datën 26.9.2014.

69.2. Në lidhje me këtë çështje Komisioni e ka përqendruar barrën e provës në faktin se pala kërkuare është babai i avokatit L.K, me të cilin duket se subjekti ka lidhje shoqërore, për pasojë subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile.

69.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹⁰² ka shpjeguar se: *“Po t’i referohemi ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, është e qartë se vendimi i marrë për pranimin e kërkesës me objekt sigurim prove është një vendim i ndërmjetëm, që nuk mund të shërbejë si bazë fakti për ta vendosur zyrtarin në gjendjen e konfliktit faktit, në dukje, të mundshëm apo të vazhdueshëm të interesit. Kjo pasi këqyrja dhe fotografimi i bërë në zbatim të këtij vendimi nuk përbën ndonjë kompetencë as thelbësore dhe as jothelbësore që ka ndikuar apo mund të ndikonte në vlerësimin pasues me vendimmarrje nga ai si gjyqtar në gjykimin e ndonjë çështjeje konkrete. Kjo sipas nenit 3, paragrafi 2 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, ‘Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike’, ku parashikohet se: ‘2. Për qëllimet e këtij ligji: a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit’”.*

69.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Komisioni vlerëson se subjekti, për sa kohë ka gjykuar një çështje ku si palë është paraqitur babai i një personi me të cilin ai ka pasur njohje shoqërore dhe familjare, bazuar në nenin 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile që parashikon heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie, ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga çështja në zbatim të nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Këtë çështje Komisioni do ta vlerësojë në kuadër të etikës dhe profesionalizmit të subjektit, por në këtë moment do të mbahet në vëmendje në raport me vlerësimin e favorizimit të mundshëm të palës kërkuare, shtetasi I.K.

70. Çështje gjyqësore, regjistruar në datën 4.12.2003, me paditës I.K, përfaqësuar në gjykim me prokurë nga av. L.K, me palë të paditur bashkëpronarët K, me objekt “pjesëtimi gjyqësor faktik i pasurisë së përcaktuar me vendim gjyqësor të fazës së parë ndërmjet trashëgimtarëve të shtetasit Xh.K”. Pasuritë objekt gjykimi janë: një ish-furrë buke me sip. 140 m²; dyqane me sipërfaqe trualli 220 m²; dhe një truall i lirë me sip. 253 m² në lagjen “P”.

Në datën 10.5.2004, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zhdukjen e bashkëpronësisë ndërmjet palëve ndërgjyqëse dhe caktimin e pjesëve takuese të pasurive.

70.1. Edhe në këtë rast, Komisioni konstaton se palë paditëse është shtetasi I.K, babai i avokatit L.K, i cili është përfaqësues i palëve të paditura.

¹⁰² Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

70.2. Komisioni i kaloi subjektit përsëri të njëjtën barrë prove në lidhje me konfliktin e interesit me këtë avokat.

70.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës në mënyrë të përmbledhur¹⁰³, ka shpjeguar se i qëndron shpjegimeve të mëparshme në raport me marrëdhënien me av. L.K, ndërkohë ka shtuar se vendimi i marrë për këtë çështje është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe nga Gjykata e Lartë. Pra, ka autoritetin e vendimit gjyqësor që përbën gjë të gjykuar sipas nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile.

70.4. Komisioni shqyrtoi shpjegimet e subjektit dhe në lidhje me konfliktin e interesit do të mbajë një qëndrim përfundimtar në raport me vlerësimin e etikës dhe profesionalizmit të subjektit, ndërkohë që në këtë moment do t'i referohet kësaj marrëdhënieje në funksion të favorizimit të palës në gjykim. Për sa i përket pretendimit të subjektit se jemi përpara gjykimit të gjësë së gjykuar, Komisioni vlerëson se është një pretendim që nuk qëndron, përderisa nuk po vlerësohet themeli i çështjes, si dhe procesi i rivlerësimit është një proces që nuk i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

71. Çështje gjyqësore, regjistruar në datën 18.6.2012, me paditës I.K, me palë të paditur Bashkia Shkodër dhe ZVRPP, me objekt “detyrimi i palës së paditur të njohë pronar të pasurisë paditësin, mbi pasurinë që ka fituar me parashkrim fitues me vendim gjyqësor të formës së prerë”. Në seancën gjyqësore datë 29.1.2013 nuk u paraqit paditësi dhe avokati i tij dhe, për pasojë, trupa gjykuese, në përbërje të së cilës ishte edhe subjekti i rivlerësimit, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Kjo çështje është regjistruar sërish në gjykatë në datën 11.2.2013 dhe është gjykuar nga e njëjta trupë gjykuese, në përbërje të së cilës ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. ***, datë 1.7.2013, trupi gjykues ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

71.1. Në pjesën argumentuese të vendimit gjyqësor nr. *** përcaktohet se:

- Komisioni i Ndarjes së Tokës, Komuna Rethin, fshati Z, ka pajisur me AMTP familjen bujqësore të z. F.D, me sip. 21.020 m² dhe familjen bujqësore të shtetasit F.Z me sipërfaqe totale 19.630 m².
- Familjet e mësipërme janë paraqitur në ZVRPP-në Shkodër për të regjistruar AMTP-në, por kërkesa u është refuzuar për shkak se zona kadastrale nuk është hedhur në sistem.
- Në datën 30.6.2001, të dyja këto familje kanë shitur sipërfaqet e tokës në favor të shtetasit I.K.
- Mbi këtë bazë, paditësi ka investuar gjykatën duke paditur shitësit e pasurisë së paluajtshme, duke kërkuar që ta njohin faktin juridik të pronësisë me parashkrim fitues. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 16.5.2012, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

71.2. Komisioni konstaton se vendimi nr. ***, datë 16.5.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është i argumentuar, pasi si palë e paditur nuk mund të thirreshin shtetasit F.D dhe F.Z, për sa kohë ata nuk kanë qenë pronarë të kësaj pasurie. Parashkrimi fitues i kundrejtohet vetëm pronarëve të ligjshëm të pasurisë, që rezultojnë në regjistrat publikë. Në këtë rast, si palë e paditur duhej të thirrej pronari i kësaj pasurie, Bashkia Shkodër, pasi kjo pasuri rezulton e regjistruar në emër të saj në ZVRPP. Komisioni vlerëson si shkelje procedurale rregullimin e ndërgjyqësisë, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e pronarit shtet, Bashkia Shkodër.

¹⁰³ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

71.3. Z. I.K është përpjekur të regjistrojë pasuritë e mësipërme në ZVRPP-në Shkodër, por nga ana e tyre është informuar se pronarët e këtyre pasurive nuk kanë qenë shtetasit F.D dhe F. Z, por Bashkia Shkodër, për rrjedhojë vendimi i gjykatës krijonte mbivendosje me pasuri të regjistruara në emër të Bashkisë Shkodër. Në këto kushte, z. K i është drejtuar sërish gjykatës, duke kërkuar që Bashkia Shkodër ta njihte pronar mbi këto pasuri. Nga ana e gjykatës, me vendimin gjyqësor nr. ***, viti 2013, është vendosur pranimi i padisë, duke argumentuar edhe fitimin e pasurisë me parashkrimin fitues.

71.4. Komisioni, pasi analizoi vendimin gjyqësor nr. ***, viti 2013, konstatoi se:

- i. Gjykata nuk ka argumentuar parashkrim fitues sipas dispozitave të Kodit Civil, pasi, bazuar në këto dispozita, ai i kundrejtohet palës pronare, në këtë rast Bashkisë Shkodër, dhe jo personave që kanë përfituar me AMTP, të cilët nuk ishin bërë ende pronarë, për sa kohë kjo pasuri nuk ishte regjistruar në emër të tyre në ZVRPP-në Shkodër dhe, për rrjedhojë ata nuk kanë qenë të pajisur me titull pronësie sipas parashikimeve ligjore.
- ii. Gjykata në këtë vendim analizon përfitimin e pasurisë me parashkrim fitues ndaj Bashkisë Shkodër, ndërkohë që objekti i padisë është detyrimi për të njohur pronar shtetasin I.K. Gjykata argumenton se pavarësisht se Bashkia Shkodër nuk ka qenë palë në gjykimin e çështjes së përfunduar me vendim të formës së prerë, ku shtetasi I.K është njohur pronar me parashkrim fitues, ajo cenon të drejtën subjektive të paditësit.
- iii. Gjyqfitues është shtetasi I.K, babai i avokatit L.K, me të cilin subjekti ka pasur njohje shoqërore dhe familjare.

71.5. Në përfundim të shqyrtimit të dosjes gjyqësore rezulton se vendimi nr. ***/2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është i argumentuar, si dhe evidentohet shkelje procedurale, pasi gjykata në argumentim ka dalë tej objektit të padisë, duke e kanalizuar çështjen sërish në parashkrim fitues. Subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka gjykuar një çështje, ku si palë është paraqitur babai i një personi me të cilin ai ka pasur njohje shoqërore dhe familjare.

➤ Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioni ngriti dyshime për favorizimin e shtetasit I.K.

71.6. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmblodhur¹⁰⁴, ka shpjeguar se: *“Gjetjet dhe konkluzionet për të cilat Komisioni më ngarkon barrë prove nuk kanë lidhje me mua. Kjo pasi sikurse rezulton nga dokumentacioni provues që do iu dërgoj dhe, konkretisht, nga nënshkrimi im në vendimin origjinal, si dhe nga procesverbali i mendimit në pakicë, unë kam votuar për rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit I.K.*

Për konfliktin e interesit jam shprehur më sipër. Në shtim të argumenteve që tashmë kam dhënë, ftoj Komisionin të vlerësojë mënyrën se si kam votuar unë në këtë çështje, si provë dhe fakt në favorin tim se gjendja e dukjes së konfliktit të interesit për të cilën më është ngarkuar barrë prove, jo vetëm nuk ekziston, por është në kundërshtim me rregullat më minimale të logjikës. Kjo pasi nuk ka mbështetje në arsyetim logjik, pretendimi se dy çështjet më të rëndësishme ku paraqitet si paditës, babai i personit për të cilin supozohet se kam marrëdhënie shoqërore dhe familjare të shtrira në kohë, rezultati i gjykimin, për sa është varur nga unë, ka qenë, njëra pushim gjykimi, ndërsa tjetra rrëzimi i padisë.

Vlerësoj se Komisioni duhet të rezervohet në dhënien e opinionëve lidhur me këtë çështje, pasi formimi i rregullt i ndërgjyqësisë përbën çështje të gjykuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim, po në

¹⁰⁴ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

Gjykatën e Apelit Shkodër, gjë që e nënkupton faktin se formimi i ndërgjyqësisë ka qenë i rregullt (pasi në të kundërt çështja do të kthehej për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë)”.

71.7. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

i) Në lidhje me pretendimin e subjektit se ai ka qenë në pakicë, Komisioni vlerëson se është i pambështetur në fakt.

Në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafi i parë, parashikohet se: *“Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Gjyqtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën ‘kundër’ dhe nënshkruan vendimin”.*

Në nenin 307 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafi i dytë, parashikohet se: *“Së pari voton gjyqtari më i ri në moshë dhe së fundi voton kryetari i seancës. Asnjë nga gjyqtarët nuk mund të abstenojë nga vendimi. Mendimi i gjyqtarit të mbetur në pakicë, i parashtruar me shkrim, bashkohet me vendimin”.*

Bazuar në vendimin origjinal të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton se subjekti ka firmosur së bashku me dy anëtarët e tjerë dhe nuk ka asnjë shënim “kundër”, si dhe as mendim kundër të bashkëlidhur nga ana e gjykatës.

Subjekti për të provuar pretendimin e tij ka depozituar një fletë me emërtimin “vendim”, e cila duket se është firmosur nga tre gjyqtarët e çështjes, përfshirë edhe subjektin, në të cilën ka nënshkrimin “në pakicë”. Në këtë fletë nuk rezulton të ketë firmosur sekretarja gjyqësore. Gjithashtu, ai ka paraqitur edhe shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Shkodër, sipas së cilës i vihet në dispozicion mendimi i pakicës për këtë çështje gjyqësore.

Në lidhje me fletën e depozituar nga subjekti, Komisioni konstaton se ajo nuk i përket dosjes gjyqësore, si dhe nuk rezulton të jetë pjesë e vendimit gjyqësor. Gjithashtu, ajo nuk përputhet me vullnetin e subjektit në vendimin origjinal, kopje e të cilit është administruar nga Komisioni, ku subjekti nuk ka shprehur vullnetin e tij kundër. Në këto kushte, duket sikur kjo fletë është prodhuar pas kalimit të barrës së provës, me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv në favor të subjektit, në lidhje me këtë barrë prove. Komisioni nuk ka tagrat e organit të Prokurorisë dhe nuk mund të merret me autenticitetin e kësaj flete, por vlerëson të mos e konsiderojë atë si provë.

ii) Për sa i përket shkresës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Komisioni vlerëson se nuk përputhet me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2022, të së njëjtës gjykatë, ku në faqen 3 të saj në seksionin nr. III, pika 6, cilësohet se: *“Po na vihet në dispozicion kopje e njehsuar e vendimit nr. ***, datë 1.7.2013”.* Kopja e njehsuar e vendosur në dispozicion nga gjykata nuk ka të bashkëlidhur mendimin e pretenduar të pakicës. Për këtë arsye, Komisioni nuk mund të marrë në cilësinë e provës këtë shkresë të dytë, e cila duket se përmban të dhëna që janë bërë me qëllim favorizimin e subjektit për procesin e rivlerësimit. Për më tepër, mendimi i pakicës, i presupozuar se gjendej në kasafortën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është njehsuar me origjinalin nga kancelarja e kësaj gjykate, znj. B.B, dhe jo nga dy anëtarët e tjera të sekretarisë gjyqësore¹⁰⁵. Konstatohet gjithashtu se mungon edhe nënshkrimi i kryesekretares së sekretarisë gjyqësore, e cila është personi përgjegjës për mbajtjen e kasafortës, por dhe personi i ngarkuar me ligj për të nënshkruar njehsimin e vendimeve gjyqësore.

¹⁰⁵ Shihni procesverbalin nr. *** prot., datë 2.11.2022, të depozituar nga subjekti më 30.11.2022.

Si konkluzion, Komisioni vlerëson të mos e marrë në konsideratë pretendimin e subjektit se ai ka qenë në pakicë në këtë vendimmarrje, pasi veprimet e tij nuk janë në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile.

iii) Në lidhje me pretendimin e subjektit se kjo çështje nuk mund të merret në vlerësim nga Komisioni për sa kohë është ende në gjykim në një gjykatë më të lartë, Komisioni vlerëson se ky pretendim i tij nuk duhet të merret në konsideratë, pasi Kolegji¹⁰⁶ ka një jurisprudencë të konsoliduar në lidhje me çështjen në gjykim. Në vendimin nr. 28/2020, Kolegji shprehet se: *“Në një qëndrim të konsoliduar tashmë, Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: [...] Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë. Në këto rrethana, çështja gjyqësore e analizuar ka përfunduar shqyrtimin e saj prej subjektit të rivlerësimit, i cili është shprehur me vendimin përfundimtar për zgjidhjen e saj dhe qenia e saj e varur para Gjykatës së Lartë, në pritje të një gjykimi atje, nuk e bën këtë çështje ‘nën shqyrtim’, në kuptim të parashikimit të nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, për pasojë Komisioni ka qenë i legjitimuar të analizojë e vlerësojë edhe këtë çështje në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit”.*

Në nenin E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Në çdo rast shkarkimi i një gjyqtari ose prokurori nuk është shkak për rihapjen e çështjeve të gjykuara ose të hetuara prej tij, përveçse kur ekzistojnë shkaqet, mbi të cilat realizohet kërkesa për rishikim, sipas parashikimeve në ligjet procedurale”.*

Për rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit në lidhje me këtë çështje nuk mund të ndikojë dhe nuk mund të përbëjë provë për gjykimin e saj në të gjitha shkallët e gjykimit të juridiksionit gjyqësor.

iv) Për sa i përket konfliktit të interesit, Komisioni mban të njëjtin qëndrim si më lart.

71.8. Në përfundim, Komisioni vlerëson se ngrihen dyshime për favorizimin e z. I.K duke marrë në konsideratë faktin që: (i) vendimi nr. ***, viti 2013, nuk është i argumentuar, si dhe evidentohet shkelje procedurale, pasi gjykata në argumentim ka dalë tej objektit të padisë, duke e kanalizuar çështjen sërish në parashkrim fitues; (ii) subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka gjykuar një çështje, ku si palë është paraqitur babai i një personi me të cilin ai ka pasur njohje shoqërore dhe familjare; (iii) subjekti është përpjekur të paraqesë një situatë në favor të tij, duke depozituar si provë: një fletë, që përmban të dhëna të paprovuara/jo në formën e kërkuar nga ligji; dhe një mendim të pretenduar si pakicë e tij, i cili nuk është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, pasi nuk është nënshkruar nga kryesekretarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, madje duket se është prodhuar pas kalimit të barrës së provës, për sa kohë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ia ka dërguar Komisionit me shkresën zyrtare në bazë të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016.

72. Në përfundim, pasi vlerësoi rezultatet e hetimit, si dhe shpjegimet e provat e subjektit, të përshkruara në këtë vendim në pikat 67-71, Komisioni konstaton se të paktën në këto pesë dosje gjyqësore të analizuara konstatohen gabime serioze dhe thelbësore të subjektit, të cilat reflektojnë dukshëm favorizim të palës në gjykim, pikërisht të shtetasit I.K, konfliktin e interesit me të cilin trupi gjykues do ta vlerësojë në kuadër të etikës dhe profesionalizmit. Komisioni çmon se pavarësisht se këto gabime do të përfshihen në vlerësimin profesional, në këtë moment ato reflektojnë veprime/mosveprime, të cilat kanë çuar në favorizimin e njërës palë në mënyrë të përsëritur.

¹⁰⁶ Shihni vendimet nr. 7/2019(JR), datë 5.4.2019, nr. 16/2020(JR), datë 13.7.2020 dhe nr. 28/2020 të Kolegjit.

Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë shtetasin Sh.M

73. Çështje gjyqësore, regjistruar në datën 26.9.2011, me palë kërkuese Sh.M dhe objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, vërtetim fakti të qenies së kërkuesit bashkëpronar të pasurisë në lagjen “Z”, Shkodër, si dhe rivendosje në afat për t’iu drejtuar AKKP-së Tiranë. Me vendimin nr. ***, datë 17.10.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

73.1. Nga verifikimi i padisë duket se:

- i. Kërkimet e palës së paditur nuk mund të shqyrtoheshin në të njëjtin proces gjyqësor, pasi ka të bëjë me objekte të ndryshme dhe dëshmia e trashëgimisë nuk përbën vërtetim fakti juridik.
- ii. Njohja bashkëpronar i një pasurie të paluajtshme nuk bëhet me vërtetim fakti, pasi nuk mund të prodhojë pasoja për palët e treta.
- iii. Vërtetimi i faktit nuk është një nga format e padisë për të zgjidhur njohjen e pronësisë së një pasurie të paluajtshme.

Në lidhje me këto konstatime subjektit iu kalua barra e provës.

73.2. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹⁰⁷, ka shpjeguar se: *“Kërkesa me objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë është vërtetim fakti juridik. Neni 55 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: ‘Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore. Në këtë rast, gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme’. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore besoj se është e qartë se kërkimet kryesore të çështjes janë dy (pasi qëndrojnë të pavarura përkundrejt njëri-tjetrit). Ato janë: (a) lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë dhe (b) përcaktimi përmes rrugës së vërtetimit gjyqësor të faktit, të planvendosjes së pasurisë, të sipërfaqes së saj, të faktit se i ati i kërkuesit ka bërë pjesë në bashkëpronarët e pasurisë, përpara se ajo (sipas kërkuesit) të shtetëzohej. Kërkimi më objekt ‘rivendosje në afat’ ka karakter dytësor, pra mund të gjykohet së bashku me kërkimin për përcaktimin përmes rrugës së vërtetimit gjyqësor të faktit, të planvendosjes së pasurisë, të sipërfaqes së saj, të faktit se i ati i kërkuesit ka bërë pjesë në bashkëpronarët e pasurisë, përpara se ajo (sipas kërkuesit) të shtetëzohej. Neni 159 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: ‘Në një kërkesëpadi mund të parashtrihen shumë kërkime, në rast se gjykata është kompetente për të gjitha kërkimet. Kur gjykata çmon se shqyrtimi i përbashkët i tyre do të shkaktojë vështirësi të dukshme në zhvillimin e gjykimit, vendos që ato të shqyrtohen veç e veç’. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore është e qartë se të tre kërkimet mund të gjykohen së bashku, përderisa gjykata ka qenë kompetente për të gjitha. Për më tepër, gjykata nuk ka pasur ndonjë rol për të luajtur sepse përcaktimin e objektit të gjykimit e ka realizuar kërkuesi Sh.M, përmes kërkesës së paraqitur prej tij dhe jo gjykata. Sipas neneve 5 dhe 185 të Kodit të Procedurës Civile e drejta e disponimit të padisë i përket në këtë mënyrë paditësit/kërkuesit dhe gjykata nuk mund të ndërhyjë për kufizimin e saj... është e qartë se ‘objekti i gjykimit’ i kërkesës së gjykuar me vendimin nr. **-2011-***, datë 17.10.2011 (për çështjen e regjistruar me datën 26.9.2011), me kërkues shtetasin Sh. M, nuk ka pasur të përfshirë në objektin e tij, ndonjë kërkim për njohje bashkëpronësie, përcaktime raportesh bashkëpronarësh, etj... Ndoshta mund të ketë një keqkuptim-ngatërrim me faktin se me të njëjtin vendim është lëshuar njëkohësisht edhe dëshmia e trashëgimisë dhe, për rrjedhojë, Komisioni i konsideron të gjithë trashëgimtarët e ish-pronarit S.M si bashkëpronarë të pasurisë, për shkak të faktit se të gjithë këta bashkëtrashëgimtarë do të duhet të ishin përfytyes*

¹⁰⁷ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

nga vendimi i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (tek e cila do të paraqitej vendimi krahas dokumentacionit tjetër tekniko-ligjor), nëse ky organ administrativ do ta konsideronte të bazuar kërkesën e tyre për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

73.3. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se bazuar në vendimin nr. ***, datë 17.10.2011, objekti i padisë është vërtetimi i faktit juridik të qenies bashkëpronar të kërkuarit Sh.M, ndërkohë është e vërtetë se subjekti në dispozitiv të vendimit ka vendosur vërtetimin e faktit juridik se i ndjeri S.M ka pasur në pronësi pasurinë e paluajtshme. Vetë subjekti në parashtrimet e tij pranon faktin se nga vendimmarrja e tij mund të lindin keqkuptime, për sa kohë në të njëjtin vendim është shprehur edhe në lidhje me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Në lidhje me pretendimin e subjektit se ka të bëjë me kërkesa të ndërvarura, ky pretendim i tij nuk qëndron, pasi ka të bëjë me tri kërkesa të natyrave të ndryshme dhe që nuk ndërvaren nga njëra-tjetra, për më tepër ato nuk mund të përfshihen në një vendim.

73.4. Në përfundim, Komisioni vlerëson se pavarësisht faktit që subjekti nuk duhej të gjykonte këto kërkesa në një gjykim të vetëm, kjo mangësi, e parë më vete, nuk ndikon në vlerësimin profesional të subjektit, por e parë së bashku me mangësitë e mëposhtme ajo afektton kriteret e vlerësimit profesional, të cilat do të analizohen në vlerësimin profesional të subjektit.

73.5. Nga analizimi i pjesës argumentuese të vendimit konstatohet se:

- i. Në lidhje me objektin e padisë vërtetimi i faktit të qenies së kërkuarit bashkëpronar në një pasuri të paluajtshme:
 - Subjekti, në vendim, në seksionin “legjislacioni i zbatueshëm i vendimit”, citon si bazë ligjore nenet 388-392 e Kodit të Procedurës Civile.
 - Subjekti i referohet notës së transkriptit në favor të shtetasit S.M me nr. *** rep., nr. *** kol., të vitit 1935, për të provuar pronësinë e shtetasit Sh.M. Nga ana e tij nuk ka referim në asnjë dokument tjetër për t’u provuar pronësia e z. M në lidhje me këtë pasuri.
 - Nga ana e subjektit nuk është administruar asnjë provë në lidhje me ekzistencën e ndonjë AMTP-je, për sa kohë ka të bëjë me një pasuri të llojit “kullotë”, të ndodhur në fshatin Z, si dhe statusin juridik të kësaj prone në momentin e gjyqimit.

Për sa më sipër, duket se vendimi i subjektit në lidhje me vërtetimin e faktit të qenies së kërkuarit bashkëpronar nuk është i argumentuar dhe nuk është në përputhje me normat¹⁰⁸ procedurale civile, pasi vërtetimi i faktit juridik nuk është padi njohjeje pronësie.

- ii. Në lidhje me objektin e padisë të rivendosje në afat:

Subjekti në vendim deklaron se kërkuari ka argumentuar objektivisht në lidhje me humbjen e afatit për t’u drejtuar pranë AKKPPronave në Tiranë, por nuk referon në asnjë provë apo fakt. Për sa më sipër, duket se vendimi i subjektit në lidhje me këtë pjesë të padisë nuk është i argumentuar.

¹⁰⁸ Në nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë. Kërkesa për vërtetimin e fakteve paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në territorin e së cilës ka banimin kërkuari. Kur kërkohet vërtetimi i faktit për një send të paluajtshëm, ajo paraqitet në gjykatën e shkallës së parë në territorin e së cilës ndodhet sendi. Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohet edhe korrigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni”.

iii. Në të njëjtin vendim subjekti lëshon edhe dëshminë e trashëgimisë për të ndjerin S.M.

73.6. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹⁰⁹, ka parashtruar të njëjtat pretendime si në paragrafin 73.2, për sa i përket vendimit të tij në lidhje me vërtetimin e faktit të njohjes së pronësisë dhe vlerësimi i Komisionit është i njëjtë.

Për sa i përket pjesës tjetër të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se nota e transkriptimit në fjalë është paraqitur si provë nga kërkuesi Sh.M, në formën e aktit zyrtar me fuqi të plotë provuese. Duke pasur këtë cilësi, ky dokument, sipas nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, ka vlerësuar se ka qenë i panevojshëm thellimi i hetimit gjyqësor. Ndërkohë, subjekti ka pretenduar se: *“... vlerësoj se Komisioni duke u shprehur në mënyrë të nënkuptuar për thellësinë e hetimit gjyqësor, mund të ketë rënë në kundërshtim me nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’. Gjithashtu, duket se Komisioni, përmes këtij opinioni, bie në kundërshtim edhe me standardin detyrues të përcaktuar me vendimin nr. 28/2020(JR), të marrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit për subjektin e rivlerësimit F.V në paragrafët 10.7, 10.8 dhe 12.4 të tij.*

Gjithashtu, vlerësoj se Komisioni, duke u shprehur në mënyrë të nënkuptuar për thellësinë e hetimit gjyqësor, si dhe duke e vendosur këtë vlerësim të tij në atë pjesë të raportit që merr në analizë ‘kriterin e figurës’ të veprimtarisë time gjyqësore, duket se bie në kundërshtim edhe me standardin detyrues të përcaktuar me vendimin nr. 20/20(JR), datë 8.9.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për subjektin e rivlerësimit F.L, në paragrafët 34.3, 34.4 dhe 34.5...

Hetimi, nëse mbi pasurinë ka pasur apo jo ndonjë AMTP, nuk ka qenë pjesë e objektit të gjykimit. Sipas nenit 6 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata shprehet për gjithçka që kërkohet, por vetëm për atë që kërkohet. Sipas ligjit të kohës për kthimin e pronës, ky hetim lidhur me AMTP-të do duhet të kryhej nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pasi vetëm ky organ administrativ kishte juridiksionin dhe kompetencën lëndore për të hetuar nëse kishte apo jo AMTP.

Vendimi i dhënë prej meje absolutisht nuk ka sjellë dhe madje as mund të sillte ndonjë pasojë ligjore. Ky vendim thjesht ka ndihmuar shtetasin Sh.M për t’i treguar Agjencisë së Kthimit të Pronave elementet identifikuese të pasurisë që ajo do të duhej të trajtonte sipas ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, ‘Për kthimin dhe kompensimin e pronës’ (i ndryshuar) mbi bazën e kërkesës së tij.

Në lidhje me objektin e padisë së rivendosjes në afat, nga ana e kërkuesit më është pretenduar se ka qenë në padijeni të ekzistencës së notës së transkriptimit të pasurisë së babait të tij mbi pronën dhe prandaj e ka humbur afatin. Kur kam pranuar kërkesën për rivendosje në afat, kam vlerësuar se përbën fakt të njohur botërisht se humbja e afatit për të paraqitur kërkesën për kthimin/kompensimin e ish-pronës në ish-AKP, në shumicën dërrmuese të rasteve nuk është shkaktuar për fajin e subjekteve ...”.

73.7. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

i) Në lidhje me pretendimet e subjektit, për sa i përket jurisprudencës së Kolegjit, përkatësisht vendimet nr. 20/2020 dhe nr. 28/2020, çmohet se nuk gjejnë zbatim në këtë rast. Vërtet Komisioni në kriterin e kontrollit të figurës i ka kaluar barrë prove subjektit edhe në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional, por ky fakt i është vënë në dijeni subjektit me dërgimin e

¹⁰⁹ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

rezultateve të hetimit¹¹⁰, ku Komisioni shprehet se analizimi i këtyre dosjeve do të jetë pjesë e vlerësimit profesional. Sikundër është shprehur më lart, analizimi i dosjeve gjyqësore në funksion të rivlerësimit të figurës është bërë edhe në kuadrin e vlerësimit profesional, por përfundimet për gjetjet janë të ndara, sipas kriterit që do të rivlerësohet. Fakt është që këto dosje janë administruar në kuadër të hetimit për figurën.

ii) Për sa i përket pretendimeve të subjektit se Komisioni ka analizuar themelin e çështjes, vlerësohet se ky pretendim nuk qëndron, pasi në asnjë moment Komisioni nuk është shprehur për vendimmarrjen e subjektit, por është bazuar në kriteret e vlerësimit të parashikuara nga nenet 72-76 të ligjit nr. 96/2016, ndër të cilat është edhe cilësia e analizës dhe argumentimit logjik sipas nenit 72/3, si dhe aftësia për të identifikuar konfliktin e normave dhe analizuar jurisprudencën sipas nenit 72/2. Në asnjë rast Komisioni nuk ka kryer një arsyetim e analizë të ndryshme të fakteve e rrethanave të çështjes, si dhe nuk ka analizuar zgjidhjen në themel të çështjes, sikundër parashikohet në nenin 72/4 të ligjit nr. 96/2016, të cilit gabimisht subjekti i referohet si neni 74/4.

Më konkretisht, në lidhje me çështjen gjyqësore në fjalë Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka argumentuar në vendim arsyet që e çuan në pranimin e padisë për rivendosjen në afat. Në faqen 5 të këtij vendimi subjekti shprehet tekstualisht: *“Subjekti i interesuar Sh.M provoi para kësaj gjykate se e ka pasur objektivisht të pamundur të respektojë afatin ligjor ...”*.

Në asnjë moment subjekti në këtë vendim nuk argumentuar se cilat kanë qenë provat apo faktet mbi të cilat ka arritur në këtë konkluzion. Në prapësimet e tij, subjekti pretendon se kërkuesi ka deklaruar se ka qenë në padijeni të ekzistencës së notës së transkriptimit të pasurisë së babait të tij mbi pronën, ndërkohë në vendimin objekt vlerësimi, në faqen 4, subjekti shprehet se kërkuesit i është dashur të plotësojë dokumentacionin e tij të pronësisë në aspektin hartografik.

Për sa më sipër, mungesa e argumentimit të vendimit në lidhje me pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat afekton kriterin e vlerësimit të parashikuar nga neni 72/3 i ligjit nr. 96/2016.

iii) Subjekti, edhe në rastin e vërtetimit të faktit juridik të njohjes së pronësisë, është mbështetur mbi një dokument që, siç rezulton më poshtë, është deklaruar i falsifikuar. Subjekti në vendim sërish nuk argumenton se pse kjo notë transkripti përbën provë të plotë, si dhe në vijim deklaron në faqen 4, paragrafi 6, se: *“Gjykata vlerëson aktekspertimin me fuqi provuese për faktin se sipas konkluzioneve të ekspertimit topografik pretendimet e palës kërkuese lidhur me vendndodhjen e pronës objekt gjykimi nuk kanë mbivendosje me pretendimet e ndonjë pronari të vjetër apo me rrugët publike”*. Ndërkohë që në dosjen gjyqësore nuk është administruar asnjë dokument që mbështet konkluzionet e aktekspertimit.

Për sa më sipër, mungesa e argumentimit të vendimit në lidhje me pranimin e kërkesës për vërtetimin e faktit juridik afekton në kriteret e vlerësimit të parashikuar nga neni 72/3 i ligjit nr. 96/2016.

73.8. Me vendimin nr. ***, datë 15.1.2018, shtetasi Sh.M së bashku me ekspertin e thirrur nga subjekti në këtë gjykim, z. G.S, janë deklaruar fajtorë për veprën penale “falsifikim në lidhje me dokumentin notë transkripti” të depozituar nga shtetasi Sh.M në këtë proces gjyqësor.

Nga shqyrtimi i kësaj dosjeje, Komisioni, në përfundim, ka konkluduar se ngrihen dyshime për favorizim të paditësit Sh.M, pasi duket se nga ana e subjektit vendimi nuk është i argumentuar, si dhe ka kryer shkelje procedurale në lidhje me gjykimin e tri padive të llojeve të ndryshme në një padi.

¹¹⁰ Shihni f. 43 të rezultateve të hetimit, paragrafi 1.

73.9. Subjekti, në lidhje me këtë barrë prove, i qëndron prapësimeve të tij si më lart, duke shtuar se ky rast është i ngjashëm me rastin e subjektit A.K.

Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, Komisioni i qëndron argumenteve të tij në pikën 36.4 të këtij vendimi për sa i përket rasteve të ngjashme.

73.10. Në përfundim të analizimit të kësaj çështjeje gjyqësore, Komisioni vlerëson se veprimet e subjektit do të vlerësohen në kuadrin profesional, por në këtë pikë këto veprime demonstrojnë favorizim të palës, fakt ky që do të mbahet në konsideratë në vlerësimin e figurës.

74. Çështje gjyqësore, regjistruar në datën 15.12.2011, me palë kërkuese Sh.M dhe objekt vërtetimin e faktit juridik të qenies pronar të ish-pronarit S.M për pasurinë e ndodhur në fshatin K, Komuna Bushat, Shkodër, me sip. 20,000 m² dhe rivendosje në afat të së drejtës së kërkuarit për t'iu drejtuar AKKP-së Tiranë.

74.1. Në lidhje me këtë gjykim konstatohet se:

- Subjekti ka caktuar tri seanca gjyqësore në harkun kohor të 5 ditëve. Seanca e parë është caktuar në datën 19.12.2011 dhe seanca e fundit në datën 23.12.2011. Në seancën e datës 21.12.2011 subjekti ka caktuar ekspert duke i dhënë vetëm 2 ditë kohë për aktekspertimin.
- Në dosjen gjyqësore nuk gjendet njoftimi i shtetasit Sh.M për zhvillimin e seancës, megjithëse vendimi është marrë ditë të premtë dhe seanca është caktuar për ditën e hënë.
- Nga analizimi i vendimit konstatohet se nga ana e subjektit nuk është argumentuar kërkesa për rivendosjen në afat të së drejtës së kërkuarit Sh.M për t'iu drejtuar AKKP-së Tiranë.
- Subjekti nuk ka respektuar afatet ligjore të nenit 155 të Kodit të Procedurës Civile për caktimin e seancës.

Në përfundim, duke marrë në konsideratë kohën e shkurtër vetëm 5 ditë të gjykimit të çështjes, caktimin e një afati shumë të shkurtër ekspertit për të bërë aktekspertimin, si dhe mungesën e njoftimit të paditësit për zhvillimin e gjykimit, ngrihen dyshime për favorizim të paditësit Sh. M.

74.2. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹¹¹, ka shpjeguar se:

i) Në lidhje me njoftimin e palës i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna si në rastin e shtetasit I. K. Subjekti ka detajuar më tej se: *“Fakti që nuk gjendet njoftimi i shtetasit Sh.M, justifikohet me faktin se ai pas shortimit të çështjes, që është data 15.12.2011, pasi ka marrë njoftim për emrin e gjyqtarit është paraqitur personalisht dhe ka marrë kontakt me sekretaren, e cila i ka njoftuar gojarisht dhe pa e dokumentuar njoftimin për seancën e parë, që është zhvilluar në datën 19.12.2011, seancë në të cilën ai është paraqitur ...”*

Subjekti i ka qëndruar pretendimit të tij se, sipas nenit 451/a, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, nuk ka ekzistuar ligjërisht as mundësia për të bërë favorizime apo disfavorizime. Kjo pasi vendimi duket qartë se ka pasur vetëm një palë dhe, për rrjedhojë, vendimi ka fuqi detyruese vetëm për këtë person. Sipas subjektit, afati ligjor i parashikuar nga neni 155/1 i Kodit të Procedurës Civile zbatohet për paditë me palë kundërshtare (të juridiksionit gjyqësor kontencioz) dhe nuk zbatohet për kërkesat pa palë kundërshtare, që në thelbin e tyre janë vërtetime faktesh gjyqësore (që përfshihen në juridiksionin gjyqësor grocioz). Kjo sipas interpretimit literal (gjuhësor) të normës. Kjo çështje, sipas tij, është kërkesë pa palë. Ratioja e ekzistencës së këtij afati ligjor është garantimi i

¹¹¹ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

zbatimit të parimit të kontradiktoritetit dhe e së drejtës së mbrojtjes. Në gjykimet e të njëjtës natyrë me çështjen në fjalë, pra pa palë kundërshtare, nuk ka një ratio të tillë, pasi nuk ka kontradiktoritet palësh.

ii) Në lidhje me afatin e caktuar ekspertit, subjekti ka prapësuar se: *“Në seancën e dytë të datës 21.12.2011, në të cilën eksperti është paraqitur dhe ka marrë detyrat, unë e kam pyetur ekspertin sa kohë të nevojitet dhe ai vetë më ka thënë dy ditë. Për rrjedhojë, unë kam shtyrë seancën, fiks aq kohë sa i është dashur ekspertit ...*

Në seancën e datës 23.11.2011, në të cilën është administruar aktekspertimi, është dhënë vendimi përfundimtar. Kjo pasi pala Sh.M nuk ka pasur kundërshtime, si dhe çështja jo vetëm që nuk ka pasur karakter kompakt, por ka qenë e thjeshtë.

Lidhur me substancën e këtij vlerësimi evidentoj se nga ana e kërkuesit më është pretenduar se e ka humbur afatin për të paraqitur kërkesën në AKP, për trajtimin e ish-pronës, pikërisht për shkak të faktit se pa u përcaktuar më parë hartografikisht planvendosja e pasurisë në rrugën e vërtetimit gjyqësor të faktit, AKP-ja nuk pranon që ta shqyrtojë dokumentacionin (faktikisht, kjo ka qenë edhe arsyeja se përse kam çmuar se shqyrtohen bashkë kërkimi i vërtetimit gjyqësor të faktit dhe kërkimi për rivendosjen në afat). Unë kam vlerësuar se ky pretendim është i bazuar, pasi është çështje ligji dhe jo fakti ...”.

Subjekti pretendon se Komisioni ka shkelur standardet e përcaktuara në vendimet nr. 20 dhe nr. 28, të vitit 2020, të Kolegjit. Për të mos rënë në përsëritje, Komisioni i qëndron të njëjtave argumente si më lart.

74.3. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

i) Në kërkesën e shtetasit Sh.M nuk gjendet asnjë e dhënë, për sa i përket adresës së banimit të tij apo numër kontakti për të bërë të mundur njoftimin e tij nga ana e sekretarisë gjyqësore, sikundër pretendohet nga subjekti. Gjithashtu, në dosjen gjyqësore nuk gjendet i administruar njoftimi i këtij shtetasi, detyrim ligjor i parashikuar nga neni 128 i Kodit të Procedurës Civile i kohës së shqyrtimit të çështjes gjyqësore, ku parashikohet se thirrja në gjykatë bëhet me letërthirrje, e cila si rregull njoftohet me anë të nëpunësit gjyqësor. Edhe sikur të qëndrojë pretendimi i subjektit, minimalisht, sekretaria gjyqësore do t'i kërkonte z. M të nënshkruante marrjen e njoftimit, sikundër ndodh në çdo rast të njoftimit në seancat kur gjyqtari nuk është prezent.

ii) Në lidhje me vendosjen e një afati 2-ditor për ekspertin, subjekti pretendon se ky afat është kërkuar nga eksperti, pasi është pyetur nga ana e tij. Ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi në procesverbalin e seancës së datës 21.12.2011 rezulton se ka qenë eksperti ai që ka kërkuar kohë, por pa specifikuar afatin 2-ditor. Nëse krahasohen dy gjykimet e vetë subjektit për të njëjtin objekt padie për të njëjtin shtetas në gjykimin e parë (më lart), çështja është regjistruar në datën 26.9.2011 dhe ka përfunduar në datën 17.10.2011. Aktekspertimi i kryer nga i njëjti ekspert mban datën 17.10.2011, duke u kryer për një periudhë më shumë se 3-javore, ndërkohë në çështjen objekt shqyrtimi është kryer për një afat 2-ditor.

iii) Në lidhje me mosrespektimin e afatit 10-ditor për seancën, konstatohet se në Kodit të Procedurës Civile nuk ka asnjë parashikim përjashtues sikundër është rasti i lëshimit të urdhërekzekutimit, ku në nenin 511 të tij parashikohet afati 5-ditor.

iv) Në lidhje me çështjen gjyqësore në fjalë, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka argumentuar¹¹² në vendim arsyet, të cilat e çuan subjektin në pranimin e padisë për rivendosjen

¹¹² Në f. 3 të këtij vendimi subjekti shprehet tekstualisht: *“Subjekti i interesuar Sh.M provoi para kësaj gjykate se e ka pasur objektivisht të pamundur të respektojë afatin ligjor...”.*

në afat. Në asnjë moment subjekti në këtë vendim nuk ka argumentuar se cilat kanë qenë provat apo faktet mbi të cilat është mbështetur për të arritur në konkluzione.

74.4. Në analizë të sa më sipër, duke marrë në konsideratë: (i) kohën e shkurtër të gjykimit të çështjes; (ii) mungesën e njoftimit të shtetasit Sh.M; (iii) mosrespektimin e afatit 10-ditor për njoftimin e kërkesës, Komisioni çmon se të gjitha veprimet/mosveprimet e subjektit kanë sjellë favorizimin e palës. Problematikat e ndeshura në analizimin e dosjes, që nuk përputhen me treguesit e nenit 72, pika 3 dhe nenit 74, pikat 2, 3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016, do të konsiderohen në vlerësimin profesional të subjektit, por këto problematika të evidentuara qartazi tregojnë favorizim të palës, që do të jetë pjesë e vlerësimit të figurës për subjektin.

75. Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë shtetasit H.T dhe H.T

75.1. Çështje gjyqësore me palë paditëse H.H, e përfaqësuar në gjykim nga av. L.K, të paditur H.B dhe persona të tretë H e H.T dhe A.D, përfaqësuar nga z. L.K, objekt gjykimi “detyrimi i të paditurit për të njohur pronar paditësin”. Me vendimin e datës 23.12.2015, subjekti ka vendosur pushimin e padisë.

75.2. Çështje gjyqësore me palë paditëse H.H, e përfaqësuar në gjykim nga av. L.K, të paditur H.B dhe persona të tretë H e H.T dhe A.D, përfaqësuar nga z. L.K, me objekt gjykimi “detyrimi i të paditurit për të njohur pronar paditësin dhe saktësimin e kufijve”. Me vendimin e datës 4.10.2016 subjekti ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, duke rrëzuar kërkimin për zërin “ndërtesë” të objektit material të gjykimit. Sipas shënimit të sekretarisë gjyqësore, ky vendim është ankimuar nga pala paditëse dhe pala e paditur dhe Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate me trup tjetër gjykues. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga pala e paditur dhe çështja është regjistruar për gjykim pranë Gjykatës së Lartë.

75.3. Nga analizimi i vendimit gjyqësor konstatohet se:

- Subjekti nuk ka argumentuar arsyet se përse kjo padi duhet të pranohet, por ka argumentuar arsyet se përse prapësimet e palës së paditur nuk duhet të pranohen. Në vendim subjekti shprehet për ekzistencën e tre vendimeve gjyqësore të formës së prerë, sipas të cilave, në lidhje me padinë objekt gjykimi duket se ka të bëjë me gjë të gjykuar.
- Pala paditëse dhe palët e treta përfaqësohen në këtë proces nga ana e shtetasit L.K, me të cilin subjekti ka njohje shoqërore dhe familjare.

75.4. Për sa më sipër duket se:

- i. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është i argumentuar.
- ii. Jemi përpara gjësë së gjykuar.
- iii. Subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka gjykuar një çështje, ku përfaqësues i palës ka qenë z. L.K, me të cilin ka pasur marrëdhënie shoqërore.

Për rrjedhojë, duke marrë në konsideratë informacionin e organeve ligjzbatuese, ngrihen dyshime për favorizimin e palës paditëse.

75.5. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹¹³, ka shpjeguar se:

*i) “Për sa i përket konstatimit të Komisionit se kemi të bëjmë me ‘gjë të gjykuar’, vlerësoj se është i pasaktë. Si provë për këtë do t’ju ftoja t’i referoheni vendimit nr. ***, datë 14.5.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër, që në faqen 11, në paragrafin 2 të tij shprehet: ‘Gjykata e Apelit*

¹¹³ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituar nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

e gjen të drejtë arsyetimin që ka bërë gjykata e shkallës së parë lidhur me parimin e 'gjësë së gjykuar', ashtu edhe me parashkrimin e padisë së paditëses H.H, duke konkluduar se pretendimet e saj të pronësisë duhen gjykuar në themel, me një vendim gjyqësor përfundimtar'. Për sa i përket vlerësimit të Komisionit se subjekti nuk ka argumentuar arsyet se pse kjo padi duhet të pranohet, por ka argumentuar arsyet se pse prapësimet e palës së paditur nuk duhet të pranohen, kjo ka të bëjë me cilësinë e arsyetimit. Megjithatë, shumë shkurt, po shtoj se vetë natyra e çështjes, si dhe struktura e arsyetimit të vendimit e nënkuptojnë që ose do të pranohet padia dhe nuk do të merreshin në konsideratë prapësimet për truallin ose e kundërta, do të pranoheshin prapësimet dhe, për rrjedhojë, të rrëzohej padia për truallin. Po ashtu, janë cilësuar të gjitha provat që kam vlerësuar në krijimin e bindjes se padia duhet pranuar pjesërisht për zërin truall të pasurisë, kam përshkruar saktësisht faktet, gjë që vërehet edhe nga fakti se këtë përshkrim e ka marrë të mirëqenë fjalë për fjalë edhe Gjykata e Apelit në vendimin e saj, si dhe kam cituar dhe analizuar korrektësisht normat ligjore që kam vlerësuar se kanë pasur rëndësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ...”.

ii) Subjekti sërish referon në vendimin nr. 20 dhe nr. 28/2020 të Kolegjit, për të cilët Komisioni është shprehur më lart dhe i njëjti arsyetim vlen edhe në këtë rast.

iii) Në lidhje me konfliktin e interesit subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si në pikën të 95.4-95.6 këtij vendimi dhe qëndrimi i Komisionit është i njëjtë.

iv) Subjekti i kërkon Komisionit që për sa kohë çështja është në Gjykatën e Lartë, i duhet të tregohet i rezervuar në lidhje me themelin e saj.

75.6. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, çmon se që në rezultatet e hetimit për këtë çështje, Komisioni ka qenë i rezervuar, duke shmangur vlerësimin e themelit, bazuar në nenin 72/4 të ligjit nr. 96/2016 dhe jo për faktin se çështja është për gjykim në Gjykatën e Lartë.

Për sa i përket barrës së provës, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Subjekti nuk ka arsyetuar dhe nuk ka provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit. Nisur nga vendimi nr. ***, datë 14.5.2018, i Gjykatës së Apelit Shkodër, dokument që nuk ishte administruar nga Komisioni më parë, por u depozitua nga subjekti, konstatohet se në faqen 11 gjykata shprehet se *e gjen të drejtë arsyetimin e bërë nga gjykata e shkallës së parë në lidhje me parimin e gjësë së gjykuar*. Për rrjedhojë, për sa kohë ka një vendim gjykate (që shprehet specifikisht në lidhje me gjënë e gjykuar të kësaj çështjeje) Komisioni nuk mund të vijojë më tej vlerësimin në lidhje me aspektin e gjësë së gjykuar.

75.7 Komisioni çmon se aftësitë argumentuese të subjektit do të vlerësohen në kuadër të rivlerësimit profesional të tij, por në funksion të vlerësimit të figurës vlerësohet se subjekti me veprimet/mosveprimet e tij ka favorizuar njërën nga palët.

76. Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë shtetasin V.C

Çështje gjyqësore, regjistruar në datën 13.9.2004, me trup gjykues në përbërje të së cilit ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit. Ky gjykim i përket çështjes penale të paraqitur për gjykim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kundër të pandehurit V.C, i akuzuar për veprat penale “vrasje me paramendim të kryer në bashkëpunim” dhe “armëmbajtje pa leje”.

76.1. Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore konstatohet se:

- i. Prokurori i çështjes i kërkoi gjykatës:

- deklarinim fajtor të të pandehurit për veprën penale “vrasje me paramendim të kryer në bashkëpunim” dhe dënimin e tij me 20 vjet burg;
 - deklarinim fajtor të të pandehurit për veprën penale “armëmbajtje pa leje” dhe dënimin e tij me 4 vjet burg;
 - në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal që bën fjalë për bashkimin e dënimeve, dënimin e të pandehurit V.C me 20 vjet burg.
- ii. Në vendimin gjyqësor nr. **, datë 24.1.2005, trupi gjykues arsyeton se i pandehuri V. C është përgjegjës për veprën penale “vrasje në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, të parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal, pasi ai ishte nën kërcënimin e një sulmi të drejtpërdrejtë, të rrezikshëm për jetën, por i është kundërpërgjigjur këtij sulmi kur ky ishte ndërprerë dhe nuk kishte më intensitet. Pretendimet e organit të akuzës se gjendet para veprës penale “vrasje me paramendim për motive gjakmarrje” nuk qëndrojnë, pasi nuk u provuan gjatë gjykimit. Gjithashtu, sipas trupit gjykues, citon se vrasja për gjakmarrje bëhet në emër të zakoneve dhe kanunit dhe si rregull vihet në dijeni e gjithë familja e personit që do të kryejë krimin (që do të marrë gjak) dhe në të tilla raste autori shoqërohet me një pjesëtar të afërm të familjes, ndërsa pjesëtarët e tjerë ruhen. Në rastin në fjalë pjesëtarët e familjes të të pandehurit nuk kanë pasur dijeni për ngjarjen. Gjykata është e bindur se viktima ka sulmuar i pari dhe se sulmi mund të ketë pasur për bazë frikën kundrejt të pandehurit. Gjykata çmon se i pandehuri është i pafajshëm për veprën penale “armëmbajtje pa leje”, pasi nuk u provua që ai të ketë pasur armë tjetër veç armës që mbante me leje të organeve kompetente.

Në këto kushte, trupi gjykues ka vendosur: “Në bazë të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, nga vepra penale ‘vrasje me paramendim’ në veprën penale ‘vrasje në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme’ dhe dënimin e shtetasit V.C me tre vjet burgim”.

Vendimi i mësipërm është ankimuar nga Prokuroria e Apelit Shkodër. Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

iii. Në dosjen gjyqësore gjendet:

- Aktekspertimi mjeko-ligjor nr. **, datë 6.6.2003, nga ku rezulton se te viktima ka dy plagë të shkaktuara me armë zjarri.
- Aktekspertimi nr. ***, datë 12.8.2003, sipas të cilit fishekët e gjetur në vendngjarje nuk janë qitur nga arma tip TT, mod **, kal 7.62 mm, e cila i është sekuestruar z. V.C.
- Procesverbal për deklarinim e personit që tregon rrethanat e hetimit datë 12.8.2003, në të cilin shtetasi M.K ka deklaruar: “...V ka dalë nga dera e para e pasagjerit me pistoletë në dorë dhe ka qëlluar mbi V, kam parë që edhe V ka qëlluar me pistoletë ndaj V...”.
- Procesverbal për deklarinim e personit që tregon rrethanat e hetimit datë 7.6.2003, në të cilin shtetasi M.K ka deklaruar se: “... pasi i kaluam pallatet na del përpara një makinë tip ‘Benz ***’, me ngjyrë të bardhë, në të cilën ndodheshin dy persona, sapo po ndërroheshim me veturën tip ‘Benz’ në drejtimin tonë qëlluan me armë, personi që qëlloi me armë zbriti nga makina dhe qëlloi në drejtimin tonë dhe hipi përsëri në makinë dhe u largua në drejtim të urës së Th... personi që qëlloi në drejtimin tonë ishte afërsisht 1.70 m i gjatë, i shëndoshë, kishte një kapele në kokë dhe flokët i kishte në ngjyrë të zezë, kishte veshur një kostum sportiv”.

Ky shtetas, ndërkohë, ka ndryshuar deklaram përpara gjykatës kur është kërkuar sigurimi i provës duke u dënuar më pas me vendimin nr. ***, datë 29.9.2003, për veprën penale “dëshmi e rreme”, dhënë para gjykatës.

- Procesverbal për deklaramin e personit që tregon rrethanat e hetimit datë 7.6.2003, në të cilin shtetasi A.A ka deklaruar: “...dëgjoj disa krisma dhe pashë një person që ra në tokë dhe një makinë ‘Benz’ i bardhë u largua në drejtim të urës së Th, personi që ndodhej në sedilien e pasme të veturës ishte me flokë të shkurtra me ngjyrë të zezë... kam parë që në momentin që është qëlluar në drejtim të V prapa tij ndodhej një person me motor papaq”.
- Procesverbal për deklaramin e personit që tregon rrethanat e hetimit datë 13.6.2003, në të cilin shtetasi K.D deklaroi se: “...nga dita e shtunë ne si familje nuk jemi interesuar se kush na ka vrarë djalin tonë, duke menduar se dikush, sipas zakonisht, do të na çonin ndonjë fjalë përpara varrimit... Pikërisht ditën e diel në shtëpi të V (viktimit) kanë ardhur tre persona ..., sipas zakonisht M.N na ka thënë: ‘Burra, kam një fjalë për t’ju thënë – kemi ardhur në emër të N.P.C për t’ju thënë – djalin tuaj ia kemi vrarë ne ... mos kërkonit tjetërkund...”.

iv. Gjykata, në vendim, argumenton: “I pandehuri, i cili është përkulur për t’u mbrojtur poshtë kroskoti të makinës, kur kupton se V nuk kishte më fishekë, kundërvepron nga vetura duke qëlluar në drejtim të V me armën e tij të brezit pistoletë, të cilën e kishte si armatim personal pasi ishte polic dhe nga ky kundërveprim V merr një goditje në gjoks ...

Në të tilla rrethana, gjykata çmon se i pandehuri V.C është përgjegjës për veprën penale ‘vrasje në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme’, të parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal, pasi ishte nën kërcënimin e një sulmi të drejtpërdrejt të rrezikshëm për jetën, por i është kundërpërgjigjur këtij sulmi kur ky ishte ndërprerë dhe nuk kishte intensitet.

Gjykata çmon se i pandehuri V.C është i pafajshëm për veprën penale ‘armëmbajtje pa leje’, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal. Nga provat e marra e të administruara rezulton e provuar se i pandehuri është kundërpërgjigjur me armë, por nuk provohet se i pandehuri ka pasur armë tjetër ...”.

76.2. Komisioni, pasi analizoi fashikullin gjyqësor, si dhe vendimin e gjykatës, konstaton se:

- i. Gjykata është kontradiktore në argumentimin e saj, pasi fillimisht deklaroi se i pandehuri ka përdorur armën e brezit (duke mos marrë në konsideratë aktekspertimin, sipas të cilit gëzhhojat e gjetura në vendngjarje nuk i përkisnin armës së brezit të pandehurit) dhe më pas deklaroi se nga provat e marra nuk provohet se i pandehuri të ketë pasur armë tjetër.
- ii. Në pjesën arsyetuese të vendimit mungon argumentimi i konkluzionit se veprimet e të pandehurit plotësojnë elementet e veprës penale “kapërcim i mbrojtjes së nevojshme”, si dhe analizimi i këtyre elementeve qoftë edhe në formë të shkurtuar. Gjykata nuk analizoi faktin se nga ana e të pandehurit, pa qenë në kushtet e një sulmi të drejtpërdrejt të çastit është përdorur armë zjarri duke qëlluar mbi viktimën.
- iii. Gjithashtu mungon argumentimi i konkluzionit se veprimet e të pandehurit nuk plotësojnë elementet e veprës penale “armëmbajtje pa leje”, si dhe analizimi i këtyre elementeve qoftë edhe në formë të shkurtuar. Gjykata nuk analizoi faktin se i pandehuri, pa qenë në detyrë, ka përdorur armë, qoftë kjo armë edhe me leje për shkak të detyrës.

Për sa më sipër, duket se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është i argumentuar, për rrjedhojë ngrihen dyshime për favorizimin e të pandehurit V.C.

76.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹¹⁴, ka shpjeguar se: *“Gjetjet dhe konkluzionet, për të cilat Komisioni më ngarkon barrë prove, nuk kanë lidhje me mua. Kjo pasi sikurse rezultoi nga dokumentacioni provues që do ju dërgoj dhe, konkretisht, nga nënshkrimi im në vendimin origjinal, si dhe nga procesverbali i mendimit në pakicë (mbi 20 faqe). Unë kam votuar për dënimin e këtij të pandehuri me 20 vjet burgim sipas akuzës së prokurorit”*.

76.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se referimi i subjektit tek një subjekt tjetër, që ka qenë anëtar i trupit gjykues në çështjen e të pandehurit V. C, nuk qëndron, sepse në atë rast vendimi i Komisionit është bazuar në dy komponentë dhe jo me tre sikundër subjekti.

76.5. Në lidhje me pretendimin se subjekti ka qenë në pakicë, Komisioni vlerëson se:

i) Në vendimin origjinal¹¹⁵ subjekti nuk ka nënshkruar kundër. Gjithashtu, edhe në procesverbalin e seancës së datës 24.1.2005¹¹⁶ nuk gjendet ndonjë deklaram i subjektit që ka votuar kundër. Ky procesverbal është hartuar nga vetë subjekti.

ii) Është e vërtetë që në fashikullin gjyqësor gjendet një zarf i shoqëruar me një fletë me numërtim 254, e cila nuk gjen pasqyrim në listën e dokumenteve që përmban dosja në faqen 2 të fashikullit. Në këtë zarf gjendet një dokument me emërtim procesverbal i mbetjes në pakicë, i cili nuk ka as vulën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas së cilës subjekti ka dalë në mendim pakice.

iii) Në këtë procesverbal, vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka një shënim ku thuhet se ai u nënshkrua nga të tre anëtarët e trupës gjykuese, në përputhje me disponimet e parashikuara nga neni 112/5 i Kodit të Procedurës Penale. Kopja origjinale me tre nënshkrimet e anëtarëve të trupit gjykues u depozitua e futur në zarf në k/sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndërsa një kopje që mban vetëm nënshkrimin e gjyqtarit të mbetur në pakicë u përfshi në fashikullin gjyqësor.

iv) Subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas së cilës i vihet në dispozicion mendimi i pakicës për këtë çështje gjyqësore. Nga ana e kësaj gjykate është vendosur procesverbali i firmosur nga të tre anëtarët e trupës gjykuese, si dhe procesverbali i firmosur nga vetë subjekti. Kjo procedurë është në përputhje me kërkesat e nenit 112/5 të Kodit të Procedurës Penale.

77. Në lidhje me çështjet gjyqësore të gjykuara nga subjekti me palë D.R të S.Sh Shkodër

Komisioni, bazuar në informacionet e administruara nga organet ligjzbatuese, ka administruar të gjitha vendimet gjyqësore ndër vite të subjektit me palë Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka gjykuar me vendim përfundimtar 918 çështje me palë DRSSH-në Shkodër, për periudhën 2003 – 2015, nga të cilat ka rrëzuar vetëm 49 padi të palës paditëse ose vetëm 5% të padive.

77.1. Në lidhje me këto vendime¹¹⁷ Komisioni ka konstatuar se nga ana e subjektit, në vazhdimësi, janë gjykuar çështje brenda 1 dite pune:

¹¹⁴ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

¹¹⁵ Shihni fashikullin gjyqësor të administruar gjatë hetimit numërtimet 249-253 dhe 256-259.

¹¹⁶ Shihni f. 246-249 të fashikullit gjyqësor.

¹¹⁷ Shihni Aneksin 1 të rezultateve të hetimit.

- Çështja rezulton e regjistruar ditën e premte dhe të hënën subjekti ka gjykuar çështjen, duke marrë edhe vendimin përfundimtar.
- Ditën e regjistrimit të çështjes subjekti ka gjykuar duke marrë edhe vendimin përfundimtar.
- Subjekti gjykon çështjen duke marrë edhe vendimin përfundimtar ditën pasardhëse të regjistrimit.
- Në disa raste çështja rezulton e regjistruar ditën e shtunë.

77.2. Në përfundim të hetimit administrativ, duke marrë në konsideratë edhe informacionin e organeve ligjzbatuese, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës si vijon:

- i. Subjekti nuk ka respektuar parashikimet ligjore të parashikuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile në lidhje me afatin për caktimin e seancës, duke cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt.
- ii. Nga ana e subjektit janë favorizuar palët paditëse në gjykimin e këtyre çështjeve, pasi: (a) njoftimi i palëve nga ana e gjykatës është i pamundur të kryhet, për sa kohë afati për njoftim nuk është asnjë ditë pune; (b) është e paqartë se si subjekti ka studiuar dosjen, ka marrë vendim, si dhe ka zhvilluar gjykime të tjera brenda së njëjtës ditës; (c) afati i gjykimit për çështje të ngjashme nga subjekti është 20 ditë - 5 muaj.

77.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹¹⁸ ka shpjeguar se pretendon se për sa kohë ka të bëjë me vendime të formës së prerë, ato nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit, bazuar në jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese.

Subjekti ka analizuar disa prej vendimeve duke depozituar edhe dosjet përkatëse. Subjekti pretendon se data e regjistrimit në vendim nuk lidhet me datën e depozitimit të kërkesëpadisë, si dhe me shortimin e çështjen. Ai vijon shpjegimet e tij duke deklaruar se regjistrimi i çështjes nga sekretaria gjyqësore bëhej më vonë se shortimi i dosjeve duke u bazuar edhe në dosje konkrete, të cilat i citon në prapësime. Në lidhje me njoftimin e palëve ai pretendon se parregullsitë nuk mund të cenojnë procesin, për sa kohë palët janë paraqitur në gjykim.

77.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se pretendimi se vendimet e tij kanë marrë formë të prerë dhe nuk mund të shërbejnë si shkak për shkarkimin e tij, nuk qëndron, pasi në rastin e procesit të rivlerësimit bëhet një vlerësim i aftësive profesionale të subjektit sipas kriterëve të parashikuara në nenet 71-76 të ligjit nr. 96/2016. Në asnjë rast, Komisioni nuk vlerëson themelin e çështjes, si dhe nuk i ka ngarkuar barrë prove subjektit në lidhje me këtë themel.

77.5. Nga verifikimi i fashikujve të depozituar nga subjekti konstatohet se:

- i. Në lidhje me fashikullin gjyqësor që i përket vendimit nr. ***, viti 2009, konstatohet se mungon njoftimi i palës paditëse dhe të paditur në dosje. Pala e paditur DRSSH Shkodër, përfaqësuar nga znj. A.T, shprehet se është dakord me pranimin e padisë. Subjekti nuk ka respektuar afatin e parashikuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile. Në të vetmen seancë subjekti ka thirrur dy dëshmitare, të cilat janë paraqitur në gjykatë dhe pas dëgjimit të tyre është vendosur pranimi i padisë. Komisioni, në lidhje me veprimet procedurale të subjektit në këtë seancë, nuk mund të shprehet, pasi nuk i ka kaluar barrë prove. Në lidhje me këtë vendim Komisioni konstaton se njoftimi i palëve nuk është

¹¹⁸ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

kryer, nuk është respektuar neni 155 i Kodit të Procedurës Civile, si dhe subjekti e ka përfunduar çështjen brenda një dite pune.

- ii. Në lidhje me fashikullin gjyqësor që i përket vendimit nr. ***, viti 2009, konstatohet se mungon njoftimi i palës paditëse në dosje. Çështja është shortuar në datën 30.4.2009. Pala e paditur DRSSH Shkodër, përfaqësuar nga znj. A.T, shprehet se është dakord me pranimin e padisë. Subjekti nuk ka respektuar afatin e parashikuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile. Subjekti, pas përfundimit të seancës përgatitore, në të njëjtën ditë ka caktuar seancën gjyqësore. Komisioni, në lidhje me veprimet procedurale të subjektit në këtë seancë nuk mund të shprehet, pasi nuk i ka kaluar barrë provës. Në lidhje me këtë vendim Komisioni konstaton se njoftimi i palës paditëse nuk është kryer, nuk është respektuar neni 155 i Kodit të Procedurës Civile, si dhe subjekti e ka përfunduar çështjen brenda një dite pune.
- iii. Në lidhje me fashikullin gjyqësor që i përket vendimit nr. ***, viti 2006, konstatohet se mungon njoftimi i palëve në dosje përfshirë dhe ai i avokaturës së shtetit, i cili gjendej në dy dosjet e mësipërme. Kërkesëpadia është depozituar në datën 5.7.2006. Në dosje nuk gjendet vendimi për caktimin e seancës. Pala e paditur DRSSH Shkodër, përfaqësuar nga znj. S.D, shprehet se është dakord me pranimin e padisë. Subjekti nuk ka respektuar afatin e parashikuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile. Në të vetmen seancë subjekti ka thirrur dy dëshmitare, të cilat janë paraqitur në gjykatë dhe pas dëgjimit të tyre është vendosur pranimi i padisë. Komisioni në lidhje me veprimet procedurale të subjektit në këtë seancë nuk mund të shprehet, pasi nuk i ka kaluar barrë provës. Në lidhje me këtë vendim Komisioni konstaton se njoftimi i palës paditëse nuk është kryer, nuk është respektuar neni 155 i Kodit të Procedurës Civile, si dhe subjekti e ka përfunduar çështjen brenda një dite pune.

77.6. Komisioni, pasi analizoi dosjet e vendimeve të mësipërme, por edhe të vendimeve të tjera të depozituara nga subjekti konstaton se çështjet gjyqësore nuk janë regjistruar në datën e regjistrimit të cituar në vendim, por në një datë më të hershme duke u provuar në këtë mënyrë që subjekti nuk i ka kryer procedurat brenda një dite pune. Në lidhje me pjesën tjetër të barrës së provës ajo qëndron, pasi në këto dosje në të gjitha rastet nuk është administruar njoftimi i palëve gjyqësore ose njoftimi i palës paditëse. Afatet e parashikuara nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile nuk janë respektuar. Këto veprime të subjektit do të jenë pjesë e vlerësimit etik dhe profesional të tij.

77.7. Për sa i përket aspektit të kontrollit të figurës, duke marrë në konsideratë informacionin e organeve ligjzbatuese¹¹⁹, vendimmarrjen e subjektit brenda një seance gjyqësore, faktin që edhe vetë përfaqësuesja e palës së paditur DRSSH Shkodër bie dakord me padinë, mungesën e njoftimit të palëve, ngrihen dyshime për favorizimin e palës paditëse.

77.8. Në përfundim të hetimit në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në analizimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, si dhe duke marrë në konsideratë informacionet e organeve ligjzbatuese, subjektit iu kalua barra e provës me dyshimet se ka favorizuar palë në gjykim, si dhe në disa raste ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit duke cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

77.9. Subjekti ka prapësuar¹²⁰ duke iu referuar vendimeve të subjekteve të tjera. Në lidhje me këtë, Komisioni e ka shprehur qëndrimin e tij edhe më lart.

¹¹⁹ Për më shumë shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

¹²⁰ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

77.10. Subjekti i ka paraqitur edhe një kërkesë Komisionit për të thirrur si dëshmitarë të gjithë palët paditëse në gjykimet e tij me DRSSH Shkodër. Në lidhje me këtë kërkesë Komisioni vendosi të mos e pranojë, bazuar në nenin 49/6, geramat “a”, “b”, “ç” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, pasi ajo vlerësohet e panevojshme, si dhe kjo kërkesë është bërë me qëllim zvarritjen e gjykimit, për sa kohë subjekti nuk ka vendosur një listë shteruese të dëshmitarëve, që kërkon të thirren, por dhe përpiqet të provojë me dëshmitarë fakte që rezultojnë të provuara gjatë gjykimit. Për pasojë, Komisioni çmon se subjekti nuk arriti të përmbysë barrën e provës.

Konkluzioni përfundimtar i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

78. Në përfundim të hetimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar nga hetimi, të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, në përgjigje të barrës së provës, si dhe në seancë dëgjimore, trupi gjykues çmon se konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës nuk lidhet me saktësinë dhe vërtetësinë e plotësisht të deklaratës së figurës, pasi nga rrethanat e konstatuara nga Grupi i Punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të ketë bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

78.1. Konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmëri të subjektit lidhet me dyshimet për favorizim të palëve në gjykim, që duket se përputhet me rezultatet e hetimit nga analizimi i dosjeve gjyqësore nga Komisioni.

78.2. Duke qenë se ky rezultat nuk përmbush kushtet e nenit 61, pikat 2 dhe/ose 3 të ligjit nr. 84/2016, këto konstatime do të vlerësohen në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit¹²¹.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura në Komision.

Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

79. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

79.1. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

79.2. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; si dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

¹²¹ Shihni vendimet nr. 26/2019, nr. 1/2020, nr. 20/2020, nr. 26/2020 dhe nr. 25/2022.

80. Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti nuk u konstatuan problematika.

Nga analizimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short u konstatuan gjetjet e mëposhtme:

81. Dosja nr. 1 – çështja civile nr. *** regj., them., datë 7.5.2014 regjistrimi, që i përket paditësve K. K. dhe A. K., të paditur M. G., person i tretë “N” sh.p.k., ZVRPP Shkodër dhe Bashkia Shkodër, me objekt “njohje bashkëpronar në sipërfaqe trualli 302 m²”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 6.10.2014.

81.1. Çështja gjyqësore është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 7.5.2014 dhe me shortin e datës 8.5.2014 aktet i janë kaluar subjekti. Me vendimin e datës 14.5.2015 (pas 6 ditësh) subjekti ka caktuar seancën përgatitore në datën 28.5.2014, ora 15:00, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Nxjerrja e vendimit, data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatin 10-ditor të përcaktuar në nenin 155 të Kodit të Procedurës Civile.

Në përfundim të gjykimit subjekti ka vendosur rrëzimin e padisë.

Kundër vendimit ka ushtruar ankim pala paditëse dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 5.11.2015, ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, por me tjetër trup gjykues.

81.2. Në lidhje me këtë dosje subjektit iu kalua barra e provës si vijon:

- i. Në dy raste seancat janë shtyrë për shkak të mospagesës së ekspertit, gjykata nuk duhej të shtynte seancën, por të urdhëronte nxjerrjen e detyrueshme të shpenzimeve për ekspertët me anë të përmbauesit gjyqësor, sipas nenit 105 të Kodit të Procedurës Civile.
- ii. Duket se subjekti nuk ka formuar drejt ndërgjyqësinë duke mos vepruar në përputhje me nenin 193 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe duke cenuar të drejtën e pronarëve të tjerë të sendit objekt gjykimi për t’u mbrojtur.
- iii. Seancat gjyqësore nuk janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe nuk janë dokumentuar me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe të solemnitetit.

81.3. Për të përmbysur barrën e provës, në mënyrë të përmbledhur¹²², subjekti ka deklaruar se: *“I lutem Komisionit që, në lidhje me këtë dosje gjyqësore, përpara se të arrijë në konkluzione lidhur me profesionalizmin tim, të ketë në konsideratë, përveç praktikës së Gjykatës së Lartë, edhe tri rrethana të tjera që janë si më poshtë. Në kohën e gjykimit të çështjes objekt analize, ende nuk kishin hyrë në fuqi dispozitat e ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017, për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile. Për rrjedhojë, unë si gjyqtar, në atë kohë, nuk kam pasur asnjë mundësi juridike për të vepruar përmes urdhërimit të paditësit për të rregulluar ndërgjyqësinë pasive të detyrueshme (edhe nëse pranohet se kjo ndërgjyqësi pasive ka qenë e detyrueshme, sikurse shprehet Gjykata e Apelit). Neni 161, germa ‘ç’ e Kodit të Procedurës Civile, që i mundëson gjyqtarit të urdhërojë paditësin të rregullojë ndërgjyqësinë pasive, nuk ka qenë i shtuar në vitin 2014, kur është zhvilluar gjykimi, por është shtuar vetëm në vitin 2017. Sipas vlerësimit tim, në atë kohë, ‘e drejta e përcaktimit të ndërgjyqësisë pasive, pra përcaktimi se kush është/duhet të jetë i paditur’, në mungesë të një autorizimi ligjor të kundërt përfshihej në ‘të drejtën e disponibilitetit të paditësit’. Kjo e drejtë disponibiliteti, përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, sipas praktikës së unifikuar me vendimet nr. 9/2006, nr. 3/2012 dhe nr. 5/2012 të KBGJL-së, ka pasur karakter ‘ekskluziv dhe absolut’, vetëm në dobi të paditësit, ndryshe nga aktualisht (pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017), që prapë kjo e drejtë disponibiliteti ka karakter ‘ekskluziv’, por jo ‘absolut’, pasi*

¹²² Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

Gjykatës i është njohur përmes nenit 161, germa 'ç' të Kodit të Procedurës Civile, mundësia, pra e drejta që të urdhërojë paditësin që të rregullojë ndërgjyqësinë e paditur, kur Gjykata vlerëson se ka të bëjë më ndërgjyqësi pasive të detyrueshme...

I lutem Komisionit që në vlerësimin e performancës sime në gjykimin e çështjes, të ketë paraprakisht parasysh edhe standardin detyrues të Kolegjit, të përcaktuar me vendimin nr. 28/2020(JR), të marrë për subjektin e rivlerësimit F.V...

Në vlerësimin tim, neni 105 i Kodit të Procedurës Civile dhe mënyra e veprimit që e quan të saktë Komisioni, duhen aplikuar vetëm në rrethanat e 'ultima ratio', pra si mjeti i fundit. Kjo pasi vlerësoj se një nga parimet se si matet efienca e veprimtarisë gjyqësore është 'aftësia e gjyqtarit për të zbatuar atë mjet procedural që garanton zgjidhjen e situatës, pa kompromentuar dëmtimin e standardeve të tjera të së drejtës së palëve për një proces të rregullt ligjor, sikurse është p.sh., kohëzgjatja e arsyeshme e gjykimit, moslejimi i zvarritjeve, etj.'".

Përveç kësaj, nëse nuk do ta konsideroja vetëm 'si mjet të fundit' mënyrën e veprimit që sugjeron Komisioni, qartësisht do të ndikoja negativisht në diligençën/zellin e ekspertit/ekspertëve për të ndihmuar Gjykatën përmes këshillave të tyre shkencore në zgjidhjen e çështjeve. Kjo pasi ekspertët janë të gatshëm që të paraqiten në gjykime se kanë perceptimin e garancisë nga Gjykata që do të paguhen sipas ligjit për punën e tyre dhe kjo garanci, në perceptimin e ekspertëve, nuk është e barasvlefshme me dokumentin që mund t'i japë Gjykata sipas nenit 105 të Kodit të Procedurës Civile, mbi bazën e të cilit ato mund t'i drejtohen shërbimit përmbarimor.

Mbi 85% e seancave janë regjistruar audio nga viti 2015, kur është instaluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe deri më sot. Edhe ato pak seanca që nuk janë regjistruar audio nuk janë për fajin tim, por për shkaqe të ndryshme dhe të ditura, që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësinë time.

Ndër këto shkaqe mund të përmend numrin e kufizuar të sallave të gjykimit për numër gjyqtarësh, gabimet në vitin 2014/2015 të sekretarisë në përdorimin e sistemit RDA, (pasi nuk e kishin përvetësuar si duhet dijeninë se si përdorej ky sistem regjistrimi, mungesat e energjisë elektrike, etj.)".

81.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

i) Në lidhje me referencën e subjektit në vendimin nr. 28/2020, të Kolegjit, Komisioni e ka trajtuar në detaje më lart qëndrimin e tij në lidhje me këtë vendim.

ii) Në lidhje me rregullimin e ndërgjyqësisë, Komisioni nuk i konsideron shpjegimet e subjektit bindëse dhe në përputhje me nenin 193 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë dhe për këtë qëllim shtyn seancën gjyqësore.

iii) Në rastin konkret subjekti duhet të thërriste si palë ndërgjyqëse edhe trashëgimtarët e tjerë ligjorë të pasurisë së paluajtshme.

iv) Në lidhje me pretendimet e subjektit sa i përket seancave gjyqësore joproductive, Komisioni vlerëson se është detyrë e gjyqtarit që të marrë masat e duhura për zhvillimin e një procesi gjyqësor në kohë. Në nenin 105 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se kur një palë është e detyruar që të paguajë shpenzimet gjyqësore dhe nuk i paguan vullnetarisht, gjykata urdhëron me vendim nxjerrjen e tyre të detyrueshme.

v) Për sa i përket zhvillimit të seancave pa audio shpjegimet e subjektit janë bindëse.

81.5. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se veprimet e subjektit afektojnë kriterin e vlerësimit të përcaktuar në nenin 74, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, për sa i përket seancave produktive dhe në nenin 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për sa i përket rregullimit të ndërgjyqësisë.

82. Dosja nr. 2 – çështja penale nr. *** regj., them., datë 28.1.2015 regjistrimi, kundër të pandehurit A. K., akuzuar për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. **, datë 30.1.2015.

82.1. Çështja është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 27.1.2015 nga prokurori për *vleftësim të arrestit në flagrancë dhe gjykim të drejtpërdrejtë*. Me shortin elektronik të datës 27.1.2015, çështja i është caktuar subjektit, i cili me vendimin e datës 27.1.2015 (brenda ditës) ka caktuar seancën gjyqësore për vleftësim arresti në flagrancë dhe gjykim të drejtpërdrejtë në datën 28.1.2015, ora 10:30, duke urdhëruar njoftimin e prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit (palët në këtë rast i njofton prokurori). Nxjerrja e vendimit, data e caktuar e seancës, si dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet dhe procedurën e shpejtë të gjykimit, të përcaktuar në nenet 259 dhe 400/3 të Kodit të Procedurës Penale mbi vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe gjykimin e drejtpërdrejtë.

Gjykata, në përfundim të gjykimit, ka vendosur deklarinimin fajtor të pandehurit A. K., të akuzuar për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike”, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal dhe bazuar edhe në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimtar me 14 ditë burgim.

Kundër vendimit nuk është ushtruar ankim nga palët.

82.2. KLGJ-ja ka konstatuar se:

- i. Dënimi penal është instituti më i rëndësishëm i të drejtës penale, i cili caktohet në bazë të parimeve të përgjithshme dhe të veçanta të Kodit Penal (parimi i ligjshmërisë, i individualizimit të dënimit, i dobishmërisë apo domosdoshmërisë dhe parimi i proporcionalitetit të dënimit). Dënimi ka qëllim riedukimin e fajtorit dhe në aspektin e gjerë respektimin e ligjit për parandalimin e kryerjes së veprave penale nga shtetasit. Mënyra e caktimit të dënimit bazohet në nenet 47 - 50 të Kodit Penal, duke u përcaktuar nga: rrezikshmëria shoqërore e veprës penale; rrezikshmëria shoqërore e autorit të saj, shkalla e fajit, rrethanat e kryerjes së veprës penale; rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rënduese. Masa dhe lloji i dënimit caktohet duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në dispozitën e pjesës së posaçme të Kodit Penal. Neni 137/1 i Kodit Penal ka parashikuar: *“Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike, dëmtimi i matësit, si dhe çdo ndërhyrje tjetër e paligjshme dhe e paautorizuar në sistemin e matjes apo në rrjetin telefonik e kryer me qëllim përfitimi të paligjshëm përbën veprë penale dhe dënohet me burgim deri në 3 vjet”*. Masa e dënimit e caktuar nga gjykata me 14 ditë burgim me anë të procedurës së gjykimit të shkurtuar është në kufijtë minimalë që parashikon dispozita e Kodit Penal, ose rreth 1.3 % e masës së dënimit maksimal. Në rastin konkret, në funksion të një politike penale vihet re se vepra penale është shumë e përhapur, i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore, ai i ka kryer veprimet e kundërligjshme penale pas një mase administrative të dhënë më parë ndaj tij.

Kjo masë dënimi nuk është në proporcion mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik apo dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar, si dhe synimit që kërkon të arrijë dënimi penal. Në caktimin e dënimit janë përcaktuara ana objektive dhe subjektive e figurës së veprës penale. Ana objektive vlerësohet nga veprimi i kundërligjshëm me mjetet dhe format e përdorura në raport me gjendjen që e ka diktuar atë dhe pasojën e ardhur. Ana subjektive vlerësohet nga shkalla e fajit sipas neneve 14 dhe 15 të Kodit Penal. Në rastin konkret, i pandehuri ka vepruar me dashje direkte, megjithëse ka qenë i ndëshkuar më parë me masë administrative (ndërprerje të energjisë elektrike), e cila është shkallë

më e rëndë e fajit, me motiv interesi dhe qëllim nxjerrjen e përfitimit material. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën. Gjykata ka çmuar si rrethana lehtësuese të përgjithshme, sipas nenit 49 të Kodit Penal, qenien k/familjar, pendimin e thellë me procedurën e gjykimit të shkurtuar, pranimin e akuzës, moshën etj., por të padetajuara. Në këtë kuptim, masa e dënimit të caktuar është dhënë në interpretim të gabuar të nenit 47 të Kodit Penal dhe, për rrjedhim, është cenuar parimi i proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i Kodit Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës (shihni edhe vendimet nr. 19/2011 dhe nr. 47/2012, të Gjykatës Kushtetuese).

Në bazë të nenit 72/4 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pa zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e gjyqtarit, ky vendim të merret në konsideratë për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

ii. Seanca gjyqësore është zhvilluar në sallë gjykimi dhe është dokumentuar me proces verbal pa regjistrim audio dhe nuk relatohet shkaku.

82.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹²³ ka shpjeguar se: *“Për sa i përket konstatimit të Komisionit se argumentimi/arsyetimi i dënimit me vetëm 14 ditë burg për veprën penale ‘vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike’, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, ‘është jo i detajuar, si dhe dënimi është joproporcional’, nuk jam dakord. Kjo pasi përmes këtij konstatimi, qartësisht Komisioni shprehet për meritën e çështjes, gjë që bie në kundërshtim me standardin detyrues të vendosur me vendimin nr. 28/2020(JR). As nga pikëpamja ligjore, as nga pikëpamja faktike, ndërprerja e energjisë elektrike nuk është dënim penal (pra, i pandehuri nuk konsiderohet recidivist), por as administrativ. Kjo pasi shoqëria tregtare që ka ndërprerë energjinë elektrike nuk konsiderohet sipas ligjit nr. 48/2015 apo ndonjë ligj tjetër, organ administrativ shtetëror. Ndërprerja e energjisë elektrike më parë është element i domosdoshëm i anës objektive të veprës penale, për të cilën është dënuar i pandehuri, jo rrethanë rënduese që ndikon në ashpërsinë e dënimit që duhet caktuar”.*

82.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se pretendimi i subjektit në lidhje me themelin e çështjes nuk qëndron dhe qëndrimi i Komisionit në lidhje me këtë pretendim është trajtuar gjerësisht më lart. Argumentet e subjektit në lidhje me barrën e provës nuk janë bindëse, por meqenëse ka të bëjë me masën e dënimit për të shmangur gjykimin e korrektësisë së vendimit të subjektit, vlerëson të mos e përfshijë këtë konstatim në vlerësimin profesional të subjektit.

83. Dosja nr. 3 – çështja civile nr. ** regj., them., datë 22.1.2015 regjistrimi, që i përket paditëses A. L. kundër të paditurit A. L., me objekt “zgjidhje martesë dhe të pasojave që rrjedhin prej saj”, e përfunduar me vendimin nr. ** (**), datë 20.2.2015.

83.1. Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 22.1.2015 dhe me shortin e datës 22.1.2015, i është caktuar subjektit. Me vendimin e datës 28.1.2015 (pas 6 ditësh), gjyqtari ka caktuar seancën përgatitore të pajtimit në datën 6.2.2015, ora 15:00.

Gjykata, në përfundim të gjykimit, ka vendosur: “Pranimin e padisë, duke zgjidhur martesën midis palëve ndërgjyqëse, pa përcaktuar fajësinë”. Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim.

83.2. Në lidhje me këtë dosje gjyqësore është konstatuar se:

¹²³ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

- i. Nxjerrja e vendimit nga subjekti, data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit nuk respektojnë afatin 10-ditor të përcaktuar në nenin 155 të Kodit të Procedurës Civile.
- ii. Seancat nuk janë zhvilluar me regjistrim audio dhe nuk relatohet shkaku në funksion të solemnitetit dhe transparencës së gjykimit.

83.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹²⁴ ka shpjeguar se:

“Afati ligjor që parashikon neni 155 i Kodit të Procedurës Civile, në thelbin e tij është afat në dobi të palës, pra nuk është afat i prerë. Palët, duke marrë pjesë në seancë, në mënyrë të nënkuptuar kanë dhënë pëlqimin për shkurtimin e këtij afati.

Mosregjistrimi audio i seancës nuk ka ardhur si rezultat i fajësisë sime, pasi sallat duhet të kenë qenë të zëna me gjykime që po zhvilloheshin nga gjyqtarë të tjerë. Megjithatë, e pranoj që duhet të isha më i kujdesshëm në kontrollimin e procesverbalit gjyqësor, duke shënuar në të se arsyen se përse gjykimi nuk është zhvilluar në sallë me regjistrim audio. Faktikisht kjo iu është thënë palëve, por nuk është shënuar në procesverbal nga sekretarja. Gjithsesi, ky gabim në mungesë të pasojës nuk ka fare ndikim në procesin tim të rivlerësimit”.

83.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe janë në nivel deklarativ. Subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit asnjë provë për të provuar deklaratimet e tij.

83.5. Për rrjedhojë, veprimet e subjektit afektojnë kriterin e vlerësimit të parashikuar nga neni 74, pikat 2, 3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016, pasi subjekti nuk ka respektuar afatin e parashikuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile, seancat nuk janë zhvilluar me regjistrim audio, si dhe nuk relatohet shkaku në funksion të solemnitetit dhe transparencës së gjykimit.

84. Dosja nr. 5 – çështja civile nr. ** regj., them., datë 27.5.2015 regjistrimi, që i përket paditëses H. D. kundër të paditurit Sh. R. etj., me objekt “njohje pronësie me parashkrim fitues mbi një shtëpi banimi”, e përfunduar me vendimin nr. **, datë 24.12.2015.

84.1. Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 27.5.2015 dhe me shortin e datës 29.5.2015 i është caktuar subjektit. Me vendimin e datës 1.6.2015 (pas 3 ditësh) gjyqtari ka caktuar seancën përgatitore në datën 29.6.2015, ora 13:00. Nxjerrja e vendimit nga gjyqtari, data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatin 10-ditor të përcaktuar në nenin 155 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata, në përfundim të gjykimit, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë. Seanca është mbyllur në orën 10:22. Procesverbali është nënshkruar nga sekretari gjyqësor dhe gjyqtari i çështjes.

Ndaj vendimit është ushtruar ankim nga pala paditëse dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. **, datë 11.12.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

84.2. Në lidhje me këtë dosje Komisioni ka konstatuar:

- i. Në 4 seanca joproductive ka qenë pengesë mungesa e konfirmimit të njoftimit për të paditurit, ku vihet re se ka munguar bashkëpunimi i gjykatës me administratën gjyqësore për njoftimin e tyre.
- ii. Në 1 rast duhet evidentuar fakti se seanca e parë gjyqësore është zhvilluar në mungesë të palës së paditur pa pasur njoftim, me arsyen se është deklaruar mungesa në seancë përgatitore, në kundërshtim me nenet 175 dhe 179 të Kodit të Procedurës Civile, pasi për

¹²⁴ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

seancën e parë gjyqësore palët duhet të rinjoftoheshin përsëri me anë të fletëthirrjeve apo shpalljes publike.

84.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹²⁵, ka shpjeguar se: *“Ftuesin e gjykatës dhe/apo shërbimin postar gjyqtari nuk e ka në varësi funksionale. Gjithashtu, besoj se Komisioni e di që sipas nenit 128 të Kodit të Procedurës Civile është detyrë funksionale e nëpunësit gjyqësor (ftuesit) të bëjë kërkim proaktiv për realizimin e njoftimit gjyqësor që i adresohet palës ndërgjyqëse. Megjithatë, duke iu referuar kohëzgjatjes tërësore të gjykimit, vlerësoj se qartësisht edhe nëse ky bashkëpunim i munguar, por i paargumentuar, merret padrejtësisht si e metë e imja, prapë se prapë, sipas parimit të proporcionalitetit, kjo nuk ka ndikim për qëllimet e procesit tim të rivlerësimit.*

Kam menduar dhe vazhdoj të mendoj që sjellja gjyqësore, përveçse është sjellje me natyrë procedurale, njëherazi është edhe veprim (ose mosveprim) juridik me pasoja materiale. Sipas nenit 80 të Kodit Civil ‘veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo shfaqje të padyshimtë të vullnetit’. Unë, në rastin objekt analize, kam vlerësuar se (mos)veprimi i palës së paditur për t’u paraqitur në seancën përgatitore, ndonëse ishte njoftuar rregullisht, përbënte shfaqje të padyshimtë të vullnetit të tij, me heshtje, që ai nuk dëshironte të merrte pjesë në gjykim. Edhe nëse do të konsiderohej se kam vepruar gabim, mungon pasoja e paligjshme. Pa pasojë, nuk ka dënim. Kjo pasi i padituri është paraqitur në vijim të gjykimit dhe madje ka dalë gjyqitues përmes vendimit gjyqësor përfundimtar të marrë nga unë si gjyqtar”.

84.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Në nenin 128 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se gjyqtari kujdeset dhe kontrollon procesin e njoftimit, që kryhet nga nëpunësit e administratës gjyqësore. Për rrjedhojë, nga ana e tij nuk është marrë asnjë masë për të shmangur shtyrjen e seancave gjyqësore, për shkak të mungesës së konfirmimit të njoftimit nga ana e palëve në gjykim. Për sa i përket mosnjoftimit të palës në gjykim, ky është një detyrim ligjor i parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile në nenet 175 dhe 179 të tij dhe nuk është në diskrecion të gjyqtarit të vlerësojë dhe të abstragojë në lidhje me vullnetin e palëve për sa i përket gjykimit, nëse ky vullnet nuk shfaqet me veprime ose mosveprime sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

84.5. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 dhe mangësi në drejtim të aftësive organizative, sipas përcaktimeve të nenit 73, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

DENONCIME

Komisioni ka administruar 26 denoncime nga publiku për subjektin e rivlerësimit Andri Ymeri. Subjektit iu kalua barra e provës për 10¹²⁶ prej tyre, si vijon:

85. Denoncim nr. * prot., datë 24.3.2021, i shtetases D.D**

85.1. Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. **, datë 12.1.2021, në kundërshtim me ligjin dhe me provat. Ai nuk ka njoftuar palën e paditur “A” sh.p.k., si dhe ka dhënë vendimin pa u shprehur më parë prokuroria për përfundimin e procedimit penal nr. ***/2019 lidhur me plagosjen në vendin e punës të paditësit E.M.

¹²⁵ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

¹²⁶ Në total, duke përfshirë edhe denoncimet e përsëritura, janë 16.

85.2. Komisioni ka administruar fashikullin e çështjes gjyqësore me paditës shtetasin E.M etj., me palë të paditur shoqërinë “A” sh.p.k. dhe objekt “detyrimin e palës së paditur t’u paguajë paditësve dëmshpërblimin për dëmin pasuror dhe jopasuror për aksidentin me plagosje në punë, në datën 5.3.2019”. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore rezultoi se paditësi E.M ka qenë i punësuar mbi bazën e kontratës individuale të punës në shoqërinë “A” sh.p.k. dhe gjatë marrëdhënies së punës ka pësuar aksident me pasojë plagosjen. Për këtë ngjarje ka filluar procedimi penal nr. *** në vitin 2019.

85.3. Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për mungesën e njoftimit nga gjykata/subjekti i rivlerësimit, në gjykimin në të cilin shoqëria “A” sh.p.k. kishte cilësinë e “të paditurit”, në përmbajtje të dosjes gjyqësore evidentohet:

- i) urdhër i datës 14.9.2020, “Për kryerjen e veprimeve procedurale lidhur me paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes dhe caktimin e seancës përgatitore”, dërguar të paditurit në adresën M, Shkodër, kthyer nga posta me shënimin “objekt i pakërkuar”;
- ii) urdhër i datës 5.10.2020, “Për kryerjen e veprimeve procedurale lidhur me paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes dhe caktimin e seancës përgatitore”, dërguar të paditurit në adresën lagjja “K”, Rruga Nationale Shkodër-Lezhë, kthyer nga posta me shënimin “larguar... subjekti është mbyllur”;
- iii) nga procesverbalet e seancave gjyqësore të datave 5.10.2020 dhe 23.10.2020 rezulton se pala e paditur nuk është paraqitur dhe subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri ka vijuar me njoftimin e tyre në adresën e përcaktuar në QKB;
- iv) shpallja e datës 23.10.2020, “Për paraqitje në seancë gjyqësore” – subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se gjykata e ka të pamundur të njoftojë të paditurin, pasi nuk ka një adresë të përcaktuar të vendbanimit të tij dhe në mbështetje të neneve 131, 132 e 133 të Kodit të Procedurës Civile ka vijuar me shpallje për njoftimin e seancës, duke e afishuar në ambientet e gjykatës, në bashki, pranë QKR-së, në adresën: lagjja “K”, Rruga Nationale Shkodër-Lezhë.

85.4. Subjekti i rivlerësimit ka vijuar me caktimin e ekspertëve dhe në datën 12.2.2021 ka vendosur pranimin e padisë. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur “A” sh.p.k., duke pretenduar se gjykata ka kryer njoftimin e të paditurit në një adresë në të cilën aktiviteti i saj është pezulluar, si dhe ka gjykuar çështjen pa prituri përfundimin e hetimeve të kryera nga prokuroria në lidhje me këtë ngjarje.

85.5. Subjekti ka administruar në dosjen gjyqësore disa akte të procedimit penal nr. **/2019, por nuk ka pezulluar gjykimin në përputhje me nenin 297/a të Kodit të Procedurës Civile, ndërkohë që gjatë shqyrtimit të çështjes Gjykata e Apelit kërkoi informacion nga prokuroria lidhur me fazën e hetimit të procedimit penal dhe në vijim pezulloi gjykimin deri në përfundimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***/2019.

85.6. Për sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për mosrespektim të parashikimeve ligjore të nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile, duke cenuar, për pasojë, të drejtat e palëve për një proces të rregullt.

85.7. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹²⁷, ka shpjeguar se për këtë ankesë ka hetuar mbi të njëjtat pretendime edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Me vendimin nr. ***, datë 30.7.2021, të ILD-së, kjo ankesë është hedhur poshtë si e pabazuar, duke mos i konsideruar faktet e ekspozuara përmes saj as të mjaftueshme për të hapur një hetim disiplinor. Subjekti ka pretenduar se Komisioni e ka trajtuar themelin e çështjes duke rënë ndesh me nenin 3 të ligjit nr. 96/2016, si dhe me vendimin nr. 28/2020 të Kolegjit. Subjekti ka

¹²⁷ Për më shumë referohuni prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

pretenduar se interpretimi që i bën Komisioni përmbajtjes së nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile është jo i drejtë.

Sipas subjektit: *“Me interpretim gjuhësor vihet re qartësisht se në shkronjën ‘a’ të nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile përdoret folja ‘mund’.* Kjo folje nënkupton diskrecionalitet, liri zgjedhjeje të gjykatës, hapësirë vlerësimi nga ana e saj, të karakterit të çështjes, në mënyrë që të vendosë nëse duhet apo jo të bëhet pezullimi i gjykimit. Duke pasur këtë natyrë diskreciale, hapësira e vlerësimit të gjykatës, nëse çështja duhet apo jo të pezullohet derisa të zgjidhet çështja penale, është çështje e bindjes së brendshme të gjyqtarit, të cilën ai e krijon nga vlerësimi i rrethanave të çështjes...

Në vlerësimin tim, ushtrimi i diskrecionalitetit gjyqësor për të vendosur se duhet të pezullohet gjykimi i një çështjeje civile derisa të zgjidhet një çështje penale duhet të përbëjë jo rregull, por përjashtim nga rregulli. Në rastin konkret, unë kam vlerësuar dhe vlerësoj se nuk është cenuar nga zgjidhja që unë i kam dhënë çështjes parimi i sigurisë juridike. Këtë bindje e kam pasur dhe e kam edhe duke pasur parasysh nenin 70 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon se: ‘1. Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm për sa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari. 2. Vendimi penal që zgjidh rastësisht një fakt që lidhet me një çështje civile, administrative ose penale nuk ka efekt detyrues në asnjë proces tjetër’. Në rastin objekt gjykimi, paditësit nuk kanë pretenduar shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor nga pala e paditur, mbi shkakun se pala e paditur ka kryer veprën penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë, por mbi shkakun se sjellja e palës së paditur që ka dëmtuar punëmarrësin e saj bie në kundërshtim me Kodin e Punës (pavarësisht se mund të përbëjë ose mund të mos përbëjë vepër penale). Në kushtet kur pala e paditur nuk u paraqit fare në gjykim, qartësisht nuk duhej pezulluar gjykimi, për sa kohë kjo palë nuk e përmbushi barrën e provës që i ngarkon ligji. Aq më pak mund të pezullohej gjykimi kur pala nuk e ka kërkuar atë përpara gjykatës”.

85.8. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë dhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se fakti që kjo çështje është trajtuar nga ILD-ja nuk e përjashton mundësinë e Komisionit për vlerësimin e saj, pasi kompetencat e dy institucioneve nuk janë të njëjta. Për më tepër ILD-ja, në vendimin e saj nr. ***, datë 30.7.2021, shprehet se kjo ankesë mund të jetë objekt i shqyrtimit të mëtejshëm pas përfundimit të gjykimit¹²⁸, nëse konstatohen nga kontrolli gjyqësor shkelje të ligjit procedural apo material.

85.9. Në lidhje me pretendimet e subjektit se Komisioni ka shqyrtuar meritën e çështjes, pretendime të cilat nuk qëndrojnë, pasi subjektit nuk i ka kaluar barrë prove për vendimmarrjen, por vetëm për faktin e mospezullimit të procesit gjyqësor, për sa kohë në këtë vendim gjykata referohet në provat e fashikullit penal¹²⁹. Pra, vetë subjekti referon në një procedim penal, ndërkohë pretendon se ky procedim penal nuk kishte lidhje me çështjen që po shqyrtohej nga ana e tij.

85.10. Në lidhje me pretendimin e subjektit se në nenin 299 të Kodit të Procedurës Civile (subjekti ka bërë lapsus kur i është referuar nenit 299, pasi është neni 297 i Kodit të Procedurës Civile), folja “mund” nënkupton diskrecionalitet, liri zgjedhjeje të gjykatës, hapësirë vlerësimi nga ana e saj, Komisioni çmon se edhe ky pretendim i tij nuk qëndron, pasi në këtë nen folja “mund” shoqërohet me pjesëzën mohuese “nuk”, e cila përdoret për të mohuar plotësisht kuptimin e shprehur nga një folje.

¹²⁸ Shihni f. 3 të vendimit nr. 1812/3, paragrafi i fundit.

¹²⁹ Shihni f. 2 të vendimit, ku, ndër të tjera subjekti shprehet: *“...nga deklaratimet dhe hetimi i bërë nga ana e prokurorisë rezulton se...”*.

85.11. Për sa i përket mosparaqitjes së kërkesës nga ana e palës së paditur, ky pretendim i subjektit qëndron, por ndërkohë kjo nuk e përjashton nga përgjegjësia subjektin për të vlerësuar nëse ishin kushtet për pezullimin e çështjes apo jo, për sa kohë nga ana e tij ishte në dijeni të faktit që kishte një procedim penal dhe akte të këtij procedimi i përmend si prova në këtë çështje gjyqësore.

85.12. Në përfundim, Komisioni vlerëson se, për sa kohë subjekti ka përdorur akte të fashikullit penal në procesin e tij civil, si dhe ka konkluduar se kemi të bëjmë me shkelje të rregullave të sigurimit në punë¹³⁰, ai nuk mund të vijonte gjykimin e kësaj çështjeje derisa të përfundonte procedimi penal. Këto veprime të subjektit tregojnë mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore, në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

86. Denoncimet nr. * prot., datë 3.3.2020 dhe nr. *** prot., datë 18.1.2021, të shtetasit M.K, si dhe denoncimet nr. *** prot., datë 5.2.2020, nr. *** prot., datë 3.3.2020 dhe nr. *** prot., datë 18.1.2021, të shtetas N.K**

86.1. Komisioni ka administruar fashikullin e çështjes gjyqësore: (i) paditës/i kundërpaditur D.H; (ii) të paditur/kundërpaditës M.K etj.; (iii) objekt padie “kthim sendi, njohje pronar me parashkrim fitues”.

86.2. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit gjyqësor rezulton se:

i) Në kërkesëpadi, në cilësinë e të paditurit, përveç shtetasve M dhe P.K, është thirrur edhe shtetasja N.K. Nga verifikimi i akteve në fashikullin gjyqësor konstatohet se në datën 21.3.2017 një subjekt tjetër rivlerësimi ka vendosur pranimin e kërkesës së palës paditëse, duke hequr si palë të paditur shtetasen N.K. Nga verifikimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore të zhvilluara nga subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri, shtetasja N.K rezulton si e paditur, por ndërkohë nuk relatohet njoftimi apo prezenca e saj në proces.

ii) Çështja ka vijuar të jetë e pezulluar deri në datën 25.1.2019, datë në të cilën subjekti ka urdhëruar njoftimin e palëve për seancën e radhës gjyqësore.

iii) Nuk gjendet vendimi i subjektit për revokimin e vendimit të pezullimit të gjykimin të çështjes gjyqësore.

iv) Gjendet i administruar vendimi nr. ***, datë 4.6.2018, i Gjykatës së Apelit Shkodër, sipas të cilit është prishur vendimi i mosfillimit të procedimit penal, iniciuar me kallëzimin penal nr. ***/2018 të shtetasve M e P.K ndaj shtetasit D.H dhe është urdhëruar prokuroria të regjistrojë procedimin penal, si dhe të kryejë hetimet e nevojshme në lidhje me këtë kallëzim.

v) Gjatë gjykimin të kësaj çështjeje, në datën 4.3.2019, përfaqësuesja e palës së paditur (denoncuesit) ka paraqitur kërkesat e mëposhtme:

a. Kërkesë për “pezullimin e gjykimin të çështjes”, me argumentin se të paditurit kanë paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kallëzimin penal nr. ***, datë 2.3.2018, për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”. Në këtë kërkesë, përfaqësuesja e të paditurve informon gjykatën se prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndaj të cilit është ushtruar ankimi në gjykatë. Me vendim të Gjykatës së Apelit Shkodër është urdhëruar vazhdimi i hetimeve dhe kjo çështje penale vijon të jetë në hetim nga Prokuroria e Rrethit Shkodër.

b. Kërkesë “për konstatimin e falsifikimit të dokumentit”, përmes së cilës kërkuesi informon gjykatën se një pjesë e dokumenteve të depozituara nga pala paditëse në këtë proces civil

¹³⁰ Shihni f. 2 dhe 3 të vendimit të subjektit.

janë objekt hetimi në çështjen penale nr. ***, datë 2.3.2018, si pasojë, ai kërkon konstatimin e falsitetit të këtyre dokumenteve.

Në lidhje me këto dy kërkesa nuk gjendet në fashikull vendimi i ndërmjetëm i subjektit.

vi) Në vendimin përfundimtar nr. ***, datë 24.4.2019, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me kërkesat e mësipërme, është shprehur se: *“Gjykata i vlerëson si të papranueshme pretendimet e ndërgjyqësve K lidhur me falsitetin e vendimit të KKKP-së Shkodër dhe notës së transkriptimit, pasi këto pretendime nuk u mbështetën në prova nga ana e paditësit. Marrja në konsideratë e këtyre pretendimeve/prapësimeve bie në kundërshtim me parimin e ‘gjësë së gjykuar’, pasi, po të merren në konsideratë, vihen në diskutim fakte krijuese të pranuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, që është vendimi i vitit 2001 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Sipas jurisprudencës së konsoliduar gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare, fuqia detyruese e vendimit gjyqësor të formës së prerë, në kuptimin procedural mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit gjyqësor, por gjithashtu edhe pjesën arsyetuese të tij. Sipas vlerësimit të gjykatës, falsitetet e pretenduara nga të paditurit përbëjnë gjë të gjykuar të nënkuptuar, që nuk ekzistojnë. Kjo mosekzistencë përbën fakt juridik të pranuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe nuk mund të vihet në bisedë përsëri në këtë gjykim. Kërkesat për pezullimin e gjykimit gjykata i ka konsideruar si të paligjshme, pasi ndërgjyqësit H, sendin objekt gjykimi e kanë fituar përmes një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Për sa kohë nuk ka ndonjë procedurë ligjore që të vihet në diskutim ligjshmëria e këtij vendimi, atëherë rezultatet e këtij gjykimi nuk ndërvaren nga ndonjë çështje tjetër”.*

86.3. Në lidhje me argumentimin e subjektit se paditësit e kanë fituar pronësinë nëpërmjet një vendimi gjyqësor, ky argumentim nuk qëndron, pasi në vendimin nr. ***, datë 11.12.2001, është vendosur ndryshimi i vendimit të KKKP-së së Bashkisë Shkodër, duke u ndryshuar sipërfaqja e pronës së kthyer për shkak të njësisë matëse.

86.4. Në përfundim, subjekti i ka kaluar barra e provës, si vijon:

- i. Subjekti ka vijuar gjykimin pa u zgjidhur më parë çështja penale, duke mos respektuar parashikimet ligjore të nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile, për pasojë janë cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt.
- ii. Subjekti nuk ka nxjerrë vendim për rifillimin e gjykimit të çështjes gjyqësore.
- iii. Subjekti nuk ka argumentuar shkaqet e rifillimit të çështjes gjyqësore, pasi shkakun për të cilin ishte pezulluar çështja nuk ishte zhdukur sipas parashikimeve të nenit 298 të Kodit të Procedurës Civile.
- iv. Subjekti nuk ka nxjerrë vendime të ndërmjetme në lidhje me kërkesat e palëve për pezullimin e vendimit dhe konstatimin e falsifikimit të dokumentit.

86.5. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹³¹, ka shpjeguar se për këtë ankesë ka hetuar mbi të njëjtat pretendime edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Me vendimin nr. *** prot., datë 12.2.2021, të ILD-së, kjo ankesë është hedhur poshtë si e pabazuar, duke mos i konsideruar faktet e ekspozuara përmes saj as të mjaftueshme për të hapur një hetim disiplinor. Subjekti ka pretenduar se Komisioni ka trajtuar themelin e çështjes, duke rënë ndesh me ligjin nr. 96/2016, si dhe me vendimin nr. 28/2020 të Kolegjit.

Më tej, subjekti ka prapësuar: *“i) Vendimi i dhënë nga unë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër. Ky vendim akoma nuk është zbardhur, por unë po jua dorëzoj si provë një kopje të shkurtuar të dispozitivit të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër. Fakti që vendimi im është*

¹³¹ Për më shumë referohuni prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër ka shumë rëndësi. Kjo pasi, sipas nenit 102, paragrafi 2 i ligjit nr. 96/2016, përbën shkelje disiplinore të magistratit 'a) mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë'. Në kuptim të kësaj dispozite ligjore nuk mund të thuhet se unë kam gabuar në legjislacionin procedural, për sa kohë një gjykatë më e lartë ka lënë në fuqi vendimin tim.

*ii) Pretendimet për falsifikim janë hedhur poshtë me vendimin gjyqësor penal nr. ***, datë 15.11.2021, të Gjykatës së Apelit Shkodër, që ka lënë në fuqi vendimin nr. *** (***), datë 12.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Këtë vendim gjithashtu po jua dorëzoj si provë...*

iii) Nuk jam dakord me Komisionin kur bën vlerësimin dhe konstatimin se 'Subjekti nuk ka nxjerrë vendime të ndërmjetme në lidhje me kërkesat e palëve për pezullimin e vendimit dhe konstatimin e falsifikimit të dokumentit'. Ky qëndrim i Komisionit bie ndesh me ligjin. Konkretisht, në nenin 171/a, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se: 'Gjykata drejton procesin gjyqësor nëpërmjet vendimeve dhe urdhrave. Vendimet dhe urdhrat e shpallura në seancë gjyqësore quhen të njohura nga palët e pranishme ose që duhej të paraqiteshin në gjykatë. Vendimet e shpallura jashtë seancës dhe ato ndaj të cilave lejohet ankimi i veçantë, u komunikohen palëve të interesuara nga sekretari i seancës jo më vonë se tri ditë nga shpallja e tyre'. Nga kjo dispozitë ligjore duket qartë se unë kam pasur detyrimin për të nxjerrë vendime të ndërmjetme të zbardhura vetëm për vendime të marra jashtë seance ose kur për këto ligji parashikon ankimi të veçantë.

iv) Nuk jam dakord me Komisionin kur bën vlerësimet dhe konstatimet se 'Subjekti nuk ka nxjerrë vendim për rifillimin e gjykimit të çështjes gjyqësore. Subjekti nuk ka argumentuar shkaqet e rifillimit të çështjes gjyqësore, pasi shkak për të cilin ishte pezulluar çështja nuk ishte zhdukur sipas parashikimeve të nenit 298 të Kodit të Procedurës Civile'. Kjo pasi vendimi i pezullimit të gjykimit dhe vendimi i revokimit të pezullimit janë vendime të ndërmjetme sipas nenit 125 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon se: 'Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore, me qëllim që t'u përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi'. Duke qenë vendime të ndërmjetme, ato e humbasin fuqinë juridike ipso lege, kur janë kushtet për t'u zbatuar neni 181, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, që parashikon se: 'Kur për shkaqe të përligjura ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari ose anëtarët e rinj duhet të njihen me përmbajtjen e procesit gjyqësor. Anëtari ose anëtarët e rinj mund të kërkojnë që hetimi gjyqësor të përsëritet pjesërisht ose tërësisht'. Sikurse Komisioni e ka parë nga dosja, vendimi i pezullimit të gjykimit është bërë nga gjyqtari i mëparshëm. Me largimin e tij nga gjykimi dhe caktimin tim si gjyqtar i çështjes, ka qenë e drejta ime, sipas nenit 181/2 të Kodit të Procedurës Civile, për të konvaliduar ose jo, duke i përsëritur veprimet e gjyqtarit të mëparshëm'.

86.6. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

i) Për sa i përket pretendimit se kjo çështje është trajtuar më parë nga ILD-ja, përveç sa është çmuar në pikën 85.8 të këtij vendimi, konstatohet se ILD-ja, në faqen 6, paragrafi 3 i vendimit nr. ***, datë 12.2.2021, analizon vetëm pretendimet e ankueses për korrupsion të subjektit.

ii) Në lidhje me pretendimin se, meqenëse ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, ai nuk mund të jetë pjesë e vlerësimit profesional, çmohet se ky pretendim nuk qëndron, pasi Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove subjektit për themelin e çështjes apo për veprime procedurale që prekin themelin e çështjes.

iii) Gjithashtu, Komisioni vlerëson se edhe pretendimi i subjektit se është trajtuar themeli i gjykimit të tij, nuk qëndron, pasi barra e provës nuk ka pasur të bëjë me vendimmarrjen, por me veprime procedurale të tij, të cilat vlerësohet se prekin kriteret e vlerësimit profesional të parashikuar nga neni 71 e në vijim të ligjit nr. 96/2016.

86.7. Më konkretisht, nga ana e subjektit është vijuar gjykimi pa u zgjidhur më parë çështja penale, duke mos respektuar parashikimet ligjore të nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile, për pasojë janë cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt. Subjekti ka pretenduar se është në diskrecion të tij të vendosë ose jo pezullimin, si dhe pretendimet për falsifikim janë hedhur poshtë me vendimin gjyqësor penal nr. ***, datë 15.11.2021, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

86.8. Komisioni ka konstatuar se nga ana e subjektit është vijuar gjykimi pa u nxjerrë më parë vendimi për rifillimin e gjykimit, si dhe pa u argumentuar shkaqet e rifillimit të çështjes gjyqësore, pasi shkak për të cilin ishte pezulluar çështja nuk ishte zhdukur sipas parashikimeve të nenit 298 të Kodit të Procedurës Civile.

86.9. Subjekti pretendon se, për sa kohë është ndryshuar trupi gjykues, ai ka pasur të drejtë që hetimi gjyqësor të përsëritej tërësisht ose pjesërisht. Ky pretendim i subjektit është i drejtë, por në rastin kur çështja gjyqësore shqyrtohet nga një trup gjykues, ndërkohë, në rastin në fjalë çështja gjyqësore po gjykohej vetëm nga një gjyqtar, i cili kishte marrë vendim të ndërmjetëm për pezullimin e gjykimit. Për rrjedhojë, subjekti, në cilësinë e gjykatës, kishte detyrimin ligjor që në bazë të nenit 315 të Kodit të Procedurës Civile¹³² të vendoste revokimin e këtij vendimi dhe rifillimin e gjykimit. Nga ana e subjektit, në këtë rast, nuk është vepruar sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, pasi ai nuk ka marrë asnjë vendim për revokimin e vendimit të pezullimit dhe të rifillimit të gjykimit.

Këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 – të arsytimit ligjor në kuptim të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, pasi nuk ka argumentuar shkaqet e rifillimit të gjykimit, si dhe të aftësive organizative, në kuptim të nenit 74/3 të ligjit nr. 96/2016, pasi nuk ka nxjerrë vendimet e ndërmjetme, duke mos kryer veprimet e nevojshme procedurale.

86.10. Subjekti nuk ka nxjerrë vendime të ndërmjetme në lidhje me kërkesat e palëve për pezullimin e vendimit dhe konstatimin e falsifikimit të dokumentit. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka pretenduar se ai ka pasur detyrime për të nxjerrë vendime të zbardhura vetëm për vendime të marra jashtë seance ose kur për këto ligji parashikon ankim të veçantë.

86.11. Ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi, bazuar në nenin 171/b të Kodit të Procedurës Civile, vendimet e ndërmjetme dhe urdhrat që jep gjykata në seancë gjyqësore duhet të arsyetohen dhe të mos paragjykojnë zgjidhjen e çështjes, për rrjedhojë, ai kishte detyrimin ligjor për të nxjerrë vendimin e ndërmjetëm, parashikuar edhe në nenin 182¹³³ të Kodit të Procedurës Civile. Këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore, në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, si dhe të aftësive organizative, në kuptim të nenit 74/3 të ligjit nr. 96/2016, pasi ai nuk ka nxjerrë vendimet e ndërmjetme, duke mos kryer veprimet e nevojshme procedurale.

87. Denoncim nr. ** prot., datë 7.1.2019, i shtetas A.M

¹³² Sipas këtij neni: “Vendimet që jepen gjatë gjykimit dhe që nuk janë përfundimtare mund të ndryshohen ose të revokohen nga gjykata që i ka dhënë, përveç kur në këtë Kod parashikohet se kundër tyre mund të bëhet ankim i veçantë”.

¹³³ Sipas këtij neni: “Për kërkesat e parashtruara nga palët sipas neneve 180 dhe 182 të këtij Kodi, gjykata shprehet me vendim. Në raste të veçanta, që paraqesin vështirësi gjykimi, ajo mund ta shtyjë deklarimin e vendimit deri në tri ditë”.

87.1. Denoncuesja ankohet për dy subjekte rivlerësimi, përfshirë edhe subjektin, për të cilin pretendon se ka kryer proces jo të rregullt gjyqësor, pasi administroi në dosjen gjyqësore dokumente të falsifikuara, për të cilat ishte bërë kallëzim penal edhe në prokurori. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit vijoi gjykimin e çështjes me objekt “pjesëtim pasurie” pa pritur përfundimin e procesit penal.

87.2. Komisioni administroi kopje të fashikullit gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me palë paditëse shtetasin D.M (përfaqësuar në gjykim nga av. L.K) dhe palë të paditur K.M etj., me objekt “pjesëtimin e sendit të përbashkët”.

Konstatohet se subjekti ka vendosur pushimin e gjyimit, pasi në seancën gjyqësore të datës 3.3.2016 paditësi dhe përfaqësuesi i tij nuk janë paraqitur në gjykim.

87.3. Nga shqyrtimi i procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 1.2.2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit është shprehur: “...nuk u paraqit av. L.K, përfaqësuesi i paditësit. Av. K ka dërguar një sms... sipas sms-së, përfaqësuesi i paditësit është i shtruar në spital në qytetin e Athinës. Komunikimi është zhvilluar dje, në orën 12:13”. Pasi palët kanë dakordësuar për shtyrjen e seancës, subjekti ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore për të bërë njoftimin me letërthirrje të paditësit dhe përfaqësuesit të tij.

87.4 Kërkesëpadia është paraqitur sërish nga paditësi D.M në datën 3.5.2016 dhe gjyqtar i çështjes është caktuar sërish subjekti, i cili me vendimin e datës 7.10.2016 ka vendosur lejimin e pjesëtimin të pasurisë së paluajtshme.

87.5. Në vijim, në datën 27.3.2018, bashkëpronaret A dhe R.M kanë kërkuar vijimin e fazës së dytë të pjesëtimin të pasurisë në natyrë. Me vendimin e datës 7.12.2018 subjekti vendosi zhdukjen në fakt të bashkëpronësisë mbi pasurinë e paluajtshme dhe pjesëtimin e saj në raportet përkatëse mes bashkëpronarëve. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankimi nga bashkëpronarët e paditur, të cilët në vijim kanë hequr dorë nga ankimi i paraqitur. Për pasojë, Gjykata e Apelit Shkodër vendosi pushimin e shqyrtimit të çështjes civile.

87.6. Nga shqyrtimi tërësor i fashikullit gjyqësor nuk rezulton që denoncuesja të ketë paraqitur pretendim për falsifikim dokumentacioni dhe as kërkesë për pezullim gjykimi për shkak të një procesi penal.

87.7. Pas shqyrtimit të kësaj dosjeje gjyqësore, përtej sa ka pretenduar ankuesja, konstatohet se:

- i. Përfaqësuesi i njëres prej palëve në gjykim ka qenë z. K, i cili sipas deklarimeve të subjektit ka qenë shok shkolle me të. Nga verifikimi i sistemit TIMS konstatohet se subjekti ka kryer disa udhëtime me z. K. Gjithashtu, vetë subjekti në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 1.2.2016 është shprehur se z. K e ka njoftuar nëpërmjet SMS-së se është i shtruar babai në spital një ditë përpara zhvillimit të seancës gjyqësore.

Nga të dhënat e mësipërme duket se subjekti ka marrëdhënie shoqërore me z. K, marrëdhënie të cilat janë konfirmuar nga Komisioni dhe nga hetimi i kryer i trajtuar më poshtë.

- ii. Nga verifikimi i deklaratës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit konstatohet se ai ka deklaruar si kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar shtetasin K.M, ku ka deklaruar se ka pasur kontakte me këtë shtetas gjatë viteve 2011 - 2012.

87.8. Në përfundim, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, me dyshimet se:

- i. Ai ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit kur ka gjykuar këtë çështje, pasi përfaqësuesi i njëres prej palëve ka qenë një person me të cilin subjekti ka pasur marrëdhënie

shoqërore, si dhe njëra nga palët e paditura është deklaruar nga ana e tij si kontakt i papërshtatshëm në deklaratën e kontrollit të figurës.

- ii. Subjekti mund të ketë favorizuar palën paditëse për sa kohë ka pranuar shtyrjen e seancës me kërkesë të dërguar me SMS nga shtetasi L.K, përfaqësues i palës paditëse, e cila nuk është një nga format e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile (pasi çdo kërkesë duhet të paraqitet në sekretarinë gjyqësore me shkrim, shoqëruar me dokumentacion provues), si dhe ka vendosur në favor të kësaj pale.

87.9. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹³⁴, ka shpjeguar se: *“Lidhur me problematikën e shtetasit K.M, unë nuk kam pasur asnjë marrëdhënie me këtë shtetas, që të mund ta ndieja veten në konflikt interesi. Sikurse e kam deklaruar edhe në formularin e figurës të shqyrtuar nga DSIK-ja, nuk kam pasur miqësi ndonjëherë me këtë shtetas. Kontaktet e mia me të kanë qenë rastësore, madje aq të tilla, sa as nuk i mbaj mend. Këto kontakte kanë qenë në kohën kur unë as kam pasur dhe as mund të kisha pasur dijeni për qenien e këtij shtetasi i dënuar. Ky shtetas, në kohën që unë kam pasur kontaktet rastësore në fjalë, ka qenë kryetar i komunës Rrethina. Aty ka punuar vëllai im G. Y. Sapo unë dhe vëllai im kemi marrë dijeni, për shkak të punës time si Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, mbi faktin që ky shtetas ka qenë i dënuar, menjëherë kemi ndërprerë çdo kontakt me të. Madje, vëllai im, me këshillën time, ka lënë menjëherë, edhe punën në komunën Rrethina, duke u distancuar qartë nga ky person”.*

87.10. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit me shtetasin L.K është kryer një hetim i thelluar, konkluzionet e të cilit janë shtjelluar në vijim, në pikën 95 të këtij vendimi.

87.11. Në lidhje me shtetasin K.M, Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove subjektit për shkak të kontakteve të papërshtatshme, pasi nga ana e tij në deklaratën e kontrollit të figurës është deklaruar një gjë e tillë. Barra e provës i ka kaluar për shkak të mundësisë së një konflikti interesi, duke qenë se ai vetë e ka deklaruar këtë shtetas si njohje të tij.

87.12. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit kur ka gjykuar këtë çështje, pasi: (i) ka pasur marrëdhënie shoqërore me shtetasin L.K, (ii) si dhe njohje me shtetasin K.M, për të cilin, siç deklaroi, i ka kërkuar vëllait të tij të distancohej. Ky përfundim i Komisionit është përfshirë në vlerësimin e konfliktit të interesit, të trajtuar në pikën 95 të këtij vendimi.

88. Denoncim nr. * prot., datë 7.6.2018, i shtetasit S.K**

88.1. Denoncuesi pretendon se subjekti ka kryer shkelje ligjore dhe proces jo të rregullt gjyqësor sepse nuk u është përgjigjur pretendimeve të denoncuesit dhe e ka zhvilluar gjykimin bazuar në dokumentacion të falsifikuar. Ai pretendon gjithashtu se i ka kërkuar subjektit pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative e, më pas, pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen e çështjes penale, por këto kërkesa janë refuzuar nga subjekti. Denoncuesi shprehet se pas vendimit të padrejtë të dhënë nga subjekti, prokuroria vërtetoi falsifikimin e dokumenteve të pretenduara nga denoncuesi dhe vendimi i dhënë u prish nga Gjykata e Apelit.

Më tej, denoncuesi pretendon se avokati me të cilin konsultoi për problematikën e pronës është shprehur se “ky gjyqtar, që ta mbyllë çështjen në një seancë të vetme, kërkon 3 mijë euro”.

¹³⁴ Për më shumë, referojuni prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

88.2. Komisioni ka administruar nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër një kopje të vendimit të datës 8.7.2015, dhënë për këtë çështje nga subjekti, i cili ka vendosur pranimin e pjeshëm të kërkesëpadisë. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur S.K dhe Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga pala paditëse dhe dosja ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Lartë.

88.3. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe pretendimeve të denoncuesit konstatohet se subjekti nuk ka pezulluar gjykimin për t'u zgjidhur më parë çështja penale, në përputhje me nenin 297/a të Kodit të Procedurës Civile, për pasojë janë cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt. Subjektit iu kalua barra e provës për këtë konstatim.

88.4. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹³⁵, ka shpjeguar se, për sa i përket pezullimit, ai paraqet të njëjtat argumente si në pikën 85.7 të këtij vendimi. Në këto kushte, edhe qëndrimi i Komisionit është sikundër është trajtuar më lart.

Më pas, subjekti vijon të analizojë vendimmarrjen e tij, për të cilën Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove, pasi nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 72/4 të ligjit nr. 96/2016.

88.5. Subjekti ka paraqitur edhe një kërkesë, duke kërkuar që të merret si provë trajtimi i ankesës nga ana e ish-Inspektoratit të KLD-së. Komisioni, pasi shqyrtoi këtë kërkesë të subjektit, vendosi të mos e pranojë, duke u bazuar në germa "a" dhe "b" të nenit 49/6, pasi marrja e provës është e panevojshme dhe fakti që kërkon të provohet, ka rezultuar i provuar gjatë gjykimit.

89. Denoncim nr. * prot., datë 3.8.2020, i shtetases D.K**

89.1. Denoncuesja sqaron se ka qenë palë ndërgjyqëse në gjykimin me: (i) palë paditëse E. K e D.K; (ii) të paditur A.K dhe E.R; (iii) palë e tretë ASHK-ja dhe DAMT Shkodër; (iv) objekti "konstatim i pavërtetësisë së pjeshme të dokumentit – libër i pronësisë, qyteti Shkodër, në lidhje me regjistrimin në emër të H.K dhe saktësimin e dokumentit në lidhje me pronësinë nga H.K në H.K etj."

Denoncuesja pretendon se përmes një vendimi të ndërmjetëm subjekti ka vendosur përjashtimin nga gjykimi të personit të tretë DAMT Shkodër, ndërkohë që objekti i padisë lidhet me një dokument të lëshuar pikërisht nga DAMT Shkodër.

Paditësja/denoncuesja shprehet se ka paraqitur ankim në lidhje me këtë vendim të ndërmjetëm, por për një periudhë 4-mujore subjekti nuk ka dorëzuar materialet e dosjes në sekretarinë e gjykatës, duke penguar kështu dërgimin e ankimit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. Ajo pretendon gjithashtu se në një seancë gjyqësore ka qenë prezent në sallën e gjyqit edhe vëllai i subjektit të rivlerësimit.

89.2. Pasi u shqyrtua dokumentacioni përkatës, Komisioni ka konstatuar se:

- i. Subjekti ka zvarritur nxjerrjen e vendimit të ndërmjetëm, duke cenuar të drejtën e palës në lidhje me një proces brenda afateve të arsyeshme.
- ii. Është e paqartë prezenca e vëllait të subjektit në seancë gjyqësore.

Duke i kaluar barrën e provës për këto konstatime, subjektit iu kërkua që të paraqiste dokumentacion provues për depozitimin e vendimit të ndërmjetëm dhe vijimin e gjykimit.

¹³⁵ Për më shumë referohuni në prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

89.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹³⁶, ka deklaruar se do të paraqesë të njëjtat argumente, sikundër ka paraqitur kur ankuesi ka kërkuar përjashtimin e këtij subjekti.

89.4. Më tej, ai ka detajuar: *“Lidhur me shkakun e dytë (për sa i përket pengimit të supozuar nga ana ime të së drejtës së palës për të ushtruar ankim efektiv, përmes mosdorëzimit të dosjes që t’i jepte rrugë ankimit të veçantë), kam mendimin se ky shkak i ekspozuar, për përjashtimin tim nga gjykimi, mbështetet në të dhëna pjesërisht të rreme dhe/ose të paprovuara, si dhe të paligjshme. Kjo, pasi unë nuk kam marrë dijeni ndonjëherë mbi faktin që pala ka paraqitur ankim të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm gjyqësor për moslegjitimitimin e personit të tretë. Nga ana tjetër, fakti i paraqitjes së ankimit të veçantë nuk pezullon vazhdimin e gjykimit. Gjithashtu, kurrsesi unë nuk jam bërë pengesë për fotokopjimin e dosjes gjyqësore dhe dërgimin e dosjes në Gjykatën e Apelit (pasi vetëm tani po e marr vesh që është paraqitur ankim i veçantë). Gjithsesi, ju bëj me dije se sot, sapo u njoha me kërkesën për përjashtimin tim nga gjykimi, të bazuar, ndër të tjera, edhe mbi këtë shkak (dhe, për rrjedhojë, edhe për faktin se është paraqitur ankim i veçantë), menjëherë udhëzova dhe urdhërova sekretaren gjyqësore që të fotokopjojë dosjen gjyqësore, për të vijuar procedurat e përcjelljes së saj në Gjykatën e Apelit, por kurrsesi dosjen origjinale, pasi gjykimi vazhdon dhe paraqitja e ankimit të veçantë nuk përbën shkak pengues për përfundimin e gjykimit. Lidhur me shkakun e tretë (prania e familjarit tim në sallë), ju bëj me dije se është e vërtetë që në sallë ka qenë vëllai im G.Y, por ai ka ardhur në sallë (ndërkohë që gjykimi ka qenë në vijim) për të më sjellë një palë çelësa të automjetit tim. Duke qenë se gjykimi ishte në vijim, dhe ai nuk mund të afrohej që të m’i jepte (dhe duke qenë se seanca ishte drejt fundit), ai është ulur në vendin e publikut, ku ka qëndruar një apo dy minuta derisa përfundoi seanca, kur dhe më dha çelësat në prani të palëve, pasi dola jashtë nga salla. Unë nuk arrij të kuptoj se si kjo rrethanë paska krijuar dyshim tek pala lidhur me paanësinë time si gjyqtar, ndërkohë që kjo rrethanë, po të vlerësohej normalisht, duhet t’u shërbente palëve për të mësuar se si respektohet solemniteti i gjykimit nga gjyqtari, qoftë edhe përkundrejt familjarëve të tij. Lidhur me këtë rrethanë, ju lutem vlerësoni pamjet filmike të sallës nr. 5 të katit të tretë të gjykatës”.*

89.5. Subjekti ka paraqitur argumentet e tij edhe për faktin që ankuesja kishte kërkuar përjashtimin e tij për shkak se kishte paraqitur ankesë në Komision dhe ILD, duke e konsideruar subjektin në kushtet e konfliktit të interesit: *“Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në Gjykatën e Apelit Shkodër, ka një praktikë të konsoliduar tashmë, se vetë fakti i paraqitjes së një kallëzimi penal, ankese administrative disiplinore apo kërkesëpadie, ku thirret si i paditur gjyqtari për shkak të veprimtarisë së tij gjyqësore, nuk përbën ‘bazë faktike të mjaftueshme’ për të vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit dhe, për rrjedhojë, për t’u pranuar si ‘kërkesat e paraqitura nga gjyqtari me objekt heqje dore nga gjykimi’, ashtu edhe kërkesat e palëve me objekt ‘përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi’... Mendoj se nuk është rasti që unë të paraqes kërkesë me objekt heqjen dorë nga ana ime prej gjykimit të çështjes. Ky mendim imi përforcohet edhe nga jurisprudenca e gjykatave më të larta të rendit tonë juridik (Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut), sipas të cilave ‘testi subjektiv i paanësisë së gjyqtarit’ jo domosdosmërisht mjafton për të vënë në dyshim paanësinë e tij. Kjo pasi ‘dukja e anshmërisë’ duhet të shoqërohet edhe me elemente të ‘testit objektiv të paanësisë së gjyqtarit’, të cilat të tregojnë së ekziston rreziku serioz i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, në drejtim të respektimit të standardit ‘gjykatë e paanshme’. Në kushtet kur nga përmbajtja e kërkesës për përjashtim nuk rezulton ‘as të evidentohet, përshkruhet dhe aq më pak provohet’ ndonjë element i tillë i testit objektiv të anësisë sime të supozuar si gjyqtar, kam mendimin se gjendja e konfliktit në dukje të interesit, me të cilën pala, në thelb, e motivon*

¹³⁶ Për më shumë referohuni prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

kërkesën për përjashtim që ka paraqitur, nuk mjafton as që unë të paraqes kërkesë me objekt heqjen dorë nga gjykimi, dhe aq më pak për t'u pranuar kërkesa e paraqitur nga pala për përjashtimin tim nga gjykimi”.

89.6. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, konstaton se subjekti nuk ka depozituar vendimin e ndërmjetëm për të provuar në këtë mënyrë të kundërtën e barrës së provës, sipas kërkesës së Komisionit. Nga sa konstatohet nga leximi i shpjegimeve, rezulton se ai nuk ka kryer në kohë të gjithë procedurat e nevojshme për sa i përket zbardhjes dhe vënies në dispozicion të vendimit të ndërmjetëm për refuzimin për marrje pjesë të personit të tretë, vendim ndaj të cilit mund të bëhet ankim i veçantë, bazuar në nenin 194 të Kodit të Procedurës Civile.

89.7. Bazuar në nenin 316 të Kodit të Procedurës Civile¹³⁷ subjekti kishte detyrimin ligjor që të njoftonte palët për këtë vendim të ndërmjetëm, e drejta e ankimit të së cilit është 3 ditë nga marrja e vendimit dhe, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tri ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar.

Në këto kushte, subjekti ka zvarritur nxjerrjen e vendimit të ndërmjetëm, duke cenuar të drejtën e palës në lidhje me një proces brenda afateve të arsyeshme, duke treguar mangësi në kriterin e parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3, si dhe neni 74, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016.

90. Denoncim nr. * prot., datë 17.8.2021, i shoqërisë “K.I” sh.a.**

90.1. Në denoncimin e paraqitur, shoqëria pretendon se në çështjen gjyqësore me palë paditëse N.M dhe palë të paditur shoqërinë “K.I” sh.a., nga ana e subjektit të rivlerësimit janë kryer shkelje të rënda të standardit të procesit të rregullt ligjor dhe shkelje të rënda të etikës profesionale, si dhe është evidentuar njëanshmëri e theksuar e subjektit në favor të palës paditëse.

90.2. Në mënyrë të përmbledhur denoncuesi pretendon se:

- a. Ekzistojnë dyshime të arsyeshme se kërkesëpadia është hartuar nga vetë subjekti, duke u bazuar në faktin se:
 - kërkesëpadia është 160 faqe dhe ka 151 prova bashkëngjitur, ku bie në sy niveli i lartë i profesionalizimit dhe referencat e shumta në praktikën gjyqësore (pjesë prej së cilës janë marrë pikërisht nga vendimet e vetë subjektit të rivlerësimit);
 - vlera e objektit të padisë është përcaktuar 49,000,000 lekë, pa asnjë bazë teorike apo praktike, duke maksimalizuar “të ardhurat” për palën paditëse dhe duke evituar kështu që çështja të gjykohet nga trupi gjyqësor me tre gjyqtarë.
- b. Subjekti ka caktuar me ngut seancat përgatitore e gjyqësore dhe në seancën e parë përgatitore ka caktuar 6 ekspertë.
- c. Subjekti ka kryer gjykim të njëanshëm duke orientuar palën paditëse dhe duke e udhëzuar në përgjigjet e saj. Ky fakt mund të verifikohet nga regjistrimi audio i seancës së datës 30.6.2021.
- d. Kërkesat e përfaqësuesve ligjore të palës së paditur janë rrëzuar sistematikisht edhe pse kanë qenë të mbështetura në ligj në prova (mbështetur në raporte mjekësore e bileta udhëtimi jashtë vendit).

¹³⁷ Vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces brenda tri ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda 3 ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar. Njoftimi bëhet sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I.

- e. Subjekti ka caktuar seanca gjyqësore në një hark të shkurtër kohor.
- f. Duke marrë në konsideratë artikujt mediatikë, gjyqtari nuk mohon njohjen me avokatin e palës paditëse, duke e bërë vlerësimin e çështjes të njëanshëm.
- g. Sipas informacioneve informale, kërkesëpadia mund të jetë hedhur në disa kopje në gjykatë, për të rritur mundësitë që çështja t'i kalonte për gjykim gjyqtarit Andri Ymeri.
- h. Kërkimi i dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se shoqëria “K.I” sh.a. ka paraqitur disa kërkesa, ku, ndër të tjera, ka pretenduar se:

- i) Padia është parashkruar pasi ka kaluar afati: 1-vjeçar i parashikuar nga neni 115/e i Kodit Civil, pasi ajo është ngritur në datën 11.4.2021 dhe marrëdhënia e punës është ndërprerë në datën 27.6.2018; afati 180-ditor i parashikuar nga neni 146/2 i Kodit të Punës; dhe afati 30-ditor i zbulimit të motivit abuziv.
- ii) Subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit, pasi: ai është shprehur për themelin e çështjes në një bisedë private që ka pasur me përfaqësuesin e shoqërisë “K. I” sh.a.; avokati N.R që ka përfaqësuar palën paditëse është akuzuar për afera së bashku me subjektin dhe subjekti nuk ka mohuar njohjen me këtë avokat; ekspertit vlerësues, z. T. M, është parë në zyrën e subjektit duke biseduar me të pas përfundimit të njërës prej seancave gjyqësore.
- i. Nga verifikimi i deklaratës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit konstatohet se ai ka deklaruar si kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar shtetasin N.R.

90.3. Pas hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, me dyshimet se:

- i. Subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi sipas pretendimeve të denoncuesit ai ka pasur njohje me avokatin e palës paditëse, është shprehur privatisht për themelin e çështjes, si dhe ka biseduar me njërin prej ekspertëve në zyrën e tij.
 - ii. Padia mund të jetë hedhur në disa kopje me qëllim shortimin e saj tek subjekti i rivlerësimit.
 - iii. Subjekti nuk ka argumentuar caktimin e masës së dëmshpërblimit, si dhe të dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm.
 - iv. Subjekti ka caktuar seanca, si dhe ka përfunduar gjykimin në një afat shumë më të shkurtër se afatet normale të shqyrtimit të çështjeve të ngjashme nga ana e tij.
 - v. Subjekti ka gjykuar një padi, e cila është parashkruar.
- Për pasojë, duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin, si dhe ka vepruar jo në përputhje me dispozitat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, duke bërë që të ngrihen dyshime për favorizim të palës paditëse.

90.4. Subjekti, përveç sa i ka kaluar barra e provës për sa më lart, i është kërkuar të depozitojë dokumentacion provues për shortimin e kërkesëpadiisë, numrin e kërkesëpadive të depozituara nga paditësi, dosjen gjyqësore të vendimit, si dhe vendime të ngjashme të tij me të njëjtin afat përfundimi si në këtë gjykim.

90.5. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹³⁸, ka shpjeguar se për këtë ankesë ka hetuar mbi të njëjtat pretendime (shkaqe) edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Me vendimin nr. *** prot., datë 20.7.2022, të ILD-së, kjo ankesë është hedhur poshtë si e pabazuar, duke mos i konsideruar faktet e ekspozuara përmes saj as të mjaftueshme për të hapur një hetim disiplinor.

Gjithashtu, kjo ankesë, si dhe shkaqet ku ajo bazohet, janë shqyrtuar edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, që ka barrë në shqyrtimin e ankesës së bërë ndaj vendimit të lartpërmendur të ILD-së nga shoqëria “K.I” sh.a. KLGJ-ja, me vendimin nr. **, datë 7.11.2022 gjithashtu ka hedhur poshtë si të pabazuara shkaqet e ankesës, duke lënë në fuqi vendimin e ILD-së. Subjekti ka parashtruar se: *“Nuk besoj se mundem t’i shtoj më shumë në pikëpamje të argumentimit ligjor arsytimit të dy organeve të drejtësisë së re, sikurse janë ILD-ja dhe KLGJ-ja. Për më tepër, vendimi nr. **, datë 7.11.2022, i KLGJ-së, ka marrë formë të prerë dhe, për rrjedhojë, është bërë pjesë e rendit juridik, duke mos pasur më asnjë mundësi ligjore për cenimin e vlerësimeve, konstatimeve dhe arsytimeve të tij, qoftë drejtpërdrejt, qoftë tërthorazi të asnjë organi tjetër të drejtësisë. Lidhur me vlerësimet ‘Subjekti nuk ka argumentuar caktimin e masës së dëmshpërblimit, si dhe të dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm. Subjekti ka gjykuar një padë, e cila është parashkruar. Për sa më sipër, duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin, si dhe ka vepruar jo në përputhje me dispozitat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, për rrjedhojë ngrihen dyshime që subjekti mund të ketë favorizuar palën paditëse’, mendoj e pretendoj se vlerësimi në këtë rast bie në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, që parashikon se: ‘Magjistrati i ushtron funksionet e tij në përputhje me kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar dhe interpretuar ligjin sipas bindjes së tij të brendshme, i lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga çdo palë dhe për çdo arsye’. Po ashtu, bie ndesh edhe me standardin e vendosur me vendimin nr. 28/2020(JR), të marrë për subjektin e rivlerësimit F.V, në paragrafët 10.7, 10.8, 12.4 të tij, që i përmenda më sipër”.*

90.6. Subjekti ka pretenduar se, sipas nenit 191 të Kodit të Procedurës Civile, që është i zbatueshëm së bashku me ligjin nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të thirren si palë të interesuara në procesin e tij të rivlerësimit edhe palët paditëse të vendimit, për të cilin është ankuar shoqëria “K.I” sh.a. Këtë kërkesë ai e ka argumentuar me faktin se: *“Kjo, pasi unë kam interes përbashkues me këto subjekte, për shkak të faktit se unë nga njëra anë dua të vërtetoj se nuk i kam favorizuar, ndërsa këto subjekte qartësisht kanë interes të vërtetojnë se vendimi që kam dhënë unë jo vetëm që është produkt jo i ndonjë favorizimi, por edhe se është i drejtë, i arsytuar dhe ligjor, si dhe kanë interes që të parandalojnë formimin e çdo opinionit të kundërligjshëm që ndikon ose mund të duket se ndikon në veprimtarinë e Gjykatës së Apelit Shkodër, që akoma ka në shqyrtim çështjen”.*

90.7. Lidhur me konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, subjekti është mbrojtur nëpërmjet një vendimi gjyqësor, i marrë nga një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që ka hedhur poshtë pretendimet e kësaj natyre. Ai ka parashtruar: *“Gjithsesi, e vlerësoj me vend të bëj pjesë të këtij materiali, edhe mendimin me shkrim që i kam paraqitur gjyqtarit që ka shqyrtuar kërkesën time për përjashtim nga gjykimi, të parashtruar nga ‘K.I’ sh.a. (e shkruar me shkrim dore nga unë, që do jua paraqes si provë)... ommisis... Pasi jam njohur me kërkesën, kam për të shprehur sa më poshtë; Lidhur me shkakun e parë të përjashtimit (takimi me avokatin I.D)... ky ka ndodhur rreth një muaj më parë dhe, ndryshe nga sa pretendohet, unë kurrë nuk kam dhënë ndonjë mendim për çështjen apo për gjykimin ose për ndonjë çështje tjetër. Duke qenë se avokati në fjalë është*

¹³⁸ Për më shumë referohuni prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

pedagog në Fakultetin e Drejtësisë, mbaj mend që kemi diskutuar në mënyrë të përgjithshme çështje të interpretimit të ligjit, por jo rrethana të çështjeve që unë kam për gjykim. Takimi ka qenë jo vetëm me ne të dy, por ka qenë në prani edhe të një personi të tretë që është ish-rektori i universitetit 'Luigj Gurakuqi', Shkodër. Madje, pikërisht prezenca e këtij të fundit ka përbërë shtysën që unë të pranoj të ulem për të pirë kafe me avokatin, të cilin, ndonëse e njoh, kemi vetëm një marrëdhënie kordiale, por jo shoqëri. Pjesa tjetër e fakteve të pretenduara janë të pavërteta, të manipuluara, të shtrembëruara, të pasakta dhe me natyrë provokuese. Për rrjedhojë, çmuj se nuk duhet të zgjatem më tej. Lidhur me shkakun e dytë, takimi me ekspertin. Pas mbarimit të seancës, eksperti T.M, me profesion mjek ligjor, ka qenë në zyrën time për të marrë një datë për një çështje tjetër. Ndërkohë, në zyrën time ka ardhur edhe avokati I. D, me qëllim për të më takuar, por unë nuk kam pranuar që ta takoj, sikurse ishte kërkesa e tij. Pasi unë i refuzova takimin, ai më tha fjalët 'bën mirë me dhanë dorëheqje'. Kaq është fakti. Lidhur me takimin me ekspertin, në zyrë, ai nuk është i fshehtë sikurse pretendohet, aq më shumë nuk është i ndaluar. Kjo pasi eksperti nuk është palë dhe as përfaqësues palësh ndërgjyqëse”.

Për sa i përket pjesës tjetër së barrës së provës, subjekti ka cituar pjesë të vendimit të tij.

90.8. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se:

i) Në lidhje me kërkesën e subjektit për të thirrur si palë të interesuara në procesin e tij të rivlerësimit edhe palët paditëse të vendimit objekt vlerësimi, Komisioni, vendosi ta refuzojë këtë kërkesë, pasi procesi i rivlerësimit është një proces që sjell pasojë vetëm për subjektin e rivlerësimit dhe asnjë person tjetër.

ii) Në lidhje me pretendimin e subjektit se KLGJ-ja dhe ILD-ja janë shprehur në lidhje me këtë ankesë, Komisioni vlerëson se kompetencat e ILD-së dhe KLGJ-së nuk lidhen me kompetencat që i përkasin Komisionit. Për më tepër, juridiksioni i Komisionit lidhet vetëm me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve dhe në këtë proces është i pavarur nga çdo vendimmarrje e organeve të tjera. KLGJ-ja, në vendimin nr. **, datë 7.11.2022, në faqen 5, pika 13.1, në lidhje me pretendimin e ankuesit se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Shkodër konfirmon zbatimin e gabuar të ligjit procedural nga ana e subjektit, shprehet se ky pretendim nuk është pjesë e vendimit objekt ankimimi të ILD-së, kjo edhe për faktin se dispozitivi i Gjykatës së Apelit Shkodër mban datën 14.7.2022.

iii) Duke qenë se pas kalimit të barrës së provës subjekti nuk depozitoi dokumentacionin e kërkuar në lidhje me këtë çështje gjyqësore, Komisioni do të bazohet në një pjesë të konkluzioneve të vendimeve të ILD-së dhe KLGJ-së për të analizuar sa më drejt këtë çështje të subjektit. Refuzimi nga ana e subjektit për të depozituar dokumentacionin e kërkuar do të konsiderohet si mungesë bashkëpunimi, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, pasi duket se është bërë me qëllim arritjen e një rezultati në favor të subjektit.

90.9. Më konkretisht, nga ana e subjektit nuk është paraqitur dokumentacion provues për shortimin e kërkesëpadisë, numrin e kërkesëpadive të depozituara nga paditësi, si dhe dosjen gjyqësore të vendimit.

i) Në lidhje me shortimin e çështjes, bazuar në faqen 4 të vendimit nr. ***, datë 20.7.2022, të ILD-së, rezulton se çështja civile është regjistruar në datën 3.6.2021 dhe po në këtë datë është shortuar elektronikisht, duke i kaluar me short subjektit I.K. Kjo çështje është rishortuar në datën 7.6.2021 për shkak të kërkesës për dorëheqje të gjyqtarës, duke i kaluar me anë të shortit subjektit. Ndërkohë, nuk ka të dhëna në lidhje me numrin e mundshëm të kërkesëpadive të paraqitura nga pala paditëse.

ii) Në po të njëjtën faqe të vendimit të ILD-së rezulton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur për përjashtimin e subjektit është rrëzuar me vendimin nr. ***, datë 28.7.2021. Komisioni nuk

mund të vijojë vlerësimin në lidhje me konfliktin e interesit, për sa kohë ka një vendim gjyqate, i cili ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar dhe nuk konstatohet shkelje procedurale që nuk lidhen me themelin e çështjes.

iii) Në faqen 5 të këtij vendimi deklarohet se subjekti ka rrëzuar kërkesat për konstatimin e parashkrimit të padisë. Komisioni nuk mund të vijojë vlerësimin në lidhje me rrëzimin e kërkesave për sa kohë ka një vendim gjyqate, i cili ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar dhe nuk konstatohen shkelje procedurale që nuk lidhen me themelin.

iv) Në lidhje me barrën e provës, për sa i përket argumentimit të masës së dëmshpërblimit, si dhe të dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm, subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka cituar pjesë të vendimit të tij, të cilat ishin analizuar nga Komisioni dhe për këtë arsye iu kalua barra e provës subjektit.

v) Për sa i përket aplikimit të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, ai është shterues, si dhe ka përcaktuar kritere për zbatimin e tij, të cilat në vendimin e subjektit nuk janë të argumentuara.

vi) Subjekti, në paragrafin 195/b të vendimit nr. 436, datë 8.6.2022, shprehet se: *“Të gjitha rastet e tjera që nuk përfshihen në kategorinë e parë, vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm kur paditësi vërteton me prova se ekzekutimi i vendimit i dhënë nga gjykata e shkallës së parë mund të bëhet i pamundur... Gjykata mund të ushtrojë diskrecionalitet për të vendosur nëse duhet dhënë apo jo vendimi me ekzekutim të përkohshëm vetëm kur paditësi paraqet prova...”*.

vii) Në vendimin nr. ***, datë 8.6.2022, për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm për palën paditëse N.M, subjekti është referuar në nenin 317/1/b të Kodit të Procedurës Civile. Ky referim i subjektit nuk përputhet me parashikimin e kësaj dispozite, pasi paditësi në kërkesëpadi ka kërkuar shpërblim dëmi, i cili në një vendim tjetër (trajtuar në pikën 91.8 të këtij vendimi) të subjektit trajtohet si detyrim për ushqim.

Nga ana e subjektit nuk referohet në asnjë provë të paraqitur nga ana e paditësve për të provuar, sikurse shprehet vetë ai, se ekzekutimi i dhënë nga gjykata mund të bëhet i pamundur.

90.10. Komisioni nuk mund të analizojë vendimmarrjen e themelit të subjektit, e cila nga vendimi i KLGJ-së duket se është cenuar në Gjykatën e Apelit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të vijojë më tej me analizimin e vendimit të subjektit për sa i përket caktimit të masës së shpërblimit apo të trajtimit të kësaj marrëdhënieje.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

91. Denoncim nr. * prot., datë 22.5.2020, i shoqërisë “I.V.I.G” sh.a.**

91.1. Denoncuesi bën me dije se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër po zhvillohen dy procese gjyqësore, me objekt “shpërblim dëmi” kundër shoqërisë “I.V***”, të cilat po gjykohen nga subjekti. Denoncuesi shprehet se gjatë gjykimit të këtyre çështjeve ka konstatuar veprime të kryera në kundërshtim me etikën profesionale e gjyqësore me qëllim dëmtimin e interesave të ligjshëm të shoqërisë “I.V***”. Në mënyrë të përmbledhur denoncuesi pretendon se:

➤ Në çështjen e parë gjyqësore:

i) Subjekti ka kryer shkelje të rënda procedurale dhe nuk ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm konform nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile, duke mos pranuar asnjë nga kërkesat e shoqërisë “I.V***” si palë e paditur në procesin civil, por ka pranuar tërësisht kërkesat e palës paditëse, gjë që ka sjellë humbjen e besimit për një gjykim të drejtë e të paanshëm.

ii) Në seancën përgatitore të datës 22.11.2020 kanë kërkuar nga gjykata kthimin e padisë me të meta për arsye se pala paditëse nuk ka plotësuar dokumentacionin ligjor mbi të cilin bazon të drejtën për dëmshpërblim, si dhe pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje, sipas parashikimeve të nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile.

iii) Në seancën e datës 11.12.2019 gjykata ka caktuar ekspert mjekoligjor G. M. Denoncuesit kanë kërkuar përjashtimin e tij, për shkak se ky ekspert ka qenë në marrëdhënie kontraktuale pune me shoqërinë "IV**" dhe ka bashkëpunuar me avokatin e palës paditëse në një tjetër gjykim. Gjukata, pa analizuar provat mbi të cilat mbështetej ankesa e shoqërisë, ka rrëzuar kërkesën.

iv) Në seancën e datës 7.2.2020, subjekti ka pranuar prova të cilat nuk janë dorëzuar konform parashikimeve të nenit 158, pika 6 dhe nenit 186 të Kodit të Procedurës Civile, pasi janë paraqitur gjatë gjykimit.

v) Gjukata ka pranuar prova të marra në mënyrë të njëanshme nga eksperti.

vi) Pavarësisht kërkesës së shoqërisë "I.V**" për përjashtimin e subjektit, ai ka vazhduar gjykimin, duke orientuar avokatin e paditësit për saktësimin e objektit të padisë.

vii) Në kohën kur do të mbyllej hetimi gjyqësor, gjyqtari pranoi kërkesën e palës paditëse për pyetje shtesë drejtuar ekspertit. Në përgjigjen e tij elektronike, eksperti njoftoi gjykatën se nuk mund të kryejë detyrën shtesë të caktuar nga gjykata, duke dhënë argumentet ligjore përkatëse. Gjukata ka urdhëruar të kryhet detyra e caktuar, pasi në rast të kundërt do të paraqitet kallëzim penal. Eksperti është detyruar të përgjigjet dhe vlera e rezultuar në aktin shtesë përputhet me saktësimin e objektit të padisë, që kishte bërë avokati i paditësit disa seanca më parë.

➤ Në çështjen e dytë gjyqësore:

i) Denoncuesi ka kërkuar pezullimin e gjykimit, duke qenë se mungonte vendimi penal i formës së prerë, që shërben si provë për procesin civil. Kjo kërkesë është rrëzuar nga subjekti.

ii) Subjekti ka caktuar si ekspert në gjykim dy vlerësues me të cilët shoqëria "I.V**" ka pasur konflikte të mëparshme. Njëri prej tyre ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie dhe ai është përjashtuar nga çdo proces gjyqësor. Subjekti ka rrëzuar kërkesën e të paditurit për përjashtimin e ekspertëve, pa analizuar provat mbi të cilat mbështetej kjo kërkesë.

iii) Duke marrë shkas nga shkeljet e mësipërme procedurale, është kërkuar ndërprerja e seancës me qëllim paraqitjen e kërkesës për përjashtim të gjyqtarit, por ai ka vazhduar gjykimin duke caktuar detyrat e ekspertëve. Po në këtë seancë gjyqësore ai urdhëroi sekretaren që të merrte dorazi dosjen penale të lidhur me çështjen në gjykim, e cila ndodhej në fashikullin gjyqësor pranë një tjetër gjyqtari. Me këtë veprim gjyqtari ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile, pasi është detyrim i palëve dhe jo i gjykatës për të bazuar pretendimet e saj me anë të provave. Ky interesim personal nga gjyqtari shfaq haptazi një qëndrim favorizues të avokatit të palës paditëse.

iv) Është konstatuar se çështjet me objekt "shpërblim dëmi" që përfaqësohen nga i njëjti avokat, gjykohen vetëm nga subjekti i rivlerësimit, gjyqtari Andri Ymeri. Dyshohet se ka të bëjë me manipulime të shortit, duke marrë për gjykim ky gjyqtar të gjitha çështjet e kësaj natyre, me të njëjtin avokat, duke caktuar të njëjtët ekspertë dhe duke dhënë vendime gjithnjë në favor të palëve paditëse.

91.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e denoncuesit konstatohet se:

a. Në rastin e gjykimit të çështjes me palë paditëse G.A:

- i) Denoncuesi ka paraqitur kërkesë për pezullimin e gjykimit, pasi çështja civile nuk mund të zgjidhet pa përfunduar gjykimi i çështjes penale.
- ii) Denoncuesi ka kërkuar përjashtimin e ekspertit E.J, H.G, pasi ata kanë qenë më përpara në marrëdhënie me këtë shoqëri. Bashkëlidhur kërkesës gjendet:
 - vendimi nr. *, datë 29.2.2009, i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, ku shtetasi H.G rezulton kryetar i Komisionit Mjekësor të trajtimit të praktikave të dëmeve shëndetësore. Ky vendim është nënshkruar edhe nga përfaqësues i shoqërisë “I.V**”;
 - aktvlerësimi datë 14.1.2010, dëmi shëndetësor me logo të shoqërisë “I.V**”;
 - ”, firmosur nga shtetasi E.J;
 - miratim praktike dëmi për pagesë, datë 12.2.2010, firmosur në emër të “I.V**” nga shtetasi E.J.
- iii) Bazuar në procesverbalin e seancës të datës 25.2.2020 konstatohet se subjekti ka urdhëruar sekretaren për të tërhequr fashikullin origjinal penal tek një subjekt tjetër, si dhe e ka administruar si provë.
- b. Në rastin e gjykimit të çështjes me palë paditëse V.H etj., në vendim subjekti shprehet se ka tërhequr në cilësinë e provës kopje të vendimit gjyqësor penal me kërkesë të përfaqësuesit të ndërgjyqësve paditës dhe për të plotësuar kërkesat e nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile. Në vendim subjekti ka pranuar dhe kërkesën për ekzekutim të përkohshëm të vendimit për palën paditëse V.H.

Nga analizimi i vendimit nr. ***, datë 19.6.2020, pa analizuar themelin e çështjes, konstatohet se nga ana e subjektit nuk është argumentuar dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, pasi objekti i padisë nuk klasifikohet në një nga rastet e parashikuara nga neni 317¹³⁹, si dhe nuk plotësohen kriteret e parashikuara nga ky nen në paragrafin e dytë.

91.3. Në përfundim, subjektit i kaloi barra e provës, si vijon:

- i. Subjekti nuk ka argumentuar vendimin nr. ***, datë 19.6.2020, për sa i përket dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm.
- ii. Subjekti nuk ka vepruar sipas dispozitave të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, përkatësisht nenet 8-12 dhe 19-21, duke tërhequr dosjen gjyqësore në cilësinë e provave për palën paditëse, për rrjedhojë ka cenuar parimin e kontradiktoritetit.
- iii. Tërheqja e provave nga ana e gjykatës ka bërë të pamundur vendosjen në dispozicion të këtyre provave palëve në proces, pasi, bazuar në parimin e kontradiktoritetit janë palët ato që paraqesin provat, duke ia bërë të njohura njëra-tjetrës.
- iv. Ekspertët H.G dhe E.J kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit.
- v. Subjekti nuk ka pezulluar gjykimin sipas parashikimeve të nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile në çështjen me palë paditëse G.A, pasi për procesin penal nuk kishte ende një vendim të formës së prerë.

¹³⁹ Vendimi i gjykatës mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, kur është vendosur: (a) detyrimi për ushqim; (b) shpërblimi nga puna; (c) rivendosja në posedimin e banesës bashkëshortore. Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur ose do të vështirësohej së tepërmi. Në këtë rast, gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci.

91.4. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹⁴⁰, ka parashtruar se përmbajtja e nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, duke iu referuar ratios së normës, nuk mund të konsiderohet si dispozitë taksative (pra, me raste të mbyllura), por si dispozitë indikative, orientuese (pra, e hapur dhe rastet që tregohen në të kanë natyrë ilustrative).

91.5. Në lidhje me pezullimin e gjykimit, subjekti ka argumentuar se Komisioni nuk mund të japë vlerësime lidhur me çështjen se a kanë qenë apo jo të mjaftueshme faktet juridike, mbi të cilat gjyqtari ka dhënë vendimin gjyqësor përfundimtar. Po ashtu, nuk mund të japë vlerësim lidhur me çështjet se në çfarë kohe dhe në cilën mënyrë duhet t'i merrte gjykata këto fakte juridike, drejtpërdrejt apo përmes veprimtarisë së një organi tjetër shtetëror, sikurse është prokuroria. Këto çështje kanë të bëjnë me mënyrën se si e ka planifikuar, organizuar dhe zbatuar gjykata hetimin gjyqësor të çështjes dhe, për rrjedhojë, kanë të bëjnë me procesin e formimit të bindjes së brendshme të gjyqtarit, të krijuar nga interpretimi i fakteve dhe interpretimi i ligjit që ai vlerëson, në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar nga askush dhe për asnjë arsye, se kanë rëndësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Me interpretim gjuhësor vihet re qartësisht se në shkronjën “a” të nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile, përdoret folja “mund”. Kjo folje nënkupton diskrecionalitet, liri zgjedhjeje të gjykatës, hapësirë vlerësimi nga ana e saj të karakterit të çështjes, në mënyrë që të vendosë nëse duhet apo jo të bëhet pezullimi i gjykimit. Duke pasur këtë natyrë diskreciale, hapësira e vlerësimit të gjykatës, nëse çështja duhet apo jo të pezullohet derisa të zgjidhet çështja penale, është çështje e bindjes së brendshme të gjyqtarit, të cilën ai e krijon nga vlerësimi i rrethanave të çështjes.

91.6. Subjekti nuk bie dakord me konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit se “ekspertët H. G dhe E.J kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit”. Ai vlerëson se fakti që ekspertët kanë pasur më parë marrëdhënie juridike me palën e paditur, që ka përfunduar kohë më parë nga koha kur është zhvilluar gjykimi, nuk përbën ndonjë arsye ligjore për ta konsideruar ekspertin në konflikt interesi apo në armiqësi me palën e paditur. Përkundrazi, që eksperti i caktuar nga gjykata të “konsiderohet i njëanshëm” duhet që ai të jetë në raport me palët ndërgjyqëse, në po ato rrethana fakti që parashikohen në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile (njësoj sikurse gjyqtari) dhe/apo në rrethanat e faktit që parashikohen në nenet 3 dhe 5 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Gjukata nuk konstatoi që ekspertët në fjalë të kenë në raport me palën e paditur po ato rrethana fakti që parashikohen si konflikt interesi në këto dispozita ligjore.

91.7. Lidhur me provat e marra nga gjykata, kryesisht, por mbi bazën e kërkesës së palëve, sikurse ka ndodhur në rastin objekt analize, subjekti ka pretenduar se gjykata ka detyrim pasiv dhe jo aktiv për t'u mundësuar palëve njohjen me provat e marra kryesisht. Në rastin konkret, gjykata nuk ka penguar asnjëherë palë në këtë drejtim. Madje, pala e paditur është njohur me këto prova, duke marrë kopje të tyre përmes fotografimit (gjë për të cilën ajo ka dhënë vetë pëlqim).

91.8. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

i) Subjekti pretendon se neni 317 i Kodit të Procedurës Civile nuk është shterues, por orientues. Ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi neni 317 i këtij Kodi është shterues për sa u përket rasteve kur jemi përpara aplikimit të ekzekutimit të përkohshëm. Duke specifikuar të tria rastet dhe, më pas, në paragrafin e dytë, ky nen i jep diskrecion gjykatës për të marrë vendim në bazë të kriterëve të përcaktuara. Rastet e përcaktuara në germet “a”, “b” dhe “c” janë shteruese dhe

¹⁴⁰ Për më shumë referohuni prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

nuk mund të konsiderohen si orientuese, sikundër pretendon subjekti, pasi në këtë rast nuk do të kishte kuptim paragrafi i dytë i këtij neni, që përcakton kriteret në vlerësim të gjykatës për të vendosur edhe në raste të tjera dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

ii) Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni ka trajtuar themelin e çështjes (pretendim i ngritur vazhdimisht nga subjekti dhe është trajtuar gjerësisht më lart), vlerësohet se ky pretendim nuk qëndron. Komisioni, jo vetëm që nuk ka trajtuar themelin e çështjes, por as nuk ka interpretuar nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit, pasi nga ana e tij nuk është zbatuar neni 317 i Kodit të Procedurës Civile.

Në vendim, subjekti fillimisht deklaroi se dëmshpërblimi i palës paditëse lidhet me të drejtën për punë të saj¹⁴¹, më pas subjekti pretendon se jemi në kushtet e paragrafit të dytë të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile¹⁴² dhe në fund këtë dëmshpërblim e trajton në lidhje me të drejtën për ushqim¹⁴³, duke e bërë të paqartë, për rrjedhojë të paargumentuar vendimin e tij në lidhje me pranimin e kërkesës për ekzekutim të përkohshëm të vendimit gjyqësor.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

iii) Subjekti ka pretenduar se provat e marra prej tij janë marrë bazuar në kërkesën e palëve. Ky pretendim nuk qëndron, pasi në nenin 223 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që nuk merr pjesë në çështje, të paraqesë në gjykim një dokument ose një send tjetër, kur çmohet e nevojshme prej saj. Pra, në këtë nen nuk parashikohet që vetë gjykata të administrojë provat kryesisht, por urdhëron palën ose një person të tretë, duke mos cenuar në këtë mënyrë parimin e kontradiktoritetit.

Bazuar në procesverbalin e seancës të datës 25.2.2020 në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse G.A, konstatohet se subjekti ka urdhëruar sekretaren për të tërhequr fashikullin origjinal penal tek një gjyqtar tjetër, si dhe e ka administruar si provë pa u paraqitur kërkesë nga palët. Në rastin e gjykimit të çështjes me palë paditëse shtetasen V.H etj., në vendim subjekti shprehet se ka tërhequr në cilësinë e provës kopje të vendimit gjyqësor penal me kërkesë të përfaqësuesit të ndërgjyqësve paditës dhe për të plotësuar kërkesat e nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile.

Në të dyja këto raste subjekti nuk ka zbatuar nenin 223 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nuk ka vepruar sipas dispozitave të parashikuara nga ky Kod, përkatësisht nenet 8-12 dhe 19-21, pasi ka tërhequr dosje gjyqësore në cilësinë e provave për palën paditëse, për rrjedhojë ka cenuar parimin e kontradiktoritetit. Tërheqja e provave nga ana e gjykatës ka bërë të pamundur vendosjen në dispozicion të këtyre provave palëve në proces, ndërkohë që janë palët ato që paraqesin provat, duke ia bërë të njohura njëra-tjetrës. Subjekti pretendoi se pala e paditur ishte njohur me këto prova, por nuk vuri në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues.

Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016 dhe në aspektin e njohurive organizative parashikuar nga neni 74, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, pasi ka cenuar të drejtat e palëve, duke mos zbatuar parimin e kontradiktoritetit.

iv) Në lidhje me pezullimin e vendimit, subjekti, në vendimin nr. **/2020, në faqen 4 të tij¹⁴⁴, shprehet se vendimi gjyqësor penal i formës së prerë është detyrues dhe për këtë gjykatë, bazuar

¹⁴¹ Shihni f. 41 të vendimit nr. **/2020, paragrafi i fundit.

¹⁴² Shihni f. 41 të vendimit nr. **/2020, fjalia e fundit dhe paragrafi i parë në f. 42.

¹⁴³ Shihni f. 42 të vendimit nr. **/2020, paragrafi i fundit dhe f. 43, paragrafi i parë dhe i dytë.

¹⁴⁴ Shihni paragrafin e dytë në këtë faqe.

në nenin 70/1 të Kodit të Procedurës Penale, ndërkohë ai në të gjitha parashtrimet e tij, përfshirë edhe në rastin objekt vlerësimi, është shprehur se është në diskrecion të gjykatës pezullimi ose jo i procesit¹⁴⁵.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se, për sa kohë subjekti ka përdorur akte të fashikullit penal në procesin e tij civil, ai nuk mund të vijonte gjykimin e kësaj çështjeje derisa të përfundonte procedimi penal.

Këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

92. Denoncim nr. * prot., datë 17.6.2019, i B.F.P.F “Z.N”**

92.1. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështjen gjyqësore ku bashkësia fetare ka pasur cilësinë e paditësit, në kushtet e konfliktit të interesit. Në gjykimin e kësaj çështjeje me objekt “njohjen pronar të paditësit” gjyqtari ka lejuar pjesëmarrjen në proces gjyqësor në cilësinë e ndërhyrësit dytësor të shtetasve L dhe P.L, me arsyetimin se këta shtetas kanë pasur interes për një kontratë të lidhur me të paditurin Bashkia Shkodër.

92.2. Denoncuesi pretendon se subjekti ka pasur njohje të mëparshme me ndërhyrësin L.L, i cili është përfaqësues i shoqërisë “** C” sh.p.k., që ka ndërtuar një pallat në kufi me pronën objekt gjykimi. Në këtë pallat, kjo shoqëri i ka shitur një apartament në katin e katërt babait të gjyqtarit, z. F.Y, dhe në këtë pallat banon prej vitesh gjyqtari Andri Ymeri. Dokumentacioni që lidhet me këtë pronë ndodhet pranë noteres O.K, pranë ZVRPP-së Shkodër dhe ILDKPKI-së dhe daton në prill të vitit 2007. Denoncuesi shprehet se gjyqtari jo vetëm ka pranuar në mënyrë të kundërligjshme ndërhyrësin dytësor, edhe pse nuk kishte lidhje me çështjen objekt gjykimi, por ka gjykuar duke pasur një konflikt të pastër interesi dhe për shkak të këtij konflikti ka marrë vendim në kundërshtim me ligjin.

92.3. Në lidhje me këtë ankim Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit.

92.4. Subjekti ka parashtruar se shkaqet e kësaj ankese janë trajtuar edhe në rrugën e juridiksionit gjyqësor penal dhe janë hedhur poshtë me vendim gjyqësor penal të formës së prerë. Subjekti ka përfunduar subjekti mbrojtjen në këtë pikë se: *“Të gjitha këto vendime gjyqësore i keni në praktikën mbi bazën e së cilës është përgatitur raporti mbi rezultatet e hetimit administrativ. Lidhur me marrëdhëniet e mia me shtetasin L.L, jam shprehur në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, që i kam dërguar Komisionit. Këtyre deklarimeve unë i qëndroj dhe nuk kam gfarë t'i shtoj”*.

92.5. Komisioni konstaton se subjekti nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, pasi apartamenti është blerë në vitin 2006, ndërkohë që çështja gjyqësore është gjykuar në vitin 2016.

93. Denoncim nr. * prot., datë 18.12.2019, i B.Sh.të S**

93.1. Denoncuesi pretendon se është përballur me një shkelje të hapur të ligjit, pasi e njëjta çështje gjyqësore po zhvillohet në dy gjykata të ndryshme. Ai sqaron se paditësi F. N ka paditur B.Sh të S në padinë me objekt “shpërblim dëmi”. Gjatë gjykimit të çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë kryer të gjitha veprimet përgatitore, si dhe është caktuar eksperti mjekoligjor. Në seancën ku eksperti do të dorëzonte aktin e ekspertimit, përfaqësuesi i palës paditëse paraqiti kërkesën për pushim pa dhënë ndonjë shkak të ligjshëm dhe pa u paraqitur në seancë. Kjo kërkesë është kundërshtuar nga i padituri/denoncuesi, sepse është paraqitur pasi është dorëzuar deklarata e mbrojtjes nga pala e paditur. Me vendimin e datës 18.10.2019

¹⁴⁵ Shihni f. 197 e në vijim të parashtrimeve të subjektit me emërtim “Memo-KPK-Shkodra” dhe f. 173 e në vijim të parashtrimeve të subjektit me emërtim “Memo për raportin e vlerësimit nëntor 2022”.

gjykata ka vendosur pushimin e çështjes sipas kërkesës së palës paditëse. Kundër këtij vendimi denoncuesi ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Më pas, pala paditëse ka ngritur padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe aktualisht çështja është duke u gjykuar nga subjekti. Denoncuesi pretendon se gjyqtari ka shkelur hapur ligjin, pasi në kundërshtim me nenin 58 të Kodit të Procedurës Civile ka pranuar të vijojë gjykimin e kësaj çështjeje, pavarësisht se është vënë në dijeni nga i padituri se kjo çështje me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt e bazë ligjore po gjykohej pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

93.2. Komisioni, pasi analizoi ankesën, i kaloi barrën e provës subjektit, pasi dukej se ai kishte vepruar në kundërshtim me nenin 58 të Kodit të Procedurës Civile, duke vijuar gjykimin e një çështjeje, e cila po gjykohej nga një gjykatë më e lartë.

93.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹⁴⁶, ka shpjeguar se çështja është ende në pritje të gjykimit në Gjykatën e Apelit Shkodër. Sipas neneve 3 dhe 102/2, germa “a” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 36, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Civile, asnjë institucion shtetëror nuk mund të shprehet për meritat, themelin e çështjes, përpara se të shprehet gjykata kompetente, ka parashtruar subjekti, pasi çdo veprim në të kundërt vlerëson se cenon pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

93.4. Subjekti ka ngritur pretendimin se: *“Komisioni më ngarkon barrë prove për të vërtetuar se çështja nuk ka qenë në kushtet e litispendencës, sipas nenit 58 të Kodit të Procedurës Civile. Lidhur me këtë barrë prove unë nuk kam për të thënë asgjë më shumë se sa kam thënë në vetë vendimin e dhënë prej meje”*. Më tej, subjekti ka cituar pjesën në fjalë të arsytimit të vendimit: *“Në lidhje me këtë prapësim, gjykata, me kërkesën e përfaqësuesit të palës së paditur, administroi si provë, vendimin e lartpërmendur të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, një kopje të ankimit që ka bërë pala e paditur ndaj këtij vendimi, si dhe një vërtetim nga Gjykata e Apelit Tiranë, se çështja është në pritje të gjykimit në këtë Gjykatë. Në lidhje me këtë prapësim, gjykata vlerëson se ai është i pabazuar. Kjo pasi nga këqyrja e ankimit që pala e paditur ka paraqitur në Gjykatën e Apelit Tiranë, vihet re qartë se pala e paditur nuk ka pretenduar përmes tij shkeljen prej vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, objekt ankimi të ndonjë të drejte materiale konkrete, që të pretendohet nga pala e paditur ankimuese, që t’i përkasë asaj. Ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë është paraqitur pasi, sipas palës së paditur, është vendosur pushimi i gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndonëse pala e paditur ka paraqitur deklaratën e mbrojtjes, por pa treguar ndonjë shkak të ligjshëm apo arsye materiale fakti, se përse pala e paditur nuk ka qenë dakord me heqjen dorë nga gjykimi i padisë, nga paditësit. Sipas vlerësimit të gjykatës që po shprehet përmes këtij vendimi, në rastin në gjykim, duket qartë se ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk ka shkak të ligjshëm, dhe është depozituar vetëm me synim që në të ardhmen të tentohet për t’u përdorur thjesht si instrument pengues për ndërgjyqësit paditës, për paraqitjen e një padie të re. Kjo bindje i krijohet gjykatës pasi është parim i njohur i të drejtës që ‘nuk mund të përdoret një e drejtë procedurale, pa qenë nevoja për të njohur apo mbrojtur një të drejtë materiale. Në rastin objekt gjykimi, ankimi gjyqësor në fjalë, referuar përmbajtjes së tij, është në vlerësimin e kësaj gjykate, asgjë tjetër veçse ‘përdorim abuziv i të drejtës së mbrojtjes’ nga pala e paditur, me qëllim për t’ia vështirësuar ndërgjyqësve paditës realizimin e të drejtave të tyre dëmshpërblimore. Sipas nenit 100 të Kodit të Procedurës Civile ‘Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë detyrimin që gjatë procesit gjyqësor të sillen me mirëbesim dhe ndershmëri’. Gjykata që po shprehet përmes këtij vendimi, vlerëson se si paraqitja e ankimit të lartpërmendur në Gjykatën e Apelit Tiranë, ashtu edhe ngritja e prapësimit që përbën objektin e kësaj pjese të*

¹⁴⁶ Për më shumë, referohuni prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

arsyetimit të vendimit, lidhur me litispendencën ndërmjet çështjes që është për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, me çështjen që është për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk janë gjë tjetër, veçse 'shkelje nga pala e paditur të nenit 100 të Kodit të Procedurës Civile, që përcakton detyrimin e palëve për të qenë të ndershëm në gjykim'. Kjo pasi paraqitja e një ankimi, dukshëm pa shkak ligjor në Gjykatën e Apelit Tiranë nga pala e paditur, pra pa pretenduar kjo palë ndonjë shkak të ligjshëm material se përse është cenuar nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë objekt ankimi, tregon qartë se pala e paditur nuk ka qenë e ndershme në përdorimin e mjetit procedural ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe as është e ndershme në ngritjen e prapësimit që përbën objektin e analizës në këtë pjesë të arsyetimit të vendimit... Gjykata vlerëson se, pavarësisht se nuk përfshihet në detyrimin e saj funksional, lëndor dhe tokësor kompetenca për t'u shprehur për drejtësinë dhe bazueshmërinë e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i shërben gjykimit të çështjes, për të evidentuar faktin se 'pushimi i gjykimit' i disponuar nga ajo Gjykatë i referohet nenit 201, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, dhe, në thelbin e tij, është vendimmarrje diskrecionale e asaj gjykate”.

93.5. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, vlerëson se subjekti gjatë gjithë parashtrimeve të tij në lidhje me vlerësimin profesional, shprehet se asnjë institucion shtetëror nuk mund të shprehet për meritat, themelin e çështjes, përpara se të shprehet gjykata kompetente. Kjo, pasi çdo veprim në të kundërt vlerëson se cenon pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Ndërkohë, nga ana e tij në këtë vendim gjyqësor është analizuar ankimi i paraqitur nga pala në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra që nuk ka qenë në kompetencë të subjektit për t'u analizuar.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka vijuar gjykimin e kësaj çështjeje në kundërshtim me nenin 58 të Kodit të Procedurës Civile¹⁴⁷, duke shqyrtuar një çështje e cila ishte duke u gjykuar në një gjykatë më të lartë.

Këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor në kuptim të nenit 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

94. Denoncim nr. *prot., datë 3.10.2022, i OSHEE-së**

94.1. Denoncuesi pretendon se subjekti ka vendosur që vendimi i tij të jepet me ekzekutim të përkohshëm në shkelje të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile.

94.2. Nga analizimi i ankesës konstatohet se objekti i padisë ka qenë dëmshpërblim dëmi, i cili nuk klasifikohet në objektin e padive të përfshira në nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile, për rrjedhojë dukej se subjekti nuk ka argumentuar vendimin për sa i përket dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

94.3. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹⁴⁸, ka shpjeguar se: “Së pari, lidhur me konstatimin dhe vlerësimin e Komisionit se ‘objekti i padisë ka qenë dëmshpërblim dëmi, i cili nuk klasifikohet në objektpaditë e përfshira në nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile’, është e qartë se Komisioni bën një interpretim të ndryshëm të përmbajtjes së kësaj norme. Kjo mënyrë e kuptimit dhe interpretimit të normës juridike, duke bërë interpretim pajtues të tekstit të saj, me ration e përmbajtjes së saj, nuk është thjesht e imja, në kuptim të këtij lloj interpretimi... ILD-ja shprehet, ndër të tjera, se mospëlqimi ndaj

¹⁴⁷ Kur në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak e të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë.

¹⁴⁸ Për më shumë, referohuni prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

vendimmarrjeve të gjyqtarëve lidhur me këtë tematikë mund të adresohet vetëm në rrugën e ankimit gjyqësor në gjykatat më të larta dhe jo përmes ankesave me natyrë disiplinore. Kjo pasi, në të kundërt, kapërcehen kompetencat e ILD-së, si dhe cenohet pavarësia e pushtetit gjyqësor, e parashikuar në nenin 3 të ligjit nr. 96/2016”. Subjekti në prapësime ka përfshirë pjesën argumentuese të vendimit të tij.

94.4. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, përfshirë edhe ato në seancë dëgjimore, si dhe provat e paraqitura prej tij gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, konstaton se subjekti ka depozituar një vendim të ILD-së, duke pretenduar se ajo ka trajtuar ankesat në lidhje me aplikimin e nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë vendim me nr. ***prot., datë 20.9.2022, të ILD-së, në faqen 10, shprehet se në rast konstatimi nga kontrolli gjyqësor të shkeljeve të ligjit procedural dhe material ato mund të jenë objekt shqyrtimi i mëtejshëm nga ana e ILD-së.

Komisioni, në lidhje me aplikimin e nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, mban të njëjtin qëndrim si më lartë.

94.5. Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni ka trajtuar themelin e çështjes, vlerësohet se Komisioni jo vetëm që nuk ka trajtuar themelin e çështjes, por as nuk ka interpretuar nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit, pasi nga ana e tij nuk është zbatuar neni 317 i Kodit të Procedurës Civile.

Në vendim, subjekti fillimisht deklaroi se: (i) dëmshpërblimi i palës paditëse konsiderohet si shpërblim nga puna që i jepet punëdhënësi punëmarrësit¹⁴⁹; (ii) me pas këtë dëmshpërblim e trajton në lidhje me të drejtën për ushqim¹⁵⁰; (iii) subjekti vijon argumentimin e tij duke deklaruar se shpërblimet për varrim klasifikohen si e drejtë e përfitimit të shpërblimit nga puna dhe e detyrimit ushqimor¹⁵¹; dhe në fund (iv) subjekti deklaroi se për pjesën tjetër të padisë ajo përfshihet në paragrafin e dytë të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, duke e bërë të paqartë, për rrjedhojë të paargumentuar vendimin e tij në lidhje me pranimin e kërkesës për ekzekutim të përkohshëm të vendimit gjyqësor, pasi nga ana e tij për çdo rast, përfshirë dhe shpenzimet e varrimit, ai konsideron se përfshihen në nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

95. Në lidhje me marrëdhënien shoqërore dhe familjare të subjektit me avokatin L. K

95.1. Nga hetimi i Komisionit në lidhje me figurën¹⁵² janë ngritur dyshime që subjekti i rivlerësimit ka bashkëpunuar me shtetasin L.K (gjatë kohës që ky ka ushtruar/ushtron detyrën e avokatit), të cilin e ka pasur shok shkolle.

Në lidhje me këto të dhëna, Komisioni ka kryer një hetim për sa i përket marrëdhënies midis subjektit dhe shtetasit L.K.

95.2. Nga hetimi ka rezultuar si vijon:

- i. Subjekti në pyetësorin standard ka deklaruar se në datën 3.1.2012, me sa mban mend, kur është kthyer nga pushimet e vitit të ri, e ka marrë me veturë një shok shkolle i tij, që quhet L.K, që ndodhej në Mal të Zi dhe është kthyer në Shkodër.

¹⁴⁹ Shihni paragrafin 12.1 të vendimit nr. 144, datë 19.9.2022.

¹⁵⁰ Shihni paragrafin 12.2 të vendimit nr. 144/2022.

¹⁵¹ Shihni paragrafin 12.3 të vendimit nr. 144/2022.

¹⁵² Shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

- ii. Nga verifikimi i sistemit TIMS është konstatuar se subjekti dhe shtetasi L.K kanë udhëtuar së bashku më shumë se një herë dhe në disa raste prezente ka qenë edhe bashkëshortja e subjektit:
- në datën 2.2.2007 subjekti ka dalë së bashku me shtetasin L.K me automjetin me targa TR *** G (i cili ka qenë në pronësi të z. K) nga pika kufitare Murriqan dhe ka hyrë në po të njëjtën datë me këtë shtetas;
 - në datën 30.3.2008 subjekti ka dalë së bashku me shtetasin L.K me automjetin me targa TR *** G nga pika kufitare Murriqan dhe ka hyrë në po të njëjtën datë me këtë shtetas;
 - në datën 29.11.2009 subjekti ka dalë së bashku me shtetasin L.K me automjetin me targa U** *** tip furgon nga pika kufitare Hani i Hotit, ka hyrë në datën 1.12.2009 me këtë shtetas;
 - në datën 27.11.2010 subjekti ka dalë së bashku me shtetasin L.K me automjetin me targa SH *** E (i cili ka qenë në pronësi të z. K) nga pika kufitare e Morinës;
 - në datën 26.11.2011 subjekti ka dalë së bashku me shtetasin L.K me automjetin me targa SH ***E nga pika kufitare Murriqan. Në këtë udhëtim subjekti ka qenë i shoqëruar edhe nga bashkëshortja e tij;
 - në datën 10.11.2013 subjekti ka hyrë së bashku me shtetasin L.K me automjetin me targa SH *** E nga pika kufitare Hani i Hotit.

Siç konstatohet më lart, rezulton se subjekti ka udhëtuar disa herë me z. K në vite të ndryshme, ku në dy udhëtime ka qenë e pranishme edhe bashkëshortja e tij. Referuar këtyre udhëtimeve, si dhe deklaramentit të subjektit se z. K e ka pasur në shkollë, konstatohet një marrëdhënie shoqërore dhe familjare e subjektit me shtetasin L.K, e shtrirë në kohë.

- iii. Bazuar në të dhënat e mësipërme, Komisioni i ka kërkuar informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me çështjet e gjykuara nga subjekti, ku përfaqësues i palëve apo palë ka qenë shtetasi L.K.

Në aneksin 2 të rezultateve të hetimit gjendet lista e çështjeve¹⁵³ për periudhën 2006 deri aktualisht, të gjykuara nga subjekti Andri Ymeri, ku si përfaqësues i palëve në gjykim rezulton shtetasi L.K. Subjekti në total ka gjykuar 122 çështje gjyqësore me shtetasin L.K si përfaqësues i palëve në gjykim. Ky aneks iu vu në dispozicion subjektit, së bashku me rezultatet e hetimit.

95.3. Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, me dyshimin se ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, duke gjykuar çështjet e mësipërme gjyqësore, ku si përfaqësues i palës ka qenë shtetasi L.K, me të cilin ka pasur marrëdhënie shoqërore dhe familjare.

95.4. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur¹⁵⁴, ka shpjeguar se shtetasi L.K, për periudhën për të cilën bëhet fjalë, nuk ka ushtruar profesionin e avokatit, por ka qenë drejtor i degës Shkodër të Entit Kombëtar të Banesave. Konkretisht (sikurse rezulton nga shkesa nr. *** prot., datë 2.6.2006 e drejtorit të përgjithshëm të EKB-së), ai e ka filluar këtë detyrë në datën 2.6.2006 dhe e ka përfunduar në datën 24.10.2014 (shkresa *** prot., datë 24.10.2014), të cilat i ka depozituar si prova.

95.5. Më tej, subjekti ka shpjeguar¹⁵⁵: *“Të jesh shok shkolle nuk presupozon automatikisht lidhje shoqërore dhe aq më pak lidhje familjare, sikurse supozohet nga Komisioni. Fakti që shtetasi L.K më ka hedhur me makinë nga një vend në tjetrin = transportuar me makinë, nuk*

¹⁵³ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.8.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

¹⁵⁴ Për më shumë, referohuni prapësimeve dhe provat të depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

¹⁵⁵ Komisioni ka vlerësuar të përfshijë në këtë vendim shpjegimet e subjektit të thëna nga ai në vetë të parë.

është gjë tjetër veçse një sjellje e mirëkuptueshme mirësjelljeje njerëzore nga ana e tij. Këto 6 udhëtime mbulojnë fashën kohore 2007-2012. Pas vitit 2008 kam udhëtuar në dy raste me shtetasin L.K, së bashku me bashkëshorten time. Kjo tregon një lidhje familjare me këtë shtetas në kohën kur kam gjykuar çështjet e babait të tij dhe/apo çështjet ku shtetasi L.K ka qenë avokat për vitet 2004 - 2006! Por, në vitet 2004 - 2006 unë kam qenë beqar dhe as e njihja bashkëshorten time. Pra, si mund të kisha lidhje familjare për këtë periudhë kohe me këtë shtetas në vitet 2004 - 2006?! Ndër 122 çështjet që numëron Komisioni se kam gjykuar gjithsej me shtetasin L.K për vitet 2004 - 2022, 47 çështje i përkasin periudhës 2004 - 2006, kohë në të cilën kam qenë beqar.

Pra, për sa u përket këtyre 47 çështjeve, 'lidhja familjare' e supozuar përjashtohet haptazi, meqenëse kam qenë beqar. Për vitet 2007 - 2013, në çështjet që kam gjykuar (përveç dy-tri çështjeve që ka përfaqësuar babain e tij), shtetasi L.K ka qenë përfaqësues i Entit Kombëtar të Banesave në 14 çështje. Pra, ndër 122 çështjet që numëron Komisioni se kam gjykuar gjithsej me shtetasin L.K për vitet 2004-2022, në 14 çështje ai ka qenë përfaqësues i një institucioni shtetëror dhe këto gjykime ose 1) kanë përfunduar me pushim gjykimi ose 2) ka fituar institucioni shtetëror. Pra, interesi personal në këtë tip rastesh nuk mund të ekzistojë. Për periudhën pas vitit 2013, - a ka ndonjë logjikë mbi të cilën të mund të supozohet se, meqenëse shtetasi L.K më paska transportuar me makinë nga Shkodra për në Mal të Zi (distanca rreth 20/30 km), unë ta kem favorizuar në gjykime të ndryshme, që në pjesën më të madhe janë gjykime pa sensibilitet publik të lartë, pasi janë gjykime: (1) për njohje vjetërsie në punë për efekt përfitimi pensioni pleqërie; ose (2) gjykime në të cilat unë e kam caktuar kryesisht shtetasin L.K si avokat mbrojtës dhe gjithmonë kam vendosur caktimin e masës së sigurimit arrest në burg ose e kam dënua të pandehurin.

Komisioni në përdorimin e togfjalëshit 'duket se është në konflikt interesi për 122 çështje ku ka marrë pjesë si përfaqësues shtetasi L.K' nuk bën asnjë referencë në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe nuk bën asnjë lloj cilësimi nëse kemi të bëjmë me konflikt faktik interesi, konflikt në dukje interesi, konflikt të mundshëm interesi apo konflikt të vazhdueshëm interesi. Po ashtu, nuk bën individualizim të saktë të momentit se ku ushtrimi i detyrës sime si gjyqtar, është pikëprerë në mënyrë të paligjshme apo që duket se është e paligjshme, me favorizimin e avokatit L.K".

95.6. Subjekti pretendon se 111 vendime, të cilat kanë marrë formë të prerë dhe ku përfaqësues i palëve ka qenë shtetasi L.K, nuk mund të konsiderohen nga Komisioni si shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj tij, pasi përbëjnë gjë të gjykuar.

95.7. Në funksion të mbrojtjes së tij, subjekti ka kërkuar:

- i) të thirren si dëshmitarë R.I, L.K, S.B, A.P, S.D, Y.R, I.K, M.R, D.P, G.S, R.S, B.Rr, E. K, G.D, M.D, çdo avokat në Dhomën e Avokatisë Shkodër, çdo prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- ii) pezullimin e procesit të tij të rivlerësimit deri në përfundimin e 8 çështjeve, të cilat ndodhen në gjykatat më të larta që presin radhën për gjykim;
- iii) të thirret shtetasi L.K si person i tretë në procedimin administrativ referuar nenit 192, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile;
- iv) që Komisioni të referohet në raste të ngjashme që lidhen me vendimin nr. 26/2018 të Komisionit.

95.8. Komisioni, pasi shqyrtoi kërkesat e subjektit, vendosi të mos i pranojë ato, duke njoftuar për këtë edhe subjektin, me arsyetimin:

- i) Për sa i përket kërkesës për thirrjen e dëshmitarëve, ajo vlerësohet e panevojshme, bazuar në nenin 49/6, germa "a", kjo kërkesë është bërë me qëllim zvarritjen e gjykimit, për sa kohë

subjekti nuk ka vendosur një listë shteruese të dëshmitarëve që kërkon të thirren, si dhe përpiket të provojë me dëshmitarë fakte që rezultojnë të provuara gjatë gjyqimit. Në rastin e subjektit ka rezultuar e provuar se ai ka gjykuar 112 çështje me shtetasin L.K me të cilin ka udhëtuar disa herë në vite të ndryshme, ku në dy udhëtime prezente ka qenë edhe bashkëshortja e tij.

ii) Në lidhje me kërkesën për pezullim Komisioni vlerëson se ajo nuk është e mbështetur në ligj dhe në prova. Kolegji¹⁵⁶ ka një jurisprudencë të konsoliduar në lidhje me këtë çështje, në vendimin nr. 28/2020 shprehet se: *“Në një qëndrim të konsoliduar tashmë, Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: ‘[...] Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë’. Në këto rrethana, çështja gjyqësore e analizuar ka përfunduar shqyrtimin e saj prej subjektit të rivlerësimit, i cili është shprehur me vendimin përfundimtar për zgjidhjen e saj, dhe qenia e saj e varur para Gjykatës së Lartë, në pritje të një gjykimi atje, nuk e bën këtë çështje ‘nën shqyrtim’, në kuptim të parashikimit të nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, për pasojë Komisioni ka qenë i legjitimuar të analizojë e vlerësojë edhe këtë çështje në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit”*.

iii) Në lidhje me kërkesën për thirrjen si person i tretë të shtetasit L.K, Komisioni vlerëson se nuk është në përputhje me ligjin, pasi procesi i rivlerësimit është një proces i cili i përket vetëm subjektit të rivlerësimit dhe nuk prodhon pasoja për palë të treta apo vendimet e dhëna nga subjekti¹⁵⁷.

iv) Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka bërë referencë në ligjin për konfliktin e interesit, Komisioni vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk qëndron për sa kohë që barra e provës rezulton e qartë.

95.9. Në lidhje me pretendimet e tjera të subjektit për mungesën e konfliktit të interesit, Komisioni vlerëson se ato nuk janë të bazuara, pasi siç ka rezultuar nga hetimi, subjekti ka kryer udhëtime të vazhdueshme me shtetasin L.K, si dhe ka gjykuar çështje gjyqësore me këtë shtetas. Në të gjitha çështjet gjyqësore nga ana e subjektit në asnjërën prej tyre nuk është vendosur rrëzimi i padisë, por ky fakt nuk lidhet me gjendjen e konfliktit të interesit. Përfundimi i çështjeve gjyqësore nuk e përjashton subjektin e rivlerësimit nga detyrimi ligjor, që ka pasur për heqjen dorë gjykimi i këtyre çështjeve. Për sa i përket faktit që 111 vendime kanë marrë formë të prerë, kjo nuk përbën pengesë për Komisionin për të vlerësuar gjendjen e konfliktit të interesit, bazuar në të dhënat e administruara gjatë hetimit dhe për të cilat palët në gjykim nuk kanë pasur dijeni.

95.10. Në kuptim të nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelit merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit”*, etika në lidhje me situatën e konfliktit të interesit është përfshirë në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 40 dhe 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, procedura e vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit bëhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm. Në këtë drejtim, indikatorin e etikës dhe paanësisë vlerësohet dhe në lidhje me kujdesin e

¹⁵⁶ Shihni vendimet e Kolegjit nr. 7/2019(JR), datë 5.4.2019, nr. 16/2020(JR), datë 13.7.2020 dhe nr. 28/2020.

¹⁵⁷ Pika 3 e nenit E të Aneksit të Kushtetutës.

magjistratit ndaj konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

95.11. Në vlerësimin e kësaj çështjeje, Komisioni mban në konsideratë faktet e mëposhtme të rezultuara nga hetimi:

i) Subjekti ka udhëtuar disa herë me shtetasin L.K, me të cilin ka qenë shok klase vetëm në prani të bashkëshortes ose në prani të rrethit shoqëror, udhëtime këto të shtrira në kohë, kryesisht në raste festash.

ii) Subjekti ka pranuar se z. K ka pasur numrin e tij të telefonit dhe i ka dërguar mesazhe për shtyrjen e seancave, të paktën në një rast të evidentuar.

iii) Subjekti ka gjykuar çështje gjyqësore me palë babain e z. K, ku në njërin prej tyre janë konstatuar dhe gabime thelbësore (të pranuar dhe nga vetë subjekti) dhe serioze.

iv) Në të gjitha çështjet gjyqësore të gjykuara nga ana e subjektit, ku përfaqësues i njërit palë ka qenë z. K (si në kohën kur ka qenë avokat, ashtu dhe kur ka qenë drejtues i EKB-së), nga ana e subjektit në asnjë rast prej tyre nuk është vendosur rrëzimi i padisë, fakt i cili i parë më vete nuk lidhet me gjendjen e konfliktit të interesit.

v) I pyetur në seancë nga vëzhguesi ndërkombëtar, subjekti ka deklaruar se mund të ketë pirë edhe ndonjë kafe me z. K, specifikisht duke iu referuar vitit të fundit ai pretendon se mund të ketë ndodhur një apo dy herë, por nuk e mban mend.

vi) Gjithashtu, për aspekte të ndryshme të marrëdhënies së tij me z. K në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk mundi të deklaronte pothuajse asgjë për shoqërimin e tyre ose kohën e kaluar së bashku në ngjarje shoqërore ose profesionale. Subjekti i rivlerësimit nuk e kundërshtoi faktin që z. K ishte shok shkolle i cili kishte përfaqësuar palët në mbi 100 çështje para subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk i kundërshtoi provat se z. K dhe subjekti i rivlerësimit kishin bërë udhëtime të shumta ndërkufitare në festa dhe raste të tjera, ndonjëherë me anëtarë të familjes të pranishëm. Kur iu kërkuan detaje në lidhje me bisedat e tyre, angazhimin e tyre shoqëror ose detaje bazë për z. K, subjekti i rivlerësimit nuk mundi të jepte pothuajse asnjë informacion, të gjitha në një përpjekje për t'u distancuar nga ky shtetas.

95.12. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 5, pika 1, germa “dh/i” dhe “v” të ligjit nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” për shkak të marrëdhënies së provuar shoqërore dhe familjare me shtetasin L.K. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 17, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, që parashikojnë heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga çështja në zbatim të nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

95.13. Në mbështetje të sa më sipërarzsyetuar, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dështuar që me veprimet e tij të shmangë dyshimin për paanësinë e tij, duke mos paraqitur dorëheqjen nga çështjet e gjykuara prej tij bazuar në nenin 17, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 72/6 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie, duke afektuar kështu indikatorin e parashikuar nga neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/201624, sa i përket kujdesit ndaj konfliktit të interesit. Në kushtet kur janë evidentuar 122 raste të konfliktit të interesit bazuar

edhe në jurisprudencën e Kolegjit¹⁵⁸ me konsideratë rrethanat e çështjes, ky konflikt interesi do të ishte i mjaftueshëm për të afektuar kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

96. Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të konstatuar gjatë kontrollit të figurës

96.1. Komisioni, në dosjet e trajtuara më lart, në kriterin e vlerësimit të figurës ka konstatuar:

- në 41¹⁵⁹ raste mungesë të njoftimit të palëve në gjykim/në dosjen gjyqësore nuk gjendet njoftimi i palëve;
- në 40 raste¹⁶⁰ nuk është respektuar afati i parashikuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile;
- në 6 raste subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit;
- në një rast subjekti ka kryer gabime thelbësore dhe serioze;
- në 5 raste vendimi gjyqësor nuk është i argumentuar.

96.2. Të gjitha këto të meta të konstatuara, përveçse kanë çuar në favorizim të palëve, në kushtet e një hetimi administrativ nuk mund të çmohen për më shumë, si në një proces penal. Gjithsesi, Komisioni i ka vlerësuar për aq sa ligji nr. 84/2016 e lejon, duke i konsideruar si mangësi në: (i) aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016; (ii) aspektin e aftësive organizative, parashikuar nga neni 74, pikat 1, 2, 3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016; si dhe (iii) aspektin e etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016.

Konkluzione përfundimtare të Komisionit për vlerësimin e aftësive profesionale

97. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, dosjeve të administruara gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me kriterin e figurës së subjektit, si dhe denoncimeve të depozituara në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit¹⁶¹, konstaton gabime thelbësore dhe serioze, si dhe ekzistencën e një serie të qartë dhe të vazhdueshme të gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm, pasi ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar në disa raste të drejtat e palëve, si dhe në disa raste ngrihen dyshime për favorizim të palëve në gjykim.

97.1. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit.

97.2. Komisioni konkludon se në vlerësimin e aftësive profesionale subjekti Andri Ymeri është i papërshtatshëm, në kuptim të germës “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë

98. Në vlerësimin tërësor të procedurave lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke vlerësuar në tërësi kriterin e kontrollit të pasurisë, kriterin e figurës, kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuara së bashku e të para në harmoni me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të

¹⁵⁸ Shihni paragrafin 33.3 të vendimit nr. 3/2020, paragrafin 23.9 të vendimit nr. 35/2021 dhe paragrafin 23.13 të vendimit nr. 31/2022.

¹⁵⁹ Përfshihen edhe 38 rastet e aneksit 1 të rezultateve të hetimit.

¹⁶⁰ Përfshihen edhe 38 rastet e aneksit 1 të rezultateve të hetimit.

¹⁶¹ Vendimet nr. 16/2021, nr. 15/2021, nr. 20/2020, nr. 28/2020, nr. 25/2022, nr. 1/2020, nr. 9/2020 dhe nr. 2/2020.

pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i këtij sistemi.

98.1. Komisioni arrin në këtë konkluzion, sepse është vërtetuar që subjekti:

- i) nuk e ka paraqitur deklaratën *Vetting* të saktë dhe të plotë;
- ii) nuk ka justifikuar burimin e ligjshëm për krijimin e disa pasurive;
- iii) nuk ka siguruar dokumentacionin provues për të mbështetur pretendimet e tij për burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të caktuara;
- iv) ka bërë përpjekje për të fshehur ose bërë deklaram të pasaktë të pasurive të zotëruara aktualisht prej tij;
- v) ka marrë vazhdimisht vendime bazuar në një model, që ngre dyshime për paanshmërinë e tij;
- vi) nuk ka ndjekur procedurat e duhura të gjykimit, pasi: (a) nuk ka njoftuar rregullisht palët nga gjykata në mënyrë të vazhdueshme; (b) nuk ka përmbushur afatet ligjore për procedurat gjyqësore; (c) ka proceduar në mënyrë të parregullt me gjykimet civile pa pritur përfundimin e hetimeve përkatëse penale; (d) nuk ka nxjerrë vendime të ndërmjetme kur ishte e nevojshme;
- vii) ka qenë vazhdimisht i gatshëm të gjykonte dhjetëra çështje, pavarësisht nga konflikti i drejtpërdrejtë i interesave;
- viii) në mënyrë jo të besueshme ka pohuar në seancë se nuk kujtonte pothuajse asgjë nga ish-shoku i tij i shkollës, i cili kishte qenë përfaqësues ligjor në mbi 100 çështje para gjykatës dhe me të cilin kishte bërë udhëtime të shumta ndërkufitare gjatë pushimeve dhe rasteve të tjera. Ai bëri përpjekje të shumta të pasinqerta për t'u distancuar nga shoku i tij duke mos kujtuar asgjë për asnjë aspekt të angazhimeve të tyre shoqërore. Kështu, ai pranoi aq sa duhej të pranonte dhe mohoi aq sa mundi – të gjitha në një përpjekje për të errësuar qëllimisht marrëdhënien e tij me shokun e klasës – avokatin – mikun e tij;
- ix) gjatë procesit të rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit dokumentacion të një natyre dhe vlefshmërie të dyshimtë;
- x) nuk ka bashkëpunuar plotësisht gjatë procesit të rivlerësimit dhe ka kërkuar të zvarrisë procesin duke bërë kërkesa të shumta përjashtimi të pabazuara, duke bërë kërkesa të shumta për shtyrjen e seancave dhe duke mos specifikuar kërkesat e tij procedurale në një mënyrë që të lehtësonte shqyrtimin e duhur të kërkesave të tilla. Taktikat e zvarritjes, të cilat përfshinin paraqitjen e kallëzimeve penale kundër të gjithë komisionerëve të Komisionit, pjesë e trupit të tij gjykues, rezultuan në mbajtjen e seancave publike në shtatë raste përpara shpalljes së vendimit.

98.2. Në përmbledhje të sa është konstatuar më sipër për kriterin e kontrollit të pasurisë, kriterin e figurës, kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në analizë të problematikave të konstatuara, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve të rivlerësimit dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e këtij ligji.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, konkludon se:

- i. Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti rezultoi i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.
- iii. Nga vlerësimi tërësor, në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji, rezultoi se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 21.12.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Firdes SHULI
Anëtare

Genta TAFA (BUNGO)
Relatore

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha